



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 144

Tiranë – E martë, 1 nëntor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 71/2022, datë 20.10.2022	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e dytë shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik mbi Bashkëpunimin e Zgjeruar dhe Zbulimin e Provave Elektronike..... 17561
Dekret i Presidentit nr. 13865, datë 25.10.2022	Për shpallje ligji..... 17638
Dekret i Presidentit nr. 13866, datë 27.10.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 17638
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.10.2022	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022–2029..... 17638
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 7.7.2022	Shkëlqim Qosja kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 17475/13</i>)..... 17703
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 28.7.2022	Hasan Buci kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 38924/13</i>)..... 17706
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 2.6.2022	Agonset sh.p.k. kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 33104/15</i>)..... 17708
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 26.9.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 32, datë 1.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 5, datë 8.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar..... 17711



LIGJ
Nr. 71/2022

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E
DYTË SHITESË TË KONVENTËS PËR
KRIMIN KIBERNETIK MBI
BASHKËPUNIMIN E ZGJERUAR DHE
ZBULIMIN E PROVAVE ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin e dytë shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik mbi Bashkëpunimin e Zgjeruar dhe Zbulimin e Provave Elektronike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.10.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13865, datë 25.10.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

www.coe.int/cybercrime

Version i datës 28 maj 2021/redaktuar më 13 tetor 2021 T-CY (2020)7

T-CY(2020)7_PDP_Protocol_v5 (i redaktuar më 13 tetor 2021)

**KOMITETI I KONVENTËS SË KRIMIT
KIBERNETIK (T-CY)
PROTOKOLLI I DYTË SHITESË I
KONVENTËS PËR KRIMIN KIBERNETIK
MBI RITJEN E BASHKËPUNIMIT DHE
ZBULIMIN E PROVAVE ELEKTRONIKE
I MIRATUAR NGA T-CY NË SESIONIN E
TJË TË 24-t PLENAR (28 MAJ 2021)
ME RAPORT SHPJEGUES TË
REDAKTUAR NË TETOR 2021**

Përmbajtja

Protokolli i Dytë Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik mbi Rritjen e Bashkëpunimit dhe Zbulimin e Provave Elektronike

Hyrje

Kreu I – Dispozitat e përbashkëta

Neni 1 – Qëllimi

Neni 2 – Fusha e zbatimit

Neni 3 – Përkufizimet

Neni 4 – Gjuha

Kreu II – Masat për rritjen e bashkëpunimit

Seksioni 1 – Parimet e përgjithshme të zbatueshme për kreun II

Neni 5 – Parimet e përgjithshme të zbatueshme për kreun II

Seksioni 2 – Procedurat për rritjen e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me ofruesit dhe subjektet në Palë të tjera

Neni 6 – Kërkesa për informacion mbi regjistrimin e emrit të domenit

Neni 7 – Zbulimi i informacionit të abonentit

Seksioni 3 – Procedurat që rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet autoriteteve për zbulimin e të dhënave të ruajtura kompjuterike

Neni 8 – Zbatimi i urdhrave nga një Palë tjetër për prodhimin e përshpejtuar të informacionit të abonentit dhe të dhënat e trafikut

Neni 9 – Zbulimi i përshpejtuar i të dhënave të ruajtura kompjuterike në një rast urgjent

Seksioni 4 – Procedurat në lidhje me ndihmën e ndërsjellë në një rast urgjent

Neni 10 – Ndihma e ndërsjellë në rast urgjent



Seksioni 5 – Procedurat në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në mungesë të marrëveshjeve të zbatueshme ndërkombëtare

Neni 11 – Videokonferenca

Neni 12 – Ekipet e përbashkëta hetimore dhe hetimet e përbashkëta

Kreu III – Kushtet dhe garancitë

Neni 13 – Kushtet dhe garancitë

Neni 14 – Mbrojtja e të dhënave personale

Kreu IV – Dispozitat përfundimtare

Neni 15 – Efektet e këtij Protokolli

Neni 16 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Neni 17 – Klauzola federale

Neni 18 – Zbatimi territorial

Neni 19 – Rezervat dhe deklaratat

Neni 20 – Statusi dhe tërheqja e rezervave

Neni 21 – Ndryshimet

Neni 22 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 23 – Konsultimet e Palëve dhe vlerësimi i zbatimit

Neni 24 – Denoncimi

Neni 25 – Njoftimi

Raport shpjegues

Hyrje

Informacion paraprak

Puna përgatitore

Konsideratat materiale

Ky Protokoll

Komentari mbi nenet e këtij Protokolli

Kreu I – Dispozitat e përbashkëta

Neni 1 – Qëllimi

Neni 2 – Fusha e zbatimit

Neni 3 – Përkufizimet

Neni 4 – Gjuha

Kreu II – Masat për rritjen e bashkëpunimit

Seksioni 1 – Parimet e përgjithshme të zbatueshme për kreun II

Neni 5 – Parimet e përgjithshme të zbatueshme për kreun II

Seksioni 2 – Procedurat që rrisin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me ofrues dhe subjekte në Palë të tjera

Neni 6 – Kërkesa për informacion mbi regjistrimin e emrit të domenit

Neni 7 – Zbulimi i informacionit të abonentit

Seksioni 3 – Procedurat që rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet autoriteteve për zbulimin e të dhënave të ruajtura kompjuterike

Neni 8 – Zbatimi i urdhrave nga një Palë tjetër për prodhim të përshpejtuar të informacionit të abonentit dhe të dhënave të trafikut.

Neni 9 – Zbulimi i përshpejtuar i të dhënave të ruajtura kompjuterike në një rast urgjent

Seksioni 4 – Procedurat në lidhje me ndihmën e ndërsjellë në një rast urgjent

Neni 10 – Ndihma e ndërsjellë në një rast urgjent

Seksioni 5 – Procedurat në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në mungesë të marrëveshjeve të zbatueshme ndërkombëtare

Neni 11 – Videokonferenca

Neni 12 – Ekipet e përbashkëta hetimore dhe hetimet e përbashkëta

Kreu III – Kushtet dhe garancitë

Neni 13 – Kushtet dhe garancitë

Neni 14 – Mbrojtja e të dhënave personale

Kreu IV – Dispozitat përfundimtare

Neni 15 – Efektet e këtij Protokolli

Neni 16 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Neni 17 – Klauzola federale

Neni 18 – Zbatimi territorial

Neni 19 – Rezervat dhe deklaratat

Neni 20 – Statusi dhe tërheqja e rezervave

Neni 21 – Ndryshimet

Neni 22 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 23 – Konsultimet e Palëve dhe vlerësimi i zbatimit

Neni 24 – Denoncimi

PROTOKOLLI I DYTË SHITESË I KONVENTËS PËR KRIMIN KIBERNETIK MBI RITJEN E BASHKËPUNIMIT DHE ZBULIMIN E PROVAVE ELEKTRONIKE

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe Shtetet e tjera Palë të Konventës për Krimin Kibernetik (ETS nr. 185, në vijim e referuar si “Konventa”), të hapur për nënshkrim në Budapest, më 23 nëntor 2001, nënshkruar të Konventës,

duke pasur parasysh shtrirjen dhe ndikimin e Konventës në të gjitha rajonet e botës;

duke sjellë në vëmendje se Konventa tashmë është plotësuar nga Protokollin Shtesë, në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobe, të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike (ETS nr. 189), të hapur për



nënshkrim në Strasburg, më 28 janar 2003 (në vijim i referuar si “Protokolli i Parë”) ndërmjet Palëve të atij Protokolli;

duke marrë parasysh traktatet ekzistuese të Këshillit të Evropës për bashkëpunim në çështjet penale, si dhe marrëveshjet dhe masat e tjera për bashkëpunim në çështjet penale ndërmjet Palëve të Konventës;

duke pasur parasysh, gjithashtu, Konventën për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS nr. 108), të ndryshuar nga Protokolli i saj ndryshues (CETS Nr. 223), të hapur për nënshkrim në Strasburg, më 10 tetor 2018 dhe në të cilin çdo shtet mund të ftohet të aderojë;

duke njohur përdorimin në rritje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përfshirë shërbimet e internetit dhe rritjen e krimit kibernetik, i cili është një kërcënim për demokracinë dhe shtetin ligjor dhe që shumë shtete e konsiderojnë kërcënim për të drejtat e njeriut;

gjithashtu, *duke njohur* numrin në rritje të viktimave të krimit kibernetik dhe rëndësinë e vendosjes së drejtësisë për ato viktime;

duke sjellë në vëmendje se qeveritë kanë përgjegjësinë për të mbrojtur shoqërinë dhe individët kundër krimit jo vetëm jashtë rrjetit të internetit, por edhe në internet, përfshirë nëpërmjet hetimeve dhe ndjekjeve penale efektive;

të vetëdijshëm se provat e çdo veprë penale ruhen gjithnjë e më shumë në formë elektronike në sistemet kompjuterike në juridiksione të huaja, të shumëfishta ose të panjohura, dhe të bindur se nevojiten masa shtesë për marrjen e ligjshme të provave të tilla, në mënyrë që të mundësohet një reagim efektiv i drejtësisë penale dhe të mbështetet shteti ligjor;

duke njohur nevojën për bashkëpunim të zgjeruar dhe më efikas ndërmjet shteteve dhe sektorit privat dhe se në këtë kontekst nevojitet qartësi apo siguri më e madhe juridike për ofruesit e shërbimeve dhe subjektet e tjera, në lidhje me rrethanat në të cilat mund t’u përgjigjen kërkesave të drejtpërdrejta nga autoritetet e drejtësisë penale në Palë të tjera për zbulimin e të dhënave elektronike;

si rrjedhojë, *duke synuar* rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit për krimin kibernetik dhe marrjen e provave në formë elektronike të ndonjë veprë penale për qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike përmes mjeteve shtesë që lidhen

me ndihmën e ndërsjellë më efikase dhe formave të tjera të bashkëpunimit ndërmjet autoritetet kompetente; bashkëpunimit në raste urgjente dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë midis autoriteteve kompetente dhe ofruesve të shërbimeve dhe subjekteve të tjera që zotërojnë ose kontrollojnë informacionin përkatës;

të bindur se bashkëpunimi efektiv ndërkufitar, për qëllime të drejtësisë penale, përfshirë ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë, përfiton nga kushtet dhe garancitë efektive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

duke pranuar se marrja e provave elektronike për hetimet penale shpesh lidhet me të dhënat personale dhe duke njohur kërkesën në shumë Palë për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat personale, në mënyrë që të përmbushin detyrimet e tyre kushtetuese dhe ndërkombëtare; dhe

duke pasur parasysh nevojën për të garantuar që masat efektive të drejtësisë penale për krimin kibernetik dhe marrja e provave në formë elektronike u nënshtrohen kushteve dhe garancive, të cilat do të sigurojnë mbrojtjen e duhur të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë të drejtat që burojnë sipas detyrimeve që shtetet kanë ndërmarrë në bazë të instrumenteve të zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të tilla si Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ETS nr. 5), Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike e vitit 1966, Karta Afrikane e vitit 1981 për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, Konventa Amerikane e vitit 1969 për të Drejtat e Njeriut dhe traktate të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut,

kanë rënë dakord si më poshtë.

KREU I

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Protokolli është plotësimi i:

a) Konventës ndërmjet Palëve të këtij Protokolli; dhe

b) Protokolli të Parë ndërmjet Palëve të këtij Protokolli që janë, gjithashtu, Palë të Protokolli të Parë.



Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Përveç kur specifikohet ndryshe këtu, masat e përshkruara në këtë Protokoll do të zbatohen:

a) ndërmjet Palëve të Konventës që janë palë të këtij Protokoll, për hetime ose procedime penale specifike për veprat penale që lidhen me sistemet dhe të dhënat kompjuterike dhe me marrjen e provave, në formë elektronike, të një vepre penale; dhe

b) ndërmjet Palëve të Protokollit të Parë që janë Palë të këtij Protokoll, për hetime ose procedime penale specifike, në lidhje me veprat penale të përcaktuara në bazë të Protokollit të Parë.

2. Çdo Palë do të miratojë masa legjislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë Protokoll.

Neni 3 Përkufizimet

1. Përkufizimet e dhëna në nenet 1 dhe 18, paragrafi 3, të Konventës zbatohen për këtë Protokoll.

2. Për qëllimet e këtij Protokoll, zbatohen përkufizimet e mëposhtme shtesë:

a) “Autoritet qendror” nënkupton autoritetin ose autoritetet e përcaktuara sipas një traktati ose rregullimi të ndihmës së ndërsjellë në bazë të legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve të interesuara, ose në mungesë të tij, autoritetin ose autoritetet e përcaktuara nga një Palë, sipas nenit 27, paragrafi 2/a të Konventës;

b) “Autoritet kompetent” nënkupton një autoritet gjyqësor, administrativ ose autoritet tjetër ligjzbatues i autorizuar nga legjislacioni vendës për të urdhëruar, autorizuar ose ndërmarrë ekzekutimin e masave, sipas këtij Protokoll, me qëllim marrjen ose prodhimin e provave, në lidhje me hetimet ose procedimet specifike penale;

c) “Urgjencë” nënkupton një situatë në të cilën ekziston një rrezik i lartë dhe i afërt për jetën ose sigurinë e ndonjë personi fizik;

d) “Të dhëna personale” nënkupton informacionin, në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm;

e) “Palë transferuese” nënkupton Palën që transmeton të dhënat në përgjigje të një kërkesë ose

si pjesë e një ekipi të përbashkët hetimor ose, për qëllimet e kreut II, seksioni 2, një Palë në territorin e së cilës ndodhet një ofrues shërbimi transmetues ose subjekt që ofron shërbime për regjistrimin e emrit të domenit.

Neni 4 Gjuha

1. Kërkesat, urdhrat dhe informacioni shoqërues i dorëzuar një Pale, do të jenë në një gjuhë të pranueshme për Palën e kërkuar ose Palën e njoftuar, sipas nenit 7, paragrafi 5, ose do të shoqërohen nga një përkthim në një gjuhë të tillë.

2. Urdhrat, sipas nenit 7, dhe kërkesat, sipas nenit 6, dhe çdo informacion shoqërues:

a) do të dorëzohen në një gjuhë të Palës tjetër në të cilën ofruesi i shërbimit ose subjekti pranon proces të krahasueshëm të brendshëm;

b) do të dorëzohen në një gjuhë tjetër të pranueshme për ofruesin ose subjektin e shërbimit; ose

c) do të shoqërohen nga një përkthim në një nga gjuhët sipas paragrafëve 2/a ose 2/b.

KREU II MASAT PËR RRITJEN E BASHKËPUNIMIT

SEKSIONI 1 PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR KREUN II

Neni 5 Parimet e përgjithshme të zbatueshme për kreun II

1. Palët do të bashkëpunojnë në përputhje me dispozitat e këtij kreu në masën më të gjerë të mundshme.

2. Seksioni 2 i këtij kreu përbëhet nga nenet 6 dhe 7. Ai parashikon procedura që rrisin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me ofruesit dhe subjektet në territorin e një Pale tjetër. Seksioni 2 zbatohet pavarësisht nëse ka apo jo një traktat ose rregullim për ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve të interesuara.

3. Seksioni 3 i këtij kreu përbëhet nga nenet 8 dhe 9. Ai parashikon procedura për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet



autoriteteve për zbulimin e të dhënave të ruajtura kompjuterike. Seksioni 3 zbatohet pavarësisht nëse ka apo jo një traktat ose rregullim për ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet palëve kërkuuese dhe atyre të kërkuara.

4. Seksioni 4 i këtij kreu përbëhet nga neni 10. Ai parashikon procedurat që lidhen me ndihmën e ndërsjellë në raste urgjente. Seksioni 4 zbatohet pavarësisht nëse ka apo jo një traktat ose rregullim për ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet palëve kërkuuese dhe atyre të kërkuara.

5. Seksioni 5 i këtij kreu përbëhet nga nenet 11 dhe 12. Seksioni 5 zbatohet kur nuk ka traktat ose rregullim për ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve kërkuuese dhe atyre të kërkuara. Dispozitat e seksionit 5 nuk do të zbatohen kur ekziston një traktat ose rregullim i tillë, përveç siç parashikohet në nenin 12, paragrafi 7. Megjithatë, Palët e interesuara mund të vendosin reciprokisht të zbatojnë dispozitat e seksionit 5 në vend të tyre, nëse traktati ose rregullimi nuk e ndalon këtë.

6. Kur, në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli, Palës së kërkuar i lejohet të kushtëzojë bashkëpunimin nga ekzistenca e kriminalitetit të dyfishtë, ky kusht do të konsiderohet i përmbushur, pavarësisht nëse ligjet e saj e vendosin veprën penale brenda së njëjtës kategori të veprës penale ose e cilësojnë veprën me të njëjtën terminologji si Pala kërkuuese, nëse sjellja që përbën veprën penale për të cilën kërkohet ndihma, është vepër penale sipas ligjeve të saj.

7. Dispozitat në këtë krye nuk e kufizojnë bashkëpunimin ndërmjet Palëve ose ndërmjet Palëve dhe ofruesve të shërbimeve ose subjekteve të tjera, nëpërmjet marrëveshjeve, masave, praktikave ose legjislacioni tjetër të brendshëm të zbatueshëm.

SEKSIONI 2

PROCEDURAT QË RRISIN BASHKËPUNIMIN E DREJTPËRDREJTË ME OFRUESIT DHE SUBJEKTET NË PALË TË TJERA

Neni 6

Kërkesa për informacion mbi regjistrimin e emrit të domenit

1. Çdo Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të autorizuar autoritetet e saj kompetente, për qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike, për t'i bërë kërkesë një subjekti që ofron shërbime regjistrimi të emrit të domenit në territorin e një Pale tjetër për informacion nën zotërimin ose kontrollin e subjektit, për identifikimin ose kontaktimin me regjistruesin e një emri domeni.

2. Çdo Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme për të lejuar një subjekt në territorin e saj, që të zbulojë informacion të tillë në përgjigje të një kërkesë, sipas paragrafit 1, në bazë të kushteve të arsyeshme të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm.

3. Kërkesa, sipas paragrafit 1, përfshin:

a) datën kur është lëshuar kërkesa dhe identitetin dhe të dhënat e kontaktit të autoritetit kompetent që ka lëshuar kërkesën;

b) emrin e domenit për të cilin kërkohet informacioni dhe një listë të detajuar të informacionit të kërkuar, duke përfshirë elementet e veçanta të të dhënave;

c) një deklaratë se kërkesa është lëshuar në bazë të këtij Protokolli, se nevoja për informacion lind për shkak të lidhjes së tij me një hetim ose procedim penal specifik dhe se informacioni do të përdoret vetëm për atë hetim ose procedim penal specifik; dhe

d) afatin kohor brenda të cilit dhe mënyrën se si duhet të zbulohet informacioni dhe çdo udhëzim tjetër të veçantë procedural.

4. Nëse pranohet nga subjekti, një Palë mund të paraqesë kërkesë sipas paragrafit 1 në formë elektronike. Mund të kërkohen nivele të përshtatshme sigurie dhe vlefshmëri.

5. Në rast të mungesës së bashkëpunimit nga një subjekt i përshkruar në paragrafin 1, një Palë



kërkuese mund të kërkojë që subjekti të paraqesë arsye përse nuk po jep informacionin e kërkuar. Pala kërkuese mund të kërkojë konsultim me Palën në të cilën ndodhet subjekti, me qëllim përcaktimin e masave të disponueshme për marrjen e informacionit.

6. Çdo Palë, në kohën e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose në çdo kohë tjetër, do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës autoritetin e caktuar, për qëllime konsultimi sipas paragrafit 5.

7. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të krijojë dhe do të mbajë të përditësuar një regjistrë të autoriteteve të caktuara nga Palët, sipas paragrafit 6. Çdo Palë do të sigurojë që të dhënat që ka ofruar për regjistrin të jenë të sakta në çdo kohë.

Neni 7

Zbulimi i informacionit të abonentit

1. Çdo Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të autorizuar autoritetet e saj kompetente për të lëshuar një urdhër që do t'i dorëzohet drejtpërdrejt një ofruesi shërbimi në territorin e një Pale tjetër, në mënyrë që të garantohet zbulimi i informacionit të ruajtur të specifikuar të abonentit nën zotërimin ose kontrollin e atij ofruesi shërbimi, kur informacioni i abonentit është i nevojshëm për hetimet ose procedimet penale specifike të palës lëshuese.

2. a) Çdo Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për një ofrues shërbimi në territorin e saj për të zbuluar informacionin e abonentit në përgjigje të një urdhri sipas paragrafit 1.

b) Në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, një Palë – në lidhje me urdhrat e lëshuar për ofruesit e shërbimeve në territorin e saj – mund të bëjë deklaratën e mëposhtme: “Urdhri sipas nenit 7, paragrafi 1, duhet të lëshohet nga ose nën mbikëqyrjen e një prokurori ose autoriteti tjetër gjyqësor, ose ndryshe duhet të lëshohet nën mbikëqyrje të pavarur”.

3. Urdhri, sipas paragrafit 1, do të specifikojë:

a) autoritetin lëshues dhe datën e lëshimit;

b) një deklaratë që urdhri është lëshuar në përputhje me këtë Protokoll;

c) emrin dhe adresën e ofruesve të shërbimit që do t'u dorëzohet;

d) veprën/at që është/janë objekt hetimi apo procedimi penal;

e) autoritetin që kërkon informacionin specifik të abonentit, nëse nuk është autoriteti lëshues; dhe

f) një përshkrim të detajuar të informacionit specifik të kërkuar të abonentit.

4. Urdhri, sipas paragrafit 1, shoqërohet me informacionin shtesë të mëposhtëm:

a) bazat e brendshme ligjore që autorizojnë autoritetin për të lëshuar urdhrin;

b) një referencë ndaj dispozitave ligjore dhe dënimeve të zbatueshme për veprën që po hetohet ose ndiqet penalisht;

c) informacionin e kontaktit të autoritetit të cilit ofruesi i shërbimit do t'i kthejë informacionin e abonentit, nga i cili mund të kërkojë informacion të mëtejshëm ose të cilit do t'i përgjigjet në një formë tjetër;

d) afatin kohor brenda të cilit dhe mënyrën se si duhet të kthehet informacioni i abonentit;

e) nëse tashmë është kërkuar ruajtja e të dhënave, duke përfshirë datën e ruajtjes dhe çdo numër reference të zbatueshme;

f) çdo udhëzim të veçantë procedural;

g) nëse është e zbatueshme, një deklaratë se njoftimi i njëkohshëm është bërë në përputhje me paragrafin 5; dhe

h) çdo informacion tjetër që mund të ndihmojë në sigurimin e zbulimit të informacionit të abonentit.

5. a) Një Palë, në kohën e nënshkrimit të këtij Protokollit ose, kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe në çdo kohë tjetër, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës se kur një urdhër lëshohet sipas paragrafit 1 për një ofrues shërbimi në territorin e saj, Pala kërkon, në çdo rast ose në rrethana të identifikuara, njoftimin e njëkohshëm të urdhrit, informacion shtesë dhe një përmbledhje të fakteve që lidhen me hetimin ose procedimin.

b) Pavarësisht nëse një Palë kërkon apo jo njoftim sipas paragrafit 5.a, ajo mund t'i kërkojë ofruesit të shërbimit që të konsultohet me autoritetet e Palës në rrethana të identifikuara përpara zbulimit të informacionit.



c) Autoritetet e njoftuara sipas paragrafit 5.a ose të konsultuara sipas paragrafit 5.b, mund të udhëzojnë pa vonesë të panevojshme ofruesin e shërbimit që të mos zbulojë informacionin e abonentit, nëse:

i. zbulimi mund të cenojë hetimet ose procedimet penale në atë Palë; ose

ii. kushtet ose arsyet për refuzim do të zbatoheshin sipas nenit 25, paragrafi 4 dhe nenit 27, paragrafi 4 të Konventës, nëse informacioni i abonentit do të ishte kërkuar nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë.

d) Autoritetet e njoftuara sipas paragrafit 5/a ose të konsultuara sipas paragrafit 5/b:

i. mund të kërkojnë informacion shtesë nga autoriteti i përmendur në paragrafin 4/c për qëllimet e zbatimit të paragrafit 5/c dhe nuk do t'ia zbulojnë atë informacion ofruesit të shërbimit pa pëlqimin e atij autoriteti; dhe

ii. do të informojnë menjëherë autoritetin e përmendur në paragrafin 4/c, nëse ofruesi i shërbimit është udhëzuar që të mos zbulojë informacionin e abonentit dhe të paraqesë arsyet për kryerjen e një veprimi të tillë.

e) Një Palë do të caktojë një autoritet të vetëm për të marrë njoftimin sipas paragrafit 5/a dhe për të kryer veprimet e përshkruara në paragrafët 5/b, 5/c dhe 5/d. Pala, në kohën kur i jepet për herë të parë njoftimi Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, sipas paragrafit 5/a, do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm informacionin e kontaktit të atij autoriteti.

f) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të krijojë dhe do të mbajë të përditësuar një regjistër të autoriteteve të caktuara nga Palët, në përputhje me paragrafin 5/e dhe, nëse dhe në cilat rrethana ata kërkojnë njoftim, sipas paragrafit 5/a. Çdo Palë do të sigurojë që të dhënat që ajo jep për regjistrin të jenë të sakta në çdo kohë.

6. Nëse pranohet nga ofruesi i shërbimit, një Palë mund të dorëzojë një urdhër, sipas paragrafit 1, dhe informacion shtesë, sipas paragrafit 4, në formë elektronike. Një Palë mund të japë njoftim dhe informacion shtesë, sipas paragrafit 5 në formë elektronike. Mund të kërkojnë nivele të përshtatshme sigurie dhe vleftësimi.

7. Nëse një ofrues shërbimi informon autoritetin në paragrafin 4/c se nuk do të zbulojë informacionin e kërkuar të abonentit, ose nëse nuk zbulon informacionin e abonentit në përgjigje të

urdhrit, sipas paragrafit 1, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e urdhrit ose nga afati kohor i caktuar në paragrafin 4/d, cilado periudhë kohore të jetë më e gjatë, autoritetet kompetente të Palës lëshuese mund të kërkojnë më pas që të zbatojnë urdhrin vetëm nëpërmjet nenit 8 ose formave të tjera të ndihmës së ndërsjellë. Palët mund të kërkojnë që një ofrues shërbimi të paraqesë një arsye për refuzimin e zbulimit të informacionit të abonentit të kërkuar nga urdhri.

8. Një Palë, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, mund të deklarojë se një Palë lëshuese do të kërkojë zbulimin e informacionit të abonentit nga ofruesi i shërbimit përpara se ta kërkojë atë sipas nenit 8, përveç rasteve kur Pala lëshuese jep një shpjegim të arsyeshëm, se përse nuk ka vepruar në këtë mënyrë.

9. Në kohën e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, një Palë:

a) mund të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar këtë nen; ose

b) nëse zbulimi i llojeve të caktuara të numrave të aksesit sipas këtij neni nuk do të ishte në përputhje me parimet themelore të sistemit të saj të brendshëm ligjor, mund të rezervojë të drejtën që të mos zbatojë këtë nen për numra të tillë.

SEKSIONI 3

PROCEDURAT QË RRISIN BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR NDËRMJET AUTORITETEVE PËR ZBULIMIN E TË DHËNAVE TË RUAJTURA KOMPJUTERIKE

Neni 8

Zbatimi i urdhrave nga një Palë tjetër për prodhimin e përsheptuar të informacionit të abonentëve dhe të të dhënave të trafikut

1. Çdo Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të autorizuar autoritetet e saj kompetente që të lëshojnë një urdhër për t'u dorëzuar si pjesë e një kërkesë një Pale tjetër, me qëllim që të detyrojë një ofrues shërbimi në territorin e Palës së kërkuar të prodhojë të dhëna të specifikuar dhe të ruajtura.

a) informacionet e abonentit; dhe



b) të dhënat e trafikut,

nën zotërimin ose kontrollin e atij ofruesi shërbimi që nevojiten për hetimet ose procedimet specifike penale të Palës.

2. Çdo Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e një urdhri, sipas paragrafit 1, të dorëzuar nga një Palë kërkuese.

3. Në kërkesën e saj, Pala kërkuese do t'i dorëzojë Palës së kërkuar urdhrin sipas paragrafit 1, informacionin mbështetës dhe çdo udhëzim të veçantë procedural.

a) Urdhri duhet të specifikojë:

i. autoritetin lëshues dhe datën e lëshimit të urdhrin;

ii. një deklaratë se urdhri është dorëzuar në përputhje me këtë Protokoll;

iii. emrin dhe adresën e ofruesve të shërbimit të cilëve do t'u dorëzohet;

iv. veprën/at që është/janë objekt hetimi apo procedimi penal;

v. autoritetin që kërkon informacionin ose të dhënat, nëse nuk është autoriteti lëshues; dhe

vi. një përshkrim të detajuar të informacionit ose të të dhënave specifike të kërkuara.

b) Informacioni mbështetës, i dhënë me qëllim për të ndihmuar Palën e kërkuar që të zbatojë urdhrin dhe që nuk do t'i zbulohet ofruesit të shërbimit pa pëlqimin e Palës kërkuese, do të specifikojë:

i. bazat ligjore të brendshme që autorizojnë autoritetin për të lëshuar urdhrin;

ii. dispozitat ligjore dhe dënimet e zbatueshme për veprat që hetohen ose ndiqen penalisht;

iii. arsyen përse pala kërkuese çmon se ofruesi i shërbimit zotëron ose kontrollon të dhënat;

iv. një përmbledhje të fakteve në lidhje me hetimin ose procedimin;

v. lidhjen e informacionit ose të të dhënave me hetimin ose procedimin;

vi. informacionin e kontaktit të një autoriteti ose autoriteteve që mund të japin informacion të mëtejshëm;

vii. nëse është kërkuar tashmë ruajtja e informacionit ose e të dhënave, duke përfshirë datën e ruajtjes dhe çdo numër reference të zbatueshme; dhe

viii. nëse informacioni apo të dhënat janë kërkuar tashmë me mjete të tjera, dhe nëse po, në cilën mënyrë.

c) Pala kërkuese mund të kërkojë që Pala e kërkuar të zbatojë udhëzime të veçanta procedurale.

4. Një Palë mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, dhe në çdo kohë tjetër, se kërkohet informacion shtesë mbështetës për zbatimin e urdhrave sipas paragrafit 1.

5. Pala e kërkuar do të pranojë kërkesat në formë elektronike. Mund të kërkojë nivele të përshtatshme sigurie dhe vlefësimi përpara se të pranojë kërkesën.

6. a) Pala e kërkuar, nga data e marrjes së të gjithë informacionit të specifikuar në paragrafët 3 dhe 4, do të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'i shërbyer ofruesit të shërbimit brenda dyzet e pesë ditëve, nëse jo më shpejt, dhe do të urdhërojë kthimin e informacionit ose të dhënave të kërkuara, jo me vonë se:

a) njëzet ditë për informacionin e abonentit; dhe

b) dyzet e pesë ditë për të dhënat e trafikut.

b) Pala e kërkuar do të parashikojë transmetimin e informacionit ose të të dhënave të prodhuara te Pala kërkuese, pa vonesë të panevojshme.

7. Nëse Pala e kërkuar nuk mund të përmbushë udhëzimet sipas paragrafit 3/c në mënyrën e kërkuar, ajo do të informojë menjëherë Palën kërkuese dhe, nëse është e zbatueshme, do të specifikojë çdo kusht nën të cilin ajo mund të përmbushë udhëzimet, pas të cilit Pala kërkuese do të përcaktojë nëse kërkesa, megjithatë, duhet të ekzekutohet.

8. Pala e kërkuar mund të refuzojë të ekzekutojë një kërkesë për arsyet e caktuara në nenin 25, paragrafi 4 ose nenin 27, paragrafi 4 të Konventës ose mund të vendosë kushte që i çmon të nevojshme për të lejuar ekzekutimin e kërkesës. Pala e kërkuar mund të shtyjë ekzekutimin e kërkesave për arsyet e caktuara, sipas nenit 27, paragrafi 5 të Konventës. Pala e kërkuar do të njoftojë Palën kërkuese sa më shpejt që të jetë e mundur për refuzimin, kushtet ose shtyrjen. Pala e kërkuar do të njoftojë, gjithashtu, Palën kërkuese për rrethana të tjera që mund të vonojnë për një periudhë të gjatë ekzekutimin e kërkesës. Neni 28, paragrafi 2/b i Konventës do të zbatohet për këtë nen.

9. Nëse Pala kërkuese nuk mund të përmbushë një kusht të vendosur nga Pala e kërkuar, sipas



paragrafit 8, ajo do të informojë menjëherë Palën e kërkuar. Pala e kërkuar do të përcaktojë më pas nëse, megjithatë, informacioni ose materiali duhet të sigurohet.

b) Nëse Pala kërkuuese e pranon kushtin, ajo do të ketë detyrime ligjore në lidhje me të. Pala e kërkuar që jep informacion ose material që i nënshtrohet një kushti të tillë, mund t'i kërkojë Palës kërkuuese të shpjegojë, në lidhje me atë kusht, përdorimin e këtij informacioni ose materiali.

10. Çdo Palë, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe do të mbajë të përditësuar informacionin e kontaktit të autoriteteve të caktuara:

a) për të dorëzuar një urdhër sipas këtij neni; dhe

b) për të marrë një urdhër sipas këtij neni.

11. Një Palë, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, mund të deklarojë se kërkon që kërkesat nga Palët e tjera, sipas këtij neni, t'i paraqiten nga autoriteti qendror i Palës kërkuuese ose nga një autoritet tjetër që caktohet reciprokisht ndërmjet Palëve të interesuara.

12. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të krijojë dhe do të mbajë të përditësuar një regjistër të autoriteteve të caktuara nga palët, sipas paragrafit 10. Çdo Palë do të garantojë që të dhënat që ka paraqitur për regjistrin të jenë të sakta në çdo kohë.

13. Në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, një Palë mund të rezervojë të drejtën të mos zbatojë këtë nen për të dhënat e trafikut.

Neni 9

Zbulimi i përshpejtuar i të dhënave të ruajtura kompjuterike në një rast urgjent

1. a) Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme, në një rast urgjent, për pikën e saj të kontaktit për rrjetin 24/7 (24 orë në 7 ditë të javës) të përmendur në nenin 35 të Konventës ("pika e kontaktit") për të transmetuar një kërkesë dhe për të marrë një

kërkesë nga një pikë kontakti në një Palë tjetër që kërkon ndihmë të menjëhershme për të marrë nga një ofrues shërbimi në territorin e asaj Pale, zbulimin e përshpejtuar të të dhënave të ruajtura kompjuterike të specifikuara, nën zotërimin ose kontrollin e atij ofruesi shërbimi, pa kërkesë për ndihmë të ndërsjellë.

b) Një Palë, në kohën e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, mund të deklarojë se nuk do të ekzekutojë kërkesat sipas paragrafit 1/a, duke kërkuar vetëm zbulimin e informacionit të abonentit.

2. Çdo Palë do të miratojë masa legislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar, në përputhje me paragrafin 1:

a) që autoritetet e tij të kërkojnë të dhëna nga një ofrues shërbimi në territorin e tij pas një kërkesë, sipas paragrafit 1;

b) që një ofrues shërbimi në territorin e tij të zbulojë të dhënat e kërkuara tek autoritetet e tij në përgjigje të një kërkesë, sipas paragrafit 2/a; dhe

c) autoritetet e saj t'i japin të dhënat e kërkuara palës kërkuuese.

3. Kërkesa, sipas paragrafit 1, do të specifikojë:

a) autoritetin kompetent që kërkon të dhënat dhe datën kur është lëshuar kërkesa;

b) një deklaratë që kërkesa është lëshuar në përputhje me këtë Protokoll;

c) emrin dhe adresën e ofruesve të shërbimit që zotërojnë ose kontrollojnë të dhënat e kërkuara;

d) veprën/at që është/janë objekt hetimi apo procedimi penal dhe një referencë ndaj dispozitave të saj ligjore dhe dënimeve të zbatueshme;

e) fakte të mjaftueshme për të provuar se ekziston një rast urgjent dhe se si të dhënat kanë lidhje me të;

f) një përshkrim të detajuar të të dhënave të kërkuara;

g) çdo udhëzim të veçantë procedural; dhe

h) çdo informacion tjetër që mund të ndihmojë në sigurimin e zbulimit të të dhënave të kërkuara.

4. Pala e kërkuar do të pranojë një kërkesë në formë elektronike. Një Palë mund të pranojë, gjithashtu, një kërkesë të transmetuar verbalisht dhe mund të kërkojë konfirmim në formë elektronike. Mund të kërkojë nivele të përshtatshme sigurie dhe vlefësimi përpara pranimi të kërkesës.



5. Një Palë, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokolli ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, mund të deklarojë se u kërkon palëve kërkuese, pas ekzekutimit të kërkesës, që të paraqesin kërkesë dhe çdo informacion shtesë të transmetuar në mbështetje të tij, në një format dhe nëpërmjet një kanali të tillë, i cili mund të përfshijë ndihmën e ndërsjellë, siç specifikohet nga Pala e kërkuar.

6. Pala e kërkuar do të informojë Palën kërkuese për vendimin e saj, në lidhje me kërkesën, sipas paragrafit 1 mbi bazë të përshpejtuar dhe, nëse është e zbatueshme, do të specifikojë çdo kusht nën të cilin do të japë të dhënat dhe çdo formë tjetër bashkëpunimi që mund të jetë e disponueshme.

7. a) Nëse një Palë kërkuese nuk mund të përmbushë një kusht të vendosur nga Pala e kërkuar, sipas paragrafit 6, ajo duhet të informojë menjëherë Palën e kërkuar. Pala e kërkuar do të përcaktojë më pas nëse informacioni ose materiali duhet të jepet. Nëse Pala kërkuese e pranon kushtin, ajo do të ketë detyrime ligjore në lidhje me të.

b) Pala e kërkuar që jep informacion ose material, që i nënshtrohet një kushti të tillë, mund t'i kërkojë Palës kërkuese të shpjegojë, në lidhje me atë kusht, përdorimin e këtij informacioni ose materiali.

SEKSIONI 4

PROCEDURAT NË LIDHJE ME NDIHMËN E NDËRSJELLË NË RAST URGJENT

Neni 10

Ndihma e ndërsjellë në rast urgjent

1. Çdo Palë mund të kërkojë ndihmë të ndërsjellë mbi bazë të përshpejtuar, kur çmon se ekziston një rast urgjent. Kërkesa sipas këtij neni do të përfshijë, përveç përmbajtjeve të tjera të kërkuara, një përshkrim të fakteve që provojnë se ekziston një rast urgjent dhe të mënyrës se si ndihma e kërkuar lidhet me të.

2. Pala e kërkuar do të pranojë një kërkesë të tillë në formë elektronike. Mund të kërkojë nivele të përshtatshme sigurie dhe vlefësimi përpara pranimi të kërkesës.

3. Pala e kërkuar mund të kërkojë, mbi bazë të përshpejtuar, informacion shtesë për të vlerësuar

kërkesën. Pala kërkuese do të japë informacion të tillë plotësues mbi bazë të përshpejtuar.

4. Pasi të bindet se ekziston një rast urgjent dhe kërkesat e tjera për ndihmën e ndërsjellë janë përmbushur, Pala e kërkuar do t'i përgjigjet kërkesës mbi bazë të përshpejtuar.

5. Çdo Palë do të sigurojë që një person nga autoriteti i saj qendror ose nga autoritetet e tjera përgjegjëse për t'iu përgjigjur kërkesave për ndihmë të ndërsjellë, të jetë i disponueshëm njëzet e katër orë në shtatë ditë të javës, me qëllim që t'i përgjigjet një kërkesë sipas këtij neni.

6. Autoriteti qendror ose autoritetet e tjera përgjegjëse për ndihmën e ndërsjellë të palëve kërkuese dhe atyre të kërkuara, mund të përcaktojnë reciprokisht se rezultatet e ekzekutimit të një kërkesë sipas këtij neni, ose një kopje paraprake e saj mund t'i jepen Palës kërkuese nëpërmjet një kanali të ndryshëm nga ai i përdorur për kërkesën.

7. Kur nuk ka traktat ose rregullim të ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet palëve kërkuese dhe atyre të kërkuara, neni 27, paragrafët 2/b dhe 3 deri 8, dhe neni 28, paragrafët 2 deri 4 të Konventës do të zbatohen për këtë nen.

8. Kur ekziston një traktat ose rregullim i tillë, ky nen do të plotësohet me dispozitat e një traktati ose rregullimi të tillë, përveç rasteve kur Palët e interesuara vendosin reciprokisht të zbatojnë një ose të gjitha dispozitat e Konventës të përmendura në paragrafin 7 të këtij neni, në vend të tyre.

9. Çdo Palë, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokolli ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, mund të deklarojë se kërkesat mund t'i dërgohen, gjithashtu, drejtpërdrejt autoriteteve të saj gjyqësore, ose nëpërmjet kanaleve të Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) ose në pikën e saj të kontaktit 24/7, të krijuar sipas nenit 35 të Konventës. Në çdo rast të tillë, një kopje do t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit qendror të Palës së kërkuar nëpërmjet autoritetit qendror të Palës kërkuese. Kur një kërkesë i dërgohet drejtpërdrejt një autoriteti gjyqësor të Palës së kërkuar dhe ai autoritet nuk është kompetent për të trajtuar kërkesën, ai do t'ia drejtojë kërkesën autoritetit kombëtar kompetent dhe do të informojë drejtpërdrejt Palën kërkuese për kryerjen e një veprimi të tillë.



SEKSIONI 5
PROCEDURAT NË LIDHJE ME
BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR NË
MUNGESË TË MARRËVESHJEVE TË
ZBATUESHME NDËRKOMBËTARE

Neni 11
Videokonferenca

1. Pala kërkuese mund të kërkojë dhe Pala e kërkuar mund të lejojë marrjen e dëshmisë dhe deklaratave nga një dëshmitar ose ekspert me anë të videokonferencës. Pala kërkuese dhe Pala e kërkuar do të konsultohen për të lehtësuar zgjidhjen e çdo çështjeje që mund të lindë në lidhje me ekzekutimin e kërkesës, duke përfshirë, sipas rastit: cila Palë do të kryesojë; autoritetet dhe personat që do të jenë të pranishëm; nëse njëra ose të dyja palët do të japin betime të veçanta, paralajmërime ose do t'i japin udhëzime dëshmitarit ose ekspertit; mënyrën e marrjes në pyetje të dëshmitarit ose ekspertit; mënyrën se si të drejtat e dëshmitarit ose ekspertit do të garantohen siç duhet; trajtimin e pretendimeve për privilegj ose imunitet; trajtimin e kundërshtimeve ndaj pyetjeve ose përgjigjeve; dhe nëse njëra ose të dyja palët do të ofrojnë shërbime përkthimi, interpretimi dhe transkriptimi.

2. Autoritetet qendrore të Palëve të kërkuara dhe kërkuese do të komunikojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën për qëllimet e këtij neni. Pala e kërkuar mund të pranojë një kërkesë në formë elektronike. Mund të kërkojë nivele të përshtatshme sigurie dhe vlefësimi përpara pranimi të kërkesës.

b) Pala e kërkuar do të informojë Palën kërkuese për arsyet e mosekzekutimit ose të vonesës së ekzekutimit të kërkesës. Neni 27, paragrafi 8 i Konventës zbatohet për këtë nen. Pa cenuar ndonjë kusht tjetër që një Palë e kërkuar mund të vendosë në përputhje me këtë nen, për këtë nen zbatohet neni 28, paragrafët 2 deri 4 të Konventës.

3. Një Palë e kërkuar që ofron ndihmë, sipas këtij neni, do të përpiqet të sigurojë praninë e personit, dëshmia ose deklarata e të cilit kërkohet. Kur është e nevojshme, Pala e kërkuar, në masën që është e mundur, sipas legjislacionit të saj, mund të marrë masat e nevojshme për të detyruar një dëshmitar ose ekspert që të paraqitet në Palën e kërkuar në një kohë dhe vendndodhje të caktuar.

4. Procedurat në lidhje me zhvillimin e videokonferencës, të specifikuara nga Pala kërkuese, do të ndiqen, përveç rasteve kur nuk pajtohen me legjislacionin e brendshëm të Palës së kërkuar. Në rast të papajtueshmërisë ose në masën që procedura nuk është specifikuar nga Pala kërkuese, Pala e kërkuar do të zbatojë procedurën sipas legjislacionit të saj të brendshëm, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga palët kërkuese dhe të kërkuara.

5. Pa cenuar ndonjë juridiksion, sipas legjislacionit të brendshëm të Palës kërkuese, kur gjatë videokonferencës, dëshmitari ose ekspertit:

a) bën një deklaratë qëllimisht të rreme kur Pala e kërkuar, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palës së kërkuar, e ka detyruar atë person të dëshmojë me vërtetësi;

b) refuzon të dëshmojë kur Pala e kërkuar, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palës së kërkuar, e ka detyruar atë person të dëshmojë; ose

c) kryen sjellje tjetër të papërshtatshme që ndalohet nga legjislacioni i brendshëm i Palës së kërkuar gjatë atyre procedurave,

personi do të jetë objekt sanksionesh në Palën e kërkuar në të njëjtën mënyrë sikur një veprim i tillë të ishte kryer gjatë procedurave të saj të brendshme.

6. a) Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe reciprokisht ndërmjet Palës kërkuese dhe Palës së kërkuar, kjo e fundit do të mbulojë të gjitha kostot që lidhen me ekzekutimin e një kërkesë, sipas këtij neni, përveç:

i. tarifave të një dëshmitari ekspert

ii. kostove të përkthimit, interpretimit dhe transkriptimit; dhe

iii. kostove të një natyre të jashtëzakonshme.

b) Nëse ekzekutimi i një kërkesë do të vendoste kosto të një natyre të jashtëzakonshme, Pala kërkuese dhe Pala e kërkuar do të konsultohen me njëra-tjetrën për të përcaktuar kushtet në të cilat mund të ekzekutohet kërkesa.

7. Kur është rënë dakord reciprokisht nga Pala kërkuese dhe Pala e kërkuar:

a) dispozitat e këtij neni mund të zbatohen për qëllime të kryerjes së audiokonferencave;

b) teknologjia e videokonferencës mund të përdoret për qëllime ose seanca dëgjimore të ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafin 1, duke përfshirë për qëllimet e identifikimit të personave ose objekteve.



8. Kur një Palë e kërkuar zgjedh të lejojë dëgjimin e një personi të dyshuar ose të akuzuar, ajo mund të kërkojë kushte dhe garanci të veçanta në lidhje me marrjen e dëshmisë ose të një deklarate ose dhënien e njoftimeve ose zbatimin e masave procedurale ndaj këtij personi.

Neni 12

Ekipet e hetimeve të përbashkëta dhe hetimet e përbashkëta

1. Me marrëveshje të ndërsjellë, autoritetet kompetente të dy ose më shumë Palëve mund të krijojnë dhe të drejtojnë një ekip të përbashkët hetimor në territoret e tyre, për të lehtësuar hetimet ose procedimet penale, ku koordinimi i zgjeruar konsiderohet të jetë i një dobie të veçantë. Autoritetet kompetente do të caktohen nga Palët përkatëse të interesuara.

2. Procedurat dhe kushtet që rregullojnë funksionimin e ekipeve të përbashkëta hetimore, të tilla si qëllimet e tyre specifike; përbërja; funksionet; kohëzgjatja dhe çdo periudhë zgjatjeje; vendndodhja; organizimi; kushtet e mbledhjes, transmetimit dhe përdorimit të informacionit ose provave; kushtet e konfidencialitetit dhe kushtet për përfshirjen e autoriteteve pjesëmarrëse të një Pale në veprimtaritë hetimore që zhvillohen në territorin e një Pale tjetër, do të jenë siç është rënë dakord ndërmjet këtyre autoriteteve kompetente.

3. Një Palë mund të deklarojë në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit se autoriteti i saj qendror duhet të jetë nënshkrues ose të jetë dakord ndryshe në marrëveshjen për krijimin e ekipit.

4. Ato autoritete kompetente dhe pjesëmarrëse do të komunikojnë drejtpërdrejt, përveç kur Palët mund të caktojnë reciprokisht kanale të tjera të përshtatshme komunikimi, kur rrethanat e jashtëzakonshme kërkojnë koordinim qendror më të zgjeruar.

5. Kur duhet të ndërmerren masa hetimore në territorin e njëres prej Palëve të interesuara, autoritetet pjesëmarrëse nga ajo Palë mund t'u kërkojnë autoriteteve të tyre t'i marrin ato masa pa qenë e nevojshme që Palët e tjera të paraqesin kërkesë për ndihmë të ndërsjellë. Këto masa do të kryhen nga autoritetet e asaj Pale në territorin e saj,

sipas kushteve që zbatohen sipas legjislacionit të brendshëm në një hetim kombëtar.

6. Përdorimi i informacionit ose i provave të dhëna nga autoritetet pjesëmarrëse të njëres Palë autoriteteve pjesëmarrëse të Palëve të tjera të interesuara, mund të refuzohet ose kufizohet në mënyrën e përcaktuar në marrëveshjen e përshkruar në paragrafët 1 dhe 2. Nëse kjo marrëveshje nuk përcakton kushte për refuzimin ose kufizimin e përdorimit, Palët mund të përdorin informacionin ose provat e dhëna:

a) për qëllimet për të cilat është lidhur marrëveshja;

b) për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të ndryshme nga ato për të cilat është lidhur marrëveshja, me kusht që të merret pëlqimi paraprak i autoriteteve që japin informacionin ose provat. Megjithatë, pëlqimi nuk kërkohet kur parimet themelore ligjore të Palës që përdor informacionin ose provat kërkojnë që ajo të zbulojë informacionin ose provat për të mbrojtur të drejtat e një të akuzuari në procedimin penal. Në atë rast, këto autoritete do të njoftojnë autoritetet që kanë dhënë informacionin ose provat, pa vonesë të panevojshme; ose

c) për të parandaluar një urgjencë. Në atë rast, autoritetet pjesëmarrëse që kanë marrë informacionin ose provat, do të njoftojnë pa vonesë të panevojshme autoritetet pjesëmarrëse, që kanë dhënë informacionin ose provat, përveç rasteve kur vendoset ndryshe reciprokisht.

7. Në mungesë të një marrëveshjeje të përshkruar në paragrafët 1 dhe 2, hetimet e përbashkëta mund të ndërmerren sipas kushteve të rëna dakord reciprokisht, rast pas rasti. Ky paragraf zbatohet pavarësisht nëse ka apo jo një traktat ose rregullim për ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve të interesuara.

KREU III

KUSHTET DHE GARANCITË

Neni 13

Kushtet dhe garancitë

Në përputhje me nenin 15 të Konventës, çdo Palë do të sigurojë që krijimi, kryerja dhe zbatimi i kompetencave dhe i procedurave të parashikuara në këtë Protokoll do t'u nënshtrohen kushteve dhe



garancive të parashikuara nga legjislacioni i saj i brendshëm, i cili parashikon mbrojtjen e duhur të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Neni 14

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Fushëveprimi

Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafët 1/b dhe c, çdo palë do të përpunojë të dhënat personale që merr sipas këtij Protokoll, në përputhje me paragrafët 2 deri 15 të këtij neni.

a) Nëse, në momentin e marrjes së të dhënave personale, sipas këtij Protokoll, si Pala transferuese edhe pala marrëse kanë detyrime ligjore reciprokisht nga një marrëveshje ndërkombëtare, që krijon një kuadër gjithëpërfshirës ndërmjet këtyre Palëve për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili është i zbatueshëm për transferimin e të dhënave personale, me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale dhe që parashikon se përpunimi i të dhënave personale, sipas asaj marrëveshjeje është në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave të palëve të interesuara, do të zbatohen kushtet e kësaj marrëveshjeje për masat që përfshihen në fushëveprimin e kësaj marrëveshjeje, për të dhënat personale të marra, sipas Protokollit në vend të paragrafëve 2 deri 15, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet Palëve të interesuara.

b) Nëse pala transferuese dhe pala marrëse nuk kanë detyrime ligjore reciprokisht sipas një marrëveshjeje të përshkruar në paragrafin 1/b, ato mund të përcaktojnë reciprokisht se transferimi i të dhënave personale, sipas këtij Protokoll, mund të kryhet në bazë të marrëveshjeve ose rregullimeve të tjera ndërmjet Palëve të interesuara në vend të paragrafëve 2 deri 15.

c) Çdo Palë do të çmojë se përpunimi i të dhënave personale në përputhje me paragrafët 1/a dhe 1/b plotëson kërkesat e kuadrit ligjor të mbrojtjes së të dhënave personale për transferimet ndërkombëtare të të dhënave personale dhe nuk kërkohet autorizim i mëtejshëm për transferim sipas atij kuadri ligjor. Një Palë mund të refuzojë ose parandalojë transferimin e të dhënave të një Palë tjetër sipas këtij Protokoll për arsye të mbrojtjes së të dhënave, sipas kushteve të caktuara në paragrafin 15, kur zbatohet paragrafi 1/a; ose

sipas kushteve të një marrëveshjeje ose rregullimi të përmendur në paragrafët 1/b ose c, kur zbatohet një nga këta paragrafë.

d) Asgjë në këtë nen nuk do të pengojë një Palë që të zbatojë garanci më të rrepta për përpunimin nga autoritetet e veta, të të dhënave personale të marra sipas këtij Protokoll.

2. Qëllimi dhe përdorimi

a) Pala, që ka marrë të dhëna personale, do t'i përpunojë për qëllimet e përshkruara në nenin 2. Ajo nuk do t'i përpunojë më tej të dhënat personale për një qëllim të papajtueshëm dhe nuk do t'i përpunojë më tej të dhënat kur nuk lejohet, sipas kuadrit të saj të brendshëm ligjor. Ky nen nuk do të cenojë aftësinë e palës transferuese për të vendosur kushte shtesë, në përputhje me këtë Protokoll, në një rast specifik, megjithatë, këto kushte nuk do të përfshijnë kushte të përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave.

b) Pala marrëse do të garantojë, sipas kuadrit të saj të brendshëm ligjor, që të dhënat personale të kërkuara dhe të përpunuara të jenë të përshtatshme dhe jo të tepruara në lidhje me qëllimet e këtij përpunimi.

3. Cilësia dhe integriteti

Çdo Palë do të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale të mbahen me saktësi dhe plotësi të tillë dhe të jenë aq të përditësuara sa është e nevojshme dhe e përshtatshme për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke pasur parasysh qëllimet për të cilat përpunohen.

4. Të dhënat sensitive

Përpunimi nga një Palë i të dhënave personale që zbulojnë origjinën raciale ose etnike, opinione politike ose besime fetare ose të tjera, ose anëtarësimin në sindikata; të dhëna gjenetike; të dhëna biometrike të konsideruara sensitive, në funksion të rreziqeve të përfshira; ose të dhëna personale në lidhje me shëndetin ose jetën seksuale; do të kryhet vetëm sipas garancive të duhura për t'u mbrojtur kundër rrezikut të ndikimit paragjykses të pajustificuar nga përdorimi i këtyre të dhënave, veçanërisht kundër diskriminimit të paligjshëm.

5. Periudhat e ruajtjes

Çdo Palë do t'i ruajë të dhënat personale vetëm për aq kohë sa është e nevojshme dhe e përshtatshme në funksion të qëllimeve të përpunimit të të dhënave, sipas paragrafit 2. Për të përmbushur këtë detyrim, ajo do të parashikojë në



kuadrin e saj të brendshëm ligjor, periudha specifike ruajtjeje ose rishikimi periodik të nevojës për ruajtje të mëtejshme të të dhënave.

6. Vendimet e automatizuara

Vendimet që prodhojnë një efekt negativ thelbësor për interesat përkatës të individit me të cilin lidhen të dhënat personale, nuk mund të bazohen vetëm në përpunimin e automatizuar të të dhënave personale, përveç rasteve kur autorizohen nga legjislacioni i brendshëm dhe me garancitë e duhura që përfshijnë mundësinë për sigurimin e ndërhyrjes njerëzore.

7. Siguria e të dhënave dhe incidentet e sigurisë

a) Çdo Palë do të sigurojë që të ketë në veprim masat e duhura teknologjike, fizike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht kundër humbjes ose aksesit, zbulimit, ndryshimit ose shkatërrimit aksidental ose të paautorizuar (“incident sigurie”).

b) Me zbulimin e një incidenti sigurie në të cilin ekziston një rrezik i lartë i dëmtimit fizik ose jofizik për individët ose për Palën tjetër, Pala marrëse do të vlerësojë menjëherë mundësinë dhe shkallën e atij dëmi dhe do të ndërmarrë menjëherë veprimet e duhura për zbutjen e atij dëmi. Një veprim i tillë do të përfshijë njoftimin për autoritetin transferues ose, për qëllimet e kreut II, seksioni 2, autoritetin ose autoritetet e caktuara në përputhje me paragrafin 7/c. Megjithatë, njoftimi mund të përfshijë kufizime të duhura, në lidhje me transmetimin e mëtejshëm të njoftimit; mund të vonohet ose anashkalohet kur një njoftim i tillë mund të rrezikojë sigurinë kombëtare, ose të vonohet kur një njoftim i tillë mund të rrezikojë masat për mbrojtjen e sigurisë publike. Një veprim i tillë do të përfshijë, gjithashtu, njoftimin për individin e interesuar, përveç rastit kur Pala ka marrë masat e duhura në mënyrë që të mos ketë më një rrezik të lartë. Njoftimi i individit mund të vonohet ose anashkalohet, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 12/a/i. Pala e njoftuar mund të kërkojë konsultim dhe informacion shtesë, në lidhje me incidentin dhe reagimin ndaj tij.

c) Çdo Palë, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës autoritetin ose autoritetet që do të njoftohen sipas paragrafit 7/b për qëllimet e kreut

II, seksioni 2: informacioni i dhënë mund të ndryshohet më pas.

8. Mbajtja e të dhënave

Çdo Palë do të mbajë të dhëna ose do të ketë mjete të tjera të përshtatshme për të provuar se si aksesohen, përdoren dhe zbulohen të dhënat personale të një individ në një rast specifik.

9. Ndarja e mëtejshme brenda një Pale

a) Kur një autoritet i një Pale i jep të dhëna personale të marra fillimisht sipas këtij Protokollit një autoriteti tjetër të asaj Pale, ai autoritet tjetër do t'i përpunojë në përputhje me këtë nen, sipas paragrafit 9/b.

b) Pavarësisht nga paragrafi 9/a, një Palë që ka bërë rezervë sipas nenit 17, mund t'u japë të dhëna personale që ka marrë, shteteve të saj përbërëse ose subjekteve territoriale të ngjashme, me kusht që Pala të ketë marrë masa në mënyrë që autoritetet marrëse të vazhdojnë të mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat, duke parashikuar një nivel mbrojtjeje të të dhënave të krahasueshëm me atë të parashikuar nga ky nen.

c) Në rast të të dhënave treguese për zbatimin jo të duhur të këtij paragrafi, Pala transferuese mund të kërkojë konsultim dhe informacion përkatës, në lidhje me këto të dhëna treguese.

10. Transferimi i mëtejshëm të një Shteti tjetër ose organizatë ndërkombëtare

a) Pala marrëse mund t'i transferojë të dhënat personale një Shteti tjetër ose organizatë ndërkombëtare vetëm me autorizimin paraprak të autoritetit transferues ose, për qëllimet e kreut II, seksioni 2, autoritetit ose autoriteteve të caktuara, në përputhje me paragrafin 10/b.

b) Çdo Palë, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës autoritetin ose autoritetet për të dhënë autorizimin për qëllimet e kreut II, seksioni 2; informacioni i dhënë mund të ndryshohet më pas.

11. Transparenca dhe njoftimi

a) Çdo Palë do të japë njoftim nëpërmjet publikimit të njoftimeve të përgjithshme ose njoftimit personal për individin, të dhënat personale të të cilit janë marrë, në lidhje me:

i. bazën ligjore dhe qëllimet e përpunimit;

ii. çdo periudhë mbajtjeje ose rishikimi në përputhje me paragrafin 5, sipas rastit;



iii. marrësit ose kategoritë e marrësve të cilëve u jepen të dhëna të tilla; dhe

iv. aksesin, korrigjimin dhe rregullimin e disponueshëm.

b) Një Palë mund t'ia nënshtrojë çdo kërkesë njoftimi personal kufizimeve të arsyeshme sipas kuadrit të saj të brendshëm ligjor, në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 12/a/i.

c) Kur kuadri i brendshëm ligjor i Palës transferuese kërkon dhënien e njoftimit personal për individin, të dhënat e të cilit i janë ofruar një Palë tjetër, Pala transferuese do të marrë masa që Pala tjetër të informohet në momentin e transferimit, në lidhje me këtë kërkesë dhe informacionin e duhur të kontaktit. Njoftimi personal nuk do të jepet nëse Pala tjetër ka kërkuar që ofrimi i të dhënave të ruhet konfidencial, kur zbatohen kushtet për kufizime të përcaktuara në paragrafin 12/a/i. Nëse këto kufizime nuk zbatohen më dhe njoftimi personal mund të jepet, Pala tjetër do të marrë masa që Pala transferuese të informohet. Nëse ende nuk është informuar, pala transferuese ka të drejtë t'i bëjë kërkesa palës marrëse, e cila do të informojë palën transferuese nëse duhet të ruajë kufizimin.

12. Aksesin dhe korrigjimi

a) Çdo Palë do të sigurojë që çdo individ, të dhënat personale të të cilit janë marrë, sipas këtij Protokollit, të ketë të drejtë të kërkojë dhe të marrë, në përputhje me proceset e përcaktuara në kuadrin e saj të brendshëm ligjor dhe pa vonesë të panevojshme:

i. një kopje me shkrim ose elektronike të dokumentacionit të mbajtur për atë individ që përmban të dhënat personale të individit dhe informacionin e disponueshëm që specifikon bazën ligjore dhe qëllimet e përpunimit, periudhat e ruajtjes dhe të marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave ("aksesi"), si dhe informacion në lidhje me opsionet e disponueshme për rregullim; me kusht që aksesin, në një rast të veçantë, të mund t'i nënshtrohet zbatimit të kufizimeve proporcionale të lejuara, sipas kuadrit të saj të brendshëm ligjor, të nevojshme, në kohën e gjyqimit, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose objektiva të rëndësishëm të interesit të përgjithshëm publik dhe që i kushtojnë rëndësinë e duhur interesave legjitimë të individit në fjalë;

ii. korrigjim kur të dhënat personale të individit janë të pasakta ose janë përpunuar në mënyrë jo të

duhur; korrigjimi do të përfshijë – sipas rastit dhe në mënyrë të arsyeshme, duke pasur parasysh arsyet për korrigjim dhe kontekstin e veçantë të përpunimit – korrigjimin, plotësimin, fshirjen ose anonimizimin, kufizimin e përpunimit ose bllokimin.

b) Nëse aksesin ose korrigjimi refuzohet ose kufizohet, Pala do t'i japë individit, në formë të shkruar, e cila mund të ofrohet në mënyrë elektronike, pa vonesë të panevojshme, një përgjigje që e informon atë individ për mohimin ose kufizimin. Ajo do të paraqesë arsyet për një mohim ose kufizim të tillë dhe do të japë informacion në lidhje me opsionet e disponueshme për rregullim. Çdo shpenzim i kryer për marrjen e aksesit duhet të kufizohet në atë që është i arsyeshëm dhe jo i tepruar.

13. Mjetet juridike gjyqësore dhe jogjyqësore

Çdo Palë do të ketë në veprim mjete juridike gjyqësore dhe jogjyqësore efektive për të siguruar rregullim për shkeljet e këtij neni.

14. Mbikëqyrja

Çdo Palë do të ketë në veprim një ose më shumë autoritete publike që ushtrojnë, të vetme ose në mënyrë kumulative, funksione dhe kompetenca të pavarura dhe efektive mbikëqyrëse, në lidhje me masat e përcaktuara në këtë nen. Funksionet dhe kompetencat e këtyre autoriteteve që veprojnë të vetme ose në mënyrë kumulative, përfshijnë kompetencat e hetimit, fuqinë për të vepruar pas ankesave dhe aftësinë për të ndërmarrë veprim korrigjues.

15. Konsultimi dhe pezullimi

Një Palë mund të pezullojë transferimin e të dhënave personale të një Palë tjetër, nëse ka prova thelbësore që Pala tjetër është në shkelje sistematike ose materiale të kushteve të këtij neni ose që një shkelje materiale është e pashmangshme. Ajo nuk do të pezullojë transferimet pa njoftim të arsyeshëm dhe vetëm pasi Palët e interesuara të jenë angazhuar në një periudhë të arsyeshme konsultimi pa arritur një zgjidhje. Megjithatë, një Palë mund të pezullojë përkohësisht transferimet në rast të një shkeljeje sistematike ose materiale që paraqet rrezik thelbësor dhe të pashmangshëm për jetën ose sigurinë, ose dëmtim të konsiderueshëm të reputacionit ose dëm monetar të një personi fizik, rast në të cilin ajo do të njoftojë dhe fillojë konsultimet me Palën tjetër menjëherë më pas. Nëse konsultimi nuk ka arritur në një zgjidhje, Pala



tjetër mund të pezullojë reciprokisht transferimet, nëse ka prova thelbësore që pezullimi nga Pala pezulluese ishte në kundërshtim me kushtet e këtij paragrafi. Pala pezulluese do të heqë pezullimin sapo të jetë korrigjuar shkelja që justifikon pezullimin; çdo pezullim i ndërsjellë do të hiqet në atë kohë. Çdo e dhënë personale e transferuar përpara pezullimit do të vazhdojë të trajtohet në përputhje me këtë Protokoll.

KREU IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15 Efektet e këtij Protokoll

1. a) Neni 39, paragrafi 2 i Konventës do të zbatohet për këtë Protokoll.

b) Në lidhje me Palët që janë anëtare të Bashkimit Evropian, ato Palë, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, mund të zbatojnë legjislacionin e Bashkimit Evropian që rregullon çështjet e trajtuara në këtë Protokoll.

c) Paragrafi 1/b nuk cenon zbatimin e plotë të këtij Protokoll ndërmjet Palëve që janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe Palëve të tjera.

2. Neni 39, paragrafi 3, i Konventës do të zbatohet për këtë Protokoll.

Neni 16 Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga Palët e Konventës, të cilat mund të shprehin pëlqimin për të pasur detyrime ligjore nga:

a) nënshkrimi pa rezerva për ratifikimin, pranimin ose miratimin; ose

b) nënshkrimi që u nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimi, i pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës në të cilën pesë Palë të Konventës kanë shprehur pëlqimin për të pasur detyrime ligjore për këtë Protokoll, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Në lidhje me çdo Palë të Konventës, e cila më pas shpreh pëlqimin për të pasur detyrime ligjore për këtë Protokoll, Protokollin do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën Pala ka shprehur pëlqimin për të pasur detyrime ligjore për këtë Protokoll, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 17 Klauzola federale

1. Një shtet federal mund të rezervojë të drejtën për të marrë përsipër detyrime sipas këtij Protokoll, në përputhje me parimet e tij themelore, që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet qeverisë së tij qendrore dhe shteteve përbërëse ose subjekteve të tjera të ngjashme territoriale, me kusht që:

a) Protokollin do të zbatohet për qeverinë qendrore të shtetit federal;

b) një rezervë e tillë nuk do të cenojë detyrimet për të parashikuar bashkëpunimin e kërkuar nga Palët e tjera, në përputhje me dispozitat e kreut II; dhe

c) dispozitat e nenit 13 do të zbatohen për shtetet përbërëse të shtetit federal ose subjekte të tjera të ngjashme territoriale.

2. Një Palë tjetër mund të ndalojë autoritetet, ofruesit ose subjektet në territorin e saj që të bashkëpunojnë në përgjigje të një kërkesë ose urdhri të paraqitur drejtpërdrejt nga shteti përbërës ose një subjekt tjetër i ngjashëm territorial i një shteti federal që ka bërë rezervë, sipas paragrafit 1, përveç rasteve kur ai shtet federal njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, se një shtet përbërës ose subjekt tjetër i ngjashëm territorial zbaton detyrimet e këtij Protokoll të zbatueshëm për atë Shtet federal. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës krijon dhe mban të përditësuar një regjistër të njoftimeve të tilla.

3. Një Palë tjetër nuk do t'i pengojë autoritetet, ofruesit ose subjektet në territorin e saj që të bashkëpunojnë me një shtet përbërës ose subjekt tjetër të ngjashëm territorial mbi bazën e një rezerve, sipas paragrafit 1, nëse një urdhër ose kërkesë është dorëzuar nëpërmjet qeverisë qendrore ose një marrëveshjeje të grupit të përbashkët hetimor, sipas nenit 12, lidhet me pjesëmarrjen e qeverisë qendrore. Në situata të tilla,



qeveria qendrore do të parashikojë përmbushjen e detyrimeve të zbatueshme të Protokollit, me kusht që në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale që u ofrohet shteteve përbërëse ose subjekteve të ngjashme territoriale, do të zbatohen vetëm kushtet e nenit 14, paragrafi 9 ose kur është e zbatueshme, kushtet e një marrëveshjeje ose rregullimi të përshkruar në nenin 14, paragrafi 1/b ose 1/c.

4. Në lidhje me dispozitat e këtij Protokoll, zbatimi i të cilave përfshihet nën juridiksionin e shteteve përbërëse ose subjekteve të tjera të ngjashme territoriale, që nuk janë të detyruara nga sistemi kushtetues i federatës të marrin masa legislative, qeveria qendrore do të informojë autoritetet e organeve kompetente të këtyre shteteve për dispozitat e lartpërmendura me opinionin e saj miratues, duke i inkurajuar të ndërmarrin veprimet e duhura për t'i bërë të zbatueshme.

Neni 18 Zbatimi territorial

1. Ky Protokoll do të zbatohet për territorin ose territoret e specifikuar në një deklaratë të bërë nga një Palë, sipas nenit 38, paragrafët 1 ose 2 të Konventës, në masën që një deklaratë e tillë nuk është tërhequr sipas nenit 38, paragrafi 3.

2. Një Palë, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokoll, ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, mund të deklarojë se ky Protokoll nuk do të zbatohet në një ose më shumë territore të specifikuar në deklaratën e Palës, sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe/ose 2 të Konventës.

3. Një deklaratë sipas paragrafit 2 të këtij neni, në lidhje me ndonjë territor të specifikuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes të një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 19 Rezervat dhe deklaratat

1. Me një njoftim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, çdo Palë e Konventës, në momentin e nënshkrimit të këtij

Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, mund të deklarojë se përfiton nga rezervat e parashikuara në nenin 7, paragrafët 9/a dhe 9/b, nenin 8, paragrafi 13 dhe nenin 17 të këtij Protokollit. Nuk mund të bëhen rezerva të tjera.

2. Me një njoftim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, çdo Palë e Konventës, në momentin e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, mund të bëjë deklaratë të identifikuar në nenin 7, paragrafët 2/b dhe 8; nenin 8, paragrafi 11; nenin 9, paragrafët 1/b dhe 5; nenin 10, paragrafi 9; nenin 12, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 2 të këtij Protokollit.

3. Me një njoftim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, çdo Palë e Konventës do të bëjë deklaratë, njoftime ose komunikime të identifikuar në nenin 7, paragrafët 5/a dhe e; nenin 8, paragrafi 4, dhe 10/a dhe b; nenin 14, paragrafët 7/c dhe 10/b; dhe nenin 17, paragrafi 2, të këtij Protokollit, sipas kushteve të përcaktuara në të.

Neni 20 Statusi dhe tërheqja e rezervave

1. Një Palë që ka bërë rezervë në përputhje me nenin 19, paragrafi 1, do ta tërheqë këtë rezervë, tërësisht ose pjesërisht, sapo ta lejojnë rrethanat. Një tërheqje e tillë do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Nëse njoftimi përcakton se tërheqja e një rezerve do të hyjë në fuqi në një datë të specifikuar në të, dhe kjo datë është më e vonshme se sa data kur njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm, tërheqja do të hyjë në fuqi në këtë datë të mëvonshme.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës mund të kërkojë periodikisht informacion nga palët që kanë bërë një ose më shumë rezerva, në përputhje me nenin 19, paragrafi 1, në lidhje me mundësitë për tërheqjen e këtyre rezervave.

Neni 21 Ndryshimet

1. Ndryshimet e këtij Protokollit mund të propozohen nga çdo palë e këtij Protokollit dhe do t'u komunikohen nga Sekretari i Përgjithshëm i



Këshillit të Evropës, Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës dhe Palëve dhe nënshkruesve të Konventës, si dhe çdo shteti që është ftuar të aderohet në Konventë.

2. Çdo ndryshim i propozuar nga një Palë do t'i komunikohet Komitetit Evropian për Problemet e Krimit (CDPC), i cili do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave opinionin e tij për atë ndryshim të propozuar.

3. Komiteti i Ministrave do të shqyrtojë ndryshimin e propozuar dhe opinionin e paraqitur nga CDPC-ja dhe pas konsultimit me Palët e Konventës, mund të miratojë ndryshimin.

4. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 3, do t'u përcillet Palëve të këtij Protokollit për pranim.

5. Çdo ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 3 do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë, pasi të gjitha Palët e këtij Protokollit të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tyre.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 45 i Konventës do të zbatohet për këtë Protokoll.

Neni 23

Konsultimet e Palëve dhe vlerësimi i zbatimit

1. Neni 46 i Konventës do të zbatohet për këtë Protokoll.

2. Palët do të vlerësojnë periodikisht përdorimin dhe zbatimin efektiv të dispozitave të këtij Protokollit. Neni 2 i Rregullores së Procedurës të Komitetit të Konventës për Krimet Kibernetike, i rishikuar më 16 tetor 2020, do të zbatohet *mutatis mutandis*. Palët fillimisht do të rishikojnë dhe mund të ndryshojnë me konsensus procedurat e atij neni, siç zbatohen për këtë Protokoll, pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit.

3. Rishikimi i nenit 14 do të fillojë sapo dhjetë Palët e Konventës të kenë shprehur pëlqimin e tyre për të pasur detyrime ligjore për këtë Protokoll.

Neni 24

Denoncimi

1. Çdo Palë, në çdo kohë, mund të denoncojë këtë Protokoll me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Faqe | 17578

2. Ky denoncim do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Denoncimi i Konventës nga një Palë e këtij Protokollit përbën denoncim të këtij Protokollit.

4. Informacioni ose provat e transferuara përpara datës së hyrjes në fuqi të denoncimit, do të vazhdojnë të trajtohen në përputhje me këtë Protokoll.

Neni 25

Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Palët dhe nënshkruesit e Konventës dhe çdo shtet që është ftuar të aderohet në Konventë, në lidhje me:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokollit në përputhje me nenin 16, paragrafët 3 dhe 4;

d) çdo deklaratë ose rezervë të bërë në përputhje me nenin 19 ose tërheqje të rezervave të bëra sipas nenit 20;

e) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave për këtë, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në [VENDI], më [DATA], në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Evropës, palëve dhe nënshkruesve të Konventës dhe çdo shteti që është ftuar të aderohet në Konventë.

Raport shpjegues

1. Protokollit i Dytë Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik për Rritjen e Bashkëpunimit dhe Zbulimin e Provave Elektronike ("ky Protokoll") u miratua nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në takimin e tij [1417bis (17 nëntor 2021)] të zëvendësministrave dhe ky Protokoll u hap për nënshkrim në [VENDI] më



[DATA]. Komiteti i Ministrave, gjithashtu, mori parasysh raportin shpjegues.

2. Teksti i këtij raporti shpjegues synon të orientojë dhe të ndihmojë Palët për zbatimin e këtij Protokollit dhe pasqyron mirëkuptimin e hartuesve për funksionimin e tij.

Hyrje

Informacion paraprak

3. Konventa për Krimin Kibernetik (ETS nr. 185, në vijim e referuar si “Konventa”), që nga hapja e saj për nënshkrim në Budapest, më 23 nëntor 2001, është bërë një instrument me anëtarësim dhe ndikim në të gjitha rajonet e botës.

4. Në vitin 2003, Konventa u plotësua nga Protokollit Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik, në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobe, të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike (ETS nr. 189, në vijim i referuar si “Protokollit i Parë”).

5. Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit ka evoluar dhe transformuar shoqëritë globalisht, në mënyrë të jashtëzakonshme që nga hapja e Konventës për nënshkrim në vitin 2001. Megjithatë, që atëherë ka pasur edhe një rritje të konsiderueshme në shfrytëzimin e teknologjisë për qëllime kriminale. Krimi kibernetik aktualisht konsiderohet nga shumë palë si kërcënim serioz për të drejtat e njeriut, shtetin ligjor dhe funksionimin e shoqërive demokratike. Kërcënimet që rrjedhin nga krimi kibernetik janë të shumta. Shembujt përfshijnë dhunën seksuale në internet ndaj fëmijëve dhe shkelje të tjera kundër dinjitetit dhe integritetit të individëve; vjedhjen dhe shpërdorimin e të dhënave personale që ndikojnë në jetën private të individëve; ndërhyrjen në zgjedhje dhe sulme të tjera kundër institucioneve demokratike; sulme kundër infrastrukturës kritike, të tilla si mohimi i shpërndarë i shërbimit dhe sulmet e *ransomware* (*një lloj softueri i projektuar për bllokimin e aksesit në një sistem kompjuterik derisa të paguhet një shumë monetare) ose shpërdorimi i një teknologjie të tillë për qëllime terroriste. Në vitet 2020 dhe 2021, gjatë pandemisë COVID-19, vendet konstatuan krime të rëndësishme kibernetike të lidhura me COVID-19, duke përfshirë sulme ndaj spitaleve dhe institucioneve mjekësore që zhvillojnë vaksina kundër virusit; shpërdorim të emrave të domeneve

për të promovuar vaksina, trajtime dhe kura të rreme dhe lloje të tjera të veprimtarisë mashtruese.

6. Pavarësisht rritjes së teknologjive të bazuara në analizën dhe interpretimin e të dhënave, të mbështetura nga të dhënat dhe zgjerimit dhe evoluimit keqdashës të krimit kibernetik, konceptet e mishëruara në Konventë janë neutrale ndaj teknologjisë, në mënyrë që e drejta penale materiale të mund të zbatohet si për teknologjitë aktuale, ashtu edhe për teknologjitë e ardhshme, dhe Konventa mbetet vendimtare në luftën kundër krimit kibernetik. Konventa synon kryesisht: i. harmonizimin e elementeve të së drejtës së brendshme materiale penale të veprave dhe dispozitave të lidhura në fushën e krimit kibernetik; ii. parashikimin e kompetencave të së drejtës së brendshme penale procedurale të nevojshme për hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre veprave, si dhe të veprave të tjera të kryera me anë të një sistemi kompjuterik ose që lidhen me përdorimin e provave elektronike të krimeve të tjera; dhe iii. krijimin e një regjimi të shpejtë dhe efektiv të bashkëpunimit ndërkombëtar.

7. Në zbatim të Konventës, Palët respektojnë përgjegjësinë që kanë qeveritë për të mbrojtur individët kundër krimit, pavarësisht nëse ai kryhet në internet ose jashtë rrjetit të internetit, nëpërmjet hetimeve dhe ndjekjeve penale efektive. Në të vërtetë, disa Palë të Konventës konsiderojnë se janë të lidhura nga një detyrim ndërkombëtar për të garantuar mjetet për mbrojtjen kundër krimeve të kryera me anë të një sistemi kompjuterik (*shih KU kundër Finlandës, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (ankimi nr. 2872/ 02, vendim i datës 2 mars 2009)*, duke iu referuar procedurave dhe kompetencave për hetimet penale ose procedimet që Palët duhet të vendosin në përputhje me Konventën).

8. Palët kanë kërkuar vazhdimisht të përmbushin angazhimin e tyre për të luftuar krimin kibernetik, duke u mbështetur në mekanizma dhe organe të ndryshme të krijuara, sipas Konventës dhe duke ndërmarrë hapat e nevojshëm për të mundësuar hetime dhe procedime penale më efektive. Në mënyrë domethënëse, përdorimi dhe zbatimi i Konventës lehtësohen nga Komiteti i Konventës për Krimin Kibernetik (T-CY) i krijuar sipas nenit 46 të Konventës. Gjithashtu, Konventa mbështetet nga programet e ndërtimit të kapaciteteve të zbatuara nga Zyra e Programit të



Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik në Bukuresht, Rumanë, të cilat ndihmojnë vendet në mbarë botën për zbatimin e Konventës. Kjo triadë e: i. standardeve të përbashkëta të Konventës në fushën e krimit kibernetik; së bashku me ii. një mekanizëm të fuqishëm për angazhimin e vazhdueshëm të Palës përmes T-CY; dhe iii. theksi në programet e ndërtimit të kapaciteteve kanë kontribuar ndjeshëm në shtrirjen dhe ndikimin e Konventës.

9. Në vitin 2012, T-CY, në përputhje me mandatin e saj, sipas nenit 46, paragrafi 1 të Konventës, për të shkëmbyer “informacione mbi zhvillime të rëndësishme ligjore, politike apo teknologjike që lidhen me krimin kibernetik dhe marrjen e provave në formë elektronike” dhe për të shqyrtuar “plotësimin ose ndryshimin e mundshëm të Konventës”, ngriti Nëngrupin e Posaçëm për Juridiksionin dhe Aksesin Ndërkufitar në të Dhëna (“Grupi Ndërkufitar”). Në dhjetor 2014, T-CY përfundoi, gjithashtu, një vlerësim të dispozitave të ndihmës së ndërsjellë të Konventës për Krimin Kibernetik dhe miratoi një sërë rekomandimesh, duke përfshirë disa që do të trajtoheshin në një Protokoll të ri të Konventës. Këto përpjekje çuan në krijimin në vitin 2015 të Grupit të Punës mbi Aksesin në Drejtësinë Penale në provat e ruajtura në *Cloud* (*serverë të aksesuar në internet), duke përfshirë nëpërmjet Ndihmës së Ndërsjellë Juridike (“Grupi për Provat në *Cloud*”).

10. Në vitin 2016, Grupi për Provat në *Cloud* nxori përfundimin, ndër të tjera, se “krimi kibernetik, numri i pajisjeve, shërbimeve dhe përdoruesve (përfshirë pajisjet dhe shërbimet celulare) dhe me këto numri i viktimave ka arritur përmasa saqë vetëm një pjesë shumë e vogël e krimit kibernetik ose veprave të tjera që përfshijnë prova elektronike do të regjistrohen dhe hetohen ndonjëherë. Shumica dërmuese e viktimave të krimit kibernetik nuk mund të presin që drejtësia të vihet në vend”. Sfidat kryesore të identifikuara nga grupi ishin të lidhura me “llogaritjen e *Cloud*, territorialitetin dhe juridiksionin” dhe në këtë mënyrë, me vështirësitë për të siguruar akses efikas ose zbulimin e provave elektronike.

11. Në shqyrtimin e konkluzioneve të Grupit për Provat në *Cloud*, Palët e Konventës arritën në përfundimin se nuk ishte i nevojshëm ndryshimi i Konventës ose parashikimi i kriminalizimit shtesë nëpërmjet dispozitave të së drejtës penale materiale.

Megjithatë, Palët vendosën se nevojiteshin masa shtesë për të rritur bashkëpunimin dhe aftësinë e autoriteteve të drejtësisë penale për të marrë prova elektronike nëpërmjet një Protokolli të Dytë Shtesë, në mënyrë që të mundësohet një reagim më efektiv i drejtësisë penale dhe të mbështetet shteti ligjor.

Puna përgatitore

12. Sesioni i 17-të Plenar i T-CY (8 qershor 2017) miratoi termat e referencës për përgatitjen e këtij Protokolli bazuar në një propozim të përgatitur nga Grupi për Provat në *Cloud* T-CY. Ajo vendosi të fillojë hartimin e këtij Protokolli me nismën e vet, sipas nenit 46, paragrafi 1/c të Konventës. Më 14 qershor 2017, Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës informoi Komitetin e Ministrave (takimi i 1289-të i Zëvendësministrave) për këtë nismë T-CY.

13. Termat e referencës fillimisht mbulonin periudhën nga shtatori 2017 deri në dhjetor 2019 dhe ato u shtynë më pas nga T-CY për në dhjetor 2020 dhe sërish në maj 2021.

14. Sipas këtyre termave të referencës, T-CY ngriti një Sesion Plenar për Hartimin e Protokollit (PDP) të përbërë nga përfaqësues të Palëve të Konventës dhe nga shtete, organizata dhe organe të Këshillit të Evropës me status vëzhguesi në T-CY, si vëzhgues. PDP-ja u asistua në përgatitjen e draftprotokollit nga një grup hartues i protokollit (PDG) i përbërë prej ekspertëve nga Palët e Konventës. Nga ana tjetër, PDG-ja krijoi disa nëngrupe dhe grupe të posaçme për të punuar për dispozita specifike.

15. Midis muajve shtator 2017 dhe maj 2021, T-CY mbajti 10 sesione plenar hartues, 16 mbledhje të grupeve hartuese dhe mbledhje të shumta të nëngrupeve dhe grupeve të posaçme. Pjesa më e madhe e këtij Protokolli u përgatit gjatë pandemisë COVID-19. Për shkak të kufizimeve të lidhura me COVID-19, midis marsit 2020 dhe majit 2021, më shumë se 65 mbledhje u zhvilluan në format virtual.

16. Metodot e mësipërme të punës në sesionet plenare, grupet e hartimit dhe nëngrupet dhe grupet e posaçme lejuan përfaqësuesit dhe ekspertët nga Palët që të kontribuojnë gjerësisht në hartimin e këtij Protokolli dhe të zhvillojnë zgjidhje novatore.



17. Komisioni i Bashkimit Evropian mori pjesë në këtë punim në emër të shteteve palë të Konventës që ishin anëtare të Bashkimit Evropian nën një mandat negocimi të dhënë nga Këshilli i Bashkimit Evropian më 6 qershor 2019.

18. Pas përgatitjes së draftdispozitave dhe miratimit të tyre përkohësisht nga PDP-ja, draftnenet u publikuan dhe palët e interesuara u ftuan të paraqisnin komente.

19. T-CY mbajti gjashtë raunde konsultimesh me palët e interesuara nga shoqëria civile dhe sektori privat, dhe me ekspertë të mbrojtjes së të dhënave. Kjo ishte në lidhje me Konferencën Octopus për Bashkëpunimin kundër Krimit Kibernetik në Strasburg në korrik 2018; me ekspertë të mbrojtjes së të dhënave në Strasburg në nëntor 2018; nëpërmjet ftesës për komente me shkrim për draftnenet në shkurt 2019; në bashkëpunim me Konferencën Octopus për Bashkëpunimin kundër Krimit Kibernetik në Strasburg në nëntor 2019; nëpërmjet ftesës për komente me shkrim mbi projektnenet e mëtejshme në dhjetor 2020; dhe në maj 2021 nëpërmjet parashtrimeve me shkrim dhe një mbledhjeje virtuale të mbajtur më 6 maj 2021.

20. T-CY u konsultua, gjithashtu, me Komitetin Evropian për Problemet e Krimit (CDPC) dhe Komitetin Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (T-PD) të Këshillit të Evropës.

21. Sesioni Plenar i 24-të të T-CY, më 28 maj 2021, miratoi draftin e këtij Protokolli dhe vendosi t'ia paraqesë Komitetit të Ministrave në funksion të miratimit.

Konsideratat materiale

22. Për sa i përket përmbajtjes, puna për këtë Protokoll filloi me rezultatet e vlerësimit të TCY-së të dispozitave të ndihmës së ndërsjellë të Konventës në vitin 2014 dhe analizat dhe rekomandimet e Grupit Ndërkufitar T-CY dhe Grupit për Provat në *Cloud*, përkatësisht në vitet 2014 dhe 2017. Të një shqetësimi të veçantë ishin sfidat e territorialitetit dhe të juridiksionit, në lidhje me provat elektronike, d.m.th. që të dhënat e specifikuara të nevojshme në një hetim penal mund të ruhen në juridiksione të shumëfishta, të zhvendosura ose të panjohura ("në *Cloud*") dhe se nevojiten zgjidhje për të garantuar zbulimin e të dhënave të tilla në mënyrë efektive dhe efikase për

qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike.

23. Duke pasur parasysh kompleksitetin e këtyre sfidave, hartuesit e këtij Protokolli ranë dakord të fokusoheshin në çështjet specifike të mëposhtme:

Në kohën e hartimit të këtij Protokolli, kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ishin metoda kryesore për marrjen e provave elektronike të një vepre penale nga shtetet e tjera, duke përfshirë mjetet e ndihmës së ndërsjellë të Konventës. Megjithatë, ndihma e ndërsjellë nuk është gjithmonë mënyrë efikase për të përpunuar një numër në rritje të kërkesave për prova të paqëndrueshme elektronike. Si rrjedhojë, u çmua e nevojshme të zhvillohej një mekanizëm më i efektshëm për lëshimin e urdhrave ose kërkesave për ofruesit e shërbimeve në Palët e tjera për të prodhuar informacionin e abonentit dhe të dhënat e trafikut.

Informacioni i abonentit – për shembull, për të identifikuar përdoruesin e një llogarie të veçantë të postës elektronike ose mediave sociale ose të një adrese specifike të Protokollit të Internetit (IP) të përdorur në kryerjen e një vepre penale – është informacioni më i kërkuar në hetimet penale lokale dhe ndërkombëtare, në lidhje me krimin kibernetik dhe krime të tjera që përfshijnë prova elektronike. Pa këtë informacion, shpesh është e pamundur të vijohet me një hetim. Marrja e informacionit të abonentëve nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë në shumicën e rasteve nuk është efektive dhe mbingarkon sistemin e ndihmës së ndërsjellë. Informacioni i abonentëve zakonisht mbahet nga ofruesit e shërbimeve. Ndërsa neni 18 i Konventës trajton tashmë disa aspekte të marrjes së informacionit të abonentit nga ofruesit e shërbimeve (shihni shënimin udhëzues T-CY mbi nenin 18), duke përfshirë në Palët e tjera, mjetet plotësuese u çmuan të nevojshme për të garantuar zbulimin drejtpërdrejt të informacionit të abonentit nga një ofrues shërbimi në një Palë tjetër. Këto mjete do të rrisnin efikasitetin e procesit dhe, gjithashtu, do të lehtësonin presionin mbi sistemin e ndihmës së ndërsjellë.

Të dhënat e trafikut, gjithashtu, kërkohen shpesh në hetimet penale dhe zbulimi i tyre i shpejtë mund të jetë i nevojshëm për të gjurmuar burimin e një komunikimi si pikënisje për marrjen e provave të mëtejshme ose për të identifikuar një të dyshuar.



Në mënyrë të ngjashme, meqë shumë forma të krimit në internet lehtësohen nga domenet e krijuara ose të shfrytëzuara për qëllime kriminale, është e nevojshme të identifikohet personi që ka regjistruar një domen të tillë. Një informacion i tillë mbahet nga subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrave të domeneve, d.m.th., zakonisht nga regjistruesit dhe regjistrat. Si rrjedhojë, nevojitet një kuadër efikas për marrjen e këtij informacioni nga subjektet përkatëse në Palë të tjera.

Në një situatë urgjente, kur ka një rrezik të lartë dhe të pashmangshëm për jetën ose sigurinë e ndonjë personi fizik, nevojitet veprim i shpejtë ose duke ofruar ndihmë të ndërsjellë emergjente, ose duke përdorur pikat e kontaktit për Rrjetin 24/7 të krijuar në bazë të Konventës (neni 35).

Përveç kësaj, mjetet e provuara të bashkëpunimit ndërkombëtar duhet të përdoren më gjerësisht dhe ndërmjet të gjitha Palëve. Masa të rëndësishme, të tilla si videokonferencat ose ekipet e përbashkëta hetimore, janë tashmë të disponueshme sipas traktateve të Këshillit të Evropës (për shembull, Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale, ETS nr. 182) ose marrëveshjeve të tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe. Megjithatë, mekanizma të tillë nuk janë universalisht të disponueshëm midis Palëve të Konventës dhe ky Protokoll synon të plotësojë këtë boshllëk.

Konventa parashikon mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit dhe provave për hetime ose procedime penale specifike. Hartuesit pranuan se krijimi, kryerja dhe zbatimi i kompetencave dhe i procedurave, në lidhje me hetimet dhe ndjekjet penale duhet të jetë gjithmonë objekt i kushteve dhe i garancive që sigurojnë mbrojtjen e duhur të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Si rrjedhojë, ishte e nevojshme të përfshihej një nen mbi kushtet dhe garancitë, i ngjashëm me nenin 15 të Konventës. Gjithashtu, duke njohur kërkesën në shumë Palë për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat personale në mënyrë që të përmbushin detyrimet e tyre kushtetuese dhe ndërkombëtare, hartuesit vendosën të parashikojnë garanci specifike për mbrojtjen e të dhënave në këtë Protokoll. Garanci të tilla për mbrojtjen e të dhënave plotësojnë detyrimet e shumë prej Palëve të Konventës, të cilat janë, gjithashtu, Palë të Konventës për

Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS Nr. 108). Protokollin ndryshues i kësaj Konvente (CETS nr. 223) u hap për nënshkrim gjatë hartimit të këtij Protokollin në tetor 2018. Duhet të theksohet, gjithashtu, se procesi i hartimit të këtij Protokollin përfshinte Palë që nuk i nënshtroheshin, në atë kohë, instrumenteve të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të dhënave ose rregullave të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave. Si rrjedhojë, u ndërmorën përpjekje të konsiderueshme për të siguruar një Protokoll të balancuar që pasqyron shumë sisteme ligjore të shteteve që mund të jenë Palë të këtij Protokollin, duke respektuar rëndësinë e garantimit të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale, siç kërkohet nga kushtetutat dhe detyrimet ndërkombëtare të Palëve të tjera ndaj Konventës.

24. Hartuesit kanë shqyrtuar edhe masa të tjera të cilat, pas diskutimeve të hollësishme, nuk janë ruajtur në këtë Protokoll. Dy nga këto dispozita, përkatësisht, “hetimet e fshehta me anë të një sistemi kompjuterik” dhe “zgjerimi i kërkimeve”, ishin me interes të lartë për Palët, por u konstatua se kërkonin punë, kohë dhe konsultime shtesë me palët e interesuara, dhe për këtë arsye nuk u morën parasysh si të mundshme brenda afatit kohor të caktuar për përgatitjen e këtij Protokollin. Hartuesit propozuan që të ndiqen në një format tjetër dhe mundësisht në një instrument ligjor të veçantë.

25. Në përgjithësi, hartuesit besonin se dispozitat e këtij Protokollin do të ishin mjaft të vlefshme, si nga pikëpamja operationale, ashtu edhe nga ajo politike. Ky Protokoll do të përmirësojë ndjeshëm aftësinë e Palëve për të rritur bashkëpunimin ndërmjet Palëve dhe ndërmjet Palëve dhe ofruesve të shërbimeve dhe subjekteve të tjera, dhe për të garantuar zbulimin e provave elektronike për qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike. Kështu, ky Protokoll, ashtu si Konventa, synon të rrisë aftësinë e autoriteteve ligjzbatuese për të luftuar krimin kibernetik dhe çdo krim tjetër, duke respektuar plotësisht të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, dhe thekson rëndësinë dhe vlerën e një interneti të ndërtuar në bazë të rrjedhës së lirë të informacionit.

Ky Protokoll

26. Siç përcaktohet në Hyrje, ky Protokoll synon të përmirësojë më tej bashkëpunimin për krimin kibernetik dhe aftësinë e autoriteteve të drejtësisë



penale për të marrë prova në formë elektronike për një vepër penale për qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike me anë të mjeteve shtesë që lidhen me ndihmë të ndërsjellë më efikase dhe forma të tjera bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente; bashkëpunimi në raste urgjente (d.m.th. në situata kur ekziston një rrezik i lartë dhe i pashmangshëm për jetën ose sigurinë e ndonjë personi fizik); dhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë midis autoriteteve kompetente dhe ofruesve të shërbimeve dhe subjekteve të tjera që zotërojnë ose kontrollojnë informacionin përkatës. Si rrjedhojë, qëllimi i këtij Protokoll është që të plotësojë Konventën dhe, ndërmjet Palëve të saj, Protokollin e Parë.

27. Ky Protokoll është i ndarë në katër krerë: I. “Dispozitat e përbashkëta”; II. “Masat për rritje të bashkëpunimit”; III. “Kushtet dhe garancitë”; dhe IV. “Dispozitat përfundimtare”.

28. Dispozitat e përbashkëta të kreut I mbulojnë qëllimin dhe objektin e këtij Protokoll. Siç është rasti për Konventën, ky Protokoll lidhet me hetime ose procedime penale specifike, jo vetëm në lidhje me krimin kibernetik, por me çdo vepër penale që përfshin prova në formë elektronike, të referuara zakonisht si “prova elektronike” ose “prova digjitale”. Ky krye bën, gjithashtu, përkufizime të Konventës të zbatueshme për këtë Protokoll dhe përmban përkufizime shtesë të termave të përdorur shpesh në këtë Protokoll. Për më tepër, duke pasur parasysh se kërkesat gjuhësore për ndihmën e ndërsjellë dhe forma të tjera bashkëpunimi shpesh pengojnë efikasitetin e procedurave, u shtua një nen mbi “gjuhën” për të lejuar një qasje më pragmatike në këtë drejtim.

29. Kreu II përmban nenet kryesore materiale të këtij Protokoll, të cilët përshkruajnë metoda të ndryshme bashkëpunimi në dispozicion të Palëve. Për çdo lloj bashkëpunimi zbatohen parime të ndryshme. Për këtë arsye, ishte e nevojshme që ky krye të ndahej në seksione, me: 1. parimet e përgjithshme të zbatueshme për kreun II; 2. procedurat që rrisin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me ofruesit dhe subjektet në Palët e tjera; 3. procedurat që rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet autoriteteve për zbulimin e të dhënave të ruajtura kompjuterike; 4. procedurat që lidhen me ndihmën e ndërsjellë në raste urgjente; dhe 5. procedurat që lidhen me bashkëpunimin

ndërkombëtar në mungesë të marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme.

30. Kreu III parashikon kushtet dhe garancitë. Ato kërkojnë që Palët të zbatojnë kushte dhe garanci të ngjashme me nenin 15 të Konventës edhe për kompetencat dhe procedurat e këtij Protokoll. Përveç kësaj, ky krye përfshin një grup të detajuar të garancive për mbrojtjen e të dhënave personale.

31. Shumica e dispozitave përfundimtare të kreut IV janë të ngjashme me dispozitat përfundimtare standarde të traktateve të Këshillit të Evropës ose i bëjnë dispozitat e Konventës të zbatueshme për këtë Protokoll. Megjithatë, neni 15 për “Efektet e këtij Protokoll”, neni 17 për “Klauzolën Federale” dhe neni 23 për “Konsultimet e Palëve dhe vlerësimi i zbatimit” ndryshojnë në shkallë të ndryshme nga dispozitat e ngjashme të Konventës. Ky nen i fundit jo vetëm që e bën të zbatueshëm nenin 46 të Konventës, por edhe parashikon që përdorimi efektiv dhe zbatimi i dispozitave të këtij Protokoll do të vlerësohen periodikisht nga Palët.

KOMENTAR MBI NENET E KËTJ PROTOKOLLI

KREU I DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Neni 1 Qëllimi

32. Qëllimi i këtij Protokoll është që të plotësojë: i. Konventën ndërmjet Palëve të këtij Protokoll; dhe ii. Protokollit të Parë ndërmjet Palëve të tij që janë, gjithashtu, Palë të këtij Protokoll.

Neni 2 Fusha e zbatimit

33. Fusha e përgjithshme e zbatimit të këtij Protokoll është e njëjtë me atë të Konventës: masat e këtij Protokoll do të zbatohen, si ndërmjet Palëve të këtij Protokoll, për hetime ose procedime penale specifike për vepra penale që lidhen me sisteme dhe të dhëna kompjuterike (d.m.th., veprat e përfshira në nenin 14 të Konventës, paragrafi 2/a dhe b), si dhe për marrjen e provave, në formë



elektronike, të një veprë penale (neni 14 i Konventës, paragrafi 2/c. Siç shpjegohet në paragrafët 141 dhe 243 të raportit shpjegues të Konventës, kjo do të thotë se ose kur krimi kryhet duke përdorur një sistem kompjuterik, ose kur një krim jo i kryer nga përdorimi i një sistemi kompjuterik (për shembull një vrasje) përfshin prova elektronike, kompetencat, procedurat dhe masat e bashkëpunimit të krijuara nga ky Protokoll synohen të jenë të disponueshme.

34. Paragrafi 1/b përcakton se ndërmjet Palëve të Protokollit të Parë që janë, gjithashtu, Palë të këtij Protokoll, ky Protokoll zbatohet edhe për hetimet ose procedurat penale specifike në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me Protokollin e Parë. Palët e këtij Protokoll që nuk janë Palë të Protokollit të Parë nuk marrin përsipër asnjë detyrim që të zbatojnë kushtet e këtij Protokoll për ato vepra penale.

35. Sipas paragrafit 2, secilës palë i kërkohet të ketë një bazë ligjore për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë Protokoll, nëse traktatet, ligjet ose marrëveshjet e saj nuk përmbajnë tashmë dispozita të tilla. Kjo nuk i ndryshon dispozitat shprehimisht diskrecionale në ato të detyrueshme dhe disa dispozita lejojnë deklarata ose rezerva. Disa Palë mund të mos kërkojnë legjislacion zbatues për zbatimin e dispozitave të këtij Protokoll.

Neni 3 Përkufizimet

36. Paragrafi 1 përfshin përkufizimet e dhëna në nenin 1 (“sistemi kompjuterik”, “të dhënat kompjuterike”, “ofruesi i shërbimit” dhe “të dhënat e trafikut”) dhe 18, paragrafi 3 (“informacionet e abonentëve”) të Konventës në këtë Protokoll. Hartuesit përfshinë këto përkufizime nga Konventa, sepse këta terma janë përdorur në tekstin operativ dhe në raportin shpjegues të këtij Protokoll. Hartuesit synonin, gjithashtu, që shpjegimet e dhëna në raportin shpjegues të Konventës dhe në shënimet udhëzuese (të miratuara nga T-CY), në lidhje me këta terma, do të zbatoheshin njëjloj për këtë Protokoll.

37. Përkufizimet e veprave penale dhe të termave të tjerë të përfshirë në tekstin e Konventës synojnë të zbatohen për qëllime bashkëpunimi ndërmjet Palëve të këtij Protokoll, si dhe

përkufizimet e veprave penale dhe termave të tjerë të përfshirë në tekstin e Protokollit të Parë synohen të zbatohen për qëllime bashkëpunimi ndërmjet Palëve të Protokollit të Parë. Për shembull, neni 2, paragrafi 1 parashikon, se: “masat e përshkruara në këtë Protokoll do të zbatohen... [a] ndërmjet Palëve të Konventës që janë Palë të këtij Protokoll, për hetime apo procedime penale specifike për vepra penale të lidhura me sistemet dhe të dhënat kompjuterike”. Si rrjedhojë, kur bashkëpunohet sipas këtij Protokoll për veprat penale që lidhen me pornografinë e fëmijëve, zbatohet përkufizimi i “pornografisë së fëmijëve” në nenin 9, paragrafi 2 i Konventës dhe zbatohet përkufizimi i “të miturit” në nenin 9, paragrafi 3 të Konventës. Në mënyrë të ngjashme, midis Palëve të Protokollit të Parë që janë Palë të këtij Protokoll, zbatohet përkufizimi i “materialit racist dhe ksenofob” në nenin 2 të Protokollit të Parë. Palët e këtij Protokoll që nuk janë Palë të Protokollit të Parë nuk marrin përsipër asnjë detyrim që të zbatojnë termat ose përkufizimet e përcaktuara në Protokollin e Parë.

38. Paragrafi 2 i nenit 3 përfshin përkufizime shtesë që zbatohen për këtë Protokoll dhe bashkëpunimin sipas këtij Protokoll. Paragrafi 2/a e përkufizon “autoritetin qendror” si “autoritetin ose autoritetet e përcaktuara sipas një traktati ose rregullimi të ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi midis Palëve të interesuara, ose në mungesë të tij, autoritetin ose autoritetet e caktuara nga një Palë sipas nenit 27, paragrafi 2/a të Konventës”. Ky Protokoll përdor autoritetet qendrore në disa nene për të ofruar bashkëpunim nëpërmjet një kanali që Palët tashmë e përdorin dhe e njohin. Si rrjedhojë, Palëve që kanë traktate ose rregullime të ndihmës së ndërsjellë në bazë të legjislacionit uniform ose të ndërsjellë, u kërkohet të përdorin autoritetet qendrore të përcaktuara, sipas këtyre traktateve ose rregullimeve. Kur nuk ekziston një traktat apo rregullim i tillë ndërmjet Palëve të interesuara, atyre Palëve u kërkohet të përdorin të njëjtin kanal të autoritetit qendror që përdorin aktualisht, sipas nenit 27, paragrafi 2/a të Konventës. Edhe pse jo të gjitha traktatet ose rregullimet e ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë, do të përdorin termin “autoritet qendror”, hartuesit synuan që ky term t’u referohej autoriteteve koordinuese të përcaktuara në traktate



ose rregullime të tilla, sido që të jenë emërtuar në to.

39. Përveç kur parashikohet specifikisht në këtë Protokoll, fakti që Palët angazhojnë kanale të tilla të autoritetit qendror për qëllimin e këtij Protokoll nuk nënkupton se zbatohen dispozitat e tjera të atyre traktateve ose rregullimeve të ndihmës së ndërsjellë.

40. Përkufizimi i “autoritetit kompetent” sipas paragrafit 2/b është modeluar sipas paragrafit 138 të raportit shpjegues të Konventës. Meqë ky term përdoret shpesh në këtë Protokoll, përkufizimi u vendos në tekstin operativ për lehtësi referimi.

41. Paragrafi 2/c e përkufizon “urgjencën” si “një situatë në të cilën ekziston një rrezik i lartë dhe i pashmangshëm për jetën ose sigurinë e ndonjë personi fizik”. Ky term përdoret në nenet 9, 10 dhe 12. Përkufizimi i “urgjencës” në këtë Protokoll synon të vendosë një kufi dukshëm më të lartë sesa “rrethanat urgjente” sipas nenit 25, paragrafi 3 të Konventës. Ky përkufizim u hartua, gjithashtu, për t'i lejuar Palët të marrin në konsideratë kontekstet e ndryshme në të cilat termi përdoret në këtë Protokoll, duke pasur parasysh ligjet dhe politikat e zbatueshme të palëve.

42. Përkufizimi i urgjencës mbulon situatat në të cilat rreziku është i lartë dhe i pashmangshëm, që do të thotë se nuk përfshin situata në të cilat rreziku për jetën ose sigurinë e personit ka kaluar tashmë ose është i papërfillshëm, ose në të cilat mund të ketë një rrezik të ardhshëm që nuk është i pashmangshëm. Arsyeja për këto kërkesa të rëndësisë dhe pashmangshmërisë është se nenet 9 dhe 10 vendosin detyrime intensive të punës si për palët kërkuuese, ashtu edhe për palët e kërkuara për të reaguar në një mënyrë tejte të përshpejtuar në raste urgjente, çka rrjedhimisht kërkon që kërkesave të urgjencës t'u jepet një prioritet më i lartë se sa rasteve të tjera të rëndësishme por disi më pak urgjente, edhe nëse ato do të ishin paraqitur më herët. Situatat që përfshijnë “një rrezik të lartë dhe të pashmangshëm për jetën ose sigurinë e ndonjë personi fizik” mund të përfshijnë, për shembull, situata pengjesh në të cilat ekziston një rrezik i besueshëm i humbjes së afërt të jetës, lëndimit serioz ose dëmi tjetër të krahasueshëm për viktimit; abuzimin seksual të vazhdueshëm të një fëmije; skenarë të menjëhershëm sulmesh postterroriste, në të cilat autoritetet kërkojnë të përcaktojnë se me cilin kanë komunikuar sulmuesit,

në mënyrë që të përcaktojnë nëse sulme të mëtejshme janë të pashmangshme; dhe kërcënimet ndaj sigurisë së infrastrukturës kritike, në të cilat ekziston një rrezik i lartë dhe i pashmangshëm për jetën ose sigurinë e një personi fizik.

43. Siç shpjegohet në nenin 10, paragrafi 4, të këtij Protokoll dhe në paragrafin 154 të këtij raporti shpjegues, i cili lidhet me nenin 9, një Palë e kërkuar sipas këtyre neneve do të përcaktojë nëse ekziston një “urgjencë”, duke zbatuar përkufizimin në këtë nen.

44. Paragrafi 2/d përkufizon “të dhëna personale” si “informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm”. Një “person fizik i identifikueshëm” synohet t'i referohet një personi që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke iu referuar, në veçanti, një numri identifikimi ose një ose më shumë faktorëve specifikë për identitetin e tij ose të saj fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social. Përkufizimi i “të dhënave personale”, sipas këtij Protokoll është në përputhje me atë në instrumente të tjera ndërkombëtare, si Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, e ndryshuar nga Protokoll i saj Shtesë, udhëzimet e vitit 2013 të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) që Rregullojnë Mbrojtjen e Privatësisë dhe Flukset Ndërkufitare të të Dhënave Personale, Rregullorja e Përgjithshme e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Direktiva Ligjzbatuese për Mbrojtjen e të Dhënave, dhe Konventa e Bashkimit Afrikan për Sigurinë Kibernetike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“Konventa Malabo”).

45. Një individ nuk konsiderohet “i identifikueshëm”, nëse identifikimi do të kërkonte kohë, përpjekje ose burime të paarsyeshme. Ndërsa një informacion i caktuar mund të jetë unik për një individ të caktuar dhe kështu krijon një lidhje me atë person në vetvete, informacione të tjera mund të lejojnë identifikimin vetëm kur kombinohen me informacione shtesë personale ose identifikuese. Si rrjedhojë, nëse identifikimi i një individi bazuar në lidhjen me një informacion të tillë shtesë, do të kërkonte kohë, përpjekje ose burime të paarsyeshme, informacioni në fjalë nuk përbën të dhëna personale. Nëse një person fizik mund të identifikohet ose është i identifikueshëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi, varet nga rrethanat e



veçanta në kontekstin e tyre specifik (dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës me zhvillime teknologjike ose zhvillime të tjera).

46. Kërkesat për mbrojtjen e të dhënave të përcaktuara në këtë Protokoll nuk zbatohen për të dhënat që nuk janë “të dhëna personale”, të tilla si informacionet anonime që nuk mund të riidentifikohen pa kohë, përpjekje ose burime të paarsyeshme.

Neni 4 Gjuha

47. Neni 4 ofron një kuadër për gjuhët që mund të përdoren kur u drejtohen Palëve dhe ofruesve të shërbimeve ose subjekteve të tjera në zbatim të këtij Protokoll. Edhe kur në praktikë Palët janë të afta të punojnë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët e tyre zyrtare, një mundësi e tillë mund të mos parashikohet nga traktatet ose legjislacioni i brendshëm. Objektivi i këtij neni është të sigurojë fleksibilitet shtesë sipas këtij Protokoll.

48. Përkthimet e pasakta ose të kushtueshme të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë në lidhje me provat elektronike janë një ankesë kronike që kërkon vëmendje urgjente. Kjo pengesë shkatërron gradualisht proceset legjitime për marrjen e të dhënave dhe mbrojtjen e sigurisë publike. Të njëjtat konsiderata zbatohen jashtë ndihmës së ndërsjellë tradicionale, si p.sh. kur një Palë i transmeton një urdhër drejtpërdrejt një ofruesi shërbimi në territorin e një Pale tjetër sipas nenit 7, ose kërkon të zbatojë një urdhër sipas nenit 8. Ndërsa aftësitë e përkthimit digjital pritet të përmirësohen, aktualisht janë të pamjaftueshme. Për këto arsye, problemi i përkthimit është përmendur vazhdimisht në propozimet për nenet që do të përfshihen në këtë Protokoll.

49. Përkthimi në dhe nga gjuhët më pak të përhapura është një problem i veçantë pasi përkthime të tilla mund të vonojnë ndjeshëm një kërkesë ose mund të jenë efektivisht të pamundura për t'u siguruar. Gjithashtu, ato mund të jenë tejet çorientuese dhe cilësia e tyre e dobët mund të humbë kohën e të dyja Palëve. Megjithatë, kostoja dhe vështirësia e përkthimeve bien në mënyrë disproporcionale mbi Palët kërkuese ku fliten gjuhë më pak të përhapura.

50. Për shkak të kësaj barre disproporcionale, një numër Palësh joanglofone kërkuar që gjuha

angleze të jetë e autorizuar në këtë Protokoll. Ato theksuan se anglishtja është një gjuhë e përdorur zakonisht nga ofruesit kryesorë të shërbimeve. Për më tepër, ndërsa të dhënat zhvendosen dhe ruhen më gjerësisht në botë dhe më shumë vende përfshihen në ndihmën ndaj njëri-tjetrit, përkthimi mund të bëhet edhe më i vështirë dhe jopraktik. Për shembull, dy Palë mund të përdorin një gjuhë më pak të përhapur, të jenë me largësi gjeografike dhe të kenë kontakt të pakët. Nëse papritur Pala A ka nevojë për ndihmën e Palës B, ajo mund të mos jetë në gjendje të gjejë një përkthyes për gjuhën e B ose një përkthim eventual mund të jetë më pak i kuptueshëm se sa anglishtja joamtare. Hartuesit theksuan veçanërisht se, për të përsheptuar ndihmën, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të pranuar, në veçanti, kërkesat urgjente sipas këtij Protokoll në anglisht ose në një gjuhë të përbashkët në vend që të kërkohej përkthim në gjuhën zyrtare të Palës së kërkuar.

51. Hartuesit e këtij Protokoll arritën në përfundimin se gjuha angleze nuk duhet të jetë e autorizuar në këtë Protokoll. Disa Palë kanë kërkesa të gjuhës zyrtare që e përjashtojnë një autorizim të tillë; shumë Palë ndajnë një gjuhë dhe nuk kanë nevojë për gjuhën angleze dhe në disa Palë, zyrtarët jashtë kryeqyteteve kanë më pak gjasa të mund të lexojnë anglisht, por shpesh përfshihen në ekzekutimin e kërkesave.

52. Kështu, paragrafi 1 shprehet në termat e “një gjuhe të pranueshme për Palën e kërkuar ose Palën e njoftuar sipas nenit 7”. Kjo Palë mund të specifikojë gjuhët e pranueshme – për shembull gjuhët e folura gjerësisht si anglishtja, spanjishtja ose frëngjishtja – edhe kur nuk parashikohen në legjislacionin ose traktatet e saj të brendshme.

53. Siç përdoret në paragrafin 1, kërkesat, urdhrat dhe informacioni shoqërues i referohen:

- sipas nenit 8, kërkesës (paragrafi 3), urdhrit (paragrafi 3/a), informacionit mbështetës (paragrafi 3/b) dhe çdo udhëzimi të veçantë procedural (paragrafi 3/c);

- për Palët që kërkojnë njoftim sipas nenit 7, paragrafi 5, urdhrit (paragrafi 3), informacionit shtesë (paragrafi 4) dhe përmbledhjes së fakteve (paragrafi 5/a); – sipas nenit 9, kërkesës (paragrafi 3).

“Kërkesat” i referohen, gjithashtu, përmbajtjes së kërkesave, sipas neneve 10, 11 dhe 12 që



përfshin dokumentacionin që është pjesë e kërkesës.

54. Në praktikë, disa vende mund të përgatiten të pranojnë kërkesa dhe urdhra në një gjuhë të ndryshme nga ajo e gjuhës së përcaktuar në legjislacionin e brendshëm ose në traktate. Kështu, një herë në vit, T-CY do të angazhohet në një studim jozyrtar të gjuhëve të pranueshme për kërkesat dhe urdhrat. Palët mund të ndryshojnë informacionin e tyre në çdo kohë dhe të gjitha Palët do të njoftohen për çdo ndryshim të tillë. Ato mund të deklarojnë se pranojnë vetëm gjuhë të specifikuara për forma të caktuara të ndihmës. Rezultatet e këtij studimi do të jenë transparente për të gjitha Palët e Konventës, jo vetëm për Palët e këtij Protokoll.

55. Kjo dispozitë pragmatike provon rëndësinë ekstreme të përsheptimit të bashkëpunimit. Ajo siguron një bazë traktati që një Palë të pranojë gjuhë shtesë për qëllime të këtij Protokoll.

56. Në shumë raste, Palët kanë lidhur traktate të ndihmës së ndërsjellë që specifikojnë gjuhën ose gjuhët në të cilat duhet të dorëzohen kërkesat sipas këtyre traktateve. Ky nen nuk ndërhyr në kushtet e atyre traktateve ose marrëveshjeve të tjera ndërmjet Palëve. Për më tepër, pritet që për qëllimet e këtij Protokoll, “një gjuhë e pranueshme për Palën e kërkuar ose Palën e njoftuar sipas nenit 7” do të përfshijë një ose disa gjuhë të specifikuara nga ato traktate ose marrëveshje. Si rrjedhojë, një Palë kërkuuese duhet të aplikojë gjuhën e specifikuar në traktatet e ndihmës së ndërsjellë ose rregullimet e tjera për kërkesat dhe njoftimet e bëra sipas këtij Protokoll, përveç rastit kur Pala e kërkuar ose e njoftuar specifikon se është, gjithashtu, e gatshme të pranojë kërkesa ose njoftime të tilla në gjuhë të tjera.

57. Gatishmëria e një Pale për të pranuar gjuhë të tjera do të pasqyrohet nëpërmjet sugjerimit të saj për T-CY, se ajo synon të pranojë disa ose të gjitha llojet e kërkesave ose njoftimeve të urdhrave sipas këtij Protokoll në një gjuhë tjetër.

58. Paragrafi 2 përcakton gjuhën/t që Pala lëshuese do të përdorë për të dorëzuar urdhra ose kërkesa dhe informacione shoqëruese tek ofruesit e shërbimeve ose subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të domenit në territorin e një Pale tjetër, në përputhje me përkatësisht nenet 7 dhe 6. Kjo dispozitë është hartuar për të garantuar bashkëpunim të shpejtë dhe siguri të shtuar, pa

vendosur barrë shtesë për ofruesit e shërbimeve ose subjektet kur ata marrin urdhra ose kërkesa për të zbuluar të dhëna. Opsioni i parë, i parashikuar në paragrafin 2/a, përcakton se urdhri ose kërkesa mund të dorëzohet në një gjuhë në të cilën ofruesi ose subjekti i shërbimit zakonisht pranon urdhra të brendshëm ose kërkesa nga autoritetet e veta në kuadër të hetimeve ose procedimeve penale specifike (“proces i krahasueshëm i brendshëm”). Për palët që kanë një ose më shumë gjuhë zyrtare, kjo do të përfshijë një nga ato gjuhë. Opsioni i dytë, i parashikuar në paragrafin 2/b, përcakton se nëse një ofrues i shërbimit ose subjekt pranon të marrë urdhra ose kërkesa në një gjuhë tjetër, për shembull në gjuhën e selisë së tij, këta urdhra dhe informacione shoqëruese mund të dorëzohen në atë gjuhë. Si opsion i tretë, paragrafi 2/c parashikon që, kur urdhri ose kërkesa dhe informacioni shoqërues nuk janë lëshuar në një nga gjuhët e dy opsioneve të para, ato duhet të shoqërohen nga një përkthim në njërin nga ato gjuhë.

59. Siç përdoret në paragrafin 2: “urdhrrat, sipas nenit 7, dhe kërkesat, sipas nenit 6, dhe çdo informacion shoqërues” i referohen:

- sipas nenit 6, kërkesës (paragrafi 3); dhe;
- sipas nenit 7, urdhrat (paragrafi 3) dhe informacionit plotësues (paragrafi 4).

60. Kur një Palë ka kërkuar njoftim në përputhje me nenin 7, një Palë kërkuuese duhet të jetë e përgatitur që të dërgojë urdhrin dhe çdo informacion shoqërues në një gjuhë të pranueshme për Palën që kërkon njoftim, pavarësisht nga pranimi nga ofruesi i shërbimit i gjuhëve të tjera.

61. T-CY, gjithashtu, do të përpiqet në mënyrë joformale që të mbledhë informacion mbi gjuhët në të cilat urdhrat dhe kërkesat dhe informacioni shoqërues do t'u dorëzohen ofruesve të shërbimeve dhe subjekteve që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të domenit në përputhje me nenin 4, paragrafi 2, dhe t'i vërë Palët në dijeni të tyre si pjesë e studimit të përshtatshëm në paragrafin 54 të raportit shpjegues më sipër.



KREU II
MASAT PËR RRTJEN E BASHKËPUNIMIT

SEKSIONI 1
PARIMET E PËRGJITHSHME TË
ZBATUESHME PËR KREUN II

Neni 5

**Parimet e përgjithshme të zbatueshme për
kreun II**

62. Paragrafi 1 i nenit 5 sqaron se si në nenin 23 dhe në nenin 25, paragrafi 1 të Konventës, Palët do të bashkëpunojnë në përputhje me dispozitat e kreut II, “në masën më të gjerë të mundshme”. Ky parim kërkon që palët të ofrojnë bashkëpunim të gjerë dhe të minimizojnë pengesat për rrjedhën e qetë dhe të shpejtë të informacionit dhe provave në nivel ndërkombëtar.

63. Paragrafët 2 deri 5 organizojnë shtatë masat e bashkëpunimit të këtij Protokolli në katër seksione të ndryshme që pasojnë seksionin e parë mbi parimet e përgjithshme. Këto seksione ndahen sipas llojeve të bashkëpunimit të kërkuar: seksioni 2 mbulon bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me subjektet private; seksioni 3 përmban forma të bashkëpunimit të rritur ndërkombëtar ndërmjet autoriteteve për zbulimin e të dhënave të ruajtura; seksioni 4 parashikon ndihmën e ndërsjellë në raste urgjente; dhe seksioni 5 përfundon me dispozitat e bashkëpunimit ndërkombëtar që do të zbatohen në mungesë të një traktati ose rregullimi mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë midis Palëve të interesuara. Këto seksione janë, gjithashtu, të organizuara afërsisht në progres nga format e ndihmës hetimore të kërkuara shpesh herët në një hetim – për të siguruar zbulimin e regjistrimit të emrit të domenit dhe informacionit të abonentit – deri te kërkesat për të dhënat e trafikut dhe më pas të dhënat e përmbajtjes, të pasuara nga videokonferencat dhe ekipet e përbashkëta hetimore, të cilat janë forma ndihme që kërkojnë shpesh në fazat e mëvonshme të një hetimi.

64. Ky seksion mbi parimet e përgjithshme sqaron masën në të cilën ndonjë masë cenohet ose nuk cenohet nga ekzistenca e një traktati ose rregullimi të ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë midis Palëve të interesuara, d.m.th., Palës kërkuuese dhe Palës së kërkuar për bashkëpunim ndërqeveritar dhe Palës

që kërkon informacionin dhe Palës në territorin e së cilës ndodhet subjekti privat që zotëron ose kontrollon një informacion të tillë për bashkëpunim të drejtpërdrejtë sipas neneve 6 dhe 7. Një “marrëveshje për bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë” synon t’i referohet marrëveshjeve “të tilla si sistemi i bashkëpunimit i zhvilluar midis vendeve nordike, i cili pranohet, gjithashtu, nga Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (neni 25, paragrafi 4) dhe midis anëtarëve të Kamënuelthit” (shih raportin shpjegues, paragrafi 263 të Konventës). Masat në seksionet 2 deri 4 të këtij kreu zbatohen, pavarësisht nëse Palët e interesuara kanë ose jo detyrime ligjore reciprokisht nga një marrëveshje ose rregullim i zbatueshëm i ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë. Dispozitat e bashkëpunimit ndërkombëtar në seksionin 5 zbatohen vetëm në mungesë të marrëveshjeve ose rregullimeve të tilla, përveç nëse parashikohet ndryshe.

65. Siç përshkruhet në paragrafin 2 të këtij neni, seksioni 2 i këtij kreu përbëhet nga neni 6 me titull “Kërkesa për informacion për regjistrimin e emrit të domenit” dhe neni 7 me titull “Zbulimi i informacionit të abonentit”. Këto janë të ashtuquajturat nene të “bashkëpunimit të drejtpërdrejtë”, të cilat lejojnë autoritetet kompetente të një Pale që të angazhohen drejtpërdrejt me subjektet private – d.m.th. me subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të domenit në nenin 6 dhe me ofruesit e shërbimeve në nenin 7 – për qëllimet e hetimeve apo procedimeve penale specifike. Seksioni 2 zbatohet, pavarësisht nëse ekziston apo jo një traktat ose rregullim për ndihmë të ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palës që kërkon informacionin dhe Palës, në territorin e së cilës ndodhet subjekti privat që zotëron ose kontrollon një informacion të tillë.

66. Siç përshkruhet në paragrafin 3 të këtij neni, seksioni 3 i këtij kreu përbëhet nga neni 8, me titull “Zbatimi i urdhrave nga një Palë tjetër për prodhimin e përshpejtuar të informacionit të abonentit dhe të dhënave të trafikut” dhe neni 9 me titull “Zbulimi i përshpejtuar i të dhënave të ruajtura kompjuterike në rast urgjence”. Këto janë masa që “rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet autoriteteve”, d.m.th. parashikojnë bashkëpunim ndërmjet autoriteteve kompetente,



por të një natyre të ndryshme nga bashkëpunimi tradicional ndërkombëtar. Seksioni 3 zbatohet, pavarësisht nëse ka apo jo një traktat ose rregullim për ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve kërkuuese dhe atyre të kërkuara.

67. Siç përshkruhet në paragrafin 4 të këtij neni, pjesa 4 e këtij kreu përbëhet nga neni 10 me titull “Ndihma e ndërsjellë në raste urgjente”. Megjithatë ndihma e ndërsjellë në raste urgjente është një dispozitë e ndihmës së ndërsjellë, ajo është mjet i rëndësishëm bashkëpunimi për urgjencat që nuk parashikohen shprehimisht në shumë traktate të ndihmës së ndërsjellë. Si rrjedhojë, hartuesit vendosën që ky seksion duhet të zbatohet, pavarësisht nëse ekziston apo jo një marrëveshje ose rregullim i zbatueshëm i ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve të interesuara. Në lidhje me procedurat që rregullojnë ndihmën e ndërsjellë në raste urgjente, ekzistojnë dy mundësi. Kur Palët e interesuara kanë detyrime ligjore reciprokisht nga një marrëveshje ose rregullim i zbatueshëm i ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë, seksioni 4 plotësohet nga dispozitat e asaj marrëveshjeje, përveç rasteve kur palët e interesuara vendosin reciprokisht të zbatojnë disa dispozita të Konventës në vend të tyre (shih nenin 10, paragrafi 8 të këtij Protokoll). Kur Palët e interesuara nuk kanë detyrime ligjore reciprokisht nga një marrëveshje ose rregullim i tillë, Palët zbatojnë disa procedura të përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të Konventës, në lidhje me ndihmën e ndërsjellë në mungesë të një traktati (shih nenin 10, paragrafi 7, të këtij Protokoll).

68. Siç përshkruhet në paragrafin 5 të këtij neni, seksioni 5 i këtij kreu përbëhet nga neni 11, me titull “Videokonferenca” dhe neni 12, me titull “Ekipet e përbashkëta hetimore dhe hetimet e përbashkëta”. Këto dispozita janë masa të bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat zbatohen vetëm kur nuk ka traktat ose marrëveshje të ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet palëve kërkuuese dhe atyre të kërkuara. Këto masa nuk zbatohen kur ekziston një traktat apo rregullim i tillë, përveç kur neni 12, paragrafi 7 zbatohet, pavarësisht nëse ekziston apo jo një traktat apo rregullim i tillë. Megjithatë, Palët e interesuara mund të vendosin reciprokisht të zbatojnë

dispozitat e seksionit 5 në vend të një traktati ose rregullimi të tillë ekzistues, përveç kur kjo do të ndalohej nga kushtet e traktatit ose rregullimit.

69. Paragrafi 6 është modeluar sipas nenit 25, paragrafi 5 i Konventës dhe, si rrjedhojë, paragrafi 259 i raportit shpjegues të Konventës është, gjithashtu, i vlefshëm këtui: “Kur Palës së kërkuar i lejohet të kërkojë kriminalitetin të dyfishtë si kusht për ofrimin e ndihmës... kriminaliteti i dyfishtë do të çmohet i pranishëm, nëse sjellja që përbën veprën penale për të cilën kërkohet ndihma është, gjithashtu, veprë penale sipas ligjeve të Palës së kërkuar, edhe nëse ligjet e saj e vendosin veprën brenda një kategorie të ndryshme të veprës penale ose përdorin terminologji të ndryshme në cilësimin e veprës penale. Kjo dispozitë u çmua e nevojshme për të garantuar që Palët e kërkuara të mos aplikojnë një testim mjaft rigoroz kur aplikojnë kriminalitetin e dyfishtë. Duke pasur parasysh dallimet në sistemet e brendshme ligjore, lindin ndryshime në terminologji dhe kategorizimin e sjelljes kriminale. Nëse sjellja përbën shkelje penale, sipas të dyja sistemeve, dallime të tilla teknike nuk duhet të pengojnë ndihmën. Përkundrazi, në çështjet në të cilat është i zbatueshëm standardi i kriminalitetit të dyfishtë, ai duhet të zbatohet në një mënyrë fleksibël që do të lehtësojë dhënien e ndihmës.

70. Paragrafi 7 parashikon, se: “dispozitat në këtë krye nuk e kufizojnë bashkëpunimin ndërmjet Palëve ose ndërmjet Palëve dhe ofruesve të shërbimeve ose subjekteve të tjera, nëpërmjet marrëveshjeve, rregullimeve, praktikave ose legjislacioni tjetër të brendshëm të zbatueshëm”. Kjo do të thotë se Protokollin nuk eliminon ose kufizon asnjë bashkëpunim ndërmjet Palëve ose ndërmjet Palëve dhe subjekteve private që është i disponueshëm ndryshe – qoftë përmes marrëveshjeve, rregullimeve, legjislacioneve të brendshme apo edhe praktikave joformale në fuqi. Hartuesit synonin të zgjeronin, jo të kufizonin mjetet e disponueshme në bagazhin e profesionistëve ligjzbatues për të marrë informacion ose prova për hetime ose procedime specifike penale. Hartuesit pranian se në situata të caktuara, mekanizmat ekzistues, të tilla si ndihma e ndërsjellë, mund të jenë më të mirët për t’u përdorur nga një profesionist. Megjithatë, në situata të tjera, mjetet e krijuara nga ky Protokoll mund të jenë më efikase ose më të preferueshme. Për



shembull, nëse një autoritet kompetent ka nevojë për të dhëna për përmbajtjen mbi baza jourgjente, ai mund të zgjedhë të përdorë një kërkesë tradicionale për ndihmë të ndërsjellë, sipas një traktati dypalësh ose sipas nenit 27 të Konventës, siç është e zbatueshme, sepse Protokollin nuk përmban dispozita për marrjen e të dhënave të përmbajtjes mbi baza jourgjente. Por, nëse i nevojitet informacioni i abonentit, ai mund të zgjidhte të përdorte nenin 7 të Protokollit për të lëshuar një urdher drejtpërdrejt për një ofrues shërbimi.

71. Së fundi, një sërë dispozitash të kreut II dhe në pjesë të tjera të këtij Protokollin lejojnë vendosjen e kufizimeve ose të kushteve të përdorimit, të tilla si konfidencialiteti. Kur, në përputhje me dispozitat e këtij Protokollin, marrja e provave ose informacionit të kërkuar i nënshtrohet një kufizimi ose kushti të tillë përdorimi, përfshijet njihen nga negociatorët dhe janë të nënkuptuara në tekst. Së pari, si masë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në përputhje me nenin 13, sipas parimeve themelore ligjore të shumë shteteve, nëse materiali i dorëzuar Palës marrëse konsiderohet prej saj si shfajësues për një person të akuzuar, ai duhet t'i zbulohet mbrojtjes ose një autoriteti gjyqësor. Ky parim nuk cenon tekstin e nenit 12, paragrafi 6/b dhe raportin shpjegues, paragrafi 215 që mund të zbatohet kur palët kanë krijuar një ekip të përbashkët hetimor. Nga hartuesit u kuptua se në raste të tilla Pala marrëse do të njoftonte Palën transferuese përpara se të zbulohet dhe nëse kërkohet, do të konsultohet me Palën transferuese. Së dyti, kur është vendosur një kufizim përdorimi në lidhje me materialin e marrë sipas këtij Protokollin, i cili parashikohet të përdoret në gjykim, gjykimi (duke përfshirë zbulimet gjatë procedimeve paraprake gjyqësore) është zakonisht një proces me dyer të hapura. Pasi bëhet publik në gjykim, materiali ka kaluar në domenin publik. Në këto situata, nuk është e mundur të garantohej konfidencialiteti i hetimit ose procedimit për të cilin është kërkuar materiali. Këto përfshijet janë të ngjashme me përfshijet që lidhen me zbatimin e nenit 28, paragrafi 2 të Konventës, siç shpjegohet në paragrafin 278 të raportit shpjegues të Konventës. Së fundi, materiali mund të përdoret për një qëllim tjetër kur është marrë pëlqimi paraprak i një Pale transferuese.

SEKSIONI 2

PROCEDURAT PËR RRIJTJEN E BASHKËPUNIMIT TË DREJTPËRDREJTË ME OFRUESIT DHE SUBJEKTET NË PALË TË TJERA

Neni 6

Kërkesa për informacion mbi regjistrimin e emrit të domenit

72. Neni 6 përcakton një procedurë që parashikon bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis autoriteteve të një Pale dhe një subjekti që ofron shërbime të regjistrimit të emrave të domeneve në territorin e një Pale tjetër për të marrë informacion në lidhje me regjistrimet e emrave të domeneve në internet. Ngjashëm me nenin 7, procedura bazohet në konkluzionet e Grupit për Provat në *Cloud* të Komitetit të Konventës së Krimin Kibernetik, duke pranuar rëndësinë e aksesit në kohë ndërkuftar në provat elektronike në hetime ose procedime penale specifike, duke pasur parasysh sfidat që paraqesin procedurat ekzistuese për marrjen e provave elektronike.

73. Procedura, gjithashtu, njeh modelin aktual të qeverisjes së internetit, i cili mbështetet në zhvillimin e politikave me shumë palë të interesuara bazuar në konsensus. Këto politika zakonisht bazohen në të drejtën kontraktuale. Procedura e përcaktuar në këtë nen synon të plotësojë ato politika për qëllimet e këtij Protokollin, domethënë, për qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike. Marrja e të dhënave të regjistrimit të emrit të domenit është shpesh e domosdoshme, si hap i parë për shumë hetime penale dhe për të përcaktuar se ku të drejtohen kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtar.

74. Shumë forma të krimin kibernetik lehtësohen nga shkelësit e ligjit që krijojnë dhe shfrytëzojnë domene për qëllime keqdashëse dhe të paligjshme. Për shembull, një emër domeni mund të përdoret si platformë për përhapjen e *malware* (*softuerëve të dëmshëm), *botnets* (*rrjete të kompjuterëve privatë të infektuar me softuer të dëmshëm dhe të kontrolluar si grup pa njohurinë e pronarit), *phishing* (*një lloj sulmi social inxhinierik i përdorur shpesh për vjedhjen e të dhënave të përdoruesve) dhe aktiviteteve të ngjashme, mashtrim, shpërndarje të materialeve të abuzimit të fëmijëve dhe për qëllime të tjera kriminale. Aksesit



në informacion mbi personin juridik ose fizik që ka regjistruar një domen (“regjistruesi”) është si rrjedhojë, thelbësor për të identifikuar një të dyshuar në një hetim apo procedim penal specifik. Ndërsa të dhënat e regjistrimit të emrit të domenit ishin historikisht të disponueshme publikisht, aksesit në disa nga informacionet aktualisht është i kufizuar, çka cenon autoritetet gjyqësore dhe ligjzbatuese në detyrat e tyre të politikave publike.

75. Informacioni i regjistrimit të emrit të domenit mbahet nga subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të domenit. Këto përfshijnë organizata që shesin emra domenesh për publikun (“regjistruesit”), si dhe operatorë regjistrash rajonale ose kombëtarë, të cilët mbajnë baza të të dhënave të besueshme (“regjistra”) të të gjithë emrave të domeneve të regjistruara për një domen të nivelit të lartë dhe që pranojnë kërkesat për regjistrim. Në raste të caktuara, këto informacione mund të jenë të dhëna personale dhe mund të mbrohen sipas rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave në Palën ku ndodhet subjekti përkatës që ofron shërbimet e regjistrimit të emrit të domenit (regjistruesi ose regjistri) ose ku ndodhet personi me të cilin lidhen të dhënat.

76. Objektivi i nenit 6 është që të sigurojë një kuadër efektiv dhe efikas për marrjen e informacionit për identifikimin ose kontaktimin e regjistruesit të një emri domeni. Forma e zbatimit varet nga konsideratat ligjore dhe politike përkatëse të Palëve. Ky nen synon të plotësojë politikën dhe praktikën aktuale dhe të ardhshme të qeverisjes së internetit.

Paragrafi 1

77. Sipas paragrafit 1, çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme për të autorizuar autoritetet e saj kompetente që t’i lëshojnë kërkesa drejtpërdrejt një subjekti që ofron shërbime të regjistrimit të emrit të domenit në territorin e një Pale tjetër, d.m.th., pa kërkuar nga autoritetet në territorin ku ndodhet subjekti që të veprojnë si ndërmjetës. Paragrafi 1 u jep palëve fleksibilitet në lidhje me formatin në të cilin bëhen kërkesat, pasi formati varet nga konsideratat ligjore dhe politike përkatëse të palëve. Një Palë mund të përdorë procedurat e disponueshme sipas legjislacionit të saj të brendshëm, duke përfshirë lëshimin e një urdhri; megjithatë, për qëllimet e nenit 6, një urdhër i tillë trajtohet si kërkesë jodetyruese. Si rrjedhojë, forma e kërkesës ose efektet që ajo prodhon sipas

legjislacionit të brendshëm të Palës kërkuuese nuk do të ndikojnë në natyrën vullnetare të bashkëpunimit ndërkombëtar sipas këtij neni dhe nëse subjekti nuk zbulon informacionin e kërkuar, paragrafi 5 do të ishte i zbatueshëm.

78. Formulimi në nenin 6, paragrafi 1 është mjaft i gjerë për të pranuar se një kërkesë e tillë mund të lëshohet, gjithashtu, dhe informacioni mund të merret nëpërmjet një ndërfaqeje, portali ose mjeti tjetër teknik të vënë në dispozicion nga organizatat. Për shembull, një organizatë mund të sigurojë një ndërfaqe ose mjet kërkimi për të lehtësuar ose përshpejtuar zbulimin e informacionit të regjistrimit të emrit të domenit pas një kërkesë. Megjithatë, në vend që ta përshtatë këtë nen për ndonjë portal ose ndërfaqe të veçantë, ky nen përdor terma neutralë ndaj teknologjisë për të lejuar përshtatjen me teknologjinë në zhvillim.

79. Siç parashikohet në nenin 2, një kërkesë sipas paragrafit 1 mund të lëshohet vetëm për qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike. Termi “autoritet kompetent” përkufizohet në nenin 3, paragrafi 2/b dhe i referohet një “autoriteti gjyqësor, administrativ ose autoriteti tjetër ligjzbatues të autorizuar nga legjislacioni i brendshëm për të urdhëruar, autorizuar ose ndërmarrë ekzekutimin e masave sipas këtij Protokollit”. Një “subjekt që ofron shërbime të regjistrimit të emrit të domenit” aktualisht u referohet regjistruesve dhe regjistrave. Për të marrë parasysh situatën aktuale dhe në të njëjtën kohë për të lejuar përshtatjen pasi modelet e biznesit dhe arkitektura e internetit mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, ky nen përdor termin më të përgjithshëm të një “subjekt që ofron shërbime të regjistrimit të emrave të domeneve”.

80. Ndërsa informacioni për identifikimin ose kontaktimin me regjistruesin e një emri domeni shpesh ruhet nga subjektet që ofrojnë shërbime të përgjithshme të regjistrimit të emrit të domenit në nivel global, për shembull “domenet e përgjithshme të nivelit të lartë” (gTLDs), Palët konfirmuan se shërbime më specifike të regjistrimit të emrit të domenit të lidhura me subjektet kombëtare ose rajonale (“domenet e nivelit të lartë me kod vendi” (ccTLD) mund të regjistrohen, gjithashtu, nga persona ose subjekte në vende të tjera dhe mund të përdoren edhe nga shkelësit e ligjit. Si rrjedhojë, neni 6 nuk kufizohet te subjektet që ofrojnë gTLD, pasi të dyja llojet e shërbimeve të



regjistrimit të emrave të domeneve – ose llojet e ardhshme të shërbimeve të tilla – mund të përdoren për kryerjen e krimeve kibernetike.

81. Shprehja “informacion për identifikimin ose kontaktimin me regjistruuesin e një emri domeni” i referohet informacionit të disponueshëm më parë publikisht nëpërmjet të ashtuquajturave mjete të kërkimit WHOIS, të tilla si: emri, adresa fizike, adresa e *email*-it dhe numri i telefonit të një të regjistruari. Disa Palë mund ta konsiderojnë këtë informacion një nëngrup të informacionit të abonentit, siç përcaktohet në nenin 18, paragrafi 3 të Konventës. Informacioni i regjistrimit të emrit të domenit është informacion bazë që nuk do të lejonte nxjerrjen e përfundimeve të sakta në lidhje me jetën private dhe zakonet e përditshme të individëve. Si rrjedhojë, zbulimi i tij mund të jetë më pak ndërhyrës se sa zbulimi i kategorive të tjera të të dhënave.

Paragrafi 2

82. Paragrafi 2 kërkon që çdo palë të miratojë masa për të lejuar subjektet në territorin e saj që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të domenit, të zbulojnë një informacion të tillë në përgjigje të një kërkesë, sipas paragrafit 1, në bazë të kushteve të arsyeshme të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, i cili në disa Palë mund të përfshijë kushte për mbrojtjen e të dhënave. Në të njëjtën kohë, neni 14 kufizon mundësinë për të refuzuar transferimin e të dhënave, sipas rregullave të mbrojtjes së të dhënave për transferimet ndërkombëtare dhe faktorët në paragrafin 83 u përfshijnë për të lehtësuar përpunimin sipas rregullave të mbrojtjes së të dhënave. Këto masa duhet të lehtësojnë zbulimin e të dhënave të kërkuara në mënyrë të shpejtë dhe efektive në masën më të gjerë të mundshme.

83. Ky nen nuk kërkon që Palët të miratojnë legjislacionin që i detyron këto subjekte t'i përgjigjen një kërkesë nga një autoritet i një Pale tjetër. Kështu, subjektit që ofron shërbime të regjistrimit të emrit të domenit, mund t'i duhet të përcaktojë nëse do të zbulojë informacionin e kërkuar. Ky Protokoll ndihmon me këtë përcaktim, duke dhënë garanci që duhet të lehtësojnë aftësinë e subjekteve për t'iu përgjigjur pa vështirësi kërkesave sipas këtij neni, si për shembull:

- ky Protokoll siguron ose kërkon që Palët të ofrojnë një bazë ligjore për kërkesat;

- ky nen kërkon që kërkesa të burojë nga një autoritet kompetent (neni 6, paragrafët dhe 3/a, dhe paragrafët 79 dhe 84 të këtij raporti shpjegues);

- ky Protokoll parashikon që një kërkesë bëhet për qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike (neni 2);

- ky nen kërkon që kërkesa të përmbajë një deklaratë se nevoja për informacion lind për shkak të rëndësisë së tij për një hetim apo procedim penal specifik dhe se informacioni do të përdoret vetëm për atë hetim apo procedim penal specifik (neni 6, paragrafi 3/c);

- ky Protokoll parashikon garanci për përpunimin e të dhënave personale të zbuluara dhe të transferuara në bazë të kërkesave të tilla nëpërmjet nenit 14;

- informacioni që duhet të zbulohet është i kufizuar dhe nuk do të lejonte nxjerrjen e përfundimeve të sakta në lidhje me jetën private të individëve;

- subjektet mund të priten ose kërkohet që të bashkëpunojnë sipas marrëveshjeve kontraktuale me Korporatën e Internetit për Emrat dhe Numrat e caktuar (ICANN).

Paragrafi 3

84. Paragrafi 3 i këtij neni specifikon informacionin që minimalisht duhet të jepet nga autoriteti që lëshon kërkesën, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Ky informacion është veçanërisht i rëndësishëm për ekzekutimin e kërkesës nga subjekti që ofron shërbime të regjistrimit të emrit të domenit. Kërkesa do të duhet të përfshijë:

- a) datën e kërkesës dhe identitetin dhe të dhënat e kontaktit të autoritetit kompetent që lëshon kërkesën (paragrafi 3/a) (shih paragrafin 79 të raportit shpjegues).

- b) emrin e domenit për të cilin kërkohet informacioni dhe një listë të detajuar të informacionit të kërkuar, duke përfshirë elementet e veçanta të të dhënave, si: emri, adresa fizike, adresa e *email*-it ose numri i telefonit të një të regjistruari (paragrafi 3/b);

- c) një deklaratë se kërkesa është lëshuar në përputhje me këtë Protokoll; duke bërë këtë deklaratë, Pala përfaqëson se kërkesa është në përputhje me kushtet e këtij Protokoll (paragrafi 3/c) Pala kërkuese konfirmon, gjithashtu, në këtë deklaratë se informacioni është “i nevojshëm”, për shkak të rëndësisë së tij për një hetim apo procedim penal specifik dhe se informacioni do të



përdoret vetëm për atë hetim apo procedim penal specifik. Për vendet evropiane, cili informacion është “i nevojshëm” – d.m.th. i nevojshëm dhe proporcional – për një hetim apo procedim penal, duhet të burojë nga parimet e Konventës së Këshillit të Evropës të vitit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, jurisprudenca e saj e zbatueshme dhe legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare. Këto burime përcaktojnë se fuqia ose procedura duhet të jenë proporcionale me natyrën dhe rrethanat e një vepr penale (shih paragrafin 146 të raportit shpjegues të Konventës për Krimin Kibernetik). Palët e tjera do të zbatojnë parimet përkatëse të legjislacionit të tyre, të tilla si parimet e rëndësisë (d.m.th. që provat e kërkuara nga një kërkesë duhet të jenë të rëndësishme për hetimin ose ndjekjen penale). Palët duhet të shmangin kërkesat e zgjeruara për zbulimin e informacionit të emrit të domenit, përveç rasteve kur nevojiten për hetimin ose procedimin penal specifik;

d) kohën dhe mënyrën se si duhet të zbulohet informacioni dhe çdo udhëzim tjetër i veçantë procedural (paragrafi 3/d). “Udhëzime të veçanta procedurale” synojnë të përfshijnë çdo kërkesë për konfidencialitet, duke përfshirë një kërkesë për moszbulim të kërkesës te regjistruesi ose palë të tjera të treta. Nëse kërkohet konfidencialitet për të shmangur një zbulim të parakohshëm të çështjes, kjo duhet të specifikohet në kërkesë. Në disa Palë, konfidencialiteti i kërkesës do të ruhet sipas ligjit, ndërsa në Palë të tjera ky nuk është domosdoshmërisht rasti. Si rrjedhojë, kur nevojitet konfidencialitet, Palët inkurajohen të rishikojnë informacionin e disponueshëm publikisht dhe të kërkojnë udhëzime nga Palët e tjera në lidhje me ligjin në fuqi, si dhe politikën e subjekteve që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të domenit në lidhje me informacionin e abonentit / regjistruarit, përpara se të paraqesin një kërkesë, sipas paragrafit 1, për subjektin. Përveç kësaj, udhëzimet e veçanta procedurale mund të përfshijnë specifikimin e kanalit të transmetimit që i përshtatet më mirë nevojave të autoritetit.

85. Paragrafi 3 nuk përfshin kërkesën për të përfshirë deklaratën e fakteve në kërkesë, duke pasur parasysh se ky informacion është konfidencial në shumicën e hetimeve penale dhe nuk mund t’i zbulohet një palë private. Megjithatë, subjektit që merr një kërkesë sipas këtij neni, mund

t’i nevojiten disa informacione shtesë që do ta lejonin të merrte një vendim pozitiv në lidhje me kërkesën. Si rrjedhojë, subjekti mund të kërkojë informacione të tjera kur nuk mund ta ekzekutojë ndryshe kërkesën.

Paragrafi 4

86. Qëllimi i paragrafit 4 është që të inkurajojë përdorimin e mjeteve elektronike kur është e pranueshme për subjektin që ofron shërbime të regjistrimit të emrave të domeneve, pasi mjetet elektronike janë pothuajse gjithmonë mjetet më efikase dhe më të shpejta të komunikimit. Si rrjedhojë, nëse pranohet nga subjekti që ofron shërbime të regjistrimit të emrit të domenit, një Palë mund t’i paraqesë kërkesë subjektit në formë elektronike, për shembull duke përdorur *email*, portale elektronike ose mjete të tjera. Ndërsa supozohet se subjektet preferojnë të marrin kërkesa në një format të tillë, nuk është kërkesë që të përdoret vetëm ky format. Siç parashikohet në nene të tjerë të këtij Protokollit, që lejojnë urdhra ose kërkesa në formë elektronike (të tilla si nenet 7, 8 etj.), mund të kërkohen nivele të përshtatshme sigurie dhe vlefësimi. Palët dhe subjektet mund të vendosin vetë nëse kanalet ose mjetet e sigurta për transmetim dhe vlefësim janë të disponueshme ose nëse mund të nevojiten garanci të posaçme (duke përfshirë kodimin) në një rast të veçantë sensitiv.

Paragrafi 5

87. Ndërsa kjo dispozitë lidhet me “kërkesat” dhe jo me “urdrat” e detyrueshëm për zbulimin e të dhënave të regjistrimit të emrit të domenit, pritet që një subjekt i kërkuar do të jetë i aftë të zbulojë informacionin e kërkuar në përputhje me këtë dispozitë, kur të jenë përmbushur kushtet e zbatueshme. Nëse subjekti nuk jep informacionin e kërkuar, mund të merren parasysh mekanizma të tjerë për marrjen e informacionit, në varësi të rrethanave. Si rrjedhojë, paragrafi 5 parashikon konsultimin ndërmjet Palëve të përfshira, me qëllim marrjen e informacionit shtesë dhe përcaktimin e mekanizmave të disponueshëm, për shembull për të përmirësuar bashkëpunimin në të ardhmen. Për të lehtësuar konsultimet, paragrafi 5 parashikon, gjithashtu, që një Palë kërkuuese mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nga një subjekt. Subjektet inkurajohen të shpjegojnë arsyet e moszbulimit të të dhënave të kërkuara në përgjigje të një kërkesë të tillë.

**Paragrafi 6**

88. Paragrafi 6 kërkon që në kohën e nënshkrimit të këtij Protokollit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimi ose miratimit, ose në çdo kohë tjetër, Palët të caktojnë një autoritet për qëllime konsultimi sipas paragrafit 5. Sigurimi i një pike kontakti në Palën ku ndodhet subjekti, do të ndihmojë Palën kërkuese në caktimin e shpejtë të masave të disponueshme për marrjen e të dhënave të kërkuara, nëse subjekti refuzon të ekzekutojë një kërkesë të drejtpërdrejtë të bërë sipas nenit 6.

Paragrafi 7

89. Paragrafi 7 është vetëshpjegues dhe parashikon që Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të krijojë dhe mbajë një regjistrë të autoriteteve të përcaktuara sipas paragrafit 6 dhe që çdo palë do të garantojë se të dhënat që ka paraqitur për regjistrin janë të sakta në çdo kohë.

Neni 7**Zbulimi i informacionit të abonentit**

90. Neni 7 përcakton një procedurë që parashikon bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis autoriteteve të një Pale dhe një ofruesi shërbimi në territorin e një Pale tjetër për të marrë informacionin të abonentit. Procedura bazohet në konkluzionet e Grupit për Provat në *Cloud T-CY* dhe Shënimit Udhëzues për nenin 18 të Konventës, duke pranuar rëndësinë e aksesit në kohë ndërkuftar në provat elektronike në hetime ose procedime penale specifike, duke pasur parasysh sfidat e paraqitura nga procedurat ekzistuese për marrjen e provave elektronike nga ofruesit e shërbimeve në vende të tjera.

91. Një numër në rritje i hetimeve apo i procedimeve penale në ditët e sotme kërkon akses në provat elektronike nga ofruesit e shërbimeve në vende të tjera. Edhe për krimet që janë tërësisht të natyrës së brendshme – pra kur krimi, viktimja dhe autori janë të gjithë në të njëjtin vend me autoritetin hetues – provat elektronike mund të mbahen nga një ofrues shërbimi në territorin e një vendi tjetër. Në shumë situata, autoriteteve që po hetojnë një krim mund t'u kërkohej të përdorin procedura të bashkëpunimit ndërkombëtar, të tilla si ndihma e ndërsjellë, të cilat nuk janë gjithmonë të afta të ofrojnë ndihmë të shpejtë ose mjaftueshëm efektive për nevojat e hetimit ose të procedimit, për

shkak të një volumi vazhdimisht në rritje të kërkesave që kërkojnë prova elektronike.

92. Informacioni për abonentin është informacioni më i kërkuar në hetimet penale, në lidhje me krimin kibernetik dhe llojet e tjera të krimit për të cilat nevojiten prova elektronike. Ai siguron identitetin e një abonenti të caktuar të një shërbimi, adresën e tij ose të saj dhe informacione të ngjashme të identifikuar në nenin 18, paragrafi 3 të Konventës. Ai nuk mundëson konkluzione të sakta në lidhje me jetën private dhe zakonet e përditshme të individëve në fjalë që do të thotë se zbulimi i tij mund të jetë i një shkalle më të ulët ndërhyrëse në krahasim me zbulimin e kategorive të tjera të të dhënave.

93. Informacioni për abonentin përkufizohet në nenin 18, paragrafi 3 të Konventës (i përfshirë në nenin 3, paragrafi 1 të këtij Protokollit) si “çdo informacion që përmbahet në formën e të dhënave kompjuterike ose çdo formë tjetër që mbahet nga një ofrues shërbimi në lidhje me abonentët e shërbimeve të tij, përveç të dhënave të trafikut ose përmbajtjes dhe me anë të të cilit mund të përcaktohet: a) lloji i shërbimit të komunikimit të përdorur, masat teknike të marra për të dhe periudha e shërbimit; b) identiteti i abonentit, adresa postare ose gjeografike, numri i telefonit dhe numri tjetër i aksesit, informacioni i faturimit dhe pagesës, të disponueshme në bazë të marrëveshjes ose rregullimit të shërbimit; c) çdo informacion tjetër në vendin e instalimit të pajisjeve të komunikimit, të disponueshëm në bazë të marrëveshjes ose rregullimit të shërbimit” (shih, gjithashtu, raportin shpjegues të Konventës, paragrafët 177 deri 183). Informacioni i nevojshëm për qëllimin e identifikimit të abonentit të një shërbimi mund të përfshijë informacione të caktuara të adresës së Protokollit të Internetit (IP) – për shembull, adresën IP të përdorur në kohën kur u krijua një llogari, adresën IP më të fundit të logimit ose adresat IP të logimit të përdorura në një kohë të caktuar. Në disa Palë, ky informacion trajtohet si të dhëna trafiku për arsye të ndryshme, duke përfshirë atë që konsiderohet se lidhet me transmetimin e një komunikimi. Si rrjedhojë, paragrafi 9/b i nenit 7 paraqet një rezervë për disa Palë.

94. Ndërsa neni 18 i Konventës trajton tashmë disa aspekte të nevojës për akses të shpejtë dhe efektiv në provat elektronike nga ofruesit e



shërbimeve, ai në vetvete nuk ofron zgjidhje të plotë për këtë sfidë, pasi ky nen zbatohet në një grup më të kufizuar rrethanash. Në mënyrë specifike, neni 7 i këtij Protokolli zbatohet kur një ofrues shërbimi ndodhet “në territorin” e Palës lëshuese (shih nenin 18, paragrafi 1/a të Konventës) ose “duke ofruar shërbimet e tij” në Palën lëshuese (shih nenin 18, paragrafi 1/b të Konventës). Duke pasur parasysh kufijtë e nenit 18 dhe sfidat me të cilat përballat ndihma e ndërsjellë, u çmua i rëndësishëm krijimi i një mekanizmi plotësues që do të mundësonte akses më efektiv ndërkufitar në informacionin e nevojshëm për hetime ose procedime penale specifike. Si rrjedhojë, objekti i nenit 7 të këtij Protokolli shkon përtej objektit të nenit 18 të Konventës, duke i lejuar një Pale që të lëshojë disa urdhra për ofruesit e shërbimeve në territorin e një Pale tjetër. Palët pranuan se megjithëse urdhra të tillë të drejtpërdrejtë nga autoritetet e një Pale për ofruesit e shërbimeve të vendosura në një Palë tjetër janë të dëshirueshme për akses të shpejtë dhe efektiv në informacion, një Pale nuk duhet t’i lejohej të përdorë të gjithë mekanizmat e zbatimit të disponueshëm sipas legjislacionit të saj të brendshëm për zbatimin e këtyre urdhrave. Për këtë arsye, zbatimi i këtyre urdhrave, në rastet kur ofruesi nuk zbulon informacionin e specifikuar për abonentin, kufizohet në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 7. Kjo procedurë parashikon garanci për të marrë parasysh kërkesat unike që rrjedhin nga një bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të një Palë me ofruesit e shërbimeve të vendosur në një Palë tjetër.

95. Siç pasqyrohet në nenin 5, paragrafi 7, ky nen nuk cenon aftësinë e palëve për të zbatuar urdhrat e lëshuar sipas nenit 18 ose ndryshe siç lejohet nga Konventa, dhe as nuk cenon bashkëpunimin (përfshirë bashkëpunimin spontan) ndërmjet Palëve, ose ndërmjet Palëve dhe ofruesve të shërbimeve, nëpërmjet marrëveshjeve, rregullimeve, praktikave ose legjislacionit të brendshëm të zbatueshëm.

Paragrafi 1

96. Paragrafi 1 kërkon që Palët t’u japin autoriteteve kompetente kompetencat e nevojshme për të lëshuar urdhër për një ofrues shërbimi në territorin e një Pale tjetër për të garantuar zbulimin e informacionit të abonentit. Urdhri mund të

lëshohet vetëm për informacion të specifikuar dhe të ruajtur të abonentit.

97. Paragrafi 1 përfshin, gjithashtu, kërkesën që urdhrat mund të lëshohen dhe dorëzohen vetëm në kontekstin e “hetimeve ose procedimeve penale specifike” të vetë një Pale lëshuese, siç përdoret në nenin 2 të këtij Protokolli. Si kufizim i mëtejshëm, urdhrat mund të lëshohen edhe vetëm për informacionin “e nevojshëm” për atë hetim ose procedim. Për vendet evropiane, cili informacion është i nevojshëm – domethënë i nevojshëm dhe proporcional – për një hetim apo procedim penal, duhet të rrjedhë nga parimet e Konventës së Këshillit të Evropës të vitit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, jurisprudenca e saj e zbatueshme dhe legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare. Këto burime përcaktojnë se fuqia ose procedura duhet të jenë proporcionale me natyrën dhe rrethanat e një veprë penale (shih paragrafin 146 të raportit shpjegues të Konventës). Palët e tjera do të zbatojnë parimet përkatëse të legjislacionit të tyre, të tilla si parimet e rëndësishme (d.m.th. që provat e kërkuara nga një urdhër duhet të jenë të rëndësishme për hetimin ose ndjekjen penale) dhe për shmangien e urdhrave tejet të zgjeruar për zbulimin e informacionit të abonentit. Ky kufizim rritet parimin e vendosur tashmë nga neni 2 i këtij Protokolli dhe paragrafi 1 i nenit 7, i cili kufizon masën në hetime dhe procedime penale specifike që dispozitat nuk mund të përdoren për prodhimin masiv ose me shumicë të të dhënave (shih, gjithashtu, paragrafin 182 të raportit shpjegues të Konventës).

98. Siç përcaktohet në paragrafin 2/b të nenit 3, termi “autoritet kompetent” i referohet një autoriteti gjyqësor, administrativ ose autoriteti tjetër ligjzbatues të autorizuar nga legjislacioni i brendshëm për të urdhëruar, autorizuar ose ndërmarrë ekzekutimin e masave sipas këtij Protokolli. E njëjta qasje parashikohet për qëllime të procedurës së bashkëpunimit të drejtpërdrejtë në këtë nen. Si rrjedhojë, sistemi i brendshëm ligjor i një Pale do të rregullojë se cili autoritet konsiderohet autoritet kompetent për lëshimin e një urdhri. Ndërsa Pala lëshuese përcakton se cila nga autoritetet e saj mund të lëshojë urdhrin, neni 7 parashikon një garanci në paragrafin 5, me anë të së cilës Pala marrëse mund të kërkojë që një autoritet i caktuar të rishikojë urdhrat e lëshuar, sipas këtij neni, dhe të ketë aftësinë për të ndërprerë



bashkëpunimin e drejtpërdrejtë, siç përshkruhet më poshtë.

99. Në nenin 7, termi “një ofrues shërbimi në territorin e një Pale tjetër” kërkon që ofruesi i shërbimit të jetë fizikisht i pranishëm në Palën tjetër. Sipas këtij neni, fakti i thjeshtë që, për shembull, një ofrues shërbimi ka krijuar marrëdhënie kontraktuale me një kompani në një Palë, por vetë ofruesi i shërbimit nuk është fizikisht i pranishëm në atë Palë, nuk do të përbënte që ofruesi i shërbimit të ndodhet “në territorin” e asaj Pale. Paragrafi 1 kërkon, përveç kësaj, që të dhënat të jenë nën zotërim ose kontroll të ofruesit të shërbimit.

Paragrafi 2

100. Në paragrafin 2, të nenit 7, Palëve u kërkohej të miratojnë çdo masë të nevojshme që ofruesit e shërbimeve në territorin e tyre t'i përgjigjen një urdhri të lëshuar nga një autoritet kompetent në një Palë tjetër, në përputhje me paragrafin 1. Duke pasur parasysh dallimet në sistemet e brendshme ligjore, Palët mund të zbatojnë masa të ndryshme për të vendosur një procedurë që bashkëpunimi i drejtpërdrejtë të zhvillohet në mënyrë efektive dhe efikase. Kjo mund të variojë nga heqja e pengesave ligjore për ofruesit e shërbimeve për t'iu përgjigjur një urdhri, deri në dhënien e një baze pohuese, duke i detyruar ofruesit e shërbimeve t'i përgjigjen një urdhri nga një autoritet i një Pale tjetër në mënyrë efektive dhe efikase. Çdo Palë duhet të garantojë që ofruesit e shërbimeve të mund të zbatojnë ligjërisht urdhrat e parashikuar nga neni 7 në një mënyrë që garanton siguri juridike që ofruesit e shërbimeve të mos mbajnë përgjegjësi ligjore vetëm për faktin se kanë respektuar në mirëbesim një urdhër të lëshuar sipas paragrafit 1, që një Palë ka deklaruar (sipas nenit 7, paragrafi 3/b) se është lëshuar në përputhje me këtë Protokoll. Kjo nuk përjashton përgjegjësinë për arsye të tjera, përveç respektimit të urdhrat, për shembull, moszbatimi i ndonjë kërkesë ligjore të zbatueshme që ofruesi i shërbimit të mbajë nivelet e duhura të sigurisë së informacionit të ruajtur. Forma e zbatimit varet nga konsideratat ligjore dhe politike përkatëse të Palëve. Për Palët që kanë kërkesa për mbrojtjen e të dhënave, kjo do të përfshijë ofrimin e një baze të qartë për përpunimin e të dhënave personale. Në funksion të kërkesave shtesë, sipas ligjeve për mbrojtjen e të dhënave për të autorizuar transferimet eventuale ndërkombëtare

të informacionit të aksesueshëm të abonentit, ky Protokoll pasqyron interesin e rëndësishëm publik të kësaj mase bashkëpunimi të drejtpërdrejtë dhe përfshin garancitë e kërkuara për këtë qëllim në nenin 14.

101. Siç u shpjegua më lart, sistemi i brendshëm ligjor i një Pale do të rregullojë se cili autoritet konsiderohet si autoritet kompetent për të lëshuar një urdhër. Disa Palë çmonin se ishte e nevojshme të kishin një garanci shtesë për shqyrtimin e mëtejshëm të ligjshmërisë së urdhrat (shih, për shembull, paragrafin 98 më lart), duke pasur parasysh natyrën e drejtpërdrejtë të bashkëpunimit. Ndërsa Pala lëshuese përcakton se cilat nga autoritetet e saj mund të lëshonin urdhrin, paragrafi 2/b i lejon Palët të bëjnë një deklaratë ku përcaktohet, se: “urdhri sipas nenit 7, paragrafi 1, duhet të lëshohet nga ose nën mbikëqyrjen e një prokurori ose autoriteti tjetër gjyqësor, ose ndryshe të lëshohet nën mbikëqyrje të pavarur”. Një Palë që përdor këtë deklaratë duhet të pranojë një urdhër nga ose nën mbikëqyrjen e ndonjë prej këtyre autoriteteve të renditura.

Paragrafi 3

102. Paragrafi 3 i nenit 7 specifikon informacionin që minimalisht do të jepet nga një autoritet që lëshon një urdhër në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, megjithëse një Palë lëshuese mund të zgjedhë të përfshijë informacion shtesë në vetë urdhrin për të ndihmuar në përpunimin ose për arsye se legjislacioni i saj i brendshëm kërkon informacion shtesë. Informacioni i specifikuar në paragrafin 3 është veçanërisht i rëndësishëm për ekzekutimin e urdhrat nga ofruesi i shërbimit, si dhe përfshirjen e mundshme të autoritetit të Palës ku ndodhet ofruesi i shërbimit, në përputhje me paragrafin 5. Urdhri duhet të përfshijë emrin e autoritetit lëshues dhe datën e lëshimit të urdhrat, informacionin që identifikon ofruesin e shërbimit, veprën penale që është objekt hetimi ose procedimi penal, autoritetin që kërkon informacionin e abonentit dhe një përshkrim të detajuar të informacionit specifik të abonentit të kërkuar. Urdhri duhet të përmbajë, gjithashtu, një deklaratë se urdhri është lëshuar në përputhje me këtë Protokoll. Duke bërë këtë deklaratë, Pala shprehet se urdhri është në përputhje me kushtet e këtij Protokoll.

103. Lidhur me ndryshimin midis paragrafit 3/a (autoriteti lëshues) dhe 3/e (autoriteti që kërkon



informacionin e abonentit) në disa Palë, autoriteti lëshues dhe autoriteti që kërkon të dhënat nuk janë të njëjtë. Për shembull, hetuesit ose prokurorët mund të jenë autoritetet që kërkojnë të dhënat, ndërsa një gjyqtar lëshon urdhrin. Në situata të tilla, si autoriteti që kërkon të dhënat, ashtu edhe autoriteti që lëshon urdhrin duhet të identifikohen.

104. Nuk kërkohet deklarim i fakteve, duke marrë parasysh se ky informacion është konfidencial në shumicën e hetimeve penale dhe nuk mund t'i zbulohet një pale private.

Paragrafi 4

105. Ndërsa paragrafi 3 përcakton informacionin minimal të kërkuar për urdhrat e lëshuar në përputhje me paragrafin 1, këta urdhra shpesh mund të ekzekutohen vetëm nëse ofruesit të shërbimit (dhe, sipas rastit, autoritetit të caktuar të Palës marrëse, sipas paragrafit 5 i jepet informacion shtesë. Si rrjedhojë, paragrafi 4, i nenit 7, specifikon se një autoritet lëshues duhet të sigurojë informacion plotësues në lidhje me bazat ligjore vendëse që autorizojnë autoritetin të lëshojë urdhrin; referencë ndaj dispozitave ligjore dhe dënimeve të zbatueshme për veprën që po hetohet ose ndiqet penalisht; informacionin e kontaktit të autoritetit të cilit ofruesi i shërbimit do t'i kthejë informacionin e abonentit, do të kërkojë informacione të mëtejshme ose do të përgjigjet ndryshe; kohën dhe mënyrën e kthimit të informacionit të abonentit; nëse tashmë është kërkuar ruajtja e të dhënave, duke përfshirë datën e ruajtjes dhe çdo numër reference të zbatueshme; çdo udhëzim të veçantë procedural (për shembull kërkesat për konfidencialitet ose vleftësim); një deklaratë, nëse është e zbatueshme, se njoftimi i njëkohshëm është bërë në përputhje me paragrafin 5; dhe çdo informacion tjetër që mund të ndihmojë në sigurimin e zbulimit të informacionit të abonentit. Informacioni i kontaktit nuk duhet të identifikojë individin, por vetëm zyrën. Ky informacion shtesë mund të jepet veçmas, por mund të përfshihet edhe në vetë urdhrin nëse kjo është e lejueshme, sipas ligjit të Palës lëshuese. Si urdhri, ashtu edhe informacioni shtesë do t'i transmetohen drejtpërdrejt ofruesit të shërbimit.

106. Udhëzimet e posaçme procedurale mbulojnë, në veçanti, çdo kërkesë për konfidencialitet, duke përfshirë një kërkesë për moszbulim të urdhrin ndaj abonentit ose palëve të tjera të treta, përveç kur udhëzimet e veçanta

procedurale nuk mund ta pengojnë ofruesin që të konsultohet me autoritetet për t'u njoftuar sipas paragrafit 5/a ose t'i referohet nënparagrafit 5/b. Nëse kërkohet konfidencialitet për të shmangur një zbulim të parakohshëm të çështjes, kjo duhet të specifikohet në kërkesë. Në disa Palë, konfidencialiteti i urdhrin do të ruhet sipas ligjit, ndërsa në Palë të tjera nuk është domosdoshmërisht rasti. Si rrjedhojë, për të shmangur rrezikun e zbulimit të parakohshëm të hetimit, Palët inkurajohen të jenë të vetëdijshme për ligjin në fuqi dhe politikat e një ofruesi të shërbimit në lidhje me njoftimin e abonentit, përpara se të dorëzojnë urdhrin sipas paragrafit 1 tek ofruesi i shërbimit. Përveç kësaj, udhëzimet e veçanta procedurale mund të përfshijnë specifikimin e kanalit të transmetimit që i përshtatet më mirë nevojave të autoritetit. Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë, gjithashtu, informacion shtesë në lidhje me llogarinë ose informacione të tjera për ta ndihmuar të japë një përgjigje të shpejtë dhe të plotë. Një kërkesë për konfidencialitet nuk duhet t'i pengojë ofruesit e shërbimeve që të raportojnë transparencë për numrat e përgjithshëm anonimë të urdhrave të marrë sipas nenit 7.

Paragrafi 5

107. Sipas paragrafit 5/a, një Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës se, kur një urdhër i lëshohet sipas paragrafit 1 një ofruesi shërbimi në territorin e saj, ajo do të kërkojë njoftim të njëkohshëm ose në çdo rast (d.m.th., për të gjithë urdhrat e transmetuar tek ofruesit e shërbimeve në territorin e tij) ose në rrethana të identifikuara.

108. Sipas paragrafit 5/b, një Palë, sipas legjislacionit të saj të brendshëm, mund të kërkojë, gjithashtu, që një ofrues shërbimi që merr urdhër nga një Palë tjetër, të konsultohet me të në rrethana të identifikuara. Një Palë mund të mos kërkojë konsultim për të gjitha urdhrat, çka do të shtonte një hap shtesë që mund të shkaktonte vonesa të konsiderueshme, por vetëm në rrethana më të kufizuara, të identifikuara. Kërkesat e konsultimit duhet të kufizohen në rrethanat në të cilat ekziston një mundësi e shtuar për nevojën për të vendosur një kusht ose për të cituar një arsye për refuzim, ose shqetësim për cenim të mundshëm të hetimeve ose procedimeve penale të palës transferuese.



109. Procedurat e njoftimit dhe konsultimit janë tërësisht diskrecionale. Një Palë nuk është e detyruar të kërkojë asnjërin nga procedurat.

110. Palët e njoftuara sipas paragrafit 5/a ose të konsultuara sipas paragrafit 5/b, mund të udhëzojnë një ofrues shërbimi që të mos zbulojë informacion mbi arsyet e parashikuara në paragrafin 5/c, të cilat përshkruhen më hollësisht në paragrafin 141 të raportit shpjegues në nenin 8. Për shkak të kësaj, aftësia e një Pale për t'u njoftuar ose konsultuar ofron një garanci shtesë. Në fakt, bashkëpunimi në parim duhet të jetë i gjerë dhe pengesat për të janë rreptësisht të kufizuara. Si rrjedhojë, siç shpjegohet në paragrafët 242 dhe 253 të raportit shpjegues të Konventës, përcaktimi nga Pala e njoftuar ose konsultuar se cilat kushte dhe refuzime do të zbatoheshin sipas neneve 25, paragrafi 4 dhe 27, paragrafi 4 të Konventës, duhet, gjithashtu, të kufizohet në përputhje me objektivat e nenit 7 të Protokollit për të eliminuar barrierat dhe për të siguruar procedura më efikase dhe të përshtetshme për aksesin ndërkufitar në provat elektronike për hetimet penale.

111. Sipas paragrafit 5/d, Palët që bëjnë një deklaratë sipas paragrafit 5/a ose që kërkojnë konsultim sipas paragrafit 5/b, mund të kontaktojnë dhe kërkojnë informacion shtesë nga autoriteti i caktuar sipas paragrafit 4/c për të përcaktuar nëse ka një bazë sipas paragrafit 5/c për të udhëzuar ofruesin e shërbimit që të mos zbatojë urdhrin. Procesi synohet të jetë aq i shpejtë sa do ta lejojë rrethanat. Pala e njoftuar ose e konsultuar duhet të mbledhë informacionin e nevojshëm dhe të marrë vendimin e saj sipas paragrafit 5/c, "pa vonesë të panevojshme". Kur është e nevojshme, për të mundësuar bashkëpunim, procedura sipas paragrafit 5/d mund të ofrojë, gjithashtu, një mundësi për të sqaruar aspektet e konfidencialitetit të informacionit të kërkuar, si dhe çdo kufizim të përdorimit të synuar nga autoriteti që kërkon të dhënat. Gjithashtu, kjo Palë duhet të njoftojë menjëherë autoritetin e Palës lëshuese, në rast se vendos të udhëzojë ofruesin e shërbimit të mos pajtohet, si dhe të paraqesë arsyet për kryerjen e një veprimi të tillë.

112. Një Palë që kërkon njoftim ose konsultim, mund të vendosë t'i caktojë ofruesit një periudhë pritjeje përpara se ofruesi të japë informacionin e abonentit në përgjigje të urdhrin, në mënyrë që të

lejojë njoftimin ose konsultimin dhe çdo kërkesë pasuese nga Pala për informacion shtesë.

113. Sipas paragrafit 5/e, një Palë që kërkon njoftim ose konsultim, duhet të caktojë një autoritet të vetëm dhe kur kërkohet njoftim sipas paragrafit 5/a, t'i japë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës informacionin e duhur të kontaktit.

114. Një Palë mund të ndryshojë kërkesën e saj të njoftimit ose konsultimit në çdo kohë, në varësi të përcaktimit të çdo faktori të lidhur me të, si p.sh., nëse dëshiron të kalojë nga një regjim njoftimi në një regjim konsultimi ose nëse ka zhvilluar një nivel të mjaftueshëm komoditeti me bashkëpunim të drejtpërdrejtë që mund të rishikojë ose heqë një kërkesë të mëparshme njoftimi ose konsultimi. Ajo mund të vendosë, gjithashtu, që si rezultat i përvijës që ka fituar me mekanizmin e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, dëshiron të fillojë një regjim njoftimi ose konsultimi.

115. Sipas paragrafit 5/f, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës i kërkohet të krijojë dhe të mbajë të përditësuar një regjistër të kërkesave të njoftimit të palëve sipas paragrafëve 5/a dhe 5/e. Një regjistër i përditësuar në dispozicion të publikut është thelbësor për të siguruar që autoritetet e palës lëshuese dhe ofruesit e shërbimeve të jenë në dijeni të kërkesave të njoftimit të secilës palë, të cilat, siç u shpreh më lart, mund të ndryshojnë në çdo kohë. Meqë çdo Palë mund të bëjë një ndryshim të tillë sipas diskrecionit të saj, çdo Pale që bën ndonjë ndryshim ose vëren pasaktësi në lidhje me të dhënat e saj në regjistër, i kërkohet të njoftojë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm për të siguruar që të tjerët janë në dijeni të kërkesave aktuale dhe mund t'i zbatojnë siç duhet.

Paragrafi 6

116. Paragrafi 6 sqaron se njoftimi i një Pale tjetër dhe sigurimi i informacionit shtesë duke përdorur mjete elektronike, përfshirë përdorimin e *email*-it dhe portaleve elektronike, është i lejueshëm. Nëse pranohet nga ofruesi i shërbimit, një Palë mund të paraqesë një urdher sipas paragrafit 1 dhe informacion shtesë, sipas paragrafit 4 në formë elektronike. Qëllimi është të inkurajohet përdorimi i mjeteve elektronike nëse pranohet nga ofruesi i shërbimit, pasi këto janë pothuajse gjithmonë mjetet më efikase dhe më të shpejta të komunikimit. Metodat e vlefshëm mund të



përfshijnë një shumëllojshmëri mjetesesh ose kombinim të tyre që lejojnë identifikim të sigurt të autoritetit kërkuar. Mjete të tilla mund të përfshijnë, për shembull, marrjen e konfirmimit të autenticitetit nëpërmjet një autoriteti të njohur në Palën lëshuese (për shembull nga dërguesi ose një autoritet qendror ose i caktuar), komunikimet e mëvonshme ndërmjet autoritetit lëshues dhe Palës marrëse, përdorimin e një adrese *email*-i ose metodave të ardhshme të verifikimit teknologjik që mund të përdoren lehtësisht nga autoritetet transmetuese. Një tekst i ngjashëm përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 10 dhe udhëzime të mëtejshme, në lidhje me kërkesat e sigurisë jepen në paragrafin 174 të raportit shpjegues. Neni 6, paragrafi 4 dhe neni 8, paragrafi 5 i Protokollit, gjithashtu, përmbajnë tekst të ngjashëm.

Paragrafi 7

117. Paragrafi 7 parashikon që nëse një ofrues shërbimi nuk zbaton një urdhër të lëshuar sipas nenit 7, pala lëshuese mund të kërkojë ekzekutim vetëm në përputhje me nenin 8 ose një formë tjetër të ndihmës së ndërsjellë. Palët që procedojnë sipas këtij neni nuk mund të kërkojnë ekzekutim të njëanshëm.

118. Për zbatimin e urdhrin nëpërmjet nenit 8, ky Protokoll parashikon një procedurë të thjeshtuar të shndërrimit të një urdhri sipas këtij neni në një urdhër sipas nenit 8, për të lehtësuar aftësinë e Palës lëshuese për marrjen e informacionit të abonentit.

119. Për të shmangur përpjekjet e dyfishta, një Palë lëshuese duhet t'i japë ofruesit të shërbimit afat 30-ditor ose afatin kohor të përcaktuar në paragrafin 4/d, cilado qoftë periudha kohore më e gjatë, që të kryhet procesi i njoftimit dhe konsultimit dhe që ofruesi i shërbimit të zbulojë informacionin ose të specifikojë një refuzim për ta bërë këtë. Vetëm pas mbarimit të asaj periudhe kohore, ose nëse ofruesi ka specifikuar një refuzim për përmbushje përpara mbarimit të kësaj periudhe kohore, një Palë lëshuese mund të kërkojë zbatimin në përputhje me nenin 8 ose forma të tjera të ndihmës së ndërsjellë. Për të lejuar autoritetet që të vlerësojnë nëse duhet të kërkojnë zbatim sipas paragrafit 7, ofruesit e shërbimeve inkurajohen të shpjegojnë arsyet për mosdhënien e të dhënave të kërkuara. Për shembull, një ofrues shërbimi mund të shpjegojë se të dhënat nuk janë më të disponueshme.

120. Nëse një autoritet i njoftuar sipas paragrafit 5/a ose i konsultuar sipas paragrafit 5/b, ka informuar Palën lëshuese se ofruesi i shërbimit është udhëzuar që të mos e zbulojë informacionin e kërkuar, pala lëshuese mund të kërkojë, megjithatë, zbatimin e urdhrin nëpërmjet nenit 8 ose një forme tjetër të ndihmës së ndërsjellë. Megjithatë, ekziston rreziku që një kërkesë e tillë e mëtejshme mund të refuzohet, gjithashtu. Pala lëshuese këshillohet të konsultohet paraprakisht me një autoritet të caktuar, sipas paragrafëve 5/a ose 5/b për të trajtuar çdo të metë në urdhrin origjinal dhe për të shmangur dorëzimin e urdhrave, sipas nenit 8 ose nëpërmjet çdo mekanizmi tjetër të ndihmës së ndërsjellë që mund të jetë refuzuar.

Paragrafi 8

121. Sipas paragrafit 8, një Palë mund të deklarojë se një Palë tjetër do të kërkojë zbulimin e informacionit të abonentit nga ofruesi i shërbimit përpara se ta kërkojë atë sipas nenit 8, përveç rastit kur Pala lëshuese jep shpjegim të arsyeshëm për të mos e bërë këtë. Për shembull, një Palë mund të bëjë një deklaratë të tillë për arsye se konsideron që procedurat sipas këtij neni duhet t'u mundësojnë Palëve të tjera të marrin të dhënat e abonentit më shpejt se sa sipas nenit 8, dhe, si rezultat, mund të zvogëlojnë numrin e situatave në të cilat duhet të citohet neni 8. Procedurat e nenit 8 do të përdoren vetëm atëherë kur përpjekjet për të kërkuar zbulimin e informacionit të abonentit drejtpërdrejt nga ofruesi i shërbimit kanë qenë të pasuksesshme, kur Pala lëshuese ka një shpjegim të arsyeshëm për mospërdorimin fillimisht të këtij neni ose kur Pala lëshuese ka rezervuar të drejtën për të mos zbatuar këtë nen. Për shembull, një Palë lëshuese mund ta provojë këtë kur një ofrues shërbimi në mënyrë rutinore nuk ofron informacion për abonentin në përgjigje të urdhrave të marrë drejtpërdrejt nga ajo Palë. Ose, si shembull tjetër, nëse një Palë lëshuese, nëpërmjet një urdhri të vetëm, kërkon informacionin e abonentit dhe të dhënat e trafikut nga një Palë tjetër që zbaton nenin 8 për të dyja kategoritë e të dhënave, nuk do të ishte e nevojshme që Pala lëshuese të kërkonte fillimisht informacionin e abonentit veçmas.

Paragrafi 9

122. Sipas paragrafit 9/a, një Pale që rezervon këtë nen nuk i kërkohet të marrë masa sipas paragrafit 2, që ofruesit e shërbimeve në territorin e saj të zbulojnë informacionin e abonentit në



përgjigje të urdhrave të lëshuar nga Palët e tjera. Një Pale që rezervon këtë nen nuk i lejohet të lëshojë urdhra, sipas paragrafit 1 për ofruesit e shërbimeve në territoret e palëve të tjera.

123. Paragrafi 9/b parashikon që – për arsyet e shpjeguara në paragrafin 93 më sipër – nëse zbulimi i disa llojeve të numrave të aksesit, sipas këtij neni, do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të sistemit të saj të brendshëm ligjor, një Palë mund të rezervojë të drejtën të mos zbatojë këtë nen për numra të tillë. Një Pale që bën një rezervë të tillë nuk i lejohet të lëshojë urdhra për numra të tillë, sipas paragrafit 1 për ofruesit e shërbimeve në territoret e Palëve të tjera.

SEKSIONI 3

PROCEDURAT PËR RRITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR NDËRMJET AUTORITETEVE PËR ZBULIMIN E TË DHËNAVE TË RUAJTURA KOMPJUTERIKE

Neni 8

Zbatimi i urdhrave nga një Palë tjetër për prodhimin e përsheptuar të informacionit të abonentit dhe të dhënave të trafikut

124. Qëllimi i nenit 8 është që një Palë kërkuuese të ketë mundësinë të lëshojë një urdhër për t'u paraqitur si pjesë e një kërkesë një Pale tjetër dhe që Pala e kërkuar të ketë aftësinë për të zbatuar atë urdhër, duke detyruar një ofrues shërbimi në territorin e saj për të prodhuar informacionin e abonentit ose të dhënat e trafikut nën zotërimin ose kontrollin e ofruesit të shërbimit.

125. Ky nen krijon një mekanizëm që plotëson dispozitat e Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë. Ai është krijuar për të qenë më i thjeshtë se sa është aktualisht ndihma e ndërsjellë, për arsye se informacioni që Pala kërkuuese duhet të sigurojë është më i kufizuar dhe procesi për marrjen e të dhënave është më i shpejtë. Ky nen plotëson dhe, për këtë arsye, nuk cenon procese të tjera të ndihmës së ndërsjellë sipas Konventës ose marrëveshjeve të tjera shumëpalëshe ose dypalëshe, të cilat një Palë mbetet e lirë t'i citojë. Në të vërtetë, në situatat kur një Palë kërkuuese dëshiron të kërkojë të dhëna trafiku nga një Palë që ka rezervuar atë aspekt të nenit 8, Pala kërkuuese mund të përdorë një procedurë tjetër të ndihmës së

ndërsjellë. Kur, siç ndodh shpesh, informacioni i abonentit, të dhënat e trafikut dhe të dhënat e ruajtura të përmbajtjes kërkojnë njëkohësisht, mund të jetë më efikase që të kërkojnë të tria format e të dhënave për të njëjtën llogari nëpërmjet një kërkesë të vetme tradicionale për ndihmë të ndërsjellë, në vend që të kërkojnë disa lloje të dhënash nëpërmjet metodës së parashikuar në këtë nen dhe të tjera nëpërmjet një kërkesë të veçantë për ndihmë të ndërsjellë.

Paragrafi 1

126. Paragrafi 1 kërkon që Pala kërkuuese të mund të lëshojë një urdhër për marrjen e informacionit të abonentit ose të dhënat e trafikut nga një ofrues shërbimi në territorin e një Pale tjetër. “Urdhri” i përmendur në nenin 8 është çdo proces ligjor që synon të detyrojë një ofrues shërbimi që të sigurojë informacionin e abonentit ose të dhënat e trafikut. Për shembull, ai mund të zbatohet me një urdhër prodhimi, fletëthirrje ose mekanizëm tjetër të autorizuar me ligj dhe që mund të lëshohet për qëllim të detyrimit të prodhimit të informacionit të abonentit ose të dhënave të trafikut.

127. Siç përcaktohet në paragrafin 2/b, të nenit 3, “autoriteti kompetent” në paragrafin 1 të këtij neni i referohet një “autoriteti gjyqësor, administrativ ose autoriteti tjetër ligjzbatues të autorizuar nga legjislacioni i brendshëm për të urdhëruar, autorizuar ose ndërmarrë ekzekutimin e masave sipas këtij Protokoll, për qëllim të mbledhjes ose prodhimit të provave në lidhje me hetimet ose procedimet penale specifike”. Duhet të theksohet se autoritetet kompetente për lëshimin e një urdhri, sipas paragrafit 1, mund të mos jenë domosdoshmërisht të njëjta me autoritetet e caktuara për të dorëzuar urdhrin që do të zbatohet në përputhje me paragrafin 10/a të nenit 8, siç përshtatet më hollësisht më poshtë.

128. Neni 8, termi “një ofrues shërbimi në territorin e një Pale tjetër” kërkon që ofruesi i shërbimit të jetë fizikisht i pranishëm në Palën tjetër. Sipas këtij neni, vetëm fakti që për shembull, një ofrues shërbimi ka krijuar marrëdhënie kontraktuale me një kompani në një Palë, por vetë ofruesi i shërbimit nuk është fizikisht i pranishëm në atë Palë, nuk do të përbënte që ofruesi i shërbimit të ndodhet “në territorin” e asaj Pale. Paragrafi 1 kërkon, përveç kësaj, që të dhënat të



jenë nënzhotërim ose kontroll të ofruesit të shërbimit.

Paragrafi 2

129. Paragrafi 2 i kërkon Palës së kërkuar që të miratojë masat e nevojshme për zbatimin në territorin e saj të një urdhri të lëshuar sipas paragrafit 1, duke iu nënshtruar garancive të përshkruara më poshtë. “Zbatim” nënkupton se pala e kërkuar do të detyrojë ofruesin e shërbimit që të sigurojë informacionin e abonentit dhe të dhënat e trafikut, duke përdorur mekanizmin, sipas zgjedhjes së Palës së kërkuar, me kusht që mekanizmi ta bëjë urdhrin të zbatueshëm, sipas legjislacionit të brendshëm të Palës së kërkuar dhe të plotësojë kërkesat e këtij neni. Për shembull, një Palë e kërkuar mund të zbatojë urdhrin e një Pale kërkuese duke e pranuar atë si të barasvlerëshëm me urdhrat e brendshëm, duke e miratuar atë për t'i dhënë të njëjtën fuqi si një urdhër i brendshëm ose duke lëshuar urdhrin e saj të prodhimit. Çdo mekanizëm i tillë do t'u nënshtrohet kushteve të legjislacionit të Palës së kërkuar, pasi procedurat e Palës së kërkuar do ta kontrollojnë atë. Si rrjedhojë, Pala e kërkuar mund të garantojë që legjislacioni i saj, duke përfshirë kërkesat kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut, të respektohet, veçanërisht në lidhje me çdo garanci shtesë, duke përfshirë ato të nevojshme për prodhimin e të dhënave të trafikut.

130. Ndërsa ky nen mund të zbatohet në disa mënyra, një Palë mund të dëshirojë të hartojë proceset e saj të brendshme me fleksibilitetin për të trajtuar kërkesat nga një sërë autoritetesh kompetente. Paragrafi 3/b u negociaua për të siguruar që Palës së kërkuar i ishte dhënë informacion i mjaftueshëm për të garantuar që mund të kryhej një rishikim i plotë nëse ishte e nevojshme, pasi disa Palë u shprehën se do të lëshonin urdhrin e tyre si një mënyrë për të zbatuar urdhrin e Palës kërkuese.

Paragrafi 3

131. Për të filluar procesin e Palës së kërkuar për zbatimin e urdhrit, Pala kërkuese do të transmetojë urdhrin dhe informacionin mbështetës. Paragrafi 3 përshkruan çka një Palë kërkuese duhet t'i japë Palës së kërkuar, në mënyrë që Pala e kërkuar të zbatojë urdhrin dhe të detyrojë prodhimin nga një ofrues shërbimi në territorin e asaj Pale. Paragrafi 3/a përshkruan informacionin që duhet të përfshihet në vetë urdhrin dhe përfshin informacionin thelbësor për ekzekutimin e tij.

Informacioni në paragrafin 3/b, i cili është për përdorim vetëm nga Pala e kërkuar dhe jo për t'u ndarë me ofruesin e shërbimit, përveç me pëlqimin e Palës kërkuese, është informacion mbështetës që përcakton bazat e brendshme ligjore dhe bazën ndërkombëtare në këtë Protokoll për urdhrin dhe i jep informacion Palës së kërkuar për të vlerësuar arsyet e mundshme për kushte ose refuzim sipas paragrafit 8. Palët, në momentin që fillojnë një kërkesë sipas nenit 8, duhet të specifikojnë nëse ka ndonjë informacion sipas paragrafit 3/b që mund të ndahet me ofruesin e shërbimit. Sipas paragrafit 3/c, kërkesa duhet të përfshijë, gjithashtu, të gjitha udhëzimet e veçanta, duke përfshirë, për shembull, kërkesat për certifikim ose konfidencialitet të kërkesës (të ngjashme me nenin 27, paragrafi 8 i Konventës) në kohën e transmetimit për të siguruar përpunimin e duhur të kërkesës.

132. Urdhri për informacionin e abonentit ose të dhënat e trafikut të përshkruara në paragrafin 3/a duhet, fillimisht duhet të specifikojë: i. autoritetin që ka lëshuar urdhrin dhe datën e lëshimit të urdhrit; ii. një deklaratë që është lëshuar në përputhje me këtë Protokoll; iii. emrin dhe adresën e ofruesit të shërbimit që do të dorëzohet; iv. veprën/at që është/janë objekt hetimi apo procedimi penal; v. autoritetin që kërkon të dhënat, nëse nuk është autoriteti lëshues; dhe vi. një përshkrim të detajuar të të dhënave specifike të kërkuara (që është identiteti i abonentit, adresa postare ose gjeografike, telefoni ose numër tjetër aksesi, dhe informacioni i faturimit dhe pagesave të disponueshëm në bazë të marrëveshjes ose rregullimit të shërbimit (shih nenin 3 të këtij Protokoll që përfshin nenin 18, paragrafi 3 të Konventës dhe raportin shpjegues, paragrafin 93 më sipër); dhe në lidhje me të dhënat e trafikut, të dhënat kompjuterike për komunikim me anë të një sistemi kompjuterik të krijuar nga një sistem kompjuterik që përbënte zinxhirin e komunikimit, duke specifikuar origjinën e komunikimit, destinacionin, rrugën, kohën, datën, madhësinë, kohëzgjatjen ose llojin e shërbimit bazë (shih nenin 3, paragrafi 1 i këtij Protokoll që përfshin nenin 1, paragrafi d të Konventës). Në lidhje me paragrafin 3/a/v, nëse autoriteti lëshues dhe autoriteti që kërkon të dhënat nuk janë të njëjtë, dispozita kërkon që të dyja të identifikohen. Për shembull, një autoritet hetues ose procedues mund të jetë duke kërkuar të dhënat, ndërsa një gjyqtar lëshon



urdhrit. Ky informacion specifikon legjitimitetin e urdhrit dhe jep udhëzime të qarta për ekzekutimin e tij.

133. Informacioni mbështetës, i përshkruar në paragrafin 3/b, synon t'i japë Palës së kërkuar informacionin që do t'i nevojitej për të zbatuar urdhrin e Palës kërkuese. Kjo mund të lehtësohet, gjithashtu, nga një model që do të ishte i lehtë për t'u plotësuar, i cili mund të shtonte më tej efikasitetin në proces. Të përfshira në listën e informacionit mbështetës janë sa më poshtë:

- Paragrafi 3/b/i i referohet bazës ligjore që i jep autoritetit lëshues kompetencën për të lëshuar urdhrin për të detyruar prodhimin. Me fjalë të tjera, ky është ligji përkatës që autorizon një autoritet kompetent për të lëshuar urdhrin e përshkruar në paragrafin 1.

- Paragrafi 3/b/ii i referohet dispozitës ligjore, në lidhje me veprën e referuar në rendin në paragrafin 3/a/iv dhe gamës së saj të dënimeve. Përfshirja e të dyja këtyre elementeve është e rëndësishme për Palën e kërkuar për të vlerësuar nëse kërkesa hyn ose jo brenda fushëveprimit të detyrimeve të saj.

- Paragrafi 3/b/iii i referohet çdo informacioni që Pala kërkuese mund të ofrojë që e çoi atë në përfundimin se ofruesi/t e shërbimit që janë objekt i urdhrit, zotërojnë ose kontrollojnë informacionin ose të dhënat e kërkuara. Ky informacion është i rëndësishëm për fillimin e procesit në Palën e kërkuar. Identifikimi i ofruesit të shërbimit lokal dhe besimi se ai zotëron ose kontrollon informacionin ose të dhënat e kërkuara, është shpesh parakusht për fillimin e aplikimeve për porosinë e prodhimit.

- Paragrafi 3/b/iv i referohet një përmbledhjeje të shkurtër të fakteve që lidhen me hetimin ose procedimin. Ky informacion është, gjithashtu, faktor kyç për Palën e kërkuar për të përcaktuar nëse një urdhër sipas këtij neni duhet të zbatohet ose jo në territorin e saj.

- Paragrafi 3/b/v i referohet një deklarate në lidhje me rëndësinë e informacionit ose të dhënave për hetimin ose procedimin. Kjo deklaratë ndihmon Palën e kërkuar për të vendosur nëse janë përmbushur ose jo kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni, d.m.th. se informacioni ose të dhënat janë “të nevojshme për hetimet ose procedimet penale specifike të Palës”.

- Paragrafi 3/b/vi i referohet informacionit të kontaktit të një autoriteti ose autoriteteve, në rast se autoriteti kompetent në Palën e kërkuar kërkon informacion shtesë për zbatimin e urdhrit.

- Paragrafi 3/b/vii i referohet informacionit nëse është kërkuar tashmë ruajtja e informacionit ose e të dhënave. Ky është informacion i rëndësishëm për Palën e kërkuar, veçanërisht në lidhje me të dhënat e trafikut dhe duhet të përfshijë, për shembull, numrat e referencës dhe datën e ruajtjes, pasi ky informacion mund t'i lejojë Palës së kërkuar të përshtatë kërkesën aktuale me një kërkesë të mëparshme ruajtjeje dhe në këtë mënyrë të lehtësojë zbulimin e informacionit ose të dhënave të ruajtura fillimisht. Për të reduktuar rrezikun e fshirjes së informacionit ose të dhënave, Palët inkurajohen të kërkojnë ruajtjen e informacionit ose të dhënave të kërkuara sa më shpejt të jetë e mundur dhe përpara fillimit të një kërkesë sipas këtij neni, dhe të kërkojnë zgjerimin e ruajtjeve në kohën e duhur.

- Paragrafi 3/b/viii i referohet informacionit nëse të dhënat tashmë janë kërkuar me mjete të tjera dhe, nëse po, në cilën mënyrë. Kjo dispozitë trajton kryesisht nëse Pala kërkuese ka kërkuar tashmë informacionin e abonentit ose të dhënat e trafikut drejtpërdrejt nga ofruesi i shërbimit.

134. Informacioni që do të jepet në përputhje me paragrafin 3/b, nuk do t'i zbulohet ofruesit të shërbimit pa pëlqimin e Palës kërkuese. Në veçanti, përmbledhja e fakteve dhe deklarata në lidhje me rëndësinë e informacionit ose të dhënave për hetimin ose procedimin i jepet Palës së kërkuar, me qëllim të përcaktimit nëse ka një bazë për vendosjen e termave ose kushteve ose për refuzim, por shpesh i nënshtrohen fshehtësisë së hetimit.

135. Sipas paragrafit 3/c, Pala kërkuese mund të kërkojë udhëzime të posaçme procedurale, duke përfshirë kërkesat për moszbulimin e urdhrit tek abonenti ose formularët e vleftësimit që duhet të plotësohen për provat. Ky informacion duhet të njihet që në fillim, pasi udhëzime të posaçme mund të kërkojnë procese shtesë brenda Palës së kërkuar.

136. Për zbatimin e urdhrit dhe për të lehtësuar më tej prodhimin e informacionit ose të dhënave, Pala e kërkuar mund t'i japë ofruesit të shërbimit informacion shtesë, të tillë si mënyra e prodhimit dhe kujt duhet t'i prodhohen të dhënat në Palën e kërkuar.

**Paragrafi 4**

137. Në bazë të paragrafit 4, Palës së kërkuar mund t'i duhet t'i jepet informacion shtesë, në mënyrë që të zbatohet urdhrin. Për shembull, sipas legjislacionit të brendshëm të disa Palëve, prodhimi i të dhënave të trafikut mund të kërkojë informacione të mëtejshme, sepse ka kërkesa shtesë në ligjet e tyre për marrjen e të dhënave të tilla. Përveç kësaj, Pala e kërkuar mund të kërkojë sqarime, në lidhje me informacionin e dhënë në përputhje me paragrafin 3/b. Si shembull tjetër, disa Palë mund të kërkojnë informacion shtesë kur urdhri nuk është lëshuar ose rishikuar nga një prokuror ose autoritet tjetër gjyqësor ose administrativ i pavarur i Palës kërkuese. Kur bëjnë një deklaratë të tillë, Palët duhet të jenë sa më specifike që të jetë e mundur në lidhje me llojin e informacionit të mëtejshëm të kërkuar.

Paragrafi 5

138. Paragrafi 5 i kërkon Palës së kërkuar që të pranojë kërkesat në formë elektronike. Mund të kërkojë përdorimin e mjeteve të sigurta dhe të vërtetueshme të komunikimeve elektronike për të lehtësuar transmetimin e informacionit ose të të dhënave dhe dokumenteve, duke përfshirë transmetimin e urdhrave dhe informacionit mbështetës. Nenet 6 deri 11 parashikojnë, gjithashtu, mjete të tilla komunikimi.

Paragrafi 6

139. Sipas paragrafit 6, Pala e kërkuar duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të vijuar me shpejtësi në lidhje me kërkesën. Ajo do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të përpunuar kërkesat dhe për t'ia dorëzuar ofruesit të shërbimit brenda dyzet e pesë ditëve pasi Pala e kërkuar të ketë marrë të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm. Pala e kërkuar do të urdhërojë ofruesin e shërbimit që të prodhojë informacionin e abonentit brenda njëzet ditëve dhe të dhënat e trafikut brenda dyzet e pesë ditëve. Ndërsa Pala e kërkuar duhet të kërkojë të detyrojë prodhimin sa më shpejt të jetë e mundur, ka shumë faktorë që mund të vonojnë prodhimin, të tillë si ofruesit e shërbimeve që kundërshtojnë, nuk iu përgjigjen kërkesave ose nuk respektojnë datën e kthimit për prodhim, si dhe vëllimi i kërkesave që një Palë të kërkuar mund t'i kërkojë të përpunojë. Për shkak të kësaj, u vendos që palëve të kërkuara t'u kërkojë të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të përfunduar vetëm proceset nën kontrollin e tyre.

Paragrafi 7

140. Palët pranu se disa udhëzime të veçanta procedurale nga Pala kërkuese mund të shkaktojnë, gjithashtu, vonesa në përpunimin e urdhrave, nëse udhëzimet kërkojnë procese shtesë të brendshme për zbatimin e udhëzimeve të veçanta procedurale. Pala e kërkuar mund të kërkojë, gjithashtu, informacion shtesë nga Pala kërkuese për të mbështetur çdo aplikim për urdhra plotësues, të tillë si urdhrat e konfidencialitetit (urdhrat për moszbulim). Disa udhëzime procedurale mund të mos jenë të disponueshme, sipas legjislacionit të Palës së kërkuar, rast në të cilin paragrafi 7 parashikon që ajo duhet të informojë menjëherë Palën kërkuese dhe të specifikojë çdo kusht nën të cilin ajo mund të pajtohet, duke i dhënë Palës kërkuese mundësinë për të përcaktuar nëse dëshiron apo jo që të vijojë me kërkesën.

Paragrafi 8

141. Sipas paragrafit 8, Pala e kërkuar mund të refuzojë të ekzekutojë një kërkesë, nëse ekzistojnë arsyet për refuzim të përcaktuara në nenet 25, paragrafi 4, ose 27, paragrafi 4 të Konventës. Për shembull, në përputhje me paragrafin 257 të raportit shpjegues të Konventës, kjo parashikon që një dispozitë e tillë u nënshtrohet arsyeve për refuzim në traktatet e zbatueshme të ndihmës së ndërsjellë dhe ligjet e brendshme dhe parashikon “garanci për të drejtat e personave të ndodhur në Palën e kërkuar” dhe në përputhje me paragrafin 268 të atij raporti shpjegues, ndihma mund të refuzohet, për shkak të “cenimit të sovranitetit të shtetit, sigurisë, rendit publik ose interesave të tjerë thelbësorë”. Ajo, gjithashtu, mund të vendosë kushte të nevojshme për të lejuar ekzekutimin e kërkesës, të tilla si konfidencialiteti. Përveç kësaj, Pala e kërkuar mund të shtyjë ekzekutimin e kërkesës, sipas nenit 27, paragrafi 5 të Konventës. Pala e kërkuar do të njoftojë Palën kërkuese për vendimin e saj për të refuzuar, kushtëzuar ose shtyrë kërkesën. Përveç kësaj, Palët mund të aplikojnë kufizimin e përdorimit në përputhje me kushtet e nenit 28, paragrafi 2/b të Konventës.

142. Për të promovuar parimin e sigurimit të masës më të gjerë të bashkëpunimit (shih nenin 5, paragrafi 1, arsyet për refuzim të përcaktuara nga një Palë e kërkuar duhet të jenë të ngushta dhe të ushtrohen me kufizim. Duhet të sillen në vëmendje se paragrafi 253 i raportit shpjegues të Konventës parashikon që “ndihma e ndërsjellë në parim duhet



të jetë e gjerë dhe pengesat për të, janë rreptësisht të kufizuara”. Si rrjedhojë, kushtet dhe refuzimet duhet, gjithashtu, të kufizohen në përputhje me objektivat e këtij neni, për të eliminuar barrierat për ndarjen ndërkufitare të informacionit të abonentit dhe të dhënave të trafikut dhe për të ofruar procedura më efikase dhe të përshpejtuara se sa ndihma e ndërsjellë tradicionale.

Paragrafi 9

143. Sipas paragrafit 9, “[nëse] një Palë kërkuese nuk mund të përmbushë një kusht të vendosur nga Pala e kërkuar sipas paragrafit 8, ajo duhet të informojë menjëherë Palën e kërkuar. Pala e kërkuar do të përcaktojë më pas nëse informacioni ose materiali, gjithsesi, duhet të sigurohet... Nëse Pala kërkuese e pranon kushtin, ajo do të ketë detyrime ligjore në lidhje me të. Pala e kërkuar që jep informacion ose material që i nënshtrohet një kushti të tillë, mund t’i kërkojë Palës kërkuese të shpjegojë, në lidhje me atë kusht, përdorimin e këtij informacioni ose materiali”.

Paragrafi 10

144. Qëllimi i paragrafit 10 është të sigurojë që Palët, në kohën e nënshkrimit ose kur depozitojnë instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose miratimit, të identifikojnë autoritetet për të dorëzuar dhe marrë urdhra sipas nenit 8. Palët nuk duhet të japin emrin dhe adresën e një individi të caktuar, por mund të identifikojnë një zyrë ose njësi që konsiderohet kompetente për qëllimet e dërgimit dhe marrjes së urdhrave sipas këtij neni.

Paragrafi 11

145. Paragrafi 11 i lejon një Pale të deklarojë se kërkon që urdhrat e paraqitura në bazë të këtij neni të transmetohen nga autoriteti qendror i Palës kërkuese ose autoritet tjetër, kur përcaktohet reciprokisht ndërmjet Palëve. Palët inkurajohen të ofrojnë sa më shumë fleksibilitet për paraqitjen e kërkesave.

Paragrafi 12

146. Paragrafi 12 kërkon që Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës të krijojë dhe të mbajë të përditësuar një regjister të autoriteteve të caktuara nga palët, sipas paragrafit 10 dhe që çdo palë të sigurojë që të dhënat e saj të mbajtura në regjister të jenë të sakta. Një informacion i tillë do të ndihmojë Palët e kërkuara për të verifikuar vërtetësinë e kërkesave.

Paragrafi 13

147. Sipas paragrafit 13, një Pale që rezervon të drejtën për të mos zbatuar këtë nen për të dhënat e trafikut, nuk i kërkohet zbatimi i urdhrave për të dhënat e trafikut nga një Palë tjetër. Një Pale që bën rezervë për këtë nen nuk i lejohet të dorëzojë urdhra për të dhënat e trafikut te Palët e tjera, sipas paragrafit 1.

Neni 9

Zbulimi i përshpejtuar i të dhënave të ruajtura kompjuterike në një rast urgjent

148. Përveç formave të tjera të bashkëpunimit të përshpejtuar të parashikuara në këtë Protokoll, hartuesit ishin të vetëdijshëm për nevojën për të lehtësuar aftësinë e Palëve, në rast urgjence, për të marrë me shpejtësi të dhëna kompjuterike të ruajtura të specifikuar, nën zotërim ose kontroll të një ofruesi shërbimi në territorin e një Pale tjetër për përdorim në hetime ose procedime penale specifike. Siç përcaktohet në paragrafët 42 dhe 172 të këtij raporti shpjegues, nevoja për bashkëpunim maksimal të përshpejtuar mund të lindë në një sërë situatash emergjente, si p.sh. në pasojat e menjëhershme të një sulmi terrorist, një sulm *ransomware* që mund të dëmtojë një sistem spitalor, ose kur hetohen llogaritë e *email*-it të përdorura nga rrëmbyesit për të lëshuar kërkesa dhe për të komunikuar me familjen e viktimës.

149. Sipas Konventës, në raste urgjente, Palët bëjnë kërkesa për ndihmë të ndërsjellë për të marrë të dhëna dhe, sipas nenit 35, paragrafi 1/c i Konventës, Rrjeti 24/7 është i disponueshëm për të lehtësuar ekzekutimin e këtyre kërkesave. Përveç kësaj, sistemet ligjore të disa vendeve u lejojnë autoriteteve kompetente të vendeve të tjera të kërkojnë zbulimin emergjent të të dhënave nëpërmjet rrjetit 24/7, pa dërguar kërkesë për ndihmë të ndërsjellë.

150. Siç pasqyrohet në nenin 5, paragrafi 7, ky nen nuk cenon bashkëpunimin (përfshirë bashkëpunimin spontan) ndërmjet palëve, ose ndërmjet palëve dhe ofruesve të shërbimeve, nëpërmjet marrëveshjeve, rregullimeve, praktikave ose legjislacioni tjetër të brendshëm të zbatueshëm. Si rrjedhojë, sipas këtij Protokoll, të gjithë mekanizmat e mësipërm mbeten në dispozicion të autoriteteve kompetente që kërkojnë të dhëna në rast urgjence. Risia e këtij Protokoll është



përpunimi i dy neneve që detyrojnë të gjitha Palët të ofrojnë të paktën kanale specifike për bashkëpunim të përshtetshëm në situata urgjente: Neni 9 dhe neni 10.

151. Ky nen i lejon Palët që të bashkëpunojnë për të marrë të dhëna kompjuterike në situata urgjente, duke përdorur si kanal Rrjetin 24/7 të krijuar sipas nenit 35 të Konventës. Ky Rrjet është veçanërisht i përshtatshëm për trajtimin e kërkesave me afat të ngushtë dhe me prioritet të lartë të parashikuara në këtë nen. Rrjeti 24/7 ka personel me pika kontakti, të cilët, në praktikë, komunikojnë me shpejtësi dhe pa nevojën për përkthime me shkrim dhe janë të aftë të përmbushin kërkesat e marra nga Palët e tjera, qoftë duke shkuar drejtpërdrejt tek ofruesit në territorin e tyre, duke kërkuar ndihmë nga autoritetet e tjera kompetente ose duke iu drejtuar autoriteteve gjyqësore, nëse kjo kërkohet nga legjislacioni i brendshëm i Palës. Gjithashtu, këto pika kontakti mund të këshillojnë Palët kërkuuese për pyetjet që mund të kenë në lidhje me ofruesit dhe marrjen e provave elektronike, për shembull duke shpjeguar legjislacionin e brendshëm që duhet të respektohet për marrjen e provave. Një komunikim i tillë i plotë rrit të kuptuarin e legjislacionit të brendshëm nga Pala kërkuuese në Palën e kërkuar dhe lehtëson marrjen më të lehtë të provave të nevojshme.

152. Përdorimi i kanalit të vendosur në këtë nen mund të ketë përparësi ndaj kanalit të ndihmës së ndërsjellë emergjente të përcaktuar në nenin 10. Për shembull, ky kanal ka avantazhin që nuk është e nevojshme të përgatitet paraprakisht asnjë kërkesë për ndihmë të ndërsjellë. Mund të nevojitet kohë e konsiderueshme për përgatitjen e një kërkesë paraprake për ndihmë të ndërsjellë, përkthimin e saj dhe për t'ia kaluar, nëpërmjet kanaleve të brendshme, autoritetit qendror të Palës kërkuuese për ndihmë të ndërsjellë, çka nuk do të kërkohet sipas nenit 9. Përveç kësaj, pasi Pala e kërkuar të ketë marrë kërkesa, nëse duhet të marrë informacion shtesë përpara se të mund të japë ndihmë, koha shtesë që mund të nevojitet për një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë ka më shumë gjasa të ngadalësojë ekzekutimin e kërkesës. Në kontekstin e ndihmës së ndërsjellë, Palët e kërkuara shpesh kërkojnë që informacioni shtesë të jepet në formë të shkruar dhe më të hollësishme, ndërsa kanali 24/7 funksionon duke përdorur shkëmbimin

e informacionit në kohë reale. Nga ana tjetër, kanali i ndihmës së ndërsjellë emergjente ofron përparësi në situata të caktuara. Për shembull: i. mund të humbet pak ose aspak kohë duke përdorur atë kanal, nëse ka marrëdhënie pune veçanërisht të ngushta ndërmjet autoriteteve qendrore në fjalë; ii. ndihma e ndërsjellë emergjente mund të përdoret për të siguruar forma shtesë bashkëpunimi përveç të dhënave kompjuterike të mbajtura nga ofruesit; dhe iii. mund të jetë më e lehtë të vërtetohen dëshmitë e marra nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë. U takon palëve, bazuar në përvojën e tyre të akumuluar dhe rrethanat specifike ligjore dhe faktike në fjalë, që të vendosin se cili është kanali më i mirë për t'u përdorur në një rast të veçantë.

Paragrafi 1

153. Sipas paragrafit 1/a, çdo Palë do të marrë masa, sipas nevojës, për të garantuar që pika e saj e kontaktit për Rrjetin 24/7 të jetë e aftë të transmetojë kërkesat në rast urgjence në pikën e kontaktit në një Palë tjetër, duke kërkuar ndihmë të menjëhershme për sigurimin e zbulimit të përshtetshëm të të dhënave kompjuterike të specifikuara dhe të ruajtura, të mbajtura nga ofruesit në territorin e asaj Pale dhe marrjen e kërkesave nga pikat e kontaktit në Palët e tjera për të dhëna të tilla të mbajtura nga ofruesit në territorin e saj. Siç parashikohet në nenin 2, kërkesa duhet të bëhet në bazë të një hetimi ose procedimi penal specifik.

154. Pikat e kontaktit 24/7 duhet të kenë aftësinë për të transmetuar dhe marrë kërkesa të tilla në rast urgjence, pa qenë e nevojshme që të përgatitet dhe transmetohet paraprakisht një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë, siç përshkruhet në paragrafin 152 të raportit shpjegues më sipër, duke iu nënshtruar mundësisë së një deklarate, sipas nenit 9, paragrafi 5. Termi “urgjencë” përcaktohet në nenin 3. Sipas nenit 9, Pala e kërkuar duhet të përcaktojë nëse ekziston një “urgjencë”, në lidhje me një kërkesë, duke përdorur informacionin e dhënë në paragrafin 3.

155. Ndryshe nga nenet e tjera të këtij Protokollit, të tillë si neni 7, i cili mund të përdoret vetëm për të marrë “informacion të specifikuar, të ruajtur të abonentit”, ky nen përdor termin më të gjerë “të dhëna kompjuterike të specifikuara, të ruajtura”. Shtrirja e këtij termi është e gjerë, por jo në mënyrë jodiskriminuese: ai mbulon çdo të dhënë kompjuterike “të specifikuar”, siç



përcaktohet në nenin 1/b të Konventës që përfshihet në nenin 3, paragrafi 1 të këtij Protokoll. Përdorimi i këtij termi më të gjerë njihet rëndësinë e marrjes së përmbajtjes së ruajtur dhe të të dhënave të trafikut, dhe jo vetëm të informacionit të abonentit, në situata urgjente, pa kërkuar si kusht paraprak paraqitjen e një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë. Të dhënat në fjalë janë të ruajtura ose të dhëna ekzistuese dhe nuk përfshijnë të dhëna që nuk ekzistojnë ende, të tilla si të dhënat e trafikut ose të dhënat e përmbajtjes që lidhen me komunikimet e ardhshme (shih paragrafin 170 të raportit shpjegues të Konventës).

156. Kjo dispozitë i ofron fleksibilitet palës kërkuese për të përcaktuar se cili prej autoriteteve të saj duhet të fillojë kërkesën, siç janë autoritetet kompetente që po kryejnë hetimin ose pika e saj e kontaktit 24/7, në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Pika e kontaktit e rrjetit 24/7 në Palën kërkuese më pas funksionon si kanal për të transmetuar kërkesën në pikën e kontaktit 24/7 në Palën tjetër.

157. Sipas paragrafit 1/b, një Palë mund të deklarojë se nuk do të ekzekutojë një kërkesë, sipas nenit 9 vetëm për informacionin e abonentit, siç përcaktohet në nenin 18.3 të Konventës, të përfshirë në nenin 3, paragrafi 1 të këtij Protokoll. Për disa Palë, marrja e kërkesave sipas këtij neni vetëm për informacionin e abonentit do të rrezikonte mbingarkimin e pikave të kontaktit të Rrjetit 24/7, duke devijuar burimet dhe energjinë larg kërkesave për përmbajtje ose të dhëna trafiku. Në raste të tilla, Palët që kërkojnë vetëm informacionin e abonentit mund të përdorin në vend të kësaj nenet 7 ose 8, të cilët lehtësojnë zbulimin e shpejtë të një informacioni të tillë. Një deklaratë e tillë nuk i ndalon Palët e tjera që të përfshijnë një kërkesë për informacionin e abonentit, kur ato, gjithashtu, lëshojnë një kërkesë sipas këtij neni për përmbajtjen dhe/ose të dhënat e trafikut.

Paragrafi 2

158. Paragrafi 2 kërkon që çdo Palë të marrë masa, sipas nevojës, për të garantuar që autoriteteve të saj t'u mundësohet, sipas legjislacionit të saj të brendshëm, të kërkojnë dhe të marrin të dhëna të kërkuara sipas paragrafit 1 nga ofruesit e shërbimeve në territorin e saj, dhe t'u përgjigjen kërkesave të tilla, pa qenë e nevojshme që Pala kërkuese të paraqesë kërkesë për ndihmë të

ndërsjellë, duke iu nënshtruar mundësisë për të bërë një deklaratë, në përputhje me paragrafin 5.

159. Duke pasur parasysh ndryshimin në ligjet kombëtare, paragrafi 2 është hartuar për të ofruar fleksibilitet për Palët në ndërtimin e sistemeve të tyre për t'iu përgjigjur kërkesave sipas paragrafit 1. Megjithatë, Palët inkurajohen që të zhvillojnë mekanizma për respektimin e këtij neni që theksojnë shpejtësinë dhe efikasitetin, të cilat janë përshtatur me urgjencën e një situatë urgjente dhe që ofrojnë një bazë të gjerë ligjore për zbulimin e të dhënave ndaj palëve të tjera në situata urgjente.

160. Është në diskrecionin e Palës së kërkuar që të përcaktojë: i. nëse kërkesat për përdorimin e këtij neni janë përmbushur; ii. nëse një mekanizëm tjetër është i përshtatshëm për qëllime të asistimit të Palës kërkuese; iii. autoritetin përkatës për ekzekutimin e një kërkesë të marrë nga pika e kontaktit e rrjetit 24/7. Ndërsa pika e kontaktit të rrjetit 24/7 në disa Palë mund të ketë tashmë autoritetin e nevojshëm për të ekzekutuar vetë kërkesën, Palët e tjera mund të kërkojnë që pika e tyre e kontaktit t'ia përcjellë kërkesën një autoriteti ose autoriteti tjetër për të kërkuar zbulimin e të dhënave nga ofruesi. Në disa Palë, kjo mund të kërkojë marrjen e një urdhri gjyqësor për të kërkuar zbulimin e të dhënave. Pala e kërkuar ka, gjithashtu, diskrecionin për të përcaktuar kanalin për transmetimin e të dhënave të aksesueshme të Pala kërkuese – qoftë nëpërmjet pikës së kontaktit 24/7 ose nëpërmjet një autoriteti tjetër.

Paragrafi 3

161. Paragrafi 3 specifikon informacionin që duhet të jepet në një kërkesë në përputhje me paragrafin 1. Informacioni i specifikuar në paragrafin 3 është për të lehtësuar shqyrtimin dhe, sipas rastit, ekzekutimin e kërkesës nga autoriteti përkatës i Palës së kërkuar.

162. Në lidhje me paragrafin 3/a, Pala kërkuese do të specifikojë autoritetin kompetent në emër të të cilit kërkohen të dhënat.

163. Në lidhje me paragrafin 3/b, Pala kërkuese duhet të deklarojë se kërkesa është lëshuar në përputhje me këtë Protokoll. Kjo do të garantojë që kërkesa është bërë në përputhje me këtë Protokoll dhe se çdo e dhënë e marrë, si rezultat, do të trajtohet në një mënyrë të pajtueshme me kërkesat e këtij Protokoll. Kjo do të dallojë, gjithashtu, kërkesën nga kërkesat e tjera për



zbulimin e urgjencës që pika e kontaktit të Rrjetit 24/7 mund të marrë.

164. Sipas paragrafit 3/e, Pala kërkuuese duhet të sigurojë fakte të mjaftueshme që provojnë ekzistencën e një urgjence, siç përcaktohet në nenin 3, dhe se si të dhënat e kërkuara nga kërkesa lidhen me atë urgjencë. Nëse Pala e kërkuar kërkon sqarim të kërkesës ose informacion shtesë për të vepruar sipas kërkesës, ajo duhet të konsultohet me pikën e kontaktit të Rrjetit 24/7 të palës kërkuuese.

165. Sipas paragrafit 3/g, kërkesa duhet të specifikojë çdo udhëzim të veçantë procedural. Këto përfshijnë, në veçanti, kërkesat për moszbulim të kërkesës për abonentët dhe palët e tjera të treta ose formularët e vleftësimit që duhet të plotësohen për të dhënat e kërkuara. Sipas këtij paragrafi, këto udhëzime procedurale jepen që në fillim, pasi udhëzimet e veçanta mund të kërkojnë procese shtesë brenda Palës së kërkuar. Në disa Palë, konfidencialiteti mund të ruhet në bazë të ligjit, ndërsa në Palët e tjera, ky nuk është domosdoshmërisht rasti. Si rrjedhojë, për të shmangur rrezikun e zbulimit të parakohshëm të hetimit, Palët inkurajohen të komunikojnë në lidhje me nevojën dhe çdo vështirësi që mund të lindë në ruajtjen e konfidencialitetit, duke përfshirë çdo ligj të zbatueshëm, si dhe politikat e një ofruesi shërbimi në lidhje me njoftimin. Meqë kërkesat për vleftësimin e të dhënave të aksesueshme shpesh mund të ngadalësojnë objektivin kryesor të zbulimit të shpejtë të të dhënave të kërkuara, autoritetet e Palës së kërkuar, në konsultim me autoritetet e Palës kërkuuese, duhet të përcaktojnë se kur dhe në cilën mënyrë duhet të jepet konfirmimi i autenticitetit.

166. Përveç kësaj, Pala ose ofruesi i shërbimit mund të kërkojë informacion shtesë për të lokalizuar dhe zbuluar të dhënat e ruajtura kompjuterike të kërkuara nga Pala kërkuuese.

Paragrafi 4

167. Paragrafi 4 kërkon që Pala e kërkuar të pranojë kërkesat në formë elektronike. Palët inkurajohen që të përdorin mjete të shpejta komunikimi për të lehtësuar transmetimin e informacionit ose të të dhënave dhe dokumenteve, duke përfshirë transmetimin e kërkesave. Ky paragraf bazohet në paragrafin 5 të nenit 8, por ai është ndryshuar për të shtuar se një Palë mund të pranojë kërkesat verbalisht, një metodë komunikimi e përdorur shpesh nga Rrjeti 24/7.

Paragrafi 5

168. Paragrafi 5 i lejon një Pale të bëjë një deklaratë që kërkon nga Palët e tjera që kërkojnë të dhëna prej saj sipas këtij neni, të paraqesin, pas ekzekutimit të kërkesës dhe transmetimit të të dhënave, kërkesën dhe çdo informacion shtesë të transmetuar në mbështetje të saj, në një format specifik dhe përmes një kanali specifik. Për shembull, një Palë mund të deklarojë se në rrethana specifike, ajo do të kërkojë që një Palë kërkuuese të paraqesë kërkesë të mëvonshme për ndihmë të ndërsjellë, në mënyrë që të dokumentojë zyrtarisht kërkesën e urgjencës dhe vendimin paraprak për të siguruar të dhëna në përgjigje të një kërkesë të tillë. Për disa Palë një procedurë e tillë do të kërkohej nga legjislacioni i tyre i brendshëm, ndërsa palët e tjera specifikuan se nuk kanë kërkesa të tilla dhe nuk është e nevojshme të përdorin këtë mundësi për një deklaratë.

Paragrafi 6

169. Ky nen u referohet “kërkesave” dhe nuk u kërkon palëve të kërkuara t’u japin të dhënat e kërkuara palëve kërkuuese. Si rrjedhojë, hartuesit pranojnë se do të ketë situata kur Palët e kërkuara nuk do t’i japin të dhënat e kërkuara një Pale kërkuuese sipas këtij neni. Pala e kërkuar mund të përcaktojë që, në një rast të veçantë, ndihma e ndërsjellë urgjente, sipas nenit 10 ose një mjeti tjetër bashkëpunimi, do të ishin më të përshtatshme. Si rezultat, paragrafi 6 parashikon që kur një Palë e kërkuar vendos që nuk do t’i japë të dhënat e kërkuara një Pale që ka bërë kërkesë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, Pala e kërkuar do të informojë Palën kërkuuese për vendimin e saj në një kohë të shpejtë mbi bazë të përshpejtuar, dhe nëse është e zbatueshme, do të specifikojë çdo kusht nën të cilin do të sigurojë të dhënat dhe do të shpjegojë çdo formë tjetër bashkëpunimi që mund të jetë e disponueshme, në përputhje për të arritur qëllimin e ndërsjellë të Palëve për përshpejtimin e zbulimit të të dhënave në raste urgjente.

Paragrafi 7

170. Paragrafi 7 përshkruan procedurat e zbatueshme, kur shteti i kërkuar ka specifikuar kushte për ofrimin e bashkëpunimit sipas paragrafit 6. Sipas paragrafit 7/a, kur Pala kërkuuese nuk mund të përmbushë kushtet e specifikuara, ajo duhet ta sjellë këtë menjëherë në vëmendjen e Palës së kërkuar dhe kjo e fundit do të vendosë më pas nëse



ndihma mund të jepet ende. Në të kundërt, kur Pala kërkuese ka pranuar një kusht të caktuar, ajo do të ketë detyrime ligjore në lidhje me të. Sipas paragrafit 7/b, një Palë e kërkuar që ka dhënë informacion ose material që i nënshtrohet një kushti, sipas paragrafit 6, për të konstatuar nëse një kusht i tillë është përmbushur, mund të kërkojë që Pala kërkuese të shpjegojë përdorimin që i ka bërë informacionit ose materialit të ofruar, por u kuptua se Pala kërkuese nuk mund të kërkojë një shpjegim tejet të ngarkuar (shih raportin shpjegues, paragrafët 279 dhe 280, të Konventës).

SEKSIONI 4

PROCEDURAT NË LIDHJE ME NDIHMËN E NDËRSJELLË NË RASTE URGJENTE

Neni 10

Ndihma e ndërsjellë në raste urgjente

171. Neni 10 i këtij Protokoll synon të sigurojë një procedurë të përshpejtuar për kërkesat për ndihmë të ndërsjellë të bëra në situata urgjente. Një urgjencë përcaktohet në nenin 3, paragrafi 2/c dhe shpjegohet në paragrafët 41 dhe 42 të këtij raporti shpjegues.

172. Për shkak se neni 10 i këtij Protokoll kufizohet te rastet urgjente që justifikojnë një veprim të tillë të përshpejtuar, ai dallon nga neni 25, paragrafi 3 i Konventës, në të cilin kërkesat për ndihmë të ndërsjellë mund të bëhen me mjete të përshpejtuar komunikimi në rrethana urgjente që nuk ngrihen në nivelin e urgjencës, siç është përcaktuar. Me fjalë të tjera, neni 25, paragrafi 3 është më i gjerë në fushëveprim sesa neni 10 i këtij Protokoll, në faktin që mbulon situatat që nuk mbulohen në nenin 10, siç janë rreziqet e vazhdueshme, por jo të menjëhershme për jetën ose sigurinë e personave, shkatërrimin e mundshëm të provave që mund të rezultojnë nga vonesa, një datë gjykimi të afërt ose lloje të tjera urgjencash. Ndërsa mekanizmi në nenin 25, paragrafi 3 parashikon një metodë më të shpejtë të përcjelljes dhe përgjigjes ndaj një kërkesë, detyrimet në rast urgjence sipas nenit 10 të këtij Protokoll janë dukshëm më të zgjeruara, d.m.th., kur ka rrezik të lartë dhe të pashmangshëm për jetën ose sigurinë e një personi fizik, procesi duhet të përshpejtohet edhe më shumë (shih paragrafin 42

të këtij raporti shpjegues për shembuj të situatave urgjente).

Paragrafi 1

173. Sipas paragrafit 1, në bërjen e një kërkesë urgjente, Pala kërkuese duhet të arrijë në përfundimin se një urgjencë sipas kuptimit të nenit 3, paragrafi 2/c, ekziston dhe duhet të përfshijë në kërkesën e saj një përshkrim të fakteve që e provojnë këtë, duke shpjeguar mënyrën në të cilën ndihma e kërkuar është e nevojshme për t'iu përgjigjur urgjencës, përveç informacioneve të tjera që kërkojnë të përmbahen në kërkesë, sipas traktatit në fuqi ose legjislacionit të brendshëm të Palës së kërkuar. Në lidhje me këtë, duhet të sjellim në vëmendje se sipas nenit 25, paragrafi 4 i Konventës, ekzekutimi i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë në përgjithësi “do t'u nënshtrohet kushteve të parashikuara nga legjislacioni i Palës së kërkuar ose nga traktatet e zbatueshme të ndihmës së ndërsjellë, përfshirë arsyet mbi të cilat Pala e kërkuar mund të refuzojë bashkëpunimin”. Hartuesit e kuptuan se kjo vlen edhe për kërkesat urgjente për ndihmë të ndërsjellë sipas këtij Protokoll.

Paragrafi 2

174. Paragrafi 2 kërkon që Pala e kërkuar të pranojë kërkesën për ndihmë të ndërsjellë në formë elektronike. Përpara pranimit të kërkesës, Pala e kërkuar mund të kushtëzojë pranimin e kërkesës me pajtueshmërinë nga Pala kërkuese me nivelet e duhura të sigurisë dhe vlefësisë. Në lidhje me kërkesat e sigurisë të përfshira në këtë paragraf, Palët mund të vendosin ndërmjet tyre nëse nevojiten garanci të posaçme (përfshirë kodimin) që mund të jenë të nevojshme në një çështje veçanërisht sensitive.

Paragrafi 3

175. Kur Pala e kërkuar kërkon informacion shtesë për të arritur në përfundimin se ekziston një urgjencë sipas kuptimit të nenit 3, paragrafi 2/c dhe/ose se kërkesat e tjera për ndihmë të ndërsjellë janë përmbushur, nga paragrafi 3 kërkohej informacion shtesë mbi bazë të përshpejtuar. Në mënyrë të ngjashme, paragrafi 3 kërkon që Pala kërkuese të japë informacionin shtesë në të njëjtën mënyrë të përshpejtuar. Si rrjedhojë, të dyja palët duhet të bëjnë përpjekje maksimale për të shmangur humbjen e kohës që mund të kontribuojë pa dashje në një rezultat tragjik.

**Paragrafi 4**

176. Sipas paragrafit 4, pasi të jetë dhënë informacioni i nevojshëm për të mundësuar ekzekutimin e kërkesës, Palës së kërkuar i kërkohet t'i përgjigjet kërkesës mbi të njëjtën bazë të përshpejtuar. Kjo në përgjithësi nënkupton përshpejtimin e sigurimit të urdhrave gjyqësorë që detyrojnë një ofrues të prodhojë të dhëna që janë provë e veprës penale dhe dorëzimi po aq i shpejtë i urdhrat tek ofruesi. Megjithatë, vonesat e shkaktuara nga koha e përgjigjes së ofruesit ndaj urdhrave të tillë, nuk duhet t'u atribuohen autoriteteve të Palës së kërkuar.

Paragrafi 5

177. Sipas paragrafit 5, të gjitha Palët do të garantojnë që anëtarët e autoritetit të saj qendror ose autoritetet e tjera përgjegjëse për t'iu përgjigjur kërkesave për ndihmë të ndërsjellë, do të jenë të disponueshëm njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë të javës, në rast se nevojiten të bëhen kërkesa urgjente për ndihmë të ndërsjellë jashtë orarit të rregullt të punës. Duhet të sjellim në vëmendje se në këtë drejtim Rrjeti 24/7 sipas nenit 35 të Konventës është i disponueshëm për koordinim me autoritetet përgjegjëse për ndihmën e ndërsjellë. Detyrimi në këtë paragraf nuk kërkon që autoriteti qendror ose autoritetet e tjera përgjegjëse për t'iu përgjigjur kërkesave për ndihmë të ndërsjellë të jenë të pajisura me personel dhe në veprim gjatë gjithë kohës. Përkundrazi, ai autoritet duhet të zbatojë procedura për të siguruar që stafi mund të kontaktohet për të shqyrtuar kërkesat urgjente jashtë orarit normal të punës. T-CY do të përpiqet jozyrtarisht të mbajë një drejtori të autoriteteve të tilla.

Paragrafi 6

178. Paragrafi 6 ofron një bazë për autoritetet qendrore ose autoritetet e tjera përgjegjëse për ndihmën e ndërsjellë që të përcaktojnë reciprokisht një kanal alternativ për transmetimin e informacionit ose të provës së aksesueshme, qoftë mënyrën e transmetimit ose autoritetet ndërmjet të cilave ai transmetohet. Kështu, në vend që informacioni ose prova e aksesueshme të dërgohet përmes kanalit të autoritetit qendror që përdoret zakonisht për të transmetuar informacionin ose provat e dhëna në ekzekutimin e kërkesës së palës kërkuese, ato mund të vendosin reciprokisht të përdorin një kanal tjetër për të përshpejtuar transmetimin, duke ruajtur integritetin e provave

ose për një arsye tjetër. Për shembull, në rast urgjence, autoritetet mund të vendosin për transmetimin e provave drejtpërdrejt te një autoritet hetues ose procedues në Palën kërkuese që do të përdorë provat, në vend që të kalojë zinxhirin e autoriteteve të cilin këto prova normalisht do të përshkojnë. Autoritetet, gjithashtu, mund të vendosin, për shembull, për trajtimin e veçantë të provave fizike, në mënyrë që të mund të përjashtojnë sfidat në procedimet gjyqësore të mëvonshme që provat mund të jenë ndryshuar ose prishur, ose mund të vendosin reciprokisht për trajtimin e veçantë të transmetimit të provave sensitive.

Paragrafi 7

179. Në lidhje me procedurat që rregullojnë këtë nen, ekzistojnë dy mundësi, siç përshkruhet në paragrafët 7 dhe 8. Paragrafi 7 i nenit 10 parashikon që kur Palët e interesuara nuk kanë detyrime ligjore reciprokisht nga një marrëveshje ose rregullim i zbatueshëm i ndihmës së ndërsjellë në bazë të legjislacionit uniform ose të ndërsjellë, Palët zbatojnë disa procedura të përcaktuara në paragrafët e specifikuar të neneve 27 dhe 28 të Konventës (që rregullojnë ndihmën e ndërsjellë në mungesë të një traktati).

Paragrafi 8

180. Paragrafi 8 parashikon që kur Palët e interesuara kanë detyrime ligjore reciprokisht nga një marrëveshje ose rregullim i tillë, neni 10 plotësohet nga dispozitat e asaj marrëveshjeje ose rregullimi, përveç rastit kur palët e interesuara vendosin reciprokisht të zbatojnë një ose të gjitha dispozitat e Konventës, të referuara në paragrafin 7, në vend të tyre.

Paragrafi 9

181. Së fundi, paragrafi 9 parashikon një mundësi për një deklaratë me anë të së cilës Palët e këtij Protokollit mund të parashikojnë që kërkesat të bëhen drejtpërdrejt ndërmjet prokurorëve ose autoriteteve të tjera gjyqësore. Në disa Palë, këto kanale të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve gjyqësore janë të konsoliduara dhe mund të ofrojnë një mjet efikas për të përshpejtuar më tej bërjen dhe ekzekutimin e kërkesave. Transmetimi i kërkesës urgjente përmes pikës së kontaktit të Palës 24/7 ose nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) është i dobishëm jo vetëm për të reduktuar ndonjë vonesë, por edhe për të rritur standardet e sigurisë dhe të vlefshësisë.



Megjithatë, në disa Palë, dërgimi i një kërkesë drejtpërdrejt te një autoritet gjyqësor në Palën e kërkuar, pa përfshirjen dhe miratimin e autoritetit të saj qendror, mund të jetë kundërproduktiv, pasi pa udhëzim dhe/ose miratim nga autoriteti i saj qendror, autoriteti marrës nuk mund të jetë i autorizuar për të vepruar në mënyrë të pavarur, ose mund të mos jetë njohur me procedurën e duhur. Si rrjedhojë, një Palë duhet të deklarojë se kërkesat mund të dërgohen nëpërmjet këtyre kanaleve të autoritetit joqendror.

SEKSIONI 5

PROCEDURAT NË LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR NË MUNGESË TË MARRËVESHJEVE TË ZBATUESHME NDËRKOMBËTARE

182. Siç parashikohet në nenin 5, paragrafi 5, ky seksion, në lidhje me nenet 11 dhe 12, zbatohet “kur nuk ka traktat ose rregullim të ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve kërkuese dhe atyre të kërkuara. Dispozitat e seksionit 5 nuk do të zbatohen kur ekziston një traktat ose rregullim i tillë, përveç siç parashikohet në nenin 12, paragrafi 7. Megjithatë, Palët e interesuara mund të vendosin reciprokisht të zbatojnë dispozitat e seksionit 5 në vend të tyre, nëse traktati ose rregullimi nuk e ndalon atë”. Kjo ndjek qasjen e nenit 27 të Konventës.

183. Ndërmjet disa Palëve të këtij Protokollit, subjektet e neneve 11 dhe 12 janë rregulluar tashmë nëpërmjet kushteve të traktateve të ndihmës së ndërsjellë (për shembull, Protokollit i Dytë Shtesë i Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (ETS nr. 182) ose Marrëveshja për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës). Traktatet e Ndihmës së Ndërsjellë si ETS nr. 182 mund të japin, gjithashtu, më shumë hollësi në lidhje me rrethanat, kushtet dhe procedurat në të cilat mund të zhvillohet një bashkëpunim i tillë.

184. Megjithëse hartuesit i morën parasysh këto traktate, nenet 11 dhe 12 të këtij Protokollit përmbajnë terma që ndryshojnë nga dispozitat e ngjashme në traktate të tjera të ndihmës së ndërsjellë.

185. Ndërsa kushtet e ETS nr. 182 do të vijojnë të zbatohen ndërmjet Palëve të tij, u çmua e nevojshme që këto dy nene në këtë Protokoll të rregulloheshin në një mënyrë që ndryshon në disa aspekte për arsyt e mëposhtme:

- Anëtarësimi në ETS nr. 182 është i ndryshëm nga ai i Konventës për Krimin Kibernetik dhe si rrjedhojë, dispozitat e saj nuk janë të disponueshme për bashkëpunim ndërmjet të gjitha palëve të Konventës për Krimin Kibernetik. ETS nr. 182 u negociua për të përmbushur nevojat e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe jo kërkesat ligjore, sistemet dhe nevojat e të gjitha palëve të Konventës për Krimin Kibernetik, megjithëse, në parim, Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (ETS nr. 30) dhe Protokollat e saj janë të hapura për aderim nga shtetet joanëtare të Këshillit të Evropës pas një ftese nga Komiteti i Ministrave.

- Dispozitat e ndihmës së ndërsjellë të këtij Protokollit kanë një fushëveprim material specifik pasi ato zbatohen për “hetimet ose procedimet penale specifike për veprat penale që lidhen me sistemet dhe të dhënat kompjuterike dhe për marrjen e provave në formë elektronike të veprës penale” (neni 2). Duke pasur parasysh problemet e veçanta të këtij lloji hetimi ose procedimi – të tilla si paqëndrueshmëria e të dhënave, çështjet që lidhen me territorin dhe juridiksionin dhe volumnin e kërkesave – dispozitat e ngjashme të ETS nr. 182 mund të mos jenë gjithmonë të zbatueshme në të njëjtën mënyrë.

- Hartuesit pranuan, se: “meqë Konventa zbatohet për Palët e shumë sistemeve dhe kulturave ligjore të ndryshme, nuk është e mundur të specifikohen hollësisht kushtet dhe garancitë e zbatueshme për çdo kompetencë ose procedurë” (shih paragrafin 145 të raportit shpjgues të Konventës). Në vend të kësaj, palëve u kërkohej të garantojnë që të ofrojnë “garanci të mjaftueshme të të drejtave dhe lirive të njeriut” dhe të zbatojnë “standardet e përbashkëta [dhe] garancitë minimale të cilave duhet t'i përmbahen Palët...”, duke përfshirë: “garancitë që lindin në përputhje me detyrimet që një Palë ka ndërmarrë sipas instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme për të drejtat e njeriut” (shih paragrafin 145 të raportit shpjgues të Konventës). Shih nenin 13 të këtij Protokollit (duke përfshirë nenin 15 të Konventës). Si rrjedhojë, ndryshe nga dispozitat e ETS nr. 182 –



për shembull neni 9 për “dëgjimin me videokonferencë” – të cilët përshkruajnë procedura dhe masa mbrojtëse specifike që duhen ndjekur nga Palët e ETS nr. 182, dispozitat përkatëse të këtij Protokolli lejojnë më shumë fleksibilitet në zbatimin e palëve. Për shembull, procedurat dhe kushtet që rregullojnë funksionimin e ekipeve të përbashkëta hetimore do të jenë, siç është rënë dakord ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve (shih nenin 12, paragrafi 2) dhe në lidhje me videokonferencat, një Palë e kërkuar mund të kërkojë kushte dhe masa të veçanta kur lejohet dëgjimi i një personi të dyshuar ose të akuzuar nëpërmjet videokonferencës (shih nenin 11, paragrafi 8). Në masën e parashikuar në këto nene, Palët mund të vendosin, gjithashtu, të mos bashkëpunojnë nëse kërkesat e tyre për sa u përket kushteve dhe garancive, nuk plotësohen.

186. Nenet 11 dhe 12 të këtij Protokolli zbatohen vetëm në mungesë të traktateve ose rregullimeve të tjera të ndihmës së ndërsjellë në bazë të legjislacionit uniform ose të ndërsjellë - përveç rasteve kur Palët e interesuara vendosin reciprokisht të zbatojnë një ose të gjitha dispozitat e tyre në vend të tyre, nëse traktati ose marrëveshja nuk e ndalon atë. Megjithatë, neni 12, paragrafi 7 zbatohet, pavarësisht nëse ka apo jo një traktat ose rregullim për ndihmë të ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve të interesuara.

Neni 11

Videokonferenca

187. Neni 11 trajton kryesisht përdorimin e teknologjisë së videokonferencës për të marrë dëshmi ose deklarata. Kjo formë bashkëpunimi mund të parashikohet në traktatet ekzistuese të ndihmës së ndërsjellë dypalëshe dhe shumëpalëshe, për shembull ETS nr. 182. Për të mos zëvendësuar dispozitat e hartuara posaçërisht për të përmbushur kërkesat e palëve të atyre traktateve ose konventave dhe, siç përcaktohet në parimet e përgjithshme të zbatueshme për këtë seksion (neni 5, paragrafi 5), neni 11, ashtu si neni 12 në këtë Protokoll, “zbatohet kur nuk ka traktat ose marrëveshje të ndihmës së ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet palëve kërkuuese dhe të kërkuara. Dispozitat e seksionit 5 nuk do të zbatohen kur ekziston një traktat ose

rregullim i tillë, përveç siç parashikohet në nenin 12, paragrafi 7. Megjithatë, Palët e interesuara mund të vendosin reciprokisht që të zbatojnë dispozitat e seksionit 5 në vend të tyre, nëse traktati ose marrëveshja nuk e ndalon këtë”.

Paragrafi 1

188. Paragrafi 1 autorizon marrjen e dëshmisë dhe deklaratave nga një dëshmitar ose ekspert me anë të videokonferencës. Ky paragraf i jep Palës së kërkuar diskrecion nëse do të pranojë ose jo kërkesën për ndihmë të ndërsjellë ose të vendosë kushte në dhënien e ndihmës. Për shembull, një Palë mund të refuzojë ose të shtyjë ndihmën për arsyet e parashikuara në nenin 27, paragrafët 4 deri 5 të Konventës. Përndryshe, kur do të ishte më efektive që ndihma të jepej në një mënyrë të ndryshme, si p.sh. nëpërmjet një formulari me shkrim që vërteton të dhënat zyrtare ose të biznesit, Pala e kërkuar mund të zgjedhë të ofrojë ndihmë në atë mënyrë.

189. Në të njëjtën kohë, pritet që Palët e këtij Protokolli do të kenë aftësinë teknike bazë për të ofruar ndihmë nëpërmjet videokonferencës.

190. Zhvillimi i një videokonference për të marrë dëshmi ose deklaratë, mund të shkaktojë shumë probleme, të cilat mund të përfshijnë probleme ligjore, logjistike dhe teknike. Në mënyrë që videokonferenca të mirëfunksionojë, koordinimi paraprak është thelbësor. Mund të nevojitet një koordinim shtesë kur Pala e kërkuar vendos kushte si parakushte për zhvillimin e videokonferencës. Si rrjedhojë, paragrafi 1 kërkon, gjithashtu, që palët kërkuuese dhe të kërkuara të konsultohen në rastet kur është e nevojshme për të lehtësuar zgjidhjen e çdo problemi të tillë që lind. Për shembull, siç shpjegohet më tej më poshtë, videokonferenca mund të duhet të ndjekë një procedurë të caktuar, në mënyrë që rezultati të jetë i pranueshëm si provë në Palën kërkuuese. Në të kundërt, Palës së kërkuar mund t'i duhet të zbatojë kërkesat e veta ligjore në disa aspekte (për shembull kryerja e një betimi nga dëshmitari ose informimi mbi të drejtat e tij). Për më tepër, Pala e kërkuar mund të kërkojë që zyrtari/ët e saj të jenë të pranishëm në videokonferencë në disa ose të gjitha situatat, qoftë për qëllim të kryesimit të procedurës ose për të garantuar që të drejtat e personit, dëshmia ose deklarata e të cilit është marrë, të respektohen. Në lidhje me këtë, konsultimet mund të zbulojnë se disa palë të kërkuara kërkojnë që zyrtari i saj



pjesëmarrës të jetë në gjendje të ndërhyjë, ndërpresë ose ndalojë seancën në rast problemesh në lidhje me pajtueshmërinë me ligjin e saj, ndërsa Palët e tjera mund të lejojnë që një videokonferencë të zhvillohet pa pjesëmarrjen e zyrtarëve të saj në disa rrethana. Si shembull i mëtejshëm, Palët e kërkuara mund të kërkojnë garanci të veçanta në lidhje me dëshmitarët, siguria e të cilëve është në rrezik, dëshmitarët fëmijë dhe të ngjashëm. Këto çështje duhet të diskutohen dhe vendosen paraprakisht. Në disa raste, dëshira e palës së kërkuar për një procedurë mund të bie ndesh me ligjet e Palës kërkuese për të lehtësuar përdorimin e dëshmisë ose deklaratës në gjykim. Në raste të tilla, Palët duhet të bëjnë përpjekje maksimale për të gjetur zgjidhje kreative që plotësojnë nevojat e të dyja palëve. Përveç kësaj, Palët do të konsultohen paraprakisht për të lehtësuar zgjidhjen e çështjeve të tilla si mënyra e trajtimit të kundërshtimeve ose pretendimeve për privilegj ose imunitet, të ngritura nga personi ose avokati i tyre, ose përdorimi i dokumentacionit ose provave të tjera gjatë videokonferencës. Gjithashtu, mund të kërkojen procedura të veçanta, për shkak të kushteve të vendosura, në mënyrë që të zhvillohet një video konferencë. Çështjet logjistike të tilla si nëse Pala kërkuese duhet të sigurojë interpretimin/përkthimin dhe regjistrimin e dëshmisë ose deklaratës nga ana e saj të videokonferencës ose Pala e kërkuar nga ana e saj, duhet, gjithashtu, të diskutohen, si dhe koordinimi teknik për të filluar dhe ruajtur transmetimin dhe për të pasur kanale alternative komunikimi në rast se transmetimi ndërpritet.

Paragrafi 2

191. Paragrafi 2 trajton një sërë mekanizmesh proceduralë dhe të lidhur që rregullojnë këtë formë bashkëpunimi (përveç procedurave dhe kërkesave të tjera të zbatueshme të përcaktuara në paragrafët e tjerë të këtij neni), të cilat janë marrë ose përshtatur nga Konventa. Paragrafi 2 është i ndarë në dy nënparagrafë.

192. Meqë videokonferencat janë një formë ndihme e ndërsjellë, paragrafi 2/a parashikon që autoritetet qendrore të Palëve të kërkuara dhe kërkuese do të komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin për qëllimet e zbatimit të këtij neni. Për shkak se ky nen zbatohet vetëm në mungesë të një marrëveshjeje ose rregullimi të ndihmës së ndërsjellë në bazë të legjislacionit uniform ose të

ndërsjellë, “autoriteti qendror” këtu nënkupton autoritetin ose autoritetet e caktuara sipas nenit 27, paragrafi 2/a, të Konventës (shih nenin 3, paragrafi 2/a të këtij Protokoll dhe paragrafin 38 të raportit shpjegues).

193. Paragrafi 2/a i këtij neni parashikon, gjithashtu, që një Palë e kërkuar mund të pranojë një kërkesë për videokonferencë në formë elektronike dhe mund të kërkojë nivele të përshtatshme sigurie dhe vlefësimi përpara pranimit të kërkesës.

194. Paragrafi 2/b kërkon (ngjashëm me nenin 27, paragrafi 7 i Konventës) që Pala e kërkuar të informojë Palën kërkuese për arsyet e saj për mosekzekutimin e një kërkesë ose për vonimin e ekzekutimit të kërkesës. Siç u përcaktua në paragrafin 192 më lart, komunikime të tilla do të kryhen nëpërmjet kanaleve të autoritetit qendror. Së fundi, paragrafi 2/b parashikon se neni 27, paragrafi 8 (trajtimi i konfidencialitetit të një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë në mungesë të një traktati) dhe neni 28, paragrafët 2 deri 4 (që trajtojnë konfidencialitetin e përgjigjes dhe kufizimet e përdorimit në mungesë të një traktati) të Konventës, zbatohen për nenin e videokonferencës.

Paragrafi 3

195. Meqë një videokonferencë mund të kërkojë që zyrtarët gjyqësorë dhe ndihmës në një Palë kërkuese, të jenë të disponueshëm për të marrë pjesë në marrjen e dëshmisë ose deklaratës në Palën e kërkuar, shumë zona kohore larg, është thelbësore që personi që do të dëgjohet, të paraqitet në kohën dhe vendin e planifikuar. Sipas paragrafit 3, kur Pala e kërkuar ofron ndihmë sipas këtij neni, ajo duhet të përpikët të sigurojë praninë e personit, dëshmia ose deklarata e të cilit kërkohet. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë mund të varet nga rrethanat e çështjes, legjislacioni i brendshëm i Palës së kërkuar dhe nëse, për shembull, ekziston besimi se personi do të paraqitet vullnetarisht në kohën e caktuar. Në të kundërt, për të siguruar paraqitjen e personit, mund të jetë e këshillueshme që Pala e kërkuar të lëshojë një urdhër ose fletëthirrje që detyron personin të paraqitet dhe ky paragraf e autorizon për ta bërë këtë në përputhje me garancitë e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm.

**Paragrafi 4**

196. Procedura në lidhje me zhvillimin e videokonferencës parashtrohet në paragrafin 4. Objektivi kryesor është që Palës kërkuese t'i jepet dëshmia ose deklaratata në një formë që do të lejojë përdorimin e saj si provë në hetimin dhe procedimet e saj. Për këtë arsye, procedurat e kërkuara nga Pala kërkuese do të zbatohen, përveç rasteve kur kjo do të ishte e papajtueshme me ligjin e Palës së kërkuar, duke përfshirë parimet ligjore të zbatueshme të Palës së kërkuar, të pakodifikuara në legjislacionin e saj. Për shembull, gjatë videokonferencës, procedura e preferuar do të ishte që Pala e kërkuar të lejojë autoritetet e Palës kërkuese të pyesin drejtpërdrejt personin nga i cili kërkohet dëshmia ose deklaratat. Do të jetë prokurori i palës kërkuese, gjyqtari hetues ose hetuesi që e njeh në nivel të thelluar hetimin ose ndjekjen penale, dhe për këtë arsye e di më mirë se cilat pyetje janë më të dobishme për hetimin ose ndjekjen penale, si dhe mënyrën më të mirë për t'i formuluar në mënyrë që të pajtohen me ligjin e Palës kërkuese. Në atë rast, autoriteti i Palës së kërkuar që merr pjesë në seancë do të ndërhynte vetëm nëse është e nevojshme, sepse autoriteti i Palës kërkuese ka vepruar në një mënyrë të papajtueshme me ligjin e Palës së kërkuar. Në këtë rast, Pala e kërkuar mund të mos lejojë pyetje, të marrë përsipër marrjen në pyetje ose të ndërmarrë veprime të tjera, sipas legjislacionit të saj dhe rrethanave të videokonferencës. Termi “e papajtueshme me ligjin e Palës së kërkuar” nuk përfshin situatat në të cilat procedura është thjesht e ndryshme nga ajo në Palën e kërkuar, gjë që shpesh ndodh. Përkundrazi, ai synon të trajtojë situatat në të cilat procedura është në kundërshtim me legjislacionin e palës së kërkuar ose kur nuk zbatohet. Në raste të tilla ose kur asnjë procedurë specifike nuk kërkohet nga Pala kërkuese, procedura e paracaktuar do të jetë procedura e zbatueshme sipas ligjit të Palës së kërkuar. Nëse zbatimi i ligjit të palës së kërkuar shkakton një problem për Palën kërkuese, për shembull në lidhje me pranueshmërinë e dëshmisë ose deklaratës në gjykim, Pala kërkuese dhe e kërkuar mund të kërkojnë të arrijnë marrëveshje për një procedurë të ndryshme që do të jetë e pajtueshme për Palën kërkuese, megjithatë, duke shmangur problemin sipas ligjit të Palës së kërkuar.

Paragrafi 5

197. Qëllimi i paragrafit 5, lidhur me dënimin ose sanksionin për deklarimin e rremë, refuzimin për t'u përgjigjur dhe sjellje të tjera të papërshtatshme, është që të mbrojë integritetin e procesit të dhënies së dëshmisë ose deklaratës kur dëshmitari ndodhet fizikisht në një vend të ndryshëm nga ai në të cilin po zhvillohet procedimi penal. Në masën që Pala e kërkuar e ka vendosur personin nën detyrimin për të dëshmuar ose për të dëshmuar me vërtetësi, ose e ka ndaluar personin të përfshihet në sjellje të caktuara (për shembull ndërprerja e procesit), dëshmitari do t'u nënshtrohet pasojave në juridiksionin ku ndodhet dëshmitari. Në raste të tilla, pala e kërkuar duhet të jetë në gjendje të zbatojë sanksionin që do të zbatonte nëse një sjellje e tillë do të ndodhte gjatë proceseve të saj të brendshme. Ai do të zbatohet pa cenuar ndonjë juridiksion të Palës kërkuese. Kjo kërkesë ofron një stimul të mëtijshëm për dëshmitarin që të dëshmojë, të dëshmojë me vërtetësi dhe të mos përfshihet në sjellje të ndaluar. Nëse nuk ka asnjë sanksion që do të zbatohet në procedurat e brendshme të Palës së kërkuar (për shembull për një deklaratë të rreme nga një i akuzuar), nuk kërkohet të përcaktohet ndonjë për sjellje të tillë të kryer gjatë një videokonference. Kjo dispozitë do të jetë veçanërisht e dobishme për të siguruar ndjekjen penale të një dëshmitari që dëshmon në mënyrë të rreme, por nuk mund të ekstradohet për t'u përballur me ndjekjen penale në Palën kërkuese për shkak, për shembull, të ndalimit të një Pale të kërkuar për ekstradimin e shtetasve.

Paragrafi 6

198. Paragrafi 6 parashikon rregulla në lidhje me alokimin e kostove që lindin gjatë videokonferencave. Si rregull i përgjithshëm, të gjitha kostot që lindin gjatë një videokonference, mbulohen nga Pala e kërkuar, me përjashtim të: i. tarifave të një dëshmitari ekspert; ii. kostove të përkthimit, interpretimit dhe transkriptimit; dhe iii. kostove që janë aq të larta sa të jenë të një natyre të jashtëzakonshme. Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet për qëndrimet gjatë natës brenda Palës së kërkuar shpesh nuk janë thelbësore, kështu që kostot e tilla, nëse ka, përgjithësisht mbulohen nga Pala e kërkuar. Megjithatë, rregullat në lidhje me kostot mund të ndryshohen nga marrëveshja ndërmjet palëve kërkuese dhe atyre të kërkuara. Për shembull, nëse Pala kërkuese parashikon praninë e



një përkthyesi që është i nevojshëm ose për shërbimet e transkriptimit në fund të videokonferencës, mund të mos jetë e nevojshme që ajo të paguajë për Palën e kërkuar për të ofruar shërbime të tilla. Kur Pala e kërkuar parashikon kosto të jashtëzakonshme në ofrimin e ndihmës, në përputhje me paragrafin 6/b, Pala kërkuuese dhe Pala e kërkuar do të konsultohen përpara ekzekutimit të kërkesës, për të përcaktuar nëse Pala kërkuuese mund të përballojë këto kosto dhe, nëse jo, mënyrën si mund të shmangen.

Paragrafi 7

199. Ndërsa paragrafi 1 autorizon shprehimisht përdorimin e teknologjisë së videokonferencave për marrjen e dëshmisë ose deklaratës, paragrafi 7/a parashikon që dispozitat e nenit 11 mund të zbatohen për qëllime të kryerjes së audiokonferencave kur është rënë dakord reciprokisht. Gjithashtu, paragrafi 7/b parashikon që kur është rënë dakord nga Palët kërkuuese dhe kërkuuese, teknologjia mund të përdoret për “qëllime të tjera ose për seanca dëgjimore... duke përfshirë për qëllimet e identifikimit të personave ose objekteve”. Kështu, nëse bien dakord reciprokisht, Palët kërkuuese dhe të kërkuara mund të çmojnë të përdorin teknologjinë e videokonferencës për të dëgjuar ose kryer procedurat në lidhje me një të dyshuar ose të akuzuar (duhet të theksohet se disa Palë mund të konsiderojnë një të dyshuar ose të akuzuar si “dëshmitar”, në mënyrë që marrja e dëshmisë apo deklaratës së atij personi do të mbulohej tashmë nga paragrafi 1 i këtij neni). Kur paragrafi 1 nuk është i zbatueshëm, paragrafi 7 siguron autoritet ligjor për të lejuar përdorimin e teknologjisë në raste të tilla.

Paragrafi 8

200. Paragrafi 8 trajton situatën në të cilën Pala e kërkuar zgjedh të lejojë dëgjimin e një personi të dyshuar ose të akuzuar, si për qëllime të dhënies së dëshmisë ose deklaratave, ose për njoftime ose masa të tjera procedurale. Në të njëjtën mënyrë, meqë Pala e kërkuar ka diskrecionin për të lejuar një videokonferencë të një dëshmitari ose eksperti të zakonshëm, ajo ka diskrecion në lidhje me një të dyshuar ose të akuzuar. Për më tepër, përveç ndonjë kushti ose kufizimi tjetër që një Palë e kërkuar mund të vendosë për të lejuar kryerjen e një videokonference, legjislacioni i brendshëm i një Pale mund të kërkojë kushte të veçanta në lidhje

me dëgjimin e të dyshuarve ose të akuzuarve. Për shembull, ligji i një Pale mund të kërkojë pëlqimin e të dyshuarit ose të akuzuarit për të dhënë dëshmi ose deklaratë, ose ligji i një Pale mund të ndalojë ose kufizojë përdorimin e videokonferencës për njoftime ose masa të tjera procedurale. Kështu, paragrafi 8 synon të theksojë faktin se procedurat e synuara për një të dyshuar ose të akuzuar, mund të sjellin nevojën për kushte ose garanci plotësuese ndaj atyre që mund të lindnin ndryshe.

Neni 12

Ekipet e përbashkëta hetimore dhe hetimet e përbashkëta

201. Duke pasur parasysh natyrën transnacionale të krimit kibernetik dhe provave elektronike, hetimet dhe ndjekjet penale për krimin kibernetik dhe provat elektronike shpesh kanë lidhje me shtete të tjera. Ekipet e përbashkëta hetimore (JIT) mund të jenë një mjet efektiv për bashkëpunimin ose koordinimin operacional ndërmjet dy ose më shumë shteteve. Neni 12 ofron një bazë për forma të tilla bashkëpunimi.

202. Përvoja ka treguar se kur një shtet po heton një vepër me dimension ndërkuftar në lidhje me krimin kibernetik ose për të cilën duhet të merren prova elektronike, hetimi mund të përfitojë nga pjesëmarrja e autoriteteve të shteteve të tjera që po hetojnë, gjithashtu, sjelljen e njëjtë ose të lidhur ose kur koordinimi është i dobishëm në ndonjë formë tjetër.

203. Siç specifikohet në nenin 5 të këtij Protokollit dhe në raportin shpjegues, paragrafët 182 deri në 186, dispozitat e nenit 12 nuk do të zbatohen kur ekziston një traktat ose rregullim për ndihmë të ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet palëve kërkuuese dhe të kërkuara, përveç rasteve kur Palët e interesuara vendosin reciprokisht të zbatojnë ndonjë ose të gjithë pjesën e mbetur të këtij neni në vend të tyre, nëse traktati ose marrëveshja nuk e ndalon atë. Siç shpjegohet më poshtë, paragrafi 7 zbatohet pavarësisht nëse ka apo jo një traktat ose rregullim për ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve të interesuara.

Paragrafi 1

204. Paragrafi 1 përcakton se autoritetet kompetente të dy ose më shumë Palëve mund të



bien dakord të hartojnë një marrëveshje JIT kur gjykojnë se ka një dobi të veçantë. Një JIT lidhet me marrëveshje të ndërsjellë. Termat “marrëveshje e ndërsjellë”, “marrëveshje” dhe “pajtohen” – siç përdoren në nenin 12 – nuk duhet të kuptohen se kërkojnë një marrëveshje detyruese sipas së drejtës ndërkombëtare.

205. Ky nen përdor dy terma të ndërlidhur: “autoritete kompetente” dhe “autoritete pjesëmarrëse”. Çdo palë përcakton se cilat autoritete janë kompetente – d.m.th. “autoritetet kompetente” – për të lidhur një marrëveshje JIT. Disa Palë mund të autorizojnë një sërë zyrtarësh, të tillë si prokurorët, gjyqtarët hetues ose zyrtarë të tjerë të lartë ligjzbatues që drejtojnë hetimet ose procedimet penale, për të lidhur një marrëveshje të tillë; të tjerët mund t'i kërkojnë autoritetit qendror – zyrës normalisht përgjegjëse për çështjet e ndihmës së ndërsjellë – që ta bëjë këtë. Vendimi se cilat autoritete marrin pjesë realisht në një JIT – “autoritetet pjesëmarrëse” – në mënyrë të ngjashme do të përcaktohet nga Palët përkatëse.

Paragrafi 2

206. Paragrafi 2 parashikon se procedurat dhe kushtet sipas të cilave duhet të veprojnë ekipet e përbashkëta hetimore, siç janë qëllimet e tyre specifike: përbërja, funksionet, kohëzgjatja dhe çdo periudhë zgjatjeje, vendndodhja, organizimi, kushtet e mbledhjes, transmetimit dhe përdorimit të informacionit ose provave, kushtet e konfidencialitetit, dhe kushtet për përfshirjen e autoriteteve pjesëmarrëse të një Pale në aktivitetet hetimore që zhvillohen në territorin e një Pale tjetër, do të jenë rënë dakord ndërmjet këtyre autoriteteve kompetente. Në veçanti, gjatë përgatitjes së marrëveshjes, Palët e interesuara mund të dëshirojnë të diskutojnë kushtet për refuzimin ose kufizimin e përdorimit të informacionit ose provave, duke përfshirë, për shembull, mbi bazat e përcaktuara në nenin 27, paragrafët 4 ose 5 të Konventës, dhe cila procedure duhet ndjekur nëse informacioni ose provat nevojiten për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është lidhur marrëveshja (përfshirë përdorimin e informacionit ose provave nga prokuroria ose mbrojtja në një rast tjetër ose kur mund të nevojiten për të parandaluar një urgjencë, siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 2/c, d.m.th. një situatë në të cilën ekziston një rrezik i lartë dhe i pashmangshëm për jetën ose sigurinë e një personi

fizik). Palët inkurajohen të specifikojnë në marrëveshje kufijtë e kompetencave të zyrtarëve pjesëmarrës të një Pale që janë fizikisht të pranishëm në territorin e një Pale tjetër. Palët inkurajohen, gjithashtu, të lejojnë në marrëveshje transmetimin elektronik të provave ose informacionit të marrë.

207. Parashikohet që Palët në përgjithësi do t'i përcaktojnë reciprokisht këto procedura dhe kushte me shkrim. Në çdo marrëveshje, duhet t'i kushtohet vëmendje nivelit të detajeve të kërkuara. Një tekst i efektshëm mund të garantojë nivelin e nevojshëm të saktësisë për rrethanat e parashikueshme, me mundësinë për të shtuar dispozita shtesë nëse rrethanat e ardhshme kërkojnë saktësi të mëtejshme. Palët do të marrin në konsideratë shtrirjen gjeografike dhe kohëzgjatjen e marrëveshjes JIT dhe faktin që marrëveshja mund të duhet të ndryshohet ose zgjerohet pasi fakte të reja të bëhen të disponueshme.

208. Informacioni ose provat e përdorura si pjesë e ekipit të përbashkët hetimor, mund të përfshijë të dhëna personale në formën e informacionit të abonentit, të dhënave të trafikut ose të dhënave të përmbajtjes. Si në rastin e masave të tjera bashkëpunuese sipas këtij Protokoll, neni 14 zbatohet për transferimin e të dhënave personale në përputhje me JIT-et.

209. Siç ndodh në përgjithësi në lidhje me të gjitha provat ose informacionet e marra nga një Palë në përputhje me këtë Protokoll, rregullat e zbatueshme të provave të asaj Pale do të rregullojnë nëse informacioni ose provat do të jenë të pranueshme në procedimet gjyqësore.

Paragrafi 3

210. Paragrafi 3 i lejon një Pale që të deklarojë në momentin e nënshkrimit të këtij Protokoll, ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, se autoriteti i saj qendror duhet të jetë nënshkrues ose të pajtohet ndryshe në marrëveshjen për krijimin e ekipit. Kjo dispozitë u prezantua për disa arsye. Së pari, një numër Palësh i konsiderojnë JIT-të si një formë ndihme të ndërsjellë dhe në një sërë Palësh të tjera, autoritetet qendrore për ndihmën e ndërsjellë mund të luajnë një rol në garantimin e përmbytjes së kërkesave ligjore vendëse të zbatueshme, kur autoritetet kompetente (të cilët mund të jenë prokurorë ose oficerë policie me përvojë relativisht të kufizuara të



bashkëpunimit ndërkombëtar) po përgatisin një marrëveshje JIT sipas këtij neni. Përvoja e një autoriteti qendror me marrëveshjet ndërkombëtare që rregullojnë ndihmën e ndërsjellë dhe forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar (përfshirë këtë Protokoll) mund ta ndihmojë, gjithashtu, atë të luajë një rol të vlefshëm për të garantuar që kërkesat e Protokollit të jenë përmbushur. Së fundi, nëse një Palë ka bërë deklaratën e parashikuar në këtë paragraf, autoritetet e Palëve të tjera që kërkojnë të lidhin një JIT me Palën deklaruuese, njoftohen se autoriteti qendror i palës deklaruuese duhet të nënshkruajë ose të pajtohet ndryshe në marrëveshjen JIT për të qenë të vlefshme sipas Protokollit. Kjo mbrohet nga lidhja e një marrëveshjeje JIT që nuk ka autorizimin e kërkuar ose nuk përputhet me kërkesat ligjore në fuqi të Palës deklaruuese.

Paragrafi 4

211. Sipas paragrafit 4, autoritetet kompetente të caktuara nga Palët sipas paragrafit 1 dhe autoritetet pjesëmarrëse të përshkruara në paragrafin 2 normalisht do të komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin për të garantuar efikasitet dhe efektivitet. Megjithatë, kur rrethanat e jashtëzakonshme mund të kërkojnë një koordinim më qendror – siç janë rastet me pasoja veçanërisht serioze ose situata që ngrenë probleme të veçanta koordinimi – mund të bien dakord për kanale të tjera të përshtatshme. Për shembull, autoritetet qendrore për ndihmë të ndërsjellë mund të jenë të disponueshme për të ndihmuar në koordinimin e çështjeve të tilla.

Paragrafi 5

212. Paragrafi 5 parashikon që kur duhet të ndërmerren masa hetimore në territorin e njëres prej Palëve pjesëmarrëse, autoritetet pjesëmarrëse të asaj Pale mund t'i bëjnë kërkesë autoriteteve të tyre për të kryer këto masa. Këto autoritete përcaktojnë nëse mund të marrin masën hetimore sipas legjislacionit të tyre të brendshëm. Në rastet kur mund ta bëjnë këtë, mund të mos kërkohej një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë nga Palët e tjera pjesëmarrëse. Kjo garanton një nga aspektet më inovative të JIT-eve. Megjithatë, në disa situata, këto autoritete mund të mos kenë autoritet të mjaftueshëm të brendshëm për të marrë një masë të veçantë hetimore në emër të një Pale tjetër pa një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë.

Paragrafi 6

213. Paragrafi 6 trajton përdorimin e provave ose informacioneve të marra nga autoritetet pjesëmarrëse të një Pale nga autoritetet pjesëmarrëse të një Pale tjetër. Përdorimi mund të refuzohet ose kufizohet në përputhje me kushtet e një marrëveshjeje të përshkruar në paragrafët 1 dhe 2; megjithatë, nëse ajo marrëveshje nuk parashikon kushte për refuzimin ose kufizimin e përdorimit, informacioni ose provat mund të përdoren në mënyrën e parashikuar në paragrafët 6/a deri c. Rrethanat e përcaktuara në paragrafin 6 nuk cenojnë kërkesat e përcaktuara për transferimet e mëtejshme të informacionit ose provave në një Shtet tjetër sipas nenit 14.

214. Duhet të theksohet se kur zbatohen paragrafët 6/a deri c, autoritetet pjesëmarrëse, megjithatë, mund të vendosin reciprokisht të kufizojnë më tej përdorimin e informacionit ose provave të veçanta për të shmangur pasojat negative për një nga hetimet e tyre, qoftë më parë, ose veçanërisht pasi të jetë dhënë informacioni ose provat. Për shembull, edhe nëse përdorimi i provave është për një qëllim për të cilin JIT është krijuar nga Pala që e ka marrë atë, ajo mund të ketë ndikim negativ në hetimin e Palës që ofron informacionin ose provat (si p.sh., duke zbuluar ekzistencën e hetimit ndaj një grupi kriminal, duke bërë që kriminelët të arratisen, të shkatërrojnë provat ose të frikësojnë dëshmitarët). Në këtë rast, Pala që ka dhënë informacionin ose provat, mund t'i kërkojë palës tjetër të japë pëlqimin për të mos e bërë atë publik derisa ky rrezik të mos jetë më i pranishëm.

215. Në paragrafin 6/b hartuesit synuan që në mungesë të një marrëveshjeje që parashikonte kushte për refuzimin ose kufizimin e përdorimit, nuk do të kërkohej pëlqimi i autoriteteve që ofrojnë informacionin ose provat kur, sipas parimeve ligjore themelore të Palës, autoritetet pjesëmarrëse të të cilit e kanë marrë atë, informacioni ose provat e rëndësishme për kryerjen e një mbrojtjeje efektive në procedimet, në lidhje me ato vepra të tjera, duhet t'i zbulohen mbrojtjes ose autoritetit gjyqësor. Edhe pse në këtë rast nuk kërkohej pëlqimi, njoftimi për zbulimin e informacionit ose provës për këtë qëllim do të bëhet pa vonesë të panevojshme. Nëse është e mundur, një njoftim i tillë duhet të sigurohet përpara zbulimit, për t'i mundësuar Palës që ka dhënë informacionin ose



provat që të përgatitet për zbulimin dhe t'i lejojë Palët të konsultohen sipas rastit.

216. Hartuesit kuptuan se paragrafi 6/c u referohet rrethanave të jashtëzakonshme kur autoritetet e Palës marrëse mund të përdorin drejtpërdrejt informacionin ose provat për të parandaluar një urgjencë, siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 2/c të këtij Protokolli. Siguria e personit fizik nënkupton dëmtim të rëndë trupor. Koncepti i një “rreziku të lartë dhe të pashmangshëm për jetën ose sigurinë e ndonjë personi fizik” shpjegohet më hollësisht në paragrafin 42 të raportit shpjegues, ku jepen edhe shembuj të situatave të tilla.

Hartuesit çmuan se rastet kur një rrezik i lartë dhe i pashmangshëm ndaj aseteve ose rrjeteve përfshin jetën ose sigurinë e një personi fizik, do të përfshiheshin në një koncept të tillë. Në rastet kur informacioni ose provat përdoren sipas paragrafit 6/c, autoritetet pjesëmarrëse të Palës që ka dhënë informacionin ose provat, do të njoftohen pa vonesë të panevojshme për një përdorim të tillë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe reciprokisht. Për shembull, autoritetet pjesëmarrëse mund të përcaktojnë që autoriteti qendror duhet të njoftohet.

Paragrafi 7

217. Së fundi, duhet të silltet në vëmendje përgjithësisht se ka një histori të gjatë të përpjekjeve ndërkombëtare të bashkëpunimit të kryera ndërmjet partnerëve ligjzbatues mbi baza *ad hoc*, në të cilat një ekip prokurorësh dhe/ose hetuesish nga një vend ka bashkëpunuar me homologët e huaj në një hetim të caktuar, përveç në bazë të një JIT-i. Paragrafi 7 parashikon këto përpjekje ndërkombëtare bashkëpunimi dhe siguron një bazë traktati për të hyrë në një hetim të përbashkët në mungesë të një marrëveshjeje të përshkruar në paragrafët 1 dhe 2, nëse një Palë kërkon një bazë të tillë ligjore. Ky paragraf zbatohet, pavarësisht nëse ka apo jo një traktat ose marrëveshjeje për ndihmën e ndërsjellë mbi bazën e legjislacionit uniform ose të ndërsjellë në fuqi ndërmjet Palëve të interesuara. Si me të gjitha masat sipas këtij Protokolli, hetimet e përbashkëta sipas paragrafit 7 u nënshtrohen kushteve dhe masave mbrojtëse të kreut III.

KREU III

KUSHTET DHE GARANCITË

Neni 13

Kushtet dhe garancitë

218. Bazuar në nenin 15 të Konventës, neni 13 parashikon që “çdo Palë do të garantojë që krijimi, kryerja dhe zbatimi i kompetencave dhe procedurave të parashikuara në këtë Protokoll, t’u nënshtrohen kushteve dhe garancive të parashikuara në legjislacionin e saj të brendshëm, i cili do të garantojë mbrojtjen e duhur të të drejtave dhe lirive të njeriut”. Meqë ky nen bazohet në nenin 15 të Konventës, shpjegimi i atij neni në paragrafët 145 deri në 148 të raportit shpjegues të Konventës, është gjithashtu i vlefshëm për nenin 13 të këtij Protokolli, duke përfshirë se parimi i proporcionalitetit “do të zbatohet nga çdo Palë në përputhje me parimet përkatëse të legjislacionit të saj të brendshëm” (shih paragrafin 146 të raportit shpjegues të Konventës).

219. Duhet të theksohet se përveç këtij neni, nene të tjerë përmbajnë garanci të rëndësishme. Për shembull, masat e këtij Protokolli janë të kufizuara në fushëveprim, d.m.th. “për hetime ose procedime penale specifike për veprat penale që lidhen me sistemet dhe të dhënat kompjuterike dhe për marrjen e provave në formë elektronike të një vepre penale” (shih nenin 2). Përveç kësaj, nenet individuale specifikojnë informacionin që duhet përfshirë në kërkesat, urdhrat dhe informacionin shoqërues që mund të ndihmojë në zbatimin e garancive të brendshme (shih nenin 6, paragrafi 3; nenin 7, paragrafët 3 dhe 4; nenin 8, paragrafi 3; nenin 9, paragrafi 3). Për më tepër, llojet e të dhënave që do të zbulohen specifikohen në çdo nen, si për shembull, në nenin 7, i cili kufizohet në informacionin e abonentit. Gjithashtu, Palët mund të bëjnë rezerva dhe deklarata, për shembull për të kufizuar llojin e informacionit që duhet dhënë, si në nenet 7 dhe 8. Së fundi, kur të dhënat personale transferohen në përputhje me këtë Protokoll, zbatohen garancitë e nenit 14 për mbrojtjen e të dhënave.



Neni 14

Mbrojtja e të dhënave personale**Paragrafi 1 – Fushëveprimi**

220. Masat e parashikuara në kreun II të këtij Protokollit shpesh përfshijnë transferimin e të dhënave personale. Meqë shumë Palëve të këtij Protokollit mund t'u kërkohej, me qëllim që të përmbushin detyrimet e tyre kushtetuese ose ndërkombëtare, të garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale, neni 14 parashikon garanci për mbrojtjen e të dhënave për t'i lejuar palët të përmbushin këto kërkesa dhe në këtë mënyrë të mundësojnë përpunimin të të dhënave personale për qëllimet e këtij Protokollit.

221. Në bazë të paragrafit 1/a, çdo palë do të përpunojë të dhënat personale që merr sipas këtij Protokollit në përputhje me garancitë specifike të përcaktuara në paragrafët 2 deri 15. Kjo përfshin të dhënat personale të transferuara si pjesë e një urdhri ose kërkesë sipas këtij Protokollit. Megjithatë, paragrafët 2 deri në 15 nuk zbatohen nëse kushtet e përjashtimeve të përcaktuara në paragrafët 1/b ose 1/c janë të zbatueshme.

222. Përjashtimi i parë parashtrohet në paragrafin 1/b, i cili parashikon se “nëse në momentin e marrjes së të dhënave personale sipas këtij Protokollit, si pala transferuese dhe pala marrëse kanë detyrime ligjore reciprokisht nga një marrëveshje ndërkombëtare që përcakton një kuadër gjithëpërfshirës ndërmjet këtyre Palëve për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili është i zbatueshëm për transferimin e të dhënave personale, për qëllim të parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale dhe që parashikon se përpunimi i të dhënave personale sipas asaj marrëveshjeje përputhet me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave të palëve të interesuara, do të zbatohen kushtet e kësaj marrëveshjeje për masat që përfshihen në objektin e kësaj marrëveshjeje, për të dhënat personale të marra sipas Protokollit në vend të paragrafëve 2 deri në 15, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe ndërmjet Palëve të interesuara”. Në këtë kontekst, një kuadër përgjithësisht do të konsiderohet “gjithëpërfshirës” ku mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse aspektet e mbrojtjes së të dhënave të transferimeve të të dhënave. Dy shembuj të marrëveshjeve sipas paragrafit 1/b janë Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me

Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS Nr. 108), e ndryshuar nga Protokollit CETS Nr. 223 dhe Marrëveshja ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Informacionit Personal në lidhje me Parandalimin, Hetimin, Zbulimin dhe Ndjekjen e Veprave Penale. Kushtet e këtyre marrëveshjeve do të zbatohen në vend të paragrafëve 2 deri në 15 për masat që përfshihen në objektin e këtyre marrëveshjeve. Në lidhje me Palët e Konventës ETS nr. 108, të ndryshuar nga Protokollit CETS nr. 223, kjo nënkupton se neni 14, paragrafi 1 i atij traktati, siç shpjegohet më tej në paragrafët 105 deri në 107 të raportit të tij shpjegues, është i zbatueshëm. Për sa i përket kohës, paragrafët 2 deri në 15 të këtij neni do të zëvendësohen vetëm nëse Palët kanë detyrime ligjore reciprokisht nga marrëveshja në momentin e marrjes së të dhënave personale sipas këtij Protokollit. Kjo vlen për sa kohë që marrëveshja parashikon që të dhënat e transferuara në përputhje me të, vijojnë të përpunohen sipas kushteve të asaj marrëveshjeje.

223. Përjashtimi i dytë parashtrohet në paragrafin 1/c i cili parashikon se, edhe nëse Pala transferuese dhe Pala marrëse nuk kanë detyrime ligjore reciprokisht, sipas një marrëveshjeje të llojit të përshkruar në paragrafin 1/b ato, megjithatë, mund të përcaktojnë reciprokisht se transferimi i të dhënave personale sipas këtij Protokollit mund të kryhet në bazë të marrëveshjeve ose rregullimeve të tjera ndërmjet tyre në vend të paragrafëve 2 deri në 15 të këtij neni. Kjo garanton që Palët të ruajnë fleksibilitetin në përcaktimin e garancive për mbrojtjen e të dhënave që zbatohen për transferimet ndërmjet tyre sipas Protokollit. Për të garantuar siguri juridike dhe transparencë për individët dhe për ofruesit dhe subjektet e përfshira në transferimin e të dhënave në përputhje me masat në kreun 2, seksioni 2 i këtij Protokollit, Palët inkurajohen t'i komunikojnë qartë publikut vendosmërinë e tyre të ndërsjellë se një marrëveshje ose rregullim i tillë rregullon aspektet e mbrojtjes së të dhënave të transferimeve të të dhënave personale ndërmjet tyre.

224. Hartuesit çmuan se, nëpërmjet garancive për mbrojtjen e të dhënave të përcaktuara në paragrafët 2 deri në 15 të këtij neni, ky Protokoll garanton mbrojtje të duhur për transferimet e të dhënave sipas këtij Protokollit. Për këtë qëllim, në përputhje me paragrafin 1/d, transferimet e të



dhënave sipas paragrafit 1/a do të konsiderohen se plotësojnë kërkesat e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave për transferimet ndërkombëtare të të dhënave personale të çdo Pale dhe nuk do të ketë autorizim të mëtejshëm për transferime të tilla të kërkuara sipas kuadrove të tilla ligjore. Për më tepër, në masën që marrëveshjet e përshkruara në paragrafin 1/b parashikojnë nga kushtet e tyre që përpunimi i të dhënave personale sipas këtyre marrëveshjeve është në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave të Palëve të interesuara, paragrafi 1/d e shtrinë këtë miratim të transferimeve sipas kësaj Protokolli. Kështu, ky paragraf ofron siguri juridike për transferimet ndërkombëtare të të dhënave personale në përputhje me paragrafët 1/a ose 1/b, në përgjigje të urdhrave dhe kërkesave sipas këtij Protokolli, në mënyrë që të sigurohet shkëmbim efektiv dhe i parashikueshëm i të dhënave. Për shkak se marrëveshjet ose rregullimet e përshkruara në paragrafin 1/c mund të mos i referohen gjithmonë pajtueshmërisë me kuadrin ligjor të mbrojtjes së të dhënave të palëve për transferimet ndërkombëtare – për shembull në rastin e traktateve dypalëshe të ndihmës së ndërsjellë – ato nuk marrin të njëjtin miratim sipas këtij Protokolli si për paragrafët 1/a ose 1/b. Megjithatë, Palët e interesuara mund të parashikojnë një miratim të tillë me vendim të ndërsjellë.

225. Përveç kësaj, paragrafi 1/d parashikon që një Palë mund të refuzojë ose parandalojë transferimet e të dhënave personale në një Palë tjetër sipas këtij Protokolli për arsye të mbrojtjes së të dhënave: i. sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 15, në lidhje me konsultimin dhe pezullimin, kur zbatohet paragrafi 1/a; ose ii. sipas kushteve të marrëveshjeve ose rregullimeve specifike të përmendura në paragrafët 1/b ose 1/c, kur zbatohet një nga këta paragrafë.

226. Së fundi, objektivi i nenit 14 është që të vendosë garanci të duhura që lejojnë transferimin e të dhënave personale ndërmjet Palëve sipas këtij Protokolli. Neni 14 nuk kërkon harmonizimin e kuadrit të brendshëm ligjor për përpunimin e të dhënave personale në përgjithësi, as të kuadrit për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të zbatimit të legjislacionit penal në mënyrë specifike. Paragrafi 1/e parashikon që Palët nuk përjashtohen nga zbatimi i garancive më rigorozë për mbrojtjen e të dhënave sesa ato të parashikuara në paragrafët 2

deri në 15 për përpunimin, nga autoritetet e tyre, të të dhënave personale që ato autoritete marrin sipas këtij Protokolli. Përkundrazi, paragrafi 1/e nuk synon të lejojë Palët të vendosin kërkesa shtesë për mbrojtjen e të dhënave për transferimet e të dhënave sipas këtij Protokolli përtej atyre të lejuara specifikisht në këtë nen.

Paragrafi 2 – Qëllimi dhe përdorimi

227. Paragrafi 2 trajton qëllimet dhe përdorimin për të cilin Palët mund të përpunojnë të dhëna personale sipas këtij Protokolli. Paragrafi 2/a parashikon se “Pala që ka marrë të dhëna personale do t’i përpunojë ato për qëllime të përshkruara në nenin 2”, d.m.th. për qëllime të hetimeve specifike penale ose procedimeve për veprat penale që lidhen me sistemet dhe të dhënat kompjuterike” dhe për “marrjen e provave në formë elektronike të veprës penale”, dhe si ndërmjet palëve në Protokollin e Parë, për qëllim të “hetimeve ose procedimeve specifike penale në lidhje me veprat penale të përcaktuara në bazë të Protokollit të Parë”. Me fjalë të tjera, autoritetet duhet të hetojnë ose ndjekin penalisht një aktivitet specifik kriminal, që është qëllimi legjitim për të cilin mund të kërkohej dhe përpunohen provat ose informacionet që përmbajnë të dhëna personale.

228. Ndërsa në shkallën e parë ky Protokoll mund të përdoret vetëm për të marrë informacion ose prova në një hetim apo procedim penal specifik dhe jo për qëllime të tjera, paragrafi 2/a parashikon, gjithashtu, që një Palë “nuk do të përpunojë më tej të dhënat personale për një qëllim të papajtueshëm dhe nuk do të përpunojë më tej të dhënat kur kjo nuk lejohet nga kuadri i saj brendshëm ligjor”. Në përcaktimin nëse qëllimi i përpunimit të mëtejshëm nuk është i papajtueshëm me qëllimin fillestar, autoriteti kompetent inkurajohet të kryejë një vlerësim të përgjithshëm të rrethanave specifike, të tilla si: i. marrëdhëniet midis qëllimit fillestar dhe qëllimit të mëtejshëm (për shembull çdo lidhje objektive); ii. pasojat (e mundshme) të përdorimit të mëtejshëm të synuar për individët në fjalë, duke pasur parasysh natyrën e të dhënave personale (për shembull sensitivitetin e tyre); iii. çdo pritshmëri të arsyeshme të individëve të interesuar në lidhje me qëllimin e përdorimit të mëtejshëm dhe cilat subjekte mund të përpunojnë të dhënat; dhe iv. mënyrën në të cilën të dhënat do të përpunohen dhe mbrohen nga përdorimi jo i duhur. Kuadri ligjor i një Pale mund të vendosë më



tej kufizime të veçanta në lidhje me qëllime të tjera për të cilat mund të përdoren të dhënat.

229. Përpunimi për një qëllim të pajtueshëm zakonisht përfshin përdorimin e të dhënave për bashkëpunim ndërkombëtar në përputhje me ligjet vendëse dhe marrëveshjet ose rregullimet ndërkombëtare (për shembull ndihma e ndërsjellë) në fushën e së drejtës penale. Ai, gjithashtu, mund të përfshijë, ndër të tjera, përdorime për funksione të caktuara qeveritare, të tilla si raportimi tek organet mbikëqyrëse; hetimet lidhur me shkeljet e legjislacionit penal, civil ose administrativ (duke përfshirë hetimet nga komponentë të tjerë të qeverisë) dhe gjykimin e tyre; zbulimet e kërkuara nga urdhrat e gjykatës vendëse; zbulimin ndaj palëve ndërgjyqëse private; dhënien e informacioneve të caktuara mbrojtësit të të akuzuarit; dhe zbulimin drejtpërdrejt për publikun ose median, të lajmeve (përfshirë në kontekstin e aksesit në kërkesat për dokumente dhe procedurat ligjore publike). Gjithashtu, përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale për qëllime arkivimi në interes publik, kërkime shkencore ose historike ose qëllime statistikore mund të konsiderohen të pajtueshme.

230. Paragrafi 2/a i lejon Palët më tej të vendosin kushte dhe kufizime shtesë për përdorimin e të dhënave personale në raste individuale, në masën e parashikuar në kreun II të këtij Protokolli. Megjithatë, këto kushte nuk do të përfshijnë kushtet e përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave – d.m.th. ato që nuk janë specifike për çështjen – përtej atyre të parashikuara nga neni 14. Si shembull, sisteme të ndryshme për mbikëqyrje pranohen sipas paragrafit 14 dhe një Palë nuk mund ta bëjë atë kusht transferimi në një rast individual që Pala kërkuese ka ekuivalentin e një autoriteti të specializuar për mbrojtjen e të dhënave.

231. Së fundi, paragrafi 2/b kërkon që në kërkimin dhe përdorimin e të dhënave personale sipas këtij Protokolli, “pala marrëse do të sigurojë sipas kuadrit të saj të brendshëm ligjor që të dhënat personale të kërkuara dhe të përpunuara të jenë të rëndësishme dhe jo të tepruara në lidhje me qëllimet e një përpunimi të tillë”. Kjo kërkesë mund të zbatohet, për shembull, nëpërmjet rregullave të provave dhe kufizimeve në gamën e urdhrave të detyrueshëm, parimeve të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, parimeve

të arsyeshmërisë dhe të udhëzimeve, dhe të politikave të brendshme që kufizojnë mbledhjen ose përdorimin e të dhënave. Palët inkurajohen, gjithashtu, të marrin në konsideratë, sipas kuadrit të tyre të brendshëm ligjor, situatat që përfshijnë individë të cënueshëm, të tillë si për shembull, viktimat ose të miturit.

Paragrafi 3 – Cilësia dhe integriteti

232. Paragrafi 3 kërkon nga Palët që “të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale të mbahen me saktësi dhe plotësi të tillë dhe të jenë aq të përditësuara sa është e nevojshme dhe e përshtatshme për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke pasur parasysh qëllimet për të cilat përpunohen”. Konteksti është i rëndësishëm, në mënyrë që ky parim të mund të zbatohet ndryshe sipas rrethanave. Për shembull, parimi do të zbatohet ndryshe për procedimet penale se sa për qëllime të tjera.

233. Lidhur me hetimet dhe procedimet penale, paragrafi 3 nuk duhet të konsiderohet se kërkon nga autoritetet e zbatimit të legjislacionit penal që të ndryshojnë informacionin – edhe nëse ky informacion është i pasaktë ose i paplotë – që mund të përbëjë provë në një çështje penale, pasi pasaktësia e të dhënave mund të jetë e rëndësishme për krimin (për shembull, në rastet e mashtrimit) dhe, gjithashtu, do të cenonte qëllimin e drejtësisë ndaj të akuzuarve, nëse autoritetet do të modifikonin një pjesë të provës që u mor nëpërmjet këtij Protokolli.

234. Në shumë situata, kur ka dyshime për besueshmërinë e të dhënave personale, kjo duhet të specifikohet qartë. Për shembull, në masën që informacioni ose provat që janë marrë nëpërmjet këtij Protokolli përdoren për të gjurmuar sjelljen kriminale në të kaluarën, procedurat e zbatueshme duhet të ofrojnë mjete për korrigjimin ose memorizimin e gabimeve në informacion (si për shembull, duke ndryshuar ose plotësuar informacionin origjinal) dhe për përditësimin, ndryshimin ose plotësimin e të dhënave jo të besueshme ose të vjetruara, në mënyrë që të minimizohet rreziku që autoritetet të ndërmarrin veprime të papërshtatshme dhe potencialisht negative të zbatimit të ligjit, për shkak të cilësisë së dobët të të dhënave (për shembull, arrestimi i personit të gabuar ose arrestimi i një personi që mbështetet në një kuptim të gabuar të sjelljes së tij



ose të saj). Palët inkurajohen të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të garantuar që kur informacionet e dhëna ose të marra nga një autoritet tjetër konstatohen të pasakta ose të vjetruara, autoriteti tjetër informohet sa më shpejt të jetë e mundur për të bërë korrigjime në masën e nevojshme dhe të përshtatshme, duke pasur parasysh qëllimet e përpunimit.

Paragrafi 4 – Të dhënat sensitive

235. Paragrafi 4 lidhet me masat që duhet të merren sipas këtij Protokolli nga Palët kur trajtohen disa lloje të dhënash që mund të nevojiten, në veçanti, si prova në një hetim apo procedim penal, por në të njëjtën kohë janë të një natyre të tillë që nevojiten garanci të duhura për t'u mbrojtur nga rreziku i ndikimit paragjykues të pajustificuar ndaj individit në fjalë nga përdorimi i këtyre të dhënave, veçanërisht kundër diskriminimit të paligjshëm.

236. Paragrafi 4 parashikon që të dhënat sensitive përfshijnë “të dhënat personale që zbulojnë origjinën raciale ose etnike; opinionet politike, besimet fetare ose të tjera ose anëtarësimin në sindikata; të dhëna gjenetike; të dhëna biometrike të konsideruara sensitive, duke pasur parasysh rreziqet e përfshira; ose të dhëna personale në lidhje me shëndetin ose jetën seksuale”, të cilat do të përfshinin si orientimin seksual, ashtu edhe praktikën seksuale. Të dhënat shëndetësore mund të përfshijnë të dhëna në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të një personi që zbulojnë informacione për gjendjen e tij shëndetësore të së shkuarës, të tashmes ose të ardhmes (për shembull, informacion në lidhje me një sëmundje, aftësi të kufizuara, rrezik sëmundjeje, historinë mjekësore ose trajtimin e një personi, ose gjendjen fiziologjike ose biomjekësore të personit). Të dhënat gjenetike mund të përfshijnë, për shembull, të dhëna që rezultojnë nga analiza kromozomale, ADN-ja ose ARN-ja, dhe të lidhura me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të fituara të një personi që përmbajnë informacion unik për fiziologjinë, shëndetin ose origjinën e tij/saj.

237. Koncepti i të dhënave biometrike mbulon një sërë identifikuesish unikë që rezultojnë nga karakteristikat e matshme fizike ose fiziologjike të përdorura për të identifikuar ose verifikuar identitetin e pretenduar të një individi (për shembull gjurmët e gishtave, modele të venave të irisit ose pëllëmbës së dorës, modele zëri, fotografi

ose filmime-video). Disa Palë konsiderojnë, gjithashtu, identifikues unikë që rezultojnë nga karakteristikat biologjike ose të sjelljes si të dhëna biometrike. Ndërsa forma të caktuara të të dhënave biometrike mund të konsiderohen sensitive për shkak të rreziqeve të përfshira, forma të tjera mund të mos konsiderohen sensitive. Për shembull, disa Palë i konsiderojnë sensitive të dhënat biometrike që llogariten ose nxirren nga një mostër ose imazh biometrik (si p.sh. modelet biometrike). Anasjelltas, disa fotografi ose filmime-video, edhe nëse zbulojnë veçori fizike ose anatomike si vraga, shenja në lëkurë dhe tatuazhe, përgjithësisht nuk do të konsiderohen se hyjnë në kategorinë e të dhënave sensitive biometrike. Për shkak se niveli i sensitivitetit të të dhënave biometrike mund të ndryshojë, paragrafi 4 u ofron palëve fleksibilitet për të rregulluar këtë fushë, duke specifikuar se të dhënat sensitive përfshijnë “të dhënat biometrike që konsiderohen sensitive në funksion të rreziqeve të përfshira”. Kjo gjuhë pranon se biometria është një fushë në zhvillim dhe se cilat të dhëna konsiderohen “sensitive” sipas këtij paragrafi, do të duhet të vlerësohen me kalimin e kohës në lidhje me zhvillimet teknologjike, hetimore dhe zhvillime të tjera dhe rreziqet për individin e përfshirë. Për sa u përket Palëve të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS nr. 108), të ndryshuar nga Protokolli CETTS nr. 223, interpretimi i çka përbën të dhëna biometrike “sensitive” duhet të udhëhiqet nga neni 6, paragrafi 1 i atij traktati, siç detajohet më tej në paragrafët 58 dhe 59 të raportit të tij shpjegues.

238. Shpërdorimi dhe përpunimi i papërshtatshëm i të dhënave sensitive paraqet rreziqe të mundshme të paragjykimit të pajustificuar ndaj individëve, duke përfshirë rreziqet e diskriminimit të paligjshëm. Sistemi i drejtësisë penale duhet të konfigurohet për t'u mbrojtur nga ndikimi paragjykues i pajustificuar dhe diskriminimi i paligjshëm bazuar, për shembull, në përdorimin e provave që zbulojnë racën, fenë ose jetën seksuale. Si shembull tjetër, ky paragraf njej, gjithashtu, rëndësinë e mbrojtjes kundër rrezikut të dëmtimit të shkaktuar nga zbulimi i pajustificuar ose i paligjshëm, për shembull, një person që përjashtohet bazuar në informacione që zbulojnë orientimin seksual ose identitetin gjinor. Në lidhje me këtë, paragrafi 4 kërkon nga Palët që



të parashikojnë “garanci të duhura” për t’u mbrojtur kundër rreziqeve të tilla.

239. Përshtatshmëria e garancive duhet të vlerësohet duke iu referuar sensitivitetit të të dhënave dhe fushëveprimit, kontekstit, qëllimeve dhe natyrës së përpunimit (për shembull në rastin e vendimmarrjes së automatizuar), si dhe mundësisë dhe shkallës së rreziqeve. Këto garanci mund të ndryshojnë ndërmjet sistemeve ligjore vendëse dhe varen nga këta faktorë. Një listë joshteruese e garancive mund të përfshijë kufizimin e përpunimit (për shembull, lejimin e përpunimit vetëm për qëllime të caktuara ose rast pas rasti), kufizimin e shpërndarjes, kufizimin e aksesit (për shembull, kufizimin e aksesit vetëm për personel të caktuar nëpërmjet autorizimit të veçantë ose procedurave të vlefshimit që kërkojnë trajnim të specializuar për një personel të tillë), masa shtesë organizative ose teknike të sigurisë (për shembull, maskimi, vendosja e pseudonimeve ose ruajtja e ndarë e të dhënave biometrike nga informacioni i lidhur biografik) ose periudha më të shkurtra ruajtjeje. Në raste të caktuara, mund të jetë e dobishme të kryhet një vlerësim ndikimi për të ndihmuar në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve.

Paragrafi 5 – Periudhat e ruajtjes

240. Fjalja e parë e paragrafit 5 parashikon se çdo Palë do t’i ruajë të dhënat personale vetëm për aq kohë sa është e nevojshme dhe e përshtatshme në funksion të qëllimeve të përpunimit të të dhënave sipas paragrafit 2”. Në këtë drejtim, parimi i kufizimit të qëllimit të paragrafit 2 parashikon që një Palë që ka marrë të dhëna personale, do t’i përpunojë ato për qëllime specifike në përputhje me nenin 2 dhe nuk do t’i përpunojë më tej për një qëllim të papajtueshëm. Në përputhje me këtë parim, periudha e ruajtjes së të dhënave lidhet me qëllimet specifike për të cilat përpunohen të dhënat.

241. Për shkak se sipas nenit 2, të dhënat personale të marra nga një palë në përputhje me këtë Protokoll, janë për qëllime të hetimeve ose procedimeve penale specifike, të dhënat personale mund të mbahen për aq kohë sa nevojitet: i. për kohëzgjatjen e hetimit dhe procedimit pasues, duke përfshirë çdo apelim ose periudhë gjatë të cilës një çështje mund të rihapet sipas legjislacionit të brendshëm; dhe ii. pasi të jetë përmbyllur qëllimi i marrjes fillestare, për përpunim të mëtejshëm për një qëllim që “nuk është i papajtueshëm”, me qëllimin fillestar. Për shembull, një Palë mund të

garantojë që informacioni ose provat të mbahen për qëllime arkivimi ose kërkimi historik, ose qëllime të tjera të pajtueshme në përputhje me nenin 14, paragrafi 2, siç shpjegohet më tej në paragrafët korrespondues të këtij raporti shpjegues.

242. Fjalja e dytë e paragrafit 5 u jep Palëve dy mundësi për të përmbyllur detyrimin për të ruajtur të dhënat personale vetëm për aq kohë sa është e nevojshme dhe e përshtatshme në funksion të qëllimeve të përpunimit të të dhënave sipas paragrafit 2 të këtij neni. Së pari, një Palë mund të parashikojë periudha të caktuara ruajtjeje në kuadrin e saj të brendshëm ligjor. Përndryshe, Palët mund të parashikojnë në kuadrin e tyre të brendshëm ligjor shqyrtimin e nevojës për ruajtje të mëtejshme në intervale të planifikuara. Palët kanë një marzh diskrecioni për të vendosur se cila qasje, në kontekstin e kuadrin të tyre të brendshëm ligjor, i përshtatet më mirë grupit specifik të të dhënave. Palët mund të kombinojnë, gjithashtu, një periudhë të caktuar ruajtjeje me një sistem rishikimi periodik në intervale më të shkurtra. Ato duhet të sigurojnë në kuadrin e tyre ligjor që autoritetet kompetente të hartojnë rregulla dhe/ose procedura të brendshme për zbatimin e periudhave specifike të ruajtjes dhe/ose rishikimin periodik të nevojës për ruajtje të mëtejshme. Nëse periudha e ruajtjes ka mbaruar ose nëse Pala ka përcaktuar me rishikim periodik se nuk ka nevojë të mëtejshme për të ruajtur të dhënat, ato duhet të fshihen ose të bëhen anonime.

Paragrafi 6 – Vendimet e automatizuara

243. Paragrafi 6 lidhet me mbrojtjen e individëve kur vendimet që prodhojnë një efekt negativ të konsiderueshëm, në lidhje me interesat e tyre përkatës, bazohen vetëm në përpunimin e automatizuar të të dhënave të tyre personale. Nuk parashikohet që kur një Palë merr të dhëna personale nga një Palë tjetër sipas këtij Protokoll, vendimmarrja e automatizuar do të përfshihet shpesh, sepse provat ose informacionet do të merren nga hetuesit ose autoritetet gjyqësore për qëllime të një hetimi ose procedimi specifik penal. Megjithatë, nëse vendimmarrja e automatizuar që prodhon efekt negativ të konsiderueshëm në lidhje me interesat përkatës të individit me të cilin lidhen të dhënat personale, zhvillohet në hetimin për të cilin janë kërkuar të dhënat, autoritetet duhet të zbatojnë këtë dispozitë. Gjithashtu, autoritetet duhet të zbatojnë këtë dispozitë nëse përdorimet e mëvonshme të të dhënave bëhen për parandalimin,



zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të krimeve të tjera (për shembull arrestimi i bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar të profileve kriminale, dënimi, lirimi me garanci pasurore, lirimi me kusht) ose për një qëllim të pajtueshëm (për shembull brenda kontekstit të kontrolleve paraprake), nëse të dhënat janë objekt i mjeteve analitike të automatizuara për qëllime vendimmarreje.

244. Si rrjedhojë, paragrafi 6 ndalon një vendim të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar të të dhënave personale, kur ai prodhon një efekt negativ të konsiderueshëm në lidhje me interesat përkatës të një individ, duke përfshirë efektet e pafavorshme juridike (duke ndikuar në statusin ligjor ose të drejtat e individit), si për shembull lëshimi i një urdhërarresti ose refuzimi i lirimit me garanci pasurore ose lirimit me kusht, përveç rastit kur një vendim i tillë autorizohet sipas legjislacionit të brendshëm dhe u nënshtrohet garancive të duhura.

245. Masat e duhura mbrojtëse janë vendimtare për reduktimin e ndikimit të mundshëm ndaj interesave përkatës të individit me të cilin lidhen të dhënat personale. Garanci të tilla duhet të mbulojnë mundësinë që individ i në fjalë të marrë ndërhyrjen njerëzore për të vlerësuar vendimin. Palët inkurajohen, gjithashtu, të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të garantuar cilësinë dhe përfaqësimin e të dhënave të përdorura për zhvillimin e algoritmeve dhe saktësinë e konkluzioneve statistikore të përdorura, duke pasur parasysh rrethanat specifike dhe kontekstin e përpunimit, përfshirë kontekstin e zbatimit të së drejtës penale.

Paragrafi 7 – Siguria e të dhënave dhe incidentet e sigurisë

246. Në bazë të paragrafit 7/a, çdo Palë do të garantojë që të ketë në veprim masat e duhura teknologjike, fizike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale”. Për shembull, masat teknologjike mund të përfshijnë softuerin që mbron kundër *malware* kompjuterik, kodimin e të dhënave dhe *firewalls* (sistemeve ose rrjeteve mbrojtëse nga aksesit i paautorizuar). Masat fizike mund të përfshijnë ruajtjen e serverëve dhe skedarëve kompjuterikë në vende të sigurta dhe masat organizative mund të përfshijnë rregulla, praktika, politika dhe procedura, duke përfshirë ato që kufizojnë të drejtat e aksesit.

247. Paragrafi 7/a parashikon më tej se masat duhet të mbrojnë, në veçanti, nga humbja (për shembull procedurat e standardizuara për depozitimin dhe trajtimin e të dhënave), aksesit aksidental ose i paautorizuar (për shembull mbrojtja kundër ndërhyrjeve kompjuterike, kërkesat e autorizimit ose vleftësimit për aksesin në letër ose skedarët kompjuterikë), zbulimi aksidental ose i paautorizuar (për shembull masat teknologjike për të zbuluar dhe parandaluar zbulimet aksidentale ose të paautorizuara dhe masat organizative për të përshkruar pasojat për zbulime të tilla) dhe ndryshimi ose shkatërrimi aksidental ose ndryshe i paautorizuar i të dhënave (për shembull, kufizimi i hyrjes ose ndryshimi i të dhënave elektronike ose skedarëve në letër për personelin e autorizuar, përdorimi i sistemeve të logimit, shfaqja e periudhave të ruajtjes, instalimi i sistemeve kompjuterike ose të skedarëve rezervë në format letër).

248. Mënyra e saktë e përmbushjes së këtyre kërkesave, në një mënyrë të përshtatshme për rrethanat specifike, i është lënë palës së interesuar. Palët inkurajohen, për shembull, të hartojnë dhe zbatojnë masa sigurie që marrin parasysh faktorë të tillë si natyra e të dhënave personale (përfshirë sensitivitetin e tyre), rreziqet e identifikuar dhe çdo pasojë të mundshme negative për individin në fjalë, në rast të një incidenti sigurie. Në të njëjtën kohë, Palët mund të marrin parasysh çështjet e burimeve të përfshira në hartimin dhe zbatimin e masave të sigurisë së të dhënave. Palët inkurajohen t’ia nënshtrojnë këto masa rishikimit periodik dhe përditësimit të tyre, kur është e nevojshme, në funksion të zhvillimit të teknologjisë dhe natyrës progresive të rreziqeve.

249. Paragrafi 7/b përcakton kërkesat në rast të një “incidenti sigurie” (siç përcaktohet në paragrafin 7/a dhe të përshkruar më sipër) në lidhje me të dhënat personale të marra sipas këtij Protokollit që krijojnë një “rrezik të konsiderueshëm fizik ose dëm jofizik” për individët ose për Palën nga e cila kanë origjinën të dhënat. Dëmi përkatës ndaj një individ mund të përfshijë, për shembull, dëmtimin trupor ose reputacional, shqetësimin emocional (për shembull, nëpërmjet poshtërimit ose shkeljes së konfidencialitetit), diskriminimin ose dëmin financiar (për shembull, humbjen e punësimit ose mundësive profesionale, vlerësimin negativ të besueshmërisë, vjedhjen e



identitetit ose mundësinë për shantazh). Për sa i përket palës tjetër, dëmi përkatës mund të përfshijë në veçanti ndikimin e mundshëm negativ në një hetim paralel (për shembull, arratisja e të dyshuarit, shkatërrimi i provave). Nëse ekziston një “rrezik i konsiderueshëm” i një dëmi të tillë, Pala marrëse ka detyrimin që të “vlerësojë menjëherë mundësitë dhe shkallën” e dëmit dhe të “ndërmarrë menjëherë veprimet e duhura për të zbutur një dëm të tillë”. Faktorët që lidhen me mundësitë dhe shkallën e dëmit për t’u marrë në konsideratë, mund të përfshijnë, ndër të tjera, llojin e incidentit, si për shembull, nëse është i njohur, nëse ishte keqdashës; personat që kanë ose mund të marrin informacionin; natyrën dhe sensitivitetin e të dhënave të prekura; volumin e të dhënave potencialisht të rrezikuara dhe numrin e individëve që mund të preken; lehtësinë e identifikimit të individëve në fjalë; mundësitë e aksesit dhe përdorimit të të dhënave, për shembull, nëse të dhënat janë të koduara ose janë bërë ndryshe të paaksesueshme dhe pasojat e mundshme që mund të ndodhin si rezultat i incidentit.

250. Në përputhje me masat e përshkruara në paragrafin 7/a dhe për të siguruar një reagim të duhur sipas paragrafit 7/b, Palëve u kërkohet të kenë në veprim procese të brendshme për të qenë të afta të zbulojnë incidente sigurie. Ato, gjithashtu, duhet të kenë një proces për vlerësimin e menjëhershëm të mundësive dhe shkallës së dëmit të mundshëm, dhe për marrjen e menjëhershme të masave të duhura për të zbutur dëmin (për shembull, duke sjellë në vëmendje ose kërkuar fshirjen e informacionit që i është transmetuar aksidentalisht një marrësi të paautorizuar). Zbatimi efektiv i këtyre kërkesave mund të përfitojë nga procedurat e raportimit të brendshëm dhe nga mbajtja e të dhënave për çdo incident sigurie.

251. Paragrafi 7/b përcakton, gjithashtu, rrethanat në të cilat Pala tjetër dhe individët e prekur duhet të njoftohen në lidhje me incidentin, duke iu nënshtruar përjashtimeve dhe kufizimeve.

252. Në rast të një incidenti sigurie në të cilin ekziston një rrezik i konsiderueshëm i dëmtimit fizik ose jofizik për individët ose për Palën tjetër, njoftimi do t’i jepet autoritetit transferues ose, për qëllimet e kreut II, seksioni 2, autoritetit ose autoriteteve të caktuara në përputhje me paragrafin 7/c. Megjithatë, njoftimi mund të përfshijë kufizimet e duhura për sa i përket transmetimit të

mëtejshëm të njoftimit që do të vonohet ose anashkalohet kur një njoftim i tillë mund të rrezikojë sigurinë kombëtare ose do të vonohet kur një njoftim i tillë mund të rrezikojë masat për mbrojtjen e sigurisë publike (duke përfshirë kur njoftimi do të rrezikonte hetimin e veprave penale që rrjedhin nga incidenti i sigurisë). Për të vendosur nëse një njoftim duhet të vonohet ose anashkalohet në rrethana ku njoftimi mund të rrezikojë sigurinë kombëtare, një Palë duhet të marrë parasysh nëse do të ishte e arsyeshme në këto rrethana të anashkalohej njoftimi ose nëse një njoftim i vonuar do të ishte më i përshtatshëm.

253. Në rast të një incidenti sigurie në të cilin ekziston një rrezik i konsiderueshëm i dëmtimit fizik ose jofizik për individët, njoftimi do t’u jepet edhe individëve të prekur nga incidenti, në mënyrë që ata të mund të mbrojnë interesat, edhe pse u nënshtrohet përjashtimeve. Së pari, paragrafi 7/b përcakton se njoftimi nuk është i nevojshëm nëse Pala ka marrë masat e duhura, në mënyrë që të mos ketë më një rrezik të konsiderueshëm dëmtimi.

Për shembull, nuk do të kërkohet asnjë njoftim kur një *email* që përmban informacione sensitive personale i është dërguar aksidentalisht marrësit të gabuar dhe do të kishte krijuar një rrezik të konsiderueshëm dëmi pa masa zbutëse, por është fshirë shpejt dhe përgjithmonë nga marrësi, sipas kërkesës, përpara se të ndahej më tej. Së dyti, njoftimi i individit mund të vonohet ose anashkalohet sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 12/a/i – d.m.th., njoftimi “mund t’i nënshtrohet zbatimit të kufizimeve proporcionale të lejuara, sipas kuadrit të tij të brendshëm ligjor, të nevojshme... për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose objektivat e rëndësishëm të interesit të përgjithshëm publik dhe që u kushtojnë vëmendjen e duhur interesave legjitimë të individit në fjalë”.

254. Në përgjithësi, Palët inkurajohen të përfshijnë në një njoftim sipas paragrafit 7.b, kur është e nevojshme, informacion për llojin e incidentit të sigurisë, llojin dhe volumin e informacionit që mund të jetë kompromentuar, rreziqet e mundshme dhe masat e parashikuara për t’u marrë për zbutjen e dëmit të mundshëm, duke përfshirë masat për të frenuar incidentin. Duke pasur parasysh funksionin e tyre mbikëqyrës dhe me synimin për të përfutur nga këshillat e ekspertëve për trajtimin e incidentit, mund të jetë, gjithashtu, e nevojshme që Pala njoftuese të



informojë autoritetet mbikëqyrëse të përshkruara në paragrafin 14 të incidentit dhe çdo masë lehtësuese.

255. Për të lejuar një reagim të koordinuar dhe për ta mbështetur në përpjekjet e veta për zbutjen e rrezikut, Pala e njoftuar mund të kërkojë konsultim dhe informacion shtesë në lidhje me incidentin dhe reagimin ndaj tij nga Pala njoftuese.

256. Paragrafi 7/c parashikon procedurat e kërkuara që Palët të caktojnë autoritetin ose autoritetet të cilat do të njoftohen sipas paragrafit 7/b për qëllimet e kreut II, seksioni 2.

Paragrafi 8 – Mbajtja e të dhënave

257. Paragrafi 8 kërkon nga Palët që “të mbajnë të dhëna ose të kenë mjete të tjera të përshtatshme për të provuar se si aksesohen, përdoren dhe zbulohen të dhënat personale të një individi në një rast specifik”. Objektivi është që çdo palë të ketë mjete efektive për të provuar se si janë aksesuar, përdorur dhe zbuluar të dhënat e një individi të caktuar në një rast specifik, në përputhje me këtë nen. Të provuarit e pajtueshmërisë është i rëndësishëm, veçanërisht për qëllime mbikëqyrëse dhe si i tillë kontribuon në llogaridhënie. Ndërsa mjetet e sakta për të provuar se si përpunohen të dhënat i lihen secilës Palë për t’i zbatuar, Palët inkurajohen që t’i përshtatin metodat e tyre ndaj rrethanave, duke pasur parasysh rreziqet për individët në fjalë dhe natyrën, fushëveprimin, qëllimet dhe kontekstin e përgjithshëm të përpunimit.

258. Për shembull, disa Palë mund të vendosin të përdorin regjistrimin e automatizuar të aktiviteteve (logimin) ose alternativa të tjera (të tilla si të dhënat me shkrim dore në rastin e skedarëve në format letër). Siç u theksua më lart, objektivi është që të lehtësojë llogaridhënien, por të lejojë një shkallë fleksibiliteti në lidhje me mënyrën se si një Palë e bën këtë, në përputhje me detyrimet e tjera të zbatueshme sipas nenit 14. Për shembull, Palët duhet të mbajnë të dhëna ose dokumentacion tjetër mbi aksesin, përdorimin ose zbulimin në një mënyrë që lehtëson punën e autoriteteve mbikëqyrëse.

Paragrafi 9 – Ndarja e mëtejshme brenda një Pale

259. Paragrafi 9 parashikon se “kur një autoritet i një Pale i jep të dhëna personale të marra fillimisht sipas këtij Protokolli, një autoriteti tjetër të asaj

Pale, ai autoritet tjetër do t’i përpunojë ato në përputhje me këtë nen, në bazë të paragrafit 9/b”.

Me fjalë të tjera, sa herë që të dhënat personale të marra sipas këtij Protokolli i jepen më pas një autoriteti tjetër të së njëjtës Palë – duke përfshirë një autoritet të një shteti përbërës ose njësi tjetër të ngjashme territoriale– të dhëna të tilla duhet të përpunohen sipas këtij neni, përveç rasteve kur zbatohet përjashtimi në paragrafin 9/b. Paragrafi 9 zbatohet edhe në rastet e shumëfishta të ndarjes së mëtejshme.

260. Paragrafi 9/b parashikon një përjashtim nga paragrafi 9/a, kur një palë që është shtet federal, ka bërë rezervë ndaj detyrimeve të këtij Protokolli sipas nenit 17, në përputhje me kushtet e përcaktuara aty. Sipas paragrafit 297 të këtij raporti shpjegues, ky përjashtim zbut “vështirësitë me të cilat mund të përballen shtetet federale si rezultat i shpërndarjes së tyre karakteristike të kompetencave ndërmjet autoriteteve qendrore dhe rajonale”. Shih, gjithashtu, paragrafin 316 të raportit shpjegues të Konventës. Si rrjedhojë, paragrafi 9/b përcakton se kur një Palë ka bërë rezervë sipas nenit 17, ajo ende mund t’u japë të dhëna personale të marra fillimisht sipas këtij Protokolli, shteteve të saj përbërëse ose subjekteve të tjera të ngjashme territoriale, me kusht që Pala të ketë vënë në funksionim masa që autoritetet marrëse të vijojnë të mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat, duke parashikuar një nivel mbrojtjeje të të dhënave të krahasueshëm me atë të parashikuar nga ky nen. Mosmarrja nga një Palë e “masave të vendosura në mënyrë që autoritetet marrëse të vijojnë të mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat, duke parashikuar një nivel mbrojtjeje të të dhënave të krahasueshëm me atë të parashikuar nga ky nen”, në bazë të shkallës, arsyeve dhe rrethanave të mosplotësimit të kësaj kërkesë, përbën shkelje materiale ose sistematike sipas paragrafit 15 të nenit 14.

261. Paragrafi 9/c parashikon që në rast të të dhënave treguese për zbatimin e gabuar të këtij paragrafi nga një Palë tjetër, Pala transferuese mund të kërkojë konsultim me atë Palë tjetër dhe informacion përkatës në lidhje me këto të dhëna treguese, me qëllim sqarimin e situatës.

Paragrafi 10 – Transferimi i mëtejshëm të një Shteti tjetër ose organizatë ndërkombëtare

262. Në bazë të paragrafit 10/a, një Palë mund t’i transferojë të dhënat personale të marra sipas Protokollit “një shteti ose organizate tjetër



ndërkombëtare vetëm me autorizimin paraprak të autoritetit transferues ose, për qëllimet e kreut II, seksioni 2, autoritetit ose autoriteteve të përcaktuara në paragrafin 10/b”. Kjo lloj garancie është kusht i zakonshëm i transferimeve për të ndihmuar partnerët e huaj në kontekstin e zbatimit të së drejtës penale (për shembull në bazë të traktateve të ndihmës së ndërsjellë ose bashkëpunimit ndërpolicor) dhe kjo qasje aplikohet në këtë paragraf, gjithashtu, si një mjet për mbrojtjen e të dhënave personale të transferuara sipas këtij Protokolli.

263. Paragrafi 10/b parashikon që çdo Palë, në kohën e nënshkrimit të këtij Protokolli ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, do t’i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës autoritetin ose autoritetet e caktuara për të dhënë autorizimin, sipas paragrafit 10/a, për qëllime të transferimeve, sipas kreut II, seksioni 2, i cili mund të ndryshohet më pas.

264. Marrja e autorizimit për transferim të mëtejshëm mund të sjellë dërgimin e një kërkesë të individualizuar nga autoritetet e Palës marrëse autoriteteve të Palës transferuese për autorizim për të transferuar të dhëna personale të identifikuar specifikisht te një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare specifike. Megjithatë, paragrafi 10/a nuk i pengon Palët të përcaktojnë rregulla paraprakisht për transferimet e mëtejshme (për shembull, nëpërmjet marrëveshjes me shkrim ose marrëveshjeve të tjera). Paragrafi 10/a nuk cenon, gjithashtu, aftësinë e një Pale për të vendosur kushte të tjera për përdorim nga marrësi i të dhënave (për shembull, vendosja e kufizimeve në masën në të cilën Pala marrëse mund të përdorë ose shpërndajë të dhënat personale për të shmangur cenimin e hetimit të Palës transferuese) në përputhje me dispozitat specifike të kreut II.

265. Në përcaktimin nëse do të jepet autorizim për një transferim sipas paragrafit 10, autoriteti transferues ose i caktuar inkurajohet të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë shkallën e veprës penale, qëllimin për të cilin janë transferuar fillimisht të dhënat, kushtet e zbatueshme, në lidhje me transferimin fillestar dhe nëse vendi i tretë ose organizata ndërkombëtare garanton nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale.

Paragrafi 11 – Transparenca dhe njoftimi

266. Paragrafi 11/a vendos disa kërkesa për transparencë dhe njoftim për Palët në lidhje me nenet e specifikuar në paragrafët 11/a/i deri iv. Këto kërkesa për transparencë dhe njoftim i ndihmojnë individët të kuptojnë se si Palët mund të përpunojnë të dhënat e tyre. Këto kërkesa, gjithashtu, informojnë individët për aksesin, korrigjimin dhe rregullimin e disponueshëm.

267. Çdo Palë ka fleksibilitet nëse një njoftim dhe transparencë e tillë ofrohet nëpërmjet publikimit të njoftimeve të përgjithshme për publikun – për shembull në një faqe interneti qeveritare – ose njoftimit personal për individin, të dhënat personale të të cilit ka marrë Pala. Njoftimi duhet të jetë i aksesueshëm pa vështirësi dhe lehtësisht i kuptueshëm. Pavarësisht nëse është dhënë njoftim i përgjithshëm apo personal, duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm: i. baza ligjore për përpunim dhe qëllimi/et e përpunimit, përfshirë qëllimet e zbulimeve të parashikuara ose të zakonshme të informacionit; ii. periudhat e mbajtjes ose rishikimit sipas paragrafit 5 të këtij neni, sipas rastit; iii. marrësit ose kategoritë e marrësve të cilëve u jepen të dhënat; dhe iv. aksesit, korrigjimit dhe mjetet juridike gjyqësore dhe jogjyqësore të disponueshme.

268. Sipas paragrafit 11/b, kur njoftimi personal i jepet individit të dhënat e të cilit ka marrë Pala, kërkesa e njoftimit dhe transparencës e paragrafit 11/a mund t’u nënshtrohet kufizimeve të arsyeshme në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 12/a/i të këtij neni. Për shembull, brenda kontekstit të çështjeve të drejtësisë penale mund të ketë rrethana legjitime në të cilat dhënia e njoftimit mund të vonohet ose anashkalohet. Këto rrethana referohen në paragrafin 12/a/i dhe përshkruhen në paragrafin 272 të këtij raporti shpjegues. Mund të lindin, gjithashtu, situata kur sasia e detajeve të dhëna në njoftimin e përgjithshëm mund të jetë e kufizuar, në varësi të sensitivitetit të informacionit.

269. Paragrafi 11/c ofron një bazë për palët që të balancojnë interesin për transparencë me nevojën për konfidencialitet në çështjet e drejtësisë penale. Ai parashikon që kur kuadri i brendshëm ligjor i Palës transferuese kërkon njoftim personal për individin, të dhënat e të cilit i janë paraqitur një Pale tjetër sipas këtij Protokolli, pala transferuese do të marrë masa që Pala marrëse të informohet në



momentin e transferimit në lidhje me këtë kërkesë dhe informacionin e duhur të kontaktit. Pala transferuese nuk do ta njoftojë individin nëse Pala marrëse ka kërkuar, kur zbatohen kushtet për kufizimet e përcaktuara në paragrafin 12.a.i, që sigurimi i të dhënave të mbahet konfidencial. Pasi këto kushte për kufizime të mos zbatohen më dhe mund të jepet njoftim personal, Pala marrëse do të marrë masa që Pala transferuese të informohet se njoftimi mund të jepet. Kjo mund të përfshijë një rishikim periodik të nevojës për kufizime të tilla. Nëse ende nuk është informuar, pala transferuese ka të drejtë t'i bëjë kërkesa palës marrëse, e cila do të informojë palën transferuese nëse duhet të mbajë kufizimin.

Paragrafi 12 – Aksesit dhe korrigjimi

270. Paragrafi 12/a kërkon që çdo palë të garantojë që çdo individ, të dhënat personale të të cilit janë marrë sipas këtij Protokollit, ka të drejtë të kërkojë dhe të sigurojë, në përputhje me proceset e përcaktuara në kuadrin e saj të brendshëm ligjor dhe pa vonesë të panevojshme, akses në këto të dhëna (në bazë të kufizimeve të mundshme) dhe kur këto të dhëna janë të pasakta ose janë përpunuar në mënyrë jo të duhur, korrigjimin. Shprehja “në përputhje me proceset e përcaktuara në kuadrin e saj të brendshëm ligjor” u jep palëve fleksibilitet në lidhje me mënyrën se si mund të kërkojë dhe sigurohet aksesit dhe korrigjimi, dhe synon t'u referohet proceseve të vendosura, për shembull, në ligjet, rregulloret, rregullat në fuqi (të tilla si rregullat juridiksionale) dhe politikat, si dhe rregullat e zbatueshme të provave. Në disa sisteme ligjore, një individ do të duhet të ndjekë aksesin dhe korrigjimin administrativisht përpara se të kërkojë mjete juridike.

271. Paragrafi 12/a/i parashikon që në rastin e një kërkesë për akses, një individ ka të drejtë të marrë një kopje me shkrim ose elektronike të dokumentacionit që përmban të dhënat personale të individit dhe informacionin e disponueshëm që specifikon bazën ligjore dhe qëllimin/et e përpunimit, mbajtjen dhe marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave (“aksesi”), si dhe informacion për opsionet e disponueshme për rregullim sipas paragrafit 13. Kjo, gjithashtu, mund t'i lejojë individit të konfirmojë nëse të dhënat e tyre personale janë marrë (ose jo) sipas këtij Protokollit dhe nëse janë përpunuar ose janë duke u përpunuar. Dhënia e dokumentacionit që përmban

informacionin e disponueshëm që specifikon bazën ligjore dhe qëllimin/et e përpunimit do ta ndihmojë individin në vlerësimin nëse të dhënat personale janë duke u përpunuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shumë Palë mund të ofrojnë tashmë një kuadër për akses të tillë nëpërmjet ligjeve të tyre të privatësisë, lirisë së informacionit ose aksesit në të dhënat qeveritare.

272. Aftësia për të garantuar akses të tillë në një rast të veçantë mund t'i nënshtrohet kufizimeve proporcionale të lejuara sipas kuadrit të brendshëm ligjor të një Pale, “të nevojshme, në kohën e gjykimit, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose objektiva të rëndësishëm të interesit të përgjithshëm publik dhe që i kushtojnë vëmendjen e duhur interesave legjitimë të individit në fjalë”. Të drejtat dhe liritë e të tjerëve, për shembull, mund të përfshijnë privatësinë e individëve të tjerë, të dhënat personale të të cilëve do të zbuloheshin në rast se u jepet akses. Objektivat e rëndësishëm të interesit të përgjithshëm publik mund të përfshijnë, për shembull, mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike (për shembull informacion për kërcënimet e mundshme terroriste ose rreziqe serioze për zyrtarët ligjzbatues); parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të veprave penale dhe shmangien e cenimeve ndaj kerkimeve, hetimeve dhe procedimeve zyrtare. Në mënyrë të ngjashme me përshkrimin e proporcionalitetit në paragrafin 146 të raportit shpjegues të Konventës, “kufizimet proporcionale” në këtë kontekst pritet të zbatohen nga çdo Palë në përputhje me parimet përkatëse të kuadrit të saj të brendshëm ligjor. Për Palët e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ETS nr. 5) ose të Protokollit CETS nr. 223 që ndryshon Konventën për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, proporcionaliteti do të burojë nga kërkesat e këtyre Konventave. Palët e tjera do të zbatojnë parimet përkatëse të kuadrit të tyre të brendshëm ligjor që kufizojnë në mënyrë të arsyeshme aftësinë për të garantuar akses për mbrojtjen e interesave të tjerë legjitimë. Siç u përcaktua më lart, kufizimet proporcionale duhet të mbrojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose të mbrojnë objektiva të rëndësishëm të interesit të përgjithshëm publik dhe t'u kushtojnë vëmendjen e duhur “interesave legjitimë të individit në fjalë”. Shprehja “interesat legjitimë të individit në fjalë” u konsiderua nga



hartuesit se përfshin të drejtat dhe liritë e individit. Në rastin kur përmenden këto arsye për kufizime, autoriteti i kërkuar inkurajohet të dokumentojë një vendim të tillë për qëllimin e paragrafit 14. Palët duhet, gjithashtu, të marrin në konsideratë nëse aksesit i pjesshëm mund të jepet kur arsyet për ndonjë kufizim (për shembull për të mbrojtur informacionin e klasifikuar ose informacionin konfidencial tregtar) zbatohen vetëm për pjesë të caktuara të informacionit.

273. Kur dispozitat e tjera të këtij neni lejojnë kufizime sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 12/a/i, “në momentin e gjykimit” synohet t’i referohet, në rastin e paragrafit 7, momentit të njoftimit të një incidenti sigurie; në rastin e paragrafit 11/b, deri në kohën e dhënies së njoftimit personal dhe në rastin e 11/c, në kohën kur një Palë kërkon konfidencialitet.

274. Sipas paragrafit 12/a/ii, çdo Palë do të garantojë që çdo individ, të dhënat e të cilit janë marrë sipas këtij Protokoll, ka të drejtë të kërkojë dhe të sigurojë, në përputhje me proceset e përcaktuara në kuadrin e saj të brendshëm ligjor dhe pa vonesë të panevojshme, korrigjim kur të dhënat personale të individit janë të pasakta ose janë përpunuar në mënyrë jo të duhur. Korrigjimi do të përfshijë – sipas rastit dhe siç është e arsyeshme, duke marrë parasysh arsyet për korrigjimin dhe kontekstin e veçantë të përpunimit – korrigjim, plotësim (për shembull, nëpërmjet raportimit ose duke ofruar informacion shtesë ose korrigjues), fshirje ose anonimizim, kufizim të përpunimit ose bllokim. Në këtë drejtim, hartuesit çmuan se fshirja ose anonimizimi është masa e përshtatshme dhe e arsyeshme e veprimit, nëse të dhënat përpunohen në kundërshtim me paragrafin 5. Në rast të shkeljes së paragrafit 2, mund të jetë, gjithashtu, e nevojshme që Pala të kufizojë përpunimin; megjithatë, kjo do të varet përfundimisht nga konteksti i veçantë (për shembull nevoja për të ruajtur të dhënat personale për qëllime provash). Kur të dhënat bëhen anonime, Palët duhet të marrin në konsideratë rrezikun e ri-identifikimit të paautorizuar dhe të zbatojnë masat e duhura për të minimizuar atë rrezik. Palët inkurajohen, kur është e mundur, të njoftojnë Palën nga e cila janë marrë të dhënat dhe subjektet e tjera me të cilat janë ndarë të dhënat, për çdo veprim korrigjues të ndërmarrë.

275. Sipas paragrafit 12/b, nëse aksesit ose korrigjimi refuzohet ose kufizohet sipas paragrafit 12/a, Pala do t’i japë individit, në formë të shkruar, e cila mund të sigurohet në mënyrë elektronike, pa vonesë të panevojshme, një përgjigje që informon atë individ për mohimin ose kufizimin. Ndërsa autoriteti do të paraqesë arsyet për një mohim ose kufizim të tillë, një komunikim mund të jetë i përgjithshëm (d.m.th., pa konfirmuar ose mohuar ekzistencën e ndonjë regjistrimi përkatës), kur është e nevojshme për të mos cenuar një objektiv sipas paragrafit 12/a/i. Megjithatë, palët duhet të garantojnë që komunikimi të përfshijë informacion mbi opsionet e disponueshme për rregullim.

276. Palët mund të paguajnë një tarifë për sigurimin e aksesit (për shembull koston administrative të grumbullimit dhe shqyrtimit të dokumenteve në të cilat është kërkuar akses). Megjithatë, për të mos penguar ose shkurajuar aksesin, çdo tarifë duhet të kufizohet në atë që është e arsyeshme dhe jo e tepruar, duke pasur parasysh burimet e përfshira. Për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në paragrafin 12/a, Palët inkurajohen që të lejojnë individët të kërkojnë një përfaqësues për të ndihmuar në kërkimin dhe marrjen e masave të përshkruara aty ose për të paraqitur një kërkesë dhe/ose ankesë në emër të tij ose të saj. Në këto rrethana, njoftimi sipas paragrafit 11/a, si dhe informacioni i marrë në përgjigje të një kërkesë për akses në bazë të paragrafit 12/a/i, mund t’i referohet kësaj mundësie. Megjithatë, një përfaqësim i tillë duhet të jetë në përputhje me kërkesat ligjore të brendshme të zbatueshme të Palës në të cilën kërkohen masa të tilla, ose kërkesa dhe/ose ankesa është paraqitur siç përshkruhet më sipër, duke përfshirë rregullat që rregullojnë kushtet në të cilat personat ose subjektet mund të përfaqësojnë interesat ligjorë të të tjerëve (për shembull, në disa sisteme ligjore vendëse, rregullat që rregullojnë autorizimin/prokurën).

Paragrafi 13 – Mjetet juridike gjyqësore dhe jogjyqësore

277. Paragrafi 13 parashikon se “çdo Palë do të ketë mjete juridike efektive gjyqësore dhe jogjyqësore për të siguruar rregullim për shkeljet e këtij neni”. I lihet secilës Palë që të përcaktojë llojin e mjeteve juridike për shkelje të dispozitave të këtij neni dhe nuk kërkohet që çdo lloj mjeti juridik të jetë i disponueshëm për ndonjë shkelje të këtij neni.



Mjetet juridike të ofruara duhet të jenë efektive në trajtimin e shkeljeve të këtij neni. Palët mund të përfshijnë kompensimin si mjet juridik, në rastet kur është e nevojshme, për dëmin fizik ose jo fizik që ankuesi ka konstatuar se ka rezultuar nga shkelja.

Paragrafi 14 – Mbikëqyrja

278. Paragrafi 14 kërkon që palët të kenë “një ose më shumë autoritete publike funksionale që ushtrojnë, të vetme ose në mënyrë kumulative, funksione dhe kompetenca të pavarura dhe efektive mbikëqyrëse në lidhje me masat e përcaktuara në këtë nen”. Dispozita u lejon Palëve fleksibilitet në mënyrën se si ta zbatojnë këtë kërkesë. Disa Palë mund të krijojnë autoritete të specializuara për mbrojtjen e të dhënave, ndërsa palë të tjera mund të zgjedhin të ushtrojnë mbikëqyrje në mënyrë kumulative nëpërmjet më shumë se një autoriteti, funksionet e të cilit mund të mbivendosen. Kjo pasqyron dallimet në strukturat kushtetuese, organizative dhe administrative të palëve. Në disa palë, këto autoritete mbikëqyrëse mund të jenë vendosur brenda komponentëve qeveritarë, aktivitetet e të cilëve mbikëqyrin dhe buxhetet e tyre mund të jenë pjesë e buxhetit të përgjithshëm të komponentit. Në një rast të tillë, këto autoritete duhet të gëzojnë pavarësinë për të kryer me efektivitet përgjegjësitë e tyre mbikëqyrëse.

279. Hartuesit çmuan se një numër elementesh kontribuojnë në funksionet dhe kompetencat e pavarura dhe efektive të mbikëqyrjes. Autoritetet duhet të kryejnë detyrat e tyre dhe të ushtrojnë kompetencat në mënyrë të paanshme; ata duhet të gëzojnë aftësinë për të vepruar pa ndikime të jashtme që mund të ndërhyjnë në ushtrimin e pavarur të kompetencave dhe funksioneve të tyre; në veçanti, këto autoritete nuk duhet t'u nënshtrohen udhëzimeve, në një rast të veçantë, për ushtrimin e kompetencave të tyre hetimore dhe/ose marrjen e masave korrigjuese; dhe së fundi, është e rëndësishme që autoritetet të kenë aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer detyrat e tyre dhe për të marrë burimet e duhura financiare, teknike dhe njerëzore për kryerjen efektive të funksioneve të tyre.

280. Funksionet dhe kompetencat e këtyre autoriteteve do të “përfshijnë kompetencat hetimore, fuqinë për të vepruar sipas ankesave dhe aftësinë për të ndërmarrë veprime korrigjuese”.

Hartuesit çmuan se kompetencat hetimore duhet të përfshijnë kompetencën për të marrë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre, duke përfshirë, në bazë të kushteve të përshtatshme, aksesin në të dhënat e mbajtura sipas paragrafit 8. Veprimet korrigjuese mund të përfshijnë nxjerrjen e paralajmërimeve për mospërputhje ose udhëzime se si të përmbushen operacionet e përpunimit të të dhënave (për shembull, duke kërkuar zbatimin e masave shtesë të sigurisë për të kufizuar aksesin në të dhëna ose korrigjimin e të dhënave personale), duke kërkuar pezullimin (e përkohshëm) të disa operacioneve të përpunimit ose duke ia referuar çështjen autoriteteve të tjera (për shembull inspektorëve të përgjithshëm, prokurorëve publikë, gjyqtarëve hetues ose organeve legjislative). Një veprim i tillë korrigjues mund të merret me nismën e autoriteteve ose me ankesat e bëra nga individë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale.

281. Palët inkurajohen që të nxisin bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të tyre mbikëqyrëse përkatëse. Konsultimet ndërmjet autoriteteve përkatëse të palëve, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre mbikëqyrëse sipas këtij neni, mund të zhvillohen sipas rastit. Kjo mund të përfshijë shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira.

Paragrafi 15 – Konsultimi dhe pezullimi

282. Paragrafi 15 rregullon rastet kur, sipas nenit 14, një Palë mund të pezullojë transferimin e të dhënave personale, sipas këtij Protokollit të një Palë tjetër kur Palët veprojnë sipas paragrafit 1/a të nenit 14. Paragrafi 15 sqaron se duke marrë parasysh qëllimet e rëndësishme ligjzbatuese të këtij Protokollit, pezullime të tilla duhet të ndodhin vetëm në kushte rigorozë dhe në përputhje me procedurat specifike të përshkruara në të. Qëllimi i dispozitave për mbrojtjen e të dhënave të këtij neni është sigurimi i garancie të duhura për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë rastin e ndarjes së mëtejshme brenda një Pale dhe transferimeve të mëtejshme. Hartuesit çmuan se garancitë e këtij neni dhe zbatimi efektiv i tyre janë thelbësore dhe për këtë arsye e çmuan të rëndësishëm parashikimin e pezullimit të transferimeve të të dhënave personale për situata të caktuara. Si rrjedhojë, një Palë mund të pezullojë transferimin e të dhënave personale, sipas këtij



Protokolli të një Palë tjetër, nëse ka prova thelbësore për shkelje sistematike ose materiale të kushteve të këtij neni, ose nëse një shkelje materiale është e pashmangshme. Ndërsa kërkesa e “provave materiale” nuk e detyron një Palë të provojë një shkelje sistematike ose materiale përtej dyshimit, ajo nuk mund të pezullojë transferimet bazuar vetëm në një dyshim ose supozim. Në fakt, përcaktimi i Palës duhet të ketë mbështetje thelbësore në prova të besueshme faktike. Një “shkelje materiale” nënkupton shkelje të konsiderueshme të një detyrimi material sipas këtij neni. Kjo mund të përfshijë mos-sigurimin e një garancie të kërkuar të këtij neni në kuadrin e brendshëm ligjor të një Pale. Hartuesit pranian se pezullimi është, gjithashtu, i disponueshëm, për shkak të shkeljeve sistematike – për shembull shkeljet e shpeshta të përsëritura të garancive të këtij neni. Hartuesit pranian më tej se moszbatimi i disa garancive për përpunimin e të dhënave personale në një rast individual, në mungesë të një shkeljeje materiale, nuk do të sigurojë bazë të mjaftueshme për të cituar këtë dispozitë, pasi individ i fjalë duhet të jetë i aftë për të trajtuar shkelje të tilla nëpërmjet mjeteve efektive juridike gjyqësore jo gjyqësore sipas paragrafit 13 të nenit 14.

283. Paragrafi 15 parashikon më tej se një Palë “nuk do të pezullojë transferimet pa njoftim të arsyeshëm dhe jo derisa Palët e interesuara të jenë angazhuar në një periudhë të arsyeshme konsultimi pa arritur një zgjidhje”. Kjo kërkesë konsultimi pranon se pezullimi i transferimeve kritike ligjzbatuese duhet të ndërmerret vetëm pasi palës tjetër t’i jepet mundësi e arsyeshme për të sqaruar situatën ose për të trajtuar problemet e deklaruara. Në fillim të këtij konsultimi, Pala që citohet në paragrafin 15 mund t’i kërkojë Palës tjetër të japë informacionin përkatës. Megjithatë, siç pranohet në paragrafin 15, Pala që citohet në këtë paragraf duhet të ketë paraprakisht prova thelbësore të një shkeljeje materiale ose sistematike ose shkeljeje të pashmangshme materiale; si rrjedhojë, mekanizmi i konsultimit nuk duhet të përdoret për të marrë prova të mëtejshme kur thjesht dyshohet për një shkelje. Transferimet e të dhënave sipas këtij Protokoll mund të pezullohen vetëm pas një njoftimi të arsyeshëm dhe një periudhe të arsyeshme konsultimi pa arritur zgjidhje. Megjithatë, një Palë mund të pezullojë përkohësisht

transferimet në rast të një shkeljeje sistematike ose materiale që paraqet rrezik të lartë dhe të pashmangshëm për jetën ose sigurinë ose rrezik të lartë dhe të pashmangshëm të dëmtimit të konsiderueshëm të reputacionit ose monetar për një person fizik. Kjo përfshin një rrezik të lartë dhe të pashmangshëm për dëmtim trupor ose për shëndetin e një personi fizik. Në këto raste, Pala do të njoftojë dhe do të fillojë konsultimet me Palën tjetër menjëherë pas pezullimit të përkohshëm të transferimeve. Hartuesit çmuan se pezullimi i përkohshëm në përgjithësi duhet të kufizohet tek ato transferime që lidhen drejtpërdrejt me urgjencën që justifikon pezullimin e përkohshëm.

284. Nëse Pala pezulluese përmbush kushtet e përcaktuara në paragrafin 15, ajo mund të pezullojë transferimet dhe Pala tjetër nuk mund të reagojë. Megjithatë, nëse Pala tjetër ka prova thelbësore se pezullimi nga Pala pezulluese ishte në kundërshtim me kushtet e paragrafit 15, ajo mund të pezullojë reciprokisht transferimet e të dhënave të Pala pezulluese.

Në këtë kontekst, termi “provë thelbësore” ka të njëjtën kuptim si në lidhje me pezullimin fillestar nga pala pezulluese. Pezullimi nga pala pezulluese do të ishte në kundërshtim me kushtet e paragrafit 15, për shembull, nëse pala pezulluese nuk do të kishte “prova thelbësore”, shkelja nuk ishte as “sistematike”, as “materiale” ose pala pezulluese nuk arriti të përmbushte kërkesat procedurale për pezullim, veçanërisht ato që lidhen me konsultimet.

285. Së fundi, paragrafi 15 parashikon se “Pala pezulluese do të heqë pezullimin sapo shkelja që justifikon pezullimin të jetë korrigjuar” dhe se “çdo pezullim i ndërsjellë do të hiqet në atë kohë”. Një rregull i ngjashëm me atë të zbatuar në nenin 24, paragrafi 4, zbatohet në kontekstin e pezullimit sipas këtij paragrafi. Kjo nënkupton se paragrafi 15 parashikon që “çdo e dhënë personale e transferuar përpara pezullimit, do të vijojë të trajtohet në përputhje me këtë Protokoll”.

286. Palët inkurajohen të bëjnë publike ose të njoftojnë zyrtarisht ofruesit e shërbimeve dhe subjektet të cilëve mund t’u drejtohen kërkesat ose urdhrat sipas kreut II, seksioni 2, për çdo pezullim ose pezullim të përkohshëm sipas këtij paragrafi. Një komunikim i tillë mund të jetë i rëndësishëm për të pezulluar në mënyrë efektive transferimet e të dhënave personale të një Palë që është në shkelje materiale ose sistematike të nenit 14, por,



gjithashtu, për të siguruar që ofruesit dhe subjektet e shërbimeve të mos kufizojnë transferimin e informacionit ose provave sipas këtij Protokoll bazuar në besimin e gabuar se një Palë i nënshtrohet kësaj dispozite pezullimi.

287. Megjithatë paragrafi 15 parashikon procedura specifike në lidhje me konsultimin dhe pezullimin e transferimeve të të dhënave personale për arsye të mbrojtjes së të dhënave, procedurat në paragrafin 15 nuk synojnë të cenojnë konsultimet sipas nenit 23, paragrafi 1, ose të drejtat e pezullimit që mund të zbatohen sipas së drejtës ndërkombëtare, në lidhje me nenet e tjera të këtij Protokoll.

KREU IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

288. Dispozitat e përfshira në këtë krye, në pjesën më të madhe, bazohen si në “Klauzolat përfundimtare model për Konventat, Protokollat Shtesë dhe Protokollat Ndryshuese të lidhura brenda Këshillit të Evropës”, të cilat u miratuan nga Komiteti i Ministrave në mbledhjen e 1291-të të Zëvendësministrave në korrik 2017, dhe klauzolat përfundimtare të Konventës. Meqë disa nga nenet nën këtë krye ose përdorin gjuhën standarde të klauzolave model, ose bazohen në praktikën e konsoliduar të hartimit të traktateve në Këshillin e Evropës, ato nuk kërkojnë komente specifike. Megjithatë, disa modifikime të klauzolave të modelit standard dhe devijimet nga dispozitat përfundimtare të Konventës kërkojnë disa shpjegime.

Neni 15 Efektet e këtij Protokoll

289. Paragrafi 1/a i nenit 15 përfshin nenin 39, paragrafi 2 të Konventës. Siç pranohet në paragrafin 312 të raportit shpjegues të Konventës, ky paragraf parashikon që Palët janë të lira të zbatojnë marrëveshjet që ekzistojnë tashmë ose që mund të hyjnë në fuqi në të ardhmen. Ky Protokoll, si Konventa, në përgjithësi parashikon detyrime minimale; si rrjedhojë, ky paragraf pranon se Palët janë të lira të marrin përsipër detyrime që janë më specifike, përveç atyre të përcaktuara tashmë në këtë Protokoll, kur vendosin marrëdhëniet e tyre në lidhje me çështjet e trajtuara

në të. Megjithatë, Palët duhet të respektojnë objektivat dhe parimet e Protokollit kur veprojnë në këtë mënyrë dhe për këtë arsye nuk mund të pranojnë detyrime që do të cenonin qëllimin e tij.

290. Paragrafi 1/b i këtij neni pranon, gjithashtu, integrimin e zgjeruar të Bashkimit Evropian (BE) që nga hapja e Konventës për nënshkrim në vitin 2001, veçanërisht në fushat e zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, si dhe mbrojtjes së të dhënave. Si rrjedhojë, ai i lejon shtetet anëtare të BE-së të zbatojnë legjislacionin e Bashkimit Evropian që rregullon çështjet e trajtuara në këtë Protokoll ndërmjet tyre. Hartuesit synonin që legjislacioni i Bashkimit Evropian të përfshinte masat, parimet dhe procedurat e parashikuara në rendin juridik të BE-së, në veçanti ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative, si dhe kërkesa të tjera, përfshirë vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, paragrafi 1/b synon të mbulojë marrëdhëniet e brendshme ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe institucioneve, organeve dhe agjencive të BE-së. Nëse nuk ka legjislacion të Bashkimit Evropian në lidhje me një çështje që hyn në objektin e këtij Protokoll, ky Protokoll do të vijoje të rregullojë atë çështje ndërmjet Palëve që janë shtete anëtare të BE-së.

291. Paragrafi 1/c sqaron se paragrafi 1/b nuk cenon zbatimin e plotë të këtij Protokoll ndërmjet palëve që janë anëtare të BE-së dhe palëve të tjera. Si rrjedhojë, paragrafi 1/b nuk synon të ketë ndonjë efekt përtej marrëdhënieve të brendshme të BE-së, siç përshkruhet në paragrafin 290 më lart; ky Protokoll zbatohet plotësisht ndërmjet Palëve që janë shtete anëtare të BE-së dhe palëve të tjera. Hartuesit e konsideruan një dispozitë të tillë thelbësore, për të garantuar që palët që nuk janë shtete anëtare të BE-së do të merrnin të gjitha përfitimet e këtij Protokoll në marrëdhëniet e tyre me Palët që janë shtete anëtare të BE-së. Për shembull, hartuesit diskutuan se një shtet anëtar i BE-së që merr informacion ose prova nga një Palë joanëtare e BE-së do të duhet të kërkonte pëlqimin e palës joanëtare të BE-së përpara se të transferonte informacionin ose provat te një Palë tjetër e BE-së, në përputhje me nenin 14, paragrafi 10. Në mënyrë të ngjashme, paragrafi 1/a i këtij neni do të zbatohet plotësisht ndërmjet palëve që janë shtete anëtare të BE-së dhe palëve të tjera që nuk janë.



292. Paragrafi 2 i nenit 15 përfshin nenin 39, paragrafi 3 të Konventës. Ngjashëm me Konventën, siç shpjegohet në paragrafin 314 të raportit shpjegues të Konventës, ky Protokoll nuk synon të trajtojë të gjitha çështjet e pazgjidhura në lidhje me format e bashkëpunimit ndërmjet palëve ose ndërmjet palëve dhe subjekteve private lidhur me krimin kibernetik dhe marrjen e provave në formë elektronike të veprave penale. Si rrjedhojë, paragrafi 2 i nenit 15 u përfshi për të qartësuar se ky Protokoll prek vetëm atë që trajton. Të paprekura mbeten të drejta, kufizime, detyrime dhe përgjegjësi të tjera që mund të ekzistojnë, por që nuk trajtohen nga ky Protokoll.

293. Neni 15 nuk përmban një dispozitë të ngjashme me nenin 39, paragrafi 1 të Konventës. Kjo dispozitë në Konventë shpjegoi se qëllimi i Konventës ishte që të plotësonte traktatet ose marrëveshjet dypalëshe të zbatueshme ndërmjet Palëve, duke përfshirë disa traktate të ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjellë. Ky Protokoll nuk përmban asnjë dispozitë për ekstradimin dhe ka shumë dispozita që nuk janë dispozita të ndihmës së ndërsjellë. Siç shpjegohet më gjerësisht në nenin 5 dhe raportin e tij shpjegues shoqërues, çdo seksion i masave të bashkëpunimit në kreun II ndërvepron në mënyra të ndryshme me traktatet e ndihmës së ndërsjellë. Si rrjedhojë, hartuesit arritën në përfundimin se ata nuk duhet të përfshijnë një dispozitë të ngjashme me nenin 39, paragrafi 1.

Neni 16

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

294. Neni 16 i lejon të gjitha Palët e Konventës që të nënshkruajnë dhe të bëhen Palë të këtij Protokoll. Ndryshe nga Protokollin i Parë (neni 11), ky Protokoll nuk parashikon një procedurë për aderim në këtë Protokoll. Një shtet që dëshiron të nënshkruajë dhe të bëhet Palë e këtij Protokoll, do të duhet fillimisht të bëhet Palë e Konventës.

295. Paragrafi 3 parashikon se ky “Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën pesë Palë të Konventës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të pasur detyrime ligjore për këtë Protokoll”. Ndërsa Konventa parashikonte në nenin 36, paragrafi 3, që të paktën tre nga pesë palët duhet të ishin shtete anëtare të Këshillit të Evropës që Konventa të hynte në fuqi, një kërkesë

e tillë nuk përfshihet këtu, pasi ky është Protokoll Shtesë i një Konvente dhe se të gjitha palët duhet të kenë të njëjtën të drejtë për të zbatuar këtë Protokoll sapo një numër minimal prej pesë palëve të Konventës të kenë shprehur pëlqimin e tyre për të pasur detyrime ligjore në lidhje me të. Kjo ndjek qasjen e nenit 10 të Protokollit të Parë.

296. Paragrafi 4 përshkruan procesin për hyrjen në fuqi të këtij Protokoll për ato Palë të Konventës që shprehin pëlqimin e tyre për të pasur detyrime ligjore për këtë Protokoll pas hyrjes së tij në fuqi sipas paragrafit 3. Kjo ndjek qasjen e nenit 36, paragrafi 4 të Konventës.

Neni 17

Klauzola federale

297. Ngjashëm me klauzolën federale të parashikuar në nenin 41 të Konventës, neni 17 i këtij Protokoll përmban një klauzolë federale që lejon një Palë që është shtet federal, të bëjë rezervë “në përputhje me parimet e saj themelore që rregullojnë marrëdhëniet midis qeverisë së saj qendrore dhe Shteteve përbërëse ose subjekteve të tjera të ngjashme territoriale”. Qëllimi i nenit 17 është i njëjtë me atë të nenit 41 të Konventës. Kjo do të thotë, siç përcaktohet në paragrafin 316 të raportit shpjegues të Konventës, “për të përballuar vështirësitë me të cilat shtetet federale mund të përballen si rezultat i shpërndarjes së tyre karakteristike të pushtetit midis autoriteteve qendrore dhe rajonale”.

298. Shtetet federale lejohen të bëjnë rezervë ndaj detyrimeve në kreun II të Konventës (përcaktimi i veprave penale të brendshme dhe masave procedurale të brendshme), në shkallën që masat nuk hyjnë në kompetencën rregullatore të qeverisë qendrore të një shteti federal. Megjithatë, shteteve federale u kërkohet të jenë të aftë të ofrojnë bashkëpunim ndërkombëtar për Palët e tjera sipas kreut III të Konventës.

299. Megjithëse ky Protokoll parashikon bashkëpunim ndërkombëtar dhe jo masa të brendshme, negociatorët pranuan se një klauzolë federale është ende e nevojshme në këtë Protokoll. Ndërsa Konventa nuk parashikonte asnjë rezervë federalizmi për ndihmën e ndërsjellë, shumica e masave të këtij Protokoll nuk funksionojnë në të njëjtën mënyrë si ndihma e ndërsjellë tradicionale. Ky Protokoll ofron një sërë masash bashkëpunimi



që janë më efikase sesa ndihma e ndërsjellë tradicionale dhe që nuk kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen e qeverisë qendrore. Në veçanti, ky Protokoll prezanton dy masa, nenet 6 dhe 7, në të cilat autoritetet kompetente në një Palë mund të kërkojnë bashkëpunim drejtpërdrejt nga kompanitë private në një Palë tjetër. Këto masa kërkojnë hapa të caktuar proceduralë që një shtet federal mund të ketë vështirësi, duke i kërkuar autoriteteve kompetente nga shtetet përbërëse ose subjektet territoriale që t'i zbatojnë. Për shembull, neni 7 parashikon që një Palë, nëpërmjet njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm, mund të kërkojë që autoritetet nga Palët e tjera të njoftojnë një autoritet të caktuar qeveritar në të njëjtën kohë kur i transmetojnë një urdhër një ofruesi shërbimi që kërkon informacion të abonentit. Nene të tjerë përmbajnë kërkesa për të marrë masa legislative ose masa të tjera që një shtet federal mund të mos jetë në gjendje t'u kërkojë shteteve të tij përbërëse ose subjekteve të tjera të ngjashme territoriale që t'i miratojnë. Së fundi, ky Protokoll përmban dispozita të detajuara për mbrojtjen e të dhënave, ndërsa Konventa jo. Për shembull, në Shtetet e Bashkuara, sipas kushtetutës së saj dhe parimeve themelore të federalizmit, shtetet e saj përbërëse miratojnë ligjet e tyre procedurale penale dhe penale (të ndara nga ligjet federale); krijojnë gjykatat, prokurorët dhe policinë e tyre; dhe të hetojnë dhe ndjekin penalisht veprat penale shtetërore. Autoritetet kompetente shtetërore janë të pavarura dhe nuk varen nga autoritetet federale.

300. Nëse autoritetet e shtetit përbërës të një shteti federal ose subjekti të ngjashëm territorial kërkojnë format e bashkëpunimit të parashikuara sipas këtij Protokoll, mund të ndodhë që: i. ato të veprojnë sipas ligjeve procedurale dhe të privatësisë, të ndryshme nga ato nën të cilat funksionojnë autoritetet e qeverisë qendrore; ii. nuk i përgjigjen qeverisë qendrore për sa i përket hierarkisë organizative; ose iii. qeveria qendrore nuk ka fuqinë ligjore për të urdhëruar veprimet e tyre. Në situata të tilla, mund të ekzistonte vetëm siguria që një shtet përbërës ose subjekt i ngjashëm territorial do të përmbushte kërkesat e këtij Protokoll – ato që lidhen me kërkimin e informacionit ose provave, si dhe ato që lidhen me trajtimin e mëvonshëm të një informacioni ose prove të tillë – nëse i. i zbaton ato vetë, ose ii. nëse autoritetet e tij kërkuar bashkëpunim nëpërmjet

ose me pjesëmarrjen e autoriteteve të qeverisë qendrore, të cilat do të kujdeseshin për përmbushjen e tyre (për shembull, nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë ose pikës së kontaktit 24/7, ose me pjesëmarrjen e qeverisë qendrore në një JIT).

301. Duke pasur parasysh këto konsiderata, paragrafi 1 ofron një mundësi rezerve për palët që janë shtete federale. Këto palë mund të rezervojnë të drejtën të marrin përsipër detyrime sipas këtij Protokoll në përputhje me parimet e tyre themelore që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet qeverisë së tyre qendrore dhe shteteve përbërëse ose subjekteve të tjera të ngjashme territoriale, në bazë të paragrafëve 1/a deri c, të cilët kufizojnë qëllimin e një rezerve të tillë. Sipas paragrafit 1/a, qeverisë qendrore të një shteti federal që citon këtë rezervë, i kërkohet të zbatojë të gjitha kushtet e këtij Protokoll (në bazë të rezervave dhe deklaratave të disponueshme). Në lidhje me detyrimet për mbrojtjen e të dhënave sipas këtij Protokoll, për palët që procedojnë sipas nenit 14, paragrafi 1/a, kjo përfshin detyrimet në nenin 14, paragrafi 9/b në lidhje me ndarjen e mëtejshme me shtetet përbërëse ose subjekte të tjera të ngjashme territoriale (shih raportin shpjegues, paragrafi 260) kur një autoritet federal ka kërkuar informacion sipas këtij Protokoll, qoftë për qëllimet e veta ose në emër të një autoriteti në nivel nën-federal, dhe më pas e ndan këtë informacion me një autoritet të tillë në nivel nën-federal. Gjithashtu, paragrafi 1/b parashikon që ngjashëm me nenin 41, paragrafi 1 të Konventës, një rezervë e tillë nuk do të cenojë detyrimet e atij Shteti Federal Palë për të garantuar bashkëpunimin e kërkuar nga Palët e tjera në përputhje me dispozitat e kreut II. Së fundi, sipas paragrafit 1/c, pavarësisht nga rezerva e një shteti federal, neni 13 i këtij Protokoll – i cili kërkon, në përputhje me nenin 15 të Konventës, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut sipas legjislacionit të brendshëm – zbatohet për shtetet përbërëse të shtetit federal ose subjektet e ngjashme territoriale, përveç qeverisë qendrore, sipas paragrafit 1/a.

302. Paragrafi 2 parashikon që nëse një shtet federal bën rezervë sipas paragrafit 1 dhe autoritetet e një shteti përbërës ose subjekti të ngjashëm territorial në atë Palë kërkojnë bashkëpunim drejtpërdrejt nga një autoritet, ofrues ose subjekt në një Palë tjetër, ajo Palë tjetër “mund të parandalojë autoritetet, ofruesit ose subjektet në



territorin e saj që të bashkëpunojnë në përgjigje” ndaj tyre. Pala tjetër mund të përcaktojë se në cilën mënyrë duhet të parandalohet bashkëpunimin e autoriteteve ose ofruesve ose subjekteve në territorin e saj. Ekzistojnë dy përjashtime nga autoriteti/kompetenca e një Pale tjetër për të parandaluar bashkëpunimin.

303. Së pari, paragrafi 2 parashikon që bashkëpunimi nuk mund të pengohet nga kjo Palë tjetër nëse, për shkak se shteti përbërës ose subjekti tjetër i ngjashëm territorial përmbush detyrimet e këtij Protokollit, shteti federal palë në fjalë ka “njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës që një shtet përbërës ose subjekt tjetër i ngjashëm territorial përmbush detyrimet e këtij Protokollit të zbatueshëm për atë Shtet federal”. Termi “detyrimet e këtij Protokollit të zbatueshëm për atë Shtet Federal” nënkupton që një autoritet i një shteti përbërës ose subjekti tjetër të ngjashëm territorial nuk mund t’i nënshtrohet asnjë kërkesë që qeveria qendrore nuk i nënshtrohet, si për shembull për shkak të një rezerve të zbatueshme.

Nëse shteti federal ia ka bërë këtë njoftim Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me një shtet të caktuar përbërës, një Palë tjetër kërkohet të garantojë ekzekutimin e një urdhri ose kërkesë nga ai shtet në të njëjtën masë sikur të ishte marrë nga autoritetet e qeveria qendrore. Natyrisht, kërkesat dhe procedurat e përfshira në ndonjë masë bashkëpunimi të kreut II zbatohen ende për kërkesat ose urdhrat e paraqitura nga këto shtete përbërëse ose subjekte të ngjashme territoriale dhe pajtueshmëria me këto kërkesa është e nevojshme. Ky paragraf kërkon që Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës të krijojë dhe të mbajë të përditësuar një regjistër të njoftimeve të tilla. Palët inkurajohen që t’i ofrojnë Sekretarit të Përgjithshëm informacion të përditësuar.

304. Së dyti, sipas paragrafit 3, nëse një kërkesë ose urdhër i një shteti përbërës ose njësie tjetër të ngjashme territoriale është paraqitur nëpërmjet qeverisë qendrore ose, sipas nenit 12, në përputhje me një marrëveshje të ekipit të përbashkët hetimor që është lidhur me pjesëmarrjen e qeverisë qendrore, një Palë tjetër nuk mund të pengojë autoritetet, ofruesit ose subjektet në territorin e saj nga transferimi i informacionit ose provave në përputhje me kushtet e këtij Protokollit, me arsyetimin se bashkëpunimi është duke u kërkuar nga një shtet përbërës ose njësi e ngjashme

territoriale e një shteti federal që ka bërë rezervën sipas paragrafit 1. Kjo ndodh sepse kur kërkesa ose urdhri është dorëzuar nëpërmjet qeverisë qendrore ose kur është lidhur marrëveshja e grupit të përbashkët hetimor me pjesëmarrjen e qeverisë qendrore, qeverisë qendrore i kërkohet të “garantojë përmbushjen e detyrimeve të zbatueshme të Protokollit”. Meqë qeveria qendrore paraqet kërkesën ose urdhrin (ose merr pjesë në JIT), ajo ka mundësinë dhe detyrimin të verifikojë nëse kërkesat e këtij Protokollit në lidhje me këto masa janë përmbushur. Për shembull, nëse sipas nenit 7, paragrafi 5/a, një Palë tjetër duhet të njoftohet për transmetimin e një urdhri që kërkon informacionin e abonentit, qeveria qendrore është e detyruar të japë këtë njoftim. Në lidhje me mbrojtjen e të dhënave (për Palët që procedojnë sipas nenit 14, paragrafi 1/a), nëse një shtet përbërës ose subjekt tjetër i ngjashëm territorial kërkon bashkëpunim nëpërmjet qeverisë qendrore, kjo e fundit i jep të dhënat shtetit përbërës ose subjektit tjetër të ngjashëm territorial dhe duhet të zbatojë kërkesat e përcaktuara në nenin 14, paragrafi 9/b (ndarja e mëtejshme brenda një Pale). Kjo do të thotë se qeveria qendrore duhet të ketë në veprim masa, në mënyrë që autoritetet marrëse të vijojnë të mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat, duke parashikuar një nivel mbrojtjeje të krahasueshëm me atë të parashikuar nga neni 14. Autoritetet e një shteti përbërës ose të njësisë së ngjashme territoriale që kërkojnë dhe marrin të dhëna personale në këtë mënyrë, ndryshe nuk janë të detyruara të zbatojnë Nenin 14. Nëse Palët e interesuara po zbatojnë një marrëveshje ose rregullim tjetër të përshkruar në nenin 14, paragrafët 1/b ose 1/c, do të zbatohen kushtet e zbatueshme të kësaj marrëveshjeje ose rregullimi.

305. Paragrafi 4 ka pothuajse të njëjtin tekst dhe të njëjtin efekt si në nenin 41, paragrafi 3 të Konventës. Kështu, në lidhje me subjektet e tjera të ngjashme territoriale (përveç rastit kur njoftimi i është dhënë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni), qeverisë qendrore të shtetit federal i kërkohet: i. të informojë autoritetet e shteteve përbërëse të tij ose subjektet e tjera të ngjashme territoriale për dispozitat e këtij Protokollit, dhe ii. të japë “opinionin e saj të favorshëm, duke i inkurajuar që të ndërmarrin veprimet e duhura për zbatimin e tyre”, çka inkurajon shtetet përbërëse



ose subjektet e ngjashme territoriale që të zbatojnë plotësisht këtë Protokoll. Për këtë Protokoll, kjo synon, gjithashtu, që eventualisht të lejojë që këto shtete përbërëse ose subjekte të tjera të ngjashme territoriale të njoftohen sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 18 **Zbatimi territorial**

306. Neni 38 i Konventës i lejon Palët të përcaktojnë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet Konventa. Neni 18 i këtij Protokoll i zbaton automatikisht këtë Protokoll në territoret e përcaktuara nga një Palë sipas nenit 38, paragrafët 1 ose 2 të Konventës, në masën që një deklaratë e tillë nuk është tërhequr sipas nenit 38, paragrafi 3 të Konventës. Hartuesit çmuan se do të ishte më mirë nëse i njëjti fushëveprim territorial i Konventës dhe i këtij Protokoll të zbatohet si rregull i paracaktuar.

307. Paragrafi 2 i këtij neni parashikon që “një Palë, në kohën e nënshkrimit të këtij Protokoll ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit, mund të deklarojë se ky Protokoll nuk do të zbatohet për një ose më shumë territore të përcaktuara në deklaratën e Palës sipas nenit 38, paragrafët 1 dhe/ose 2 të Konventës”. Sipas paragrafit 3, Palët mund të tërheqin deklaratën sipas paragrafit 2 të këtij neni, në përputhje me procedurat e përcaktuara. Tërheqja e deklaratës në paragrafin 2 do të kishte efektin e zbatimit të këtij Protokoll në territore shtesë që mbuloheshin nga Konventa, por për të cilat ky Protokoll nuk ishte zbatuar më parë.

308. Ky nen nuk lejon zbatimin e këtij Protokoll për territoret që nuk mbulohen nga Konventa.

Neni 19 **Rezervat dhe deklaratat**

309. Ky nen parashikon një sërë mundësish për rezerva. Duke pasur parasysh shtrirjen globale të Konventës dhe synimin për të arritur të njëjtin nivel anëtarësie në këtë Protokoll, rezerva të tilla u mundësojnë Palëve të Konventës që të bëhen Palë të këtij Protokoll, ndërsa u lejojnë këtyre palëve të ndjekin qasje dhe koncepte të caktuara në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm,

parimet themelore ligjore ose konsideratat politike, sipas rastit.

310. Mundësitë për rezerva janë të kufizuara për të siguruar në masën më të gjerë të mundshme zbatimin uniform të këtij Protokoll nga Palët. Kështu, nuk mund të bëhen rezerva të tjera përveç atyre të renditura. Gjithashtu, rezervat mund të bëhen vetëm nga një Palë e Konventës në kohën e nënshkrimit të këtij Protokoll ose me depozitimin e instrumentit të saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

311. Ashtu si në Konventë, rezervat në këtë Protokoll përjashtojnë ose modifikojnë efektin ligjor të detyrimeve të përcaktuara në këtë Protokoll (shih paragrafin 315 të raportit shpjegues të Konventës). Në këtë Protokoll, rezervat lejohen për të përjashtuar forma të plota bashkëpunimi. Në mënyrë specifike, neni 7, paragrafi 9/a i lejon një Palë të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar nenin 7 në tërësinë e tij. Rezervat lejohen, gjithashtu, për të përjashtuar bashkëpunimin për nene të plota në lidhje me disa lloje të dhënash. Në mënyrë specifike, neni 7, paragrafi 9/b i lejon një Palë të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar Nenin 7 për disa lloje numrash aksesi, nëse zbulimi i atyre numrave të aksesit do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të sistemit të saj të brendshëm ligjor. Në mënyrë të ngjashme, neni 8, paragrafi 13 i lejon një Palë të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar nenin 8 për të dhënat e trafikut.

312. Neni 19 u referohet edhe deklaratave. Ngjashëm me Konventën, nëpërmjet deklaratave në këtë Protokoll, Palëve u lejohe të përfshijnë disa procedura shtesë të specifikuar, të cilat ndryshojnë objektin e dispozitave. Procedura të tilla shtesë synojnë të përshtatin disa dallime konceptuale, ligjore ose praktike, të cilat justifikohen duke pasur parasysh shtrirjen globale të Konventës dhe aspirojnë shtrirje të barabartë të këtij Protokoll. Deklaratat e numërtuara ndahen në dy kategori të përgjithshme.

313. Disa deklarata lejojnë një Palë të deklarojë se disa kompetenca ose masa duhet të kryhen nga autoritete të veçanta ose bashkëpunimi të transmetuar përmes kanaleve të veçanta. Kjo vlen për nenin 10, paragrafi 9 (që lejon një deklaratë që kërkesat mund t'u dërgohen autoriteteve përveç autoritetit qendror); neni 12, paragrafi 3 (autoriteti qendror duhet të jetë nënshkrues ose në ndonjë



mënyrë tjetër të pajtohet me marrëveshjen JIT); neni 8, paragrafi 11 (një Palë deklaruese mund të kërkojë që kërkesat e Palëve të tjera sipas këtij neni, duhet të transmetohen nga autoritetet e tyre qendrore ose një autoritet tjetër i caktuar reciprokisht).

314. Një kategori e dytë e deklaratave i lejon Palët që të kërkojnë hapa proceduralë të veçantë ose shtesë për masa të caktuara bashkëpunimi, në mënyrë që të jenë në përputhje me legjislacionin e brendshëm ose të shmangin mbingarkimin e autoriteteve. Për shembull, neni 7, paragrafi 8 dhe neni 9, paragrafi 1/b lejojnë një Palë që të bëjë deklaratë për t'u kërkuar palëve të tjera të ndërmarrin hapa të veçantë proceduralë në lidhje me informacionin e abonentit. Neni 7, paragrafët 2/b dhe 5/a, neni 8, paragrafi 4 dhe neni 9, paragrafi 5 lejojnë hapa proceduralë shtesë për dhënien e garancive shtesë ose për respektimin e legjislacionit të brendshëm. Efektet e deklaratave nuk synohen të jenë të ndërsjella. Për shembull, nëse një Palë bën deklaratë sipas nenit 10, paragrafi 9 – që do të thotë se kërkesat sipas këtij neni mund t'u dërgohen autoriteteve përveç autoritetit të saj qendror – Palët e tjera mund t'i drejtojnë kërkesa autoriteteve shtesë të Palës deklaruese, por Pala deklaruese mund t'u drejtojë kërkesa vetëm autoriteteve qendrore të Palëve të tjera, përveç kur ato, gjithashtu, bëjnë një deklaratë të tillë.

315. Deklaratat e renditura sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të bëhen në kohën e nënshkrimit të një Pale ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit. Në të kundërt, deklaratat e renditura në paragrafin 3 mund të bëhen në çdo kohë.

316. Paragrafi 3 kërkon që Palët të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për çdo deklaratë, njoftim ose komunikim të përmendur në nenin 7, paragrafët 5/a dhe 5/e dhe nenin 8, paragrafët 4 dhe 10/a dhe b, nenin 14, paragrafët 7/c dhe 10/b dhe nenin 17, paragrafi 2 të këtij Protokollit, sipas kushteve të përcaktuara në ato nene. Për shembull, sipas nenit 7, paragrafi 5/e, në kohën kur njoftimi i jepet për herë të parë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës sipas paragrafit 5/a, një Palë do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm informacionin e kontaktit të atij autoriteti". Palët do t'i komunikojnë më tej Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, "autoritetet" e përmendura në nenin 8,

paragrafët 10/a dhe b. Sekretari i Përgjithshëm urdhërohet të krijojë dhe të mbajë të përditësuar një regjister të këtyre autoriteteve të caktuara nga palët, dhe palët udhëzohen të sigurojnë që të dhënat që japin për regjistrin të jenë të sakta në çdo kohë (shih nenin 7, paragrafi 5. f dhe nenin 8, paragrafi 12).

Neni 20

Statusi dhe tërheqja e rezervave

317. Ashtu si neni 43 i Konventës, edhe ky nen, pa vendosur kufizime specifike kohore, u kërkon palëve të tërheqin rezervat sapo ta lejojnë rrethanat. Për të mbajtur njëfarë presioni mbi Palët dhe për t'i bërë ato të paktën të marrin në konsideratë tërheqjen e rezervave të tyre, paragrafi 2 autorizon Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës që të hetojë periodikisht për mundësitë e tërheqjes. Kjo mundësi hetimi është praktikë aktuale sipas disa instrumenteve të Këshillit të Evropës dhe pasqyrohet në nenin 43, paragrafi 3 të Konventës dhe nenin 13, paragrafi 2 të Protokollit të Parë. Palëve u jepet kështu një mundësi për të treguar nëse ende duhet të ruajnë rezervat e tyre në lidhje me disa dispozita dhe të tërheqin, më pas, ato që nuk janë më të nevojshme. Shpresohet se me kalimin e kohës Palët do të mund të heqin sa më shumë nga rezervat e tyre që të jetë e mundur, në mënyrë që të nxisin zbatimin uniform të këtij Protokollit.

Neni 21

Ndryshimet

318. Neni 21 ndjek të njëjtën procedurë si ajo e parashikuar për ndryshimet në nenin 44 të Konventës. Kjo procedurë e thjeshtuar lejon ndryshime pa nevojën e negocimit të një Protokollit Ndryshues, nëse lind nevoja. Kuptohet se rezultatet e konsultimeve me Palët e Konventës sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk janë të detyrueshme për palët e Protokollit. Siç specifikohet në paragrafin 323 të raportit shpjegues të Konventës, "procedura e ndryshimit synohet kryesisht për ndryshime relativisht të vogla të karakterit procedural dhe teknik".



Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

319. Neni 22 parashikon se mekanizmat e mosmarrëveshjeve të parashikuar nga neni 45 i Konventës zbatohen edhe për këtë Protokoll (shih paragrafin 326 të raportit shpjegues të Konventës).

Neni 23

Konsultimet e Palëve dhe vlerësimi i zbatimit

320. Paragrafi 1 i nenit 23 parashikon që neni 46 i Konventës (Konsultimet e Palëve) është i zbatueshëm për këtë Protokoll. Sipas paragrafit 327 të raportit shpjegues të Konventës, neni 46 krijoi “një kuadër për Palët për t’u konsultuar në lidhje me zbatimin e Konventës, efektin e zhvillimeve të rëndësishme ligjore, politike ose teknologjike që lidhen me subjektin e krimit kompjuterik ose krimit të lidhur kompjuterik dhe marrjen e provave në formë elektronike dhe mundësinë e plotësimit ose ndryshimit të Konventës”. Procedura u krijua për të qenë fleksibël dhe iu la palëve të vendosnin mbi mënyrën dhe kohën kur të mbledheshin. Pas hyrjes në fuqi të Konventës në 2004, Palët filluan të mbledheshin rregullisht si “Komiteti i Konventës për Krimet Kibernetike” (T-CY). Me kalimin e kohës, T-CY, i krijuar sipas nenit 46 dhe bazuar në Rregullat e Procedurës të miratuara nga Palët e Konventës, ndërmoi vlerësime të zbatimit të Konventës nga Palët, miratoi shënime udhëzuese për të lehtësuar një mirëkuptim të përbashkët të Palëve për sa i përket përdorimit të Konventës dhe përgatiti draftin e këtij Protokoll. Procedurat për konsultimet e Palëve mbeten fleksibël dhe për këtë arsye mund të përshtaten nga Palët e këtij Protokoll sipas rastit, për të marrë parasysh nevojat që mund të lindin nga zbatimi i këtij Protokoll.

321. Ngjashëm me Konventën (shih paragrafin 327 të raportit shpjegues), konsultimet sipas nenit 23 duhet “të shqyrtojnë çështje që kanë lindur në përdorimin dhe zbatimin e Konventës, duke përfshirë efektet e deklaratave dhe rezervave të bëra”. Kjo mund të përfshijë konsultimet dhe vlerësimin e zbatimit të këtij Protokoll nga shtetet përbërëse ose subjekte të ngjashme territoriale të shteteve federale të njoftuara te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës sipas nenit 17, paragrafi 2 dhe që Palët që janë anëtare të BE-së të informojnë dhe të konsultohen me Palë të tjera të

këtij Protokoll për ligjet e zbatueshme të BE-së në lidhje me përdorimin e tyre dhe zbatimin e këtij Protokoll në lidhje me nenin 15, paragrafi 1.b. Përveç konsultimeve nëpërmjet T-CY sipas këtij neni, të diskutuara në paragrafin vijues, Palët mund të angazhohen në konsultime mbi baza dypalëshe. Për shtetet federale, këto konsultime dhe vlerësime do të kryheshin nëpërmjet qeverisë së tyre qendrore.

322. Paragrafi 2 i nenit 23 përcakton procedura specifike për rishikimin e përdorimit dhe zbatimit të Protokollit brenda kuadrit më të gjerë të vendosur nga neni 46 dhe T-CY i diskutuar më sipër. Paragrafi 2 parashikon që “Palët do të vlerësojnë periodikisht përdorimin dhe zbatimin efektiv të dispozitave të këtij Protokoll” dhe specifikon se neni 2 i Rregullave të Procedurës të vendosura nga T-CY, të rishikuara më 16 tetor 2020, do të rregullojë këto vlerësime. Këto procedura janë të disponueshme në faqen e internetit të T-CY. Për shkak se T-CY ka rishikuar disa dispozita të Konventës dhe ka nxjerrë raporte në përputhje me këto procedura, hartuesit çmuan se këto procedura të mirëpërcaktuara do të zbatohen *mutatis mutandis* për vlerësimin e dispozitave të këtij Protokoll.

Duke pasur parasysh detyrimet shtesë të ndërmarra nga Palët e këtij Protokoll dhe masat unike të bashkëpunimit që paraqet, hartuesit përcaktuan që këto vlerësime do t’i kryenin vetëm Palët e këtij Protokoll. Në funksion të ekspertizës përkatëse të nevojshme për vlerësimin e përdorimit dhe zbatimit të disa prej dispozitave të këtij Protokoll, duke përfshirë nenin 14 për mbrojtjen e të dhënave, Palët mund të marrin në konsideratë përfshirjen e ekspertëve të tyre të çështjes në vlerësime.

323. Ndërsa nga njëra anë, rregullat për vlerësime të tilla duhet të jenë të parashikueshme, përvoja aktuale mund të çojë në nevojën për të përshtatur këto procedura, pa kërkuar ndryshim zyrtar të këtij Protokoll sipas nenit 21. Si rrjedhojë, paragrafi 2 përcakton që rishikimi fillestar i procedurave do të kryhet pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Protokoll, pikë në të cilin Palët mund t’i ndryshojnë këto procedura me konsensus. Palët mund të ndryshojnë procedurat me konsensus në çdo moment pas atij shqyrtimi fillestar.

324. Duke pasur parasysh rëndësinë e garancive për mbrojtjen e të dhënave të përfshira në nenin



14, hartuesit çmuan se neni 14 duhet të vlerësohet sapo të ketë të dhëna të mjaftueshme të bashkëpunimit sipas këtij Protokolli, për të rishikuar në mënyrë efektive përdorimin dhe zbatimin e kësaj dispozite nga Palët. Si rrjedhojë, paragrafi 3 parashikon se vlerësimi i nenit 14 do të fillojë pasi dhjetë Palët e Konventës të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar detyrimit ligjor sipas këtij Protokolli.

Neni 24
Denoncimi

325. Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 24 janë të ngjashëm me ato të nenit 47 të Konventës dhe nuk kërkojnë shpjegime të mëtejshme. Paragrafi 3 përcakton se “Denoncimi i Konventës nga një Palë e këtij Protokolli përbën denoncim të këtij Protokolli”. Duke pasur parasysh theksin e këtij Protokolli mbi ndarjen e informacionit ose provave, të cilat mund të përfshijnë të dhëna personale, hartuesit e çmuan të kujdesshme të shtonin paragrafin 4 për të sqaruar se informacionet ose provat e transferuara para datës së hyrjes në fuqi të denoncimit, do të vijnë të trajtohen në përputhje me këtë Protokoll”

DEKRET
Nr. 13865, datë 25.10.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 71/2022, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e dytë shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik mbi bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 13866, datë 27.10.2022

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 6, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Blerina Ymer Zeneli (Kurpali)
2. Ridvan Mehmed Pulaj
3. Endrit Vegim Çeku
4. Arianit Ymer Kurpali
5. Edison Atim Ajazaj
6. Lorik Luan Spahiu
7. Mendim Shefqet Bardhoshi
8. Valon Bashkim Himaduna
9. Lea Dashnor Kabashi
10. Fadil Sadik Avdyli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 692, datë 26.10.2022

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
KOMBËTARE TË RINISË DHE PLANIT
TË VEPRIMIT 2022–2029

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022–2029, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rininë, ministrat e linjës dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**DRAFTSTRATEGJIA KOMBËTARE
E RINISË
2022–2029**

**QËLLIMI I PARË POLITIK I STRATE-
GJISË**

Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të

koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar.

**QËLLIMI I DYTË POLITIK I STRATE-
GJISË**

Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

**QËLLIMI I TRETË POLITIK I STRATE-
GJISË**

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social.

Tiranë, korrik 2022

Lista e shkurtimeve

AKCESK	Agjencia Kombëtare për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKKSHI	Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin
AKAFPK	Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë
AKR	Agjencia Kombëtare për Rininë
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
AMA	Autoriteti i Mediave Audio-vizuale
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla e Administratës Publike
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
AT	Asistencë teknike
BE	Bashkimi Evropian
GPN	Grup pune ndërmnistror
IPSIS	Sistemit Informatik i Planifikimit të Integruar
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KiE	Këshilli i Evropës
KM	Këshilli i Ministrave
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme



MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MISHMS	Ministri i Shtetit për Mbështetjen e Sipërmarrjes
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHRF	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
OJQ	Organizata joqeveritare
OZHQ	Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
RASH	Rrjeti Akademik Shqiptar
RYCO	Regional Youth Cooperation Office (Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor)
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (State Agency for Strategic Programming and Aid Coordination)
SKR	Strategjia Kombëtare e Rinisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TIK	Teknologjia e informacionit

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Qeveria e Shqipërisë e shikon situatën me të rinjtë si një mundësi për zhvillim dhe vënies e rinisë në qendër të zhvillimit. Pikërisht për këtë gjë u krijua një portofol ministri shteti përgjegjës për rininë dhe fëmijët. Kjo është vërtet një mundësi nëse bashkëpunimi ndërqeveritar, me pushtetin vendor, donatorët dhe palët e tjera vjen e rritet. Investimet e bëra tani do ta shtyjnë rininë e Shqipërisë përpara për të trajtuar me efektshmëri sfidat e zhvillimit. Investimet do të rrisin arsimin efektiv të nivelit dytësor, do të reduktojnë dhunën në shkollë, do të krijojnë mundësi për punësimin dhe do të reduktojnë abuzimin, shfrytëzimin dhe martesën e fëmijëve. Ato do të bëjnë të mundur që të realizohet potenciali i plotë i të rinjve. Kjo strategji dëshiron ta bëjë zhvillimin e të rinjve dhe të rejave një çështje për ata vetë dhe të krijojë mundësitë që me rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën e vendit ata të ndryshojnë pozitivisht jetën e tyre duke investuar në mënyrë më të efektshme në të ardhmen e tyre.

Sikurse cituar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024 (faqe 408), se: “*Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të*

synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zëjet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm etj. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029 do të jetë në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019–2027.”

Kjo strategji bazohet në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë” i cili siguron bazën ligjore për hartimin e politikave dhe programeve strategjike për rininë. Me urdhrin e datës 30.12.2021, të Kryeministrit të Shqipërisë, Sh.TZ, Edi Rama u ngrit edhe grupi ndërmintor i punës (GNP) për të hartuar këtë strategji.

Puna për këtë strategji filloi me një seri sesionesh konsultimesh me të reja dhe të rinj në të gjithë vendin në të cilat qeveria përfaqësohej nga Kryeministri dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Në këto sesione konsultimesh morën mbi 1200 të rinj. Takime konsultative u zhvilluan edhe me 45 organizata të ndryshme rinore si edhe me 61 përfaqësues të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Me ngritjen e GNP takimet konsultative të rregullta vijuan edhe me këtë grup.

Draftet e para të strategjisë u konsultuan edhe me një grup prej 200 të rinjsh të mbajtur në



Qytezën e Fëmijëve në Korçë në datat 19–20 mars 2022.

Politika kombëtare e strategjisë së rinisë dhe përpjekjet programuese përqendrohen në sigurimin e barazisë së mundësive dhe të drejtave, mbështetjes dhe angazhimit për të reja dhe të rinjtë që janë më të prekshëm, të marginalizuar dhe më të goditur nga mungesat e shumta, të tilla si varfëria, dhuna, keqtrajtimi, paaftësia dhe përjashtimi social. Kjo strategji synon të orientojë rininë shqiptare për veprim të mëtejshëm i cili ndikon pozitivisht në të ardhmen e tyre. Politikat që zhvillohen në kuadër të kësaj strategjie janë këto qëllime:

Të reja dhe të rinjtë marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërat e tyre

- Rritje e aftësive për punësimin e të rinjve, mbështetur nga shërbimet e këshillimit të karrierës dhe punësimit që janë të orientuara nga të rinjtë, rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të drejtësisë¹ dhe të shanseve të barabarta.

- Mirëqenie aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve

- Novacion dhe edukim cilësor për të mbështetur të rinjtë për të arritur potencialin e tyre të plotë

- Siguri, mbrojtje dhe gjithëpërfshirje e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo vulnerabiliteti.

- Politika ndërsektoriale rinore e koordinuar, e bazuar në fakte, me mekanizma të mirëfinancuar të ofrimit, monitorimit dhe vlerësimit horizontal dhe vertikal.

1.1 Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Programin e Qeverisë 2021–2025

Programi qeverisës 2021–25 e ka në qendër të vëmendjes rininë sepse e shikon zhvillimin e saj dhe rolin që ajo luan në zhvillimin e vendit të integruar në fushat kryesore të programit.

- Në aspektin e **zhvillimit ekonomik** programi qeveritar e vendos theksin te besimi që qeveria ka tek të rinjtë *si forca që do të përshpejtojë progresin drejt Shqipërisë së gjeneratës tjetër*, ndaj qëndron angazhimi për të siguruar *jo vetëm mundësi*

më të mira arsimimi në fushat prioritare si shkencat natyrore, teknologji e informacionit dhe inxhinieri, por mundësi reale për të qenë sipërmarrësit e ardhshëm në fushat e inovacionit e teknologjisë, për të konkurruar denjësisht në tregun global.

- Në procesin e krijimit të **një ekonomie të fortë të bazuar në modernizim, produktivitet dhe konkurrueshmëri** Shqipëria shihet si qendër rajonale për sipërmarrjet e reja në ekonominë digjitale duke siguruar punë dinjitoze për të rinjtë për të realizuar kështu një kthesë cilësore në punësimin rinor.

- Programi qeveritar në lidhje me zhvillimin e **shoqërisë së dijes** synon rindërtimin e sistemit arsimor për ta bërë atë më të aksesueshëm dhe me infrastrukturë moderne duke i nxitur të *rinjtë në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë, fusha që garantojnë jo vetëm një të ardhme të sigurt për ta, por edhe zhvillimin dhe konkurrueshmërinë e vendit*. Në arritjen e konkurrimit në realitetin global pritët që brezat e rinj të aftësohen *në gjuhë të huaja që në klasën e parë, në kodim, si dhe do të ndërkombëtarizojmë universitet tona në bashkëpunim me universitete simotra*. Në vizionin qeveritar për Shqipërinë 2030, të rinjtë nuk shihen vetëm përmes zhvillimit të infrastrukturës së shërbimeve për kujdesin dhe rritjen e tyre. Fokusi vendoset në zhvillimin e politikave të reja për shëndet më të mirë, edukim më cilësor dhe hapësira alternative që nxisin formimin dhe talentet e të rinjve.

- Në lidhje me **arsimin**, siç reflektohet edhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–26, zhvillimi i infrastrukturave të reja shkollore që erdhi edhe si rezultat i shkatërrimit të infrastrukturës nga tërmetet e vitit 2019 shoqërohet me një plan për zhvillim të sistemit arsimor që i jep të rinjve njohuri dhe dije konkurruese. Kjo pritët të arrihet me investimet në teknologji dhe infrastrukturë laboratorike, rritjen e vlerës së diplomave në tregun e punës, si dhe fuqizimin e institucioneve vendase të arsimit të lartë. Zinxhiri i arsimit pret rritje cilësore edhe duke bërë të detyrueshëm mësimin e gjuhës angleze nga klasa e parë fillore, hapjen e kurseve të kodimit dhe profilizimin e klasave sportive.

- Në fushën e **shëndetësisë** bërja funksionale e 10 qendrave model të mjekësisë familjare me shërbime të integruara socio-shëndetësore priten të kenë edhe shërbime specifike për të rinjtë.

¹ Termi “drejtësi” i referohet termit “equity” në gjuhën angleze.



- Me një program të ri mbështetës në **strehim** pritet që familjet e reja të trajtohen me 1 milion lekë mbështetje për pagesën fillestare dhe zbutjen e interesit për blerjen e shtëpisë. Kjo masë nuk e ndërpret programin e banesave sociale në bashkitë e mëdha të cilat do të shkojnë në 2000 në vit.

- Në procesin e zhvillimit të **biznesit të vogël** merr edhe më shumë vëmendje sipërmarrja e krijuar nga të rinjtë. Fondi i mbështetjes për sipërmarrjet e reja *start-up* pesëfishohet për të arritur në 10 milionë euro.

- Edhe në **zhvillimin e fshatit drejt turizmit rural** programi ka parashikuar paketa nxitëse për të rinjtë dhe gratë që do të përfshihen në këtë sektor.

1.2 Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Strategjinë e Rinisë së OKB-së dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

- Sot në botë ka 1,8 miliardë njerëz të moshës 10 deri në 24 vjeç duke qenë brezi më i madh i të rejave dhe të rinjve në histori. Rreth 90 për qind e tyre jetojnë në vendet në zhvillim, ku përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë. Numri i popullsisë brenda kësaj moshe pritet të shkojë në rreth 2 miliardë deri në vitin 2030, rreth 1,9 miliardë të rinj parashikohet të bëhen 15 vjeç². Të lidhur me njëri-tjetrin si kurrë më parë, të rinjtë duan dhe tashmë të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e komuniteteve të tyre, duke propozuar zgjidhje inovative, duke nxitur përparimin social dhe duke frymëzuar ndryshime politike. Ata janë gjithashtu agjentë të ndryshimit, duke u mobilizuar për të çuar përpara objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm për të përmirësuar jetën e njerëzve dhe shëndetin e planetit.

- **Strategjia e OKB-së për rininë 2030** mbështetet në *vizionin global të një bote ku të drejtat njerëzore të çdo të reje dhe të rinj bëhen realitet; ku sigurohet se çdo e re apo i ri fuqizohet për të arritur potencialin e vet të plotë; dhe që e njeh kapacitetin, qëndrueshmërinë dhe kontributet pozitive të të rinjve si agjentë të ndryshimit*³.

- Të pajisur me aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për të arritur potencialin e tyre, të

rinjtë mund të jenë një forcë shtytëse për mbështetjen e zhvillimit dhe kontributin për paqen dhe sigurinë. Organizatat e udhëhequra nga të rinjtë në bazë të zhvillimeve në këtë strategji pritet të inkurajohen dhe të fuqizohen për të marrë pjesë në përkthimin e Agjendës së vitit 2030 në politika vendore, kombëtare dhe rajonale. Me angazhimin politik dhe burimet e duhura, të rinjtë kanë potencialin për të bërë transformimin më të efektshëm të botës në një vend më të mirë për të gjithë.

- Nga perspektiva e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) është veçanërisht e rëndësishme të mos lihet asnjë i ri apo fëmijë mbrapa e pa zhvillim. OZHQ-të që lidhen drejtpërsëdrejti me të rinjtë dhe të rejtat dhe zhvillimin e tyre në këtë strategji janë:

- OZHQ 3 – shëndeti i mirë dhe mirëqenie. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për moshat e reja, veçanërisht në kushtet e të jetuarit me një pandemi si COVID-19, mbetet një objektiv i rëndësishëm global për t'u arritur.

- OZHQ 4 – arsim cilësor lidhet ngushtë me mundësitë më të mira për punësim dhe ngjitjen e shkallëve të larta në profesion duke lënë pas varfërinë. Edhe në këtë objektiv situata e pandemisë ka ndikuar drejtpërsëdrejti në uljen e numrit të fëmijëve që ndjekin shkollat duke vënë në rrezik arritjet e deri më tanishme në edukimin në mbarë botën.

- OZHQ 5 – barazia gjinore me zhvillimet që kanë ndodhur në Shqipëri tregon se ajo është një themel i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe paqësor. Kjo strategji përpaket ta shikojë këtë në çdo element të saj duke u përpjekur të nxisë masa për punësimin e të rejave dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna me bazë familjare. Njëkohësisht strategjia trajton edhe çështjet e mbështetjes së shprehjes së të rinjve në bazë të identiteteve të tyre gjinore dhe të drejtave për pakicat LGBTI.

- OZHQ 8 – punë dinjitoze dhe rritje ekonomike – objektiv i cili sfidon çdo qeveri të globit me situatën e krizës pandemike dhe ndikimit që ajo ka në jetën ekonomike të të rinjve. Marrja e masave për të siguruar punësimin e vazhdueshëm të të rinjve brenda vendit duke rritur mobilitetin rinor dhe punësimin jashtë qendrave urbane shikohet si prioritet në

² Për më shumë informacion shikoni këtë lidhje:

<https://www.un.org/sustainabledevelopment/youth/>

³ Për më shumë informacion në lidhje me strategjinë e

OKB-së 2030 shikoni: [18-00080 UN-Youth-](#)

[Strategy Web.pdf](#)



bashkëpunimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me ministrinë e linjës që sigurojnë punësimin.

- OZHQ 10 – zvogëlimi i pabarazive mbetet prioritet themelor për këtë strategji në kuadër të filozofisë së zhvillimit që nuk lë asnjë të re apo të ri pas duke i bërë ata pjesë integrale në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm me anë të përfshirjes së tyre në procese.

- OZHQ 11 – qytete dhe komunitete të qëndrueshme mund të quhen atëherë kur të rejtat dhe të rinjtë e ndërtojnë jetën aty dhe nuk shikojnë migrimin si brenda vendit apo jashtë si alternativë për zhvillim individual. Me rritjen e mundësive për punë, argëtim dhe angazhim social në nivel bashkiak dhe me hapësira të dedikuara për të rinjtë synohet të rritet qëndrueshmëria dhe zhvillimi urban dhe rural kudo nëpër vend.

- OZHQ 13 – veprimi për klimën në një situatë globale ku secili vit arrin rekorde më të larta të ngrohjes globale se tjetri dhe ku cilësia e ajrit dhe ujit është në ulje kërkon angazhimin e të rinjve dhe organizatave rinore për të sjellë ndryshim në qasjen globale kundrejt këtij fenomeni. Lufta në Ukrainë dhe situata pandemike e rrisin sfidën dhe vështirësinë për zhvillim në këtë fushë, por angazhimi në marrëveshje të gjelbra për punësim dhe zhvillim ekonomik shihen në këtë strategji si masa për të ndikuar edhe në këtë proces. Angazhimi i të rinjve në veprime për klimën mbetet përparësi.

- OZHQ 16 – paqe, drejtësi, institucione të forta përbëjnë thelbin e zhvillimit për punën me rininë duke siguruar që institucionet përgjegjëse për to, jo vetëm që ofrojnë shërbime cilësore kundrejt të rinjve, por njëkohësisht këto shërbime janë miqësore dhe të përshtatura për të rinjtë. Fuqizimi institucional i organizatave dhe vetë të rejtave dhe të rinjve, duke rritur edhe rolin e tyre në zhvillimin e një sistemi drejtësie efektiv shihet me përparësi në masat e kësaj strategjie.

- OZHQ 17 – partneritet për qëllimet siguron nivele të plota të bashkëpunimit si me OKB-në dhe rrjetin e organizatave të saj prezente në Shqipëri ashtu edhe partneritet në nivelin rajonal duke pasur për bazë bashkëpunimin rinor të bazuar në përvojën e fituar nga bashkëpunimi i ngritur në kuadër të RYCO.

Të rejtat dhe të rinjtë në të gjitha takimet konsultative me përfaqësues të qeverisë kanë cilësuar me forcë nevojën për rritjen e mundësive të tyre për më shumë punësim, këshillim për karrierë dhe zhvillimin e tyre profesional brenda vendit në përputhje me OZHQ 8. Ata janë të prirur dhe e shikojnë zhvillimin e tyre të lidhur me novacionin dhe edukimin cilësor dhe ruajtjen e zhvillimin e vendit dhe mjedisit duke i bërë këto kërkesa të lidhura me OZHQ 4 dhe 13. Të rejtat dhe të rinjtë nuk ndalen vetëm në kërkesat e tyre për mirëqenie e shëndet të mirë si fizik dhe mendor, por kërkojnë që të jenë të përfshirë në shoqëri e të mos përjashtohen nga zhvillimi. Kjo kërkesë e tyre lidhet me OZHQ 3, 10, 11 dhe 16. Ndërsa kërkesat e tyre për bashkëpunim e lëvizshmëri rinore mbështeten në OZHQ 17.

1.3 Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të Tyre Anëtare (MSA)

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit përbën një dokument udhëzues themelor për politikën që ndërmerr Shqipëria në përputhje me zhvillimin e procesit të integrimit evropian. Kapitulli V, që përmban dispozitave e përgjithshme me anë të nenit 77 që përcakton kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta orientojnë në strategjinë aspektet e punësimit të të rejtave dhe të rinjve dhe krijimin e kushteve që ata të gjejnë të ardhmen profesionale në Shqipëri.

Titulli VII i MSA-së që lidhet me lirinë, drejtësinë dhe sigurinë ndërthuret me qëllimet e kësaj strategjie në çdo aspekt, duke përfshirë:

- Nenin 78 që ka të bëjë me fuqizimin e institucioneve dhe shtetin e së drejtës në kuadër të fuqizimit të organizimit rinor, si edhe në mbështetjen e të rinjve për organizim të pavarur, vullnetarizëm, pjesëmarrje aktive në jetën social politike të vendit dhe mbrojtjen e tyre veçanërisht në situata rreziku apo kontakti me ligjin.

Titulli VIII i MSA-së që trajton politikën e bashkëpunimit ndërlidh strategjinë me disa prej sfidave më kryesore që kjo strategji përpiket të përmbushë si në kuadër të zhvillimit të të rinjve, por në angazhimin e tyre në proceset e integrimit evropian:



- Në kuadër të nenit 88 – Bashkëpunimi statistikor – është me rëndësi të zhvillohen statistika të zbërthyer për të rinjtë e të rejtat në nivele qarku apo bashkie për të krijuar mundësinë për bërjen e politikave të mirinformuara rinore. Prodhimi i statistikave do të krijonte edhe mundësinë për zhvillimin e studimeve rinore në institucionet akademike dhe kërkimore.

- Në kuadër të nenit 99 – Bashkëpunimi social – shikohet me rëndësi rritja e bashkëpunimit të organizatave rinore dhe të rinjve për të sjellë qëndrueshmëri sociale në komunitet ku ata jetojnë duke rritur mundësitë për gjithë përfshirje dhe mosdiskriminim.

- Në kuadër të nenit 100 – Arsimi dhe trajnimi – dhe në përputhje edhe me zhvillimet e parashikuara në strategjinë kombëtare për arsimin dhe atë për punësimin dhe trajnimin, roli i të rinjve për të përmirësuar arsimin, përfitimet për punësim prej tij dhe proceseve të aftësimit dhe shërbimeve të karrierës mbetet themelor në këtë strategji. Ajo i shikon këto procese të ndërthurura edhe me zhvillimet evropiane në mbështetje të rinisë siç është garancia rinore.

- Në kuadër të nenit 101 – Bashkëpunimi kulturor – strategjia ka parashikuar masa të atilla që jo vetëm rrisin bashkëpunimin kulturor me Evropën duke marrë si shembull edhe fitimin e titullit të Kryeqytetit Evropian të Rinisë për Tiranën, por edhe duke nxitur rritjen e cilësisë së aktiviteteve passhkollore duke zhvilluar angazhimin në arte dhe zeje dhe aktivitete sportive amator.

- Në kuadër të nenit 103 – Shoqëria e informacionit – kjo strategji synon digjitalizimin e shërbimeve të informacionit për të rinjtë në të gjithë vendin duke realizuar një minirevolucion në mënyrën se si të rinjtë i marrin informacionet për punësim, arsimim dhe argëtim e duke krijuar hapësira të sigurta digjitale për ta. Pajisja e të rinjve me njohuri kundër lajmeve të rreme dhe për të luftuar bulizimin kibernetik pritet të realizohen me masa në këtë strategji në bashkëpunim me AKSHI-n dhe organizma të tjerë.

- Në kuadër të nenit 109 – Bashkëpunimi në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik – strategjia parashikon hapa për zhvillimin e punësimit të bazuar në zhvillim teknologjik duke

krijuar mundësi për të rritur shkallën e njohurive të kodimit dhe teknologjive të informacionit në nivele masive e jo vetëm brenda shkollave. Si rezultat i bashkëpunimit shkencor pritet edhe zhvillimi i konceptit të “studimeve rinore” si fushë e veçantë e kërkimit shkencor.

- Në kuadër të nenit 110 – Zhvillimi rajonal dhe lokal – strategjia ndërton mbi zhvillimet që kanë ndodhur për bashkëpunimin rinor lokal si ai në kuadër të programit RYCO apo edhe me instalimin e nëpunësve të dedikuar për rininë në çdo bashki. Zhvillimi i këshillave vendorë rinorë po vazhdon në mbarë vendin dhe strategjia parashikon masa për të fuqizuar kapacitetet e këtyre këshillave për të rritur cilësinë e të rinjve në proceset politikëbërëse vendore.

- Në kuadër të nenit 111 – Administrata publike – strategjia ndërton mbi suksesin e programeve të stazheve për të rejtat dhe të rinjtë me rezultate të shkëlqyera në studime dhe programin kombëtar të praktikave të punësimit duke synuar një administratë publike që rinohet vazhdimisht.

1.4 Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Strategjinë e Rinisë të BE-së

Strategjia Evropiane e Rinisë bazohet në 11 qëllime për të rinjtë në Evropë të cilat u realizuan përmes një cikli dialogësh në vitet 2017-18. Bazuar në konceptin e dialogut me të rinjtë të kësaj strategjie u zhvilluan takimet konsultative mes të rejave dhe të rinjve dhe organizatave të tyre dhe përfaqësuesve të qeverisë. Si në takimet konsultative të BE-së ashtu edhe ato në Shqipëri, pikëpamjet e shprehura u bënë baza për të zhvilluar vizionin dhe bazën konceptuale të strategjisë. Strategjia e Rinisë së BE-së bazohet në këto 11 qëllime, të cilat janë jetësuar edhe në strategjinë kombëtare të Shqipërisë:

1. Lidhja e BE-së me rininë;
2. Barazia mes të gjitha gjinive;
3. Shoqëria gjithëpërfshirëse;
4. Dialog konstruktiv dhe shpërndarje informacionesh;
5. Shëndeti mendor dhe mirëqenia;
6. Nxitje dhe përparësi për rininë rurale;
7. Punësim cilësor për të gjithë;
8. Të mësuarit cilësor;
9. Hapësirë dhe pjesëmarrje për të gjithë;
10. Evropa e gjelbër dhe e qëndrueshme;



11. Organizatat rinore dhe programet rinore evropiane.

Është rënë dakord që Strategjia Evropiane e Rinisë duhet të kontribuojë në realizimin e këtij vizioni duke mobilizuar instrumente politikash në nivel evropian, si dhe veprimet në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor. Në strategjinë evropiane të rinisë fushat kyçe të sektorit rinor shprehen me tri folje: **angazhohu, lidhu dhe fuqizohu**.

1.5 Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Strategjinë e Rinisë së Këshillit të Evropës

Kjo strategji ka si qëllim të inkurajojë të rinjtë anëmbanë Evropës që aktivisht të mbështesin, mbrojnë, nxisin dhe përfitojnë nga vlerat thelbësore të Këshillit të Evropës të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Objektivat strategjikë të këtij dokumenti synojnë të rrisin angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve në proceset demokratike, forcimin e të drejtave të njeriut dhe në vendimmarrje⁴. Këto elemente përfshihen në strategjinë kombëtare me masa specifike që rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në jetën e komunitetit dhe në jetën politike të vendit. Këshilli i Evropës në dokumentin e tij strategjik për rininë ka synuar këto prioritetet tematike:

- rigjallërimi i demokracisë pluraliste;
- akses i të rinjve në të drejta;
- jetesa e përbashkët në shoqëri gjithëpërfshirëse;
- puna rinore.

1.6 Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Agjendën e Ballkanit Perëndimor për novacionin, kërkimin shkencor, arsimin, kulturën, rininë dhe sportet

Strategjia Kombëtare e Rinisë i bën jehonë edhe agjendës së Ballkanit Perëndimor⁵, e cila paraqet një strategji dhe kornizë afatgjatë të bashkëpunimit ekonomik duke dhënë njëkohësisht një vizion pozitiv dhe largpamës në veçanti për rininë.

1. Mbështetja e transformimit digjital;

⁴ Për më shumë informacione shikoni këtë faqe: [Result details \(coe.int\)](https://resultdetails.coe.int/)

⁵ Për më shumë informacion dhe për të lexuar agjendën klikoni: ec-rt-d-western-balkans-agenda-overview.pdf (europa.eu)

2. Nxitja e zbatimit të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe pesë shtyllat e saj;

3. Nxitja dhe mbështetja e qarkullimit të trurit në veçanti me diasporën e Ballkanit Perëndimor;

4. Ngritja e standardeve të larta të cilësisë së arsimit profesional evropian dhe trajnimit si referencë për zhvillimin e aftësive, duke përfshirë mikrokredencialet; të ushqejë shoqëritë e bazuara në njohuri.

1.7 Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZHI II)

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZHI II) është dokumenti themelor strategjik që kombinon agjendën e integritimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjia përcakton vizionin për Shqipërinë si “...demokraci në forcim, në rrugën e saj drejt integritimit në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme dhe me garanci për të drejtat themelore dhe liritë e njeriut”.

- Kjo strategji ka një pikë të veçantë, 11.9, e cila lidhet me fuqizimin e rinisë përballë këtyre sfidave:

- Nevojën për më shumë pushtet ekonomik rinor përmes programeve të nxitjes së punësimit, arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale;

- Nevojën për krijimin e hapësirave publike për t’iu shërbyer të rinjve;

- Fuqizimin e kapaciteteve të organizatave rinore;

- Krijimin e rrjeteve rinore, këshillave të qarqeve dhe komisioneve kombëtare të konsultimit për çështjet rinore; dhe

- Nevojën për rritjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në komunitet dhe programeve ndërrajonale.

- Kjo strategji paraqet si vizion: “Një rini aktive dhe me barazi në të gjitha fushat e jetës shoqërore, e shëndetshme, e arsimuar dhe me një status të konsoliduar në shoqëri”, duke u bazuar tek *aktivizimi i saj dhe barazja në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Rinia vizionohet si e shëndetshme, e arsimuar dhe me një status të konsoliduar në shoqëri*.

- Në këtë dokument parashtrihen edhe këta objektiva strategjikë:



- Mbështetja dhe integrimi i të rinjve në tregun e punës, si punëmarrës dhe sipërmarrës⁶;

- Nxitja dhe thellimi i pjesëmarrjes së të rinjve në shoqëri, vendimmarrje dhe mirëqenie⁷, dhe

- Forcimi i arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë në të gjitha nivelet dhe shtimi i mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës⁸.

- Të lidhura ngushtë me rininë janë edhe pjesë të tjera të kësaj strategjie shtyllat 2, 3 dhe 4 që kanë të bëjnë me rritjen ekonomike përmes konkurrueshmërisë dhe novacionit, investimin në kapital njerëzor dhe kohezionin social, si edhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029, së bashku me dokumentet strategjike shoqërues harmonizohet dhe është në përputhje të plotë me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e SKZHI-II sipas shtyllave 2 (Rritja ekonomike përmes rritjes së konkurrueshmërisë dhe novacionit) dhe shtyllës 3 (Investimi në kapital njerëzor dhe kohezion social).

1.8 Lidhja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2022–24

1.8.1 Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–24 thekson se: *ideja e hartimit të*

⁶ Kjo do të arrihet përmes: krijimit të Shërbimit Kombëtar Rinor, si një strukturë buxhetore nën ministrinë përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe aspekteve rinore; 2 krijimit të qendrave rajonale rinore, si njësi direkte të shërbimeve rinore; 3 ngritjes së “Inkubatorëve të biznesit për rininë” për rritjen e pjesëmarrjes rinore përmes hapësirave administrative që u sigurojnë sipërmarrësve të rinj hapësirat në zyra dhe objekte të tjera administrative; 4 krijimit të Trupave Kombëtare Rinore; dhe 5 mbledhjes dhe sigurimit të informacionit për programet që nxisin punësimin e të rinjve.

⁷ Kjo do të arrihet përmes: 1. rritjes së ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të kapaciteteve rinore dhe organizatave për programet komunitare; 2 mbështetjes së ofruar për mirëqenien rinore, duke u përqendruar te nxitja e shëndetit mendor dhe seksual, aktiviteti fizik dhe jeta e shëndetshme; 3 nxitjes së pjesëmarrjes së rinisë në organizatat e shoqërisë civile në të gjitha nivelet; dhe 4. krijimit dhe nxitjes së programeve të praktikave rinore.

⁸ Kjo do të arrihet përmes: 1. certifikimit dhe njohjes së arsimit jo-formal, si pjesë e të mësuarit gjatë gjithë jetës; 2 fushatave të ndërgjegjësimit për arsimin profesional të drejtuar drejt kërkesave të tregjeve të punës; dhe 3 ngritjes së zyrave të zhvillimit të karrierës, në shkollat e mesme apo në institucionet e arsimit të lartë, me qëllim orientimin e të rinjve drejt kërkesave të tregut të punës.

Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022–2029 vjen si një domosdoshmëri jo vetëm me miratimin e ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, por edhe për faktin se në dhjetor 2020 ka përfunduar “Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 – 2020”. Në këtë mënyrë ky plan e vendos si prioritet të tij rininë si edhe miratimin e kësaj strategjie brenda tremujorit të tretë të këtij viti. Me gjerësisht çështjet me rininë si grup i caktuar shoqëror me interesa dhe nevoja të veçanta trajtohen në kapitullin 26 (f. 400), kapitull i cili në tërësinë e vet përfshin çështje të rëndësishme për rininë siç janë arsimi dhe kultura.

Çështjet që kanë të bëjnë me rininë ky plan i shikon edhe në aspektin e bashkëpunimit dhe integritetit rajonal dhe tema si “Investimi të rinia në të ardhmen evropiane” kanë marrë prioritet në proceset e asociim-stabilizimit dhe integritetit me Bashkimin Evropian. Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 22.9.2021, “Rinia” tashmë është fushë e përgjegjësisë së ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për pasojë dhe puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë ka kaluar në këtë ministri.

Përveç trajtimit të çështjeve ikonike të rinisë që lidhen me përmirësimin e cilësisë në arsim, mundësitë praktike për të vënë në zbatim dijet e marra, këshillimin për karrierë dhe argëtimin larg veseve dhe praktikave jo të ligjshme, ky plan ka prerje me strategjinë edhe në këto fusha të tjera të veprimit të tij.

- Programi Kombëtar i Praktikave të Punës.

- Programin kombëtar “Edukimi për artet dhe zëjet në institucionet arsimore parauniversitare”.

1.8.2 Në kuadër të zhvillimeve në sektorin e drejtësisë vlen të theksohet lidhja me zbatimin e dokumentit strategjik “Strategjia e Drejtësisë për të Mitur”, i shoqëruar me Planin e Veprimit për periudhën afatgjatë 2018–2021, miratuar me VKM nr. 541, datë 19.9.2018. Risi e reformës së drejtësisë penale për të mitur janë dhe institucionet e reja, si Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), si dhe Instituti Multidisiplinor i të Miturve.

1.8.3 Në kuadër të zhvillimeve strategjike në lidhje me shëndetin mendor, SKR-ja lidhet me Planin e Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013–2022.

1.8.4 Në lidhje me çështjet e kujdesit shëndetësor parësor procesi i ofrimit të



shërbimeve socio-shëndetësore pranë qendrave shëndetësore ofron mundësinë për shërbime miqësore shëndetësore kundrejt të rejave dhe të rinjve. Sipas dokumentit strategjik janë planifikuar që brenda vitit 2024 të vihen në funksionim 10 qendra model të mjekësisë familjare, me shërbime të integruara socio-shëndetësore, me fokus kryesor problemet e shëndetit mendor, por edhe shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë dhe kujdesin paliativ.

1.8.5 Strategjia Kombëtare e Rinisë do të ketë pikëprerje edhe me dokumentin e ri të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore 2022–2030.

1.8.6 Në lidhje me **politikat e punësimit rinor** Strategjia Kombëtare e Rinisë lidhet me atë për Punësimi dhe Aftësi (NESS) 2019–2022 që ka si qëllim kryesor të identifikojë dhe hartojë politikatat e duhura për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës. Plani i veprimit përqendrohet në rritjen e mundësive për punë të denjë përmes politikave efikase të tregut të punës, sigurimit të arsimit dhe aftësimi cilësor të të rinjve dhe të rriturve, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, dhe forcimin e sistemit të qeverisjes së tregut të punës dhe kualifikimeve. 40 zyra punësimi janë organizuar dhe operojnë me modelin e ri të shërbimeve të punësimit në kuadër të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim. Strategjia rishikoi indikatorët deri në vitin 2022, sipas një baze të dhënash, në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT-in. Ka edhe një sërë programesh të reja të miratuara për nxitjen e punësimit, si:

- punësim i subvencionuar (ku janë përfshirë punëkërkuar të papunë nga grupet e veçanta si të rinjtë, gratë me fëmijë në ngarkim, PAK, romet emigrante etj.;

- trajnimit nëpërmjet punës praktika profesionale;

- pune publike në komunitet;

- vetëpunësim;

- programet COVID-19.

Strategjia Kombëtare e Rinisë pritet të jetë një dokument i drejtpeshuar nga pikëpamja gjinore. Në raste kur pabarazia gjinore është e dukshme me masat që parashikon fuqizon rolin e vajzave dhe grave të reja. Në këtë aspekt, kjo strategji lidhet me pjesën e planit kombëtar që trajton

çështjet gjinore sipas Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021–2030, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.6.2021. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë Strategji ndërthuren me masat dhe veprimet e parashikuara në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020–2025 të Bashkimit Evropian dhe në lidhje me rininë synon:

- Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të reja, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, personat me aftësi ndryshe, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.

- Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet (zonat rurale, minoritetet etnike, personat me aftësi ndryshe, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.

- Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Aplikimi i integritetit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

1.9 Përzgjedhja e politikës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë

Metodologjia e përcaktimit të masave prioritare

Për përcaktimin e masave prioritare në këtë strategji janë përdorur mekanizma që kanë lidhje me të rinjtë dhe nevojat e tyre prioritare. Në përcaktimin e masave janë marrë parasysh kategoritë e mëposhtme:

Mosha e të rinjve. Nga pikëpamja moshore masat e formuluar janë parë në lidhje me dhe përputhshmërinë me tri grupe moshore, të cilat përputhen edhe me ciklet e zhvillimit edukativo profesional si vijon:



- 15–18 vjeç: arsimi i mesëm i lartë ose arsim profesional;

- 19–24 vjeç: arsimi i lartë, zhvillim i mëtejshëm profesional ose punësim;

- 25–29 vjeç: arsim pasuniversitar ose punësim pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve.

Vajzat dhe gratë e reja. Nga pikëpamja e drejtësisë dhe barazisë gjinore masat janë formuluar duke marrë në konsideratë kushtet specifike për vajzat dhe gratë e reja për të përballuar më mirë sfidat e zhvillimit profesional dhe hyrjes në jetën familjare. Në të gjitha rastet, masat e parashikuara ndërlidhen me politikat nxitëse gjinore dhe i shërbejnë fuqizimit të vajzave dhe grave të reja duke marrë në konsideratë edhe vajzat e bëra nëna apo martuar në moshë të hershme dhe ato që gjenden në situata vulnerabiliteti. Nga pikëpamja gjinore masat e parashikuara synojnë edhe rritjen e pjesëmarrjes së vajzave si në jetën sociale ashtu edhe në atë profesionale.

Vulnerabiliteti. Në përputhje edhe me strategjitë ndërkombëtare për rininë, ata të rinj që janë në situata rreziku apo ndjehen të diskriminuar apo të përjashtuar për shkak të situatës ekonomike, gjinisë, orientimit seksual, përkatësisë etnike, prejardhjes etj. Në masat e parashikuara në këtë strategji janë marrë parasysh edhe të rinjtë në kontakt me ligjin për shkak të pjesëmarrjes në aktivitete të paligjshme apo situatave të trafikimit.

Numri i të rinjve. Me prioritet është shikuar edhe çështja e numrit të të rinjve që preken nga masat e parashikuara në strategji. Kështu masat që prekin shumicën e të rinjve janë me më shumë përparësi.

Talenti rinor. Përparësi i është kushtuar edhe rinisë së talentuar dhe nxitjes së talentëve në fushat që kanë të bëjnë me sportin, artin dhe kulturën. Masat prioritare përfshijnë rritjen e talentit dhe të aftësive së të rinjve përmes pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme.

Nxitja e pjesëmarrjes rinore. Element tjetër i rëndësishëm në përcaktimin e masave prioritare është pjesëmarrja dhe angazhimi i sa më shumë grupeve dhe organizatave rinore në to. E gjithë strategjia ka për synim rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve të jetën social ekonomike të vendit. Kjo do të arrihej në mënyrë më efektive përmes rritjes së

numrit të të rinjve aktivë nëpër organizatat rinore dhe vullnetarizëm.

Nxitja e punësimit rinor. Përparësi kanë marrë edhe masat që nxisin punësimin e të rinjve, zhvillimin e karrierës së tyre dhe zhvillimin e sipërmarrjes mes të rinjve duke qenë se papunësia mes të rinjve dhe të rejave vazhdon të mbetet e lartë ashtu si edhe numri i të rinjve që nuk janë të përfshirë në arsim, aftësimin apo punësim.

Parandalimi i rrjedhjes së trurit (*brain drain*). Masat janë renditur edhe në bazë të efektit që ato kanë mbi uljen e migrimit të parregullt dhe parandalimin e rrjedhjes së trurit. Masat që mbështesin të rinjtë që kthehen nga migrimi dhe duan të zhvillojnë idetë e tyre për sipërmarrje në Shqipëri kanë marrë më shumë përparësi.

Nxitja e novacionit. E lidhur me dy faktorët e mësipërm është edhe dhënia e përparësisë për masat që nxisin inovacionin si përmes mbështetjes së ideve të reja dhe *start-up* ashtu edhe zhvillimeve digjitale.

Roli udhëheqës i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Masat të cilat drejtohen apo koordinohen drejtpërsëdrejti nga ministria përgjegjëse për rininë dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë kanë marrë përparësi më të lartë në krahasim me masat e tjera.

Bashkëpunimi me ministri dhe agjenci të linjës. Po ashtu masat janë përparuar duke parë edhe nivelin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit me ministrinë apo agjencitë e tjera sepse në shumicën e masave janë ministrinë e tjera të linjës udhëheqëse të strategjive, por nevojitet bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për rininë në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e elementeve rinore në masat e parashikuara.

Si rezultat i analizës së lidhjes me këto dokumente të rëndësishme kombëtare, konsultimeve me të reja dhe të rinj dhe në përputhje me zhvillimet e pritshme në fushën e rinisë u vendos, që:

- *Strategjia është 7 vjeçare dhe mbulon periudhën 2022–29 për të dhënë mundësi për të shtrirë politikat rinore në të gjitha fushat e veprimt dhe për të bërë ndërhyrje kuptim-plote dhe strategjike me politikat për të rejtat dhe të rinjtë.*

- *Investimet madhore në mjedise rinore, argëtuese dhe sportive duke marrë në konsideratë një skenar realist në*



kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 shtrihen në të njëjtën periudhë me prirjen për të vazhduar edhe më tej.

- Strategjia ka një natyrë shumësektorëshe dhe ndërsektoriale:

- Për të arritur në stadin që është ajo është ushqyer nga informacione të mbledhura përmes takimeve me të rinj dhe të reja me pjesëmarrjen e Kryeministrit dhe ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;

- Janë marrë parasysh programi i ri politik i qeverisë; si edhe

- Është kryer një proces sinergjizimi me strategjitë që janë në përdorim dhe ato që janë në proces finalizimi e sipër.

- Strategjia shpjegon qëllimet dhe objektivat e politikave për rininë;

- Strategjia lidhet në natyrë dhe qëllime me strategjitë evropiane dhe globale për zhvillimin rinor.

Kostot e parashikuara në kuadër të kësaj strategjie arrijnë në shumën 5,570,086,793 lekë, ndërkohë që fondi për vitin 2022 për mbështetjen për rininë është 161,370,000 lekë ose 0.05% e buxhetit të 2022 dhe gjatë gjithë periudhës së vënies në zbatim (me financimin aktual dhe me rritje modeste) të strategjisë do të jetë 1,690,960,000 lekë. Kjo vlerë është 3.3 herë më e vogël se fondet që nevojiten për të realizuar me sukses të tre qëllimet e politikës dhe objektivat e tyre përkatës.

Në hartimin e kësaj strategjie nuk u morën parasysh opsione të tjera sepse opsi i një strategjie 8 vjeçare për këtë kategori të rëndësishme të shoqërisë jo vetëm që është në përputhje me kërkesat për strategjitë ndërsektoriale, por konsiderohet si më i përshtatshmi, duke marrë në konsideratë nevojën për ndërhyrje afatmesme dhe të qëndrueshme në këtë sektor dhe në përputhje me planet buxhetore në mbështetje të nismave të kësaj strategjie.

Në këtë dokument strategjik parashikohet në një formë gjithëpërfshirëse vizioni i strategjisë, qëllimet e politikave, objektivat specifikë për secilin qëllim, rezultatet e pritshme dhe masat e nevojshme për arritjen e secilit objektiv specifik. Dokumenti parashikon treguesit kryesorë të performancës, me qëllim matjen e arritjeve, metodave të koordinimit, monitorimit dhe raportimit, si edhe parashikon buxhetin e përgjithshëm të reformës.

Duke marrë në konsideratë natyrën ndërsektoriale të zhvillimit rinor dhe

pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm ministrish dhe institucionesh, ky dokument është konceptuar si një strategji ombrellë, e cila do të përmbajë kryesisht objektivat më të rëndësishëm dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj. Për të siguruar arritjen e objektivave specifikë, dokumenti strategjik plotësohet me planin e veprimit të hartuar me synimin për të zbërthyer në hollësi masat e detajuara që secili institucion do të ndërmarrë në përmbushje të secilit objektiv specifik të qëllimeve të politikës. Gjithashtu, Strategjia synon të fuqizojë koordinimin e politikave të komunikimit nëpërmjet rritjes së performancës dhe mekanizmave të menaxhimit të riskut.

Në zbatim të vendimit nr. 290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integrues (SIPI/IPSIS)”, procesi për Strategjinë Kombëtare të Rinisë nisi me hartimin e Koncept-Dokumentit të kësaj Strategjie, një dokument i konsultuar gjerësisht dhe i miratuar nga SASPAC në Kryeministri. Plani i Veprimit dhe buxhetet e detajuara janë punuar sipas sistemit IPSIS.

2. Korniza ligjore dhe institucionale

2.1 Kushtetuta

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon mbrojtje të veçantë për të rinjtë: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti”. Të drejtat e të rinjve garantojnë në kuadrin e të drejtave dhe lirive të njeriut që parashikon ky dokument themeltar i shtetit shqiptar.

2.2 Ligji për rininë

Ligji me numër 75 u miratua në vitin 2019 nga Kuvendi i Shqipërisë. Ligji specifikon në nenin 3/f se të rinjtë janë personat nga 15 deri në 29 vjeç. Ligji përcakton aktivitetet, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve si në Shqipëri dhe diasporë dhe rrit pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Ligji u miratua për të mbrojtur të drejtat e të rinjve dhe për të krijuar kushte për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre. Ky ligj prezanton disa koncepte të rëndësishme si:



- Edukim joformal për të rinjtë që lidhet me veprimtaritë jashtë sistemit të arsimit dhe të bazuar në vullnetarizëm e pjesëmarrje aktive;

- Dialog i strukturuar mes të rinjve, organizatave të tyre, organizatave që punojnë me ta dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore nga ana tjetër duke theksuar bashkëpunimin e bazuar në ndërveprim aktiv, sistematik, transparent, të vazhdueshëm dhe afatgjatë.

- Hapësira e sigurta rinore, por vetëm si hapësira fizike të sigurta për të rinjtë, përfshirë të rinjtë me aftësi të kufizuara, por pa kaluar në elementet digjitale apo të platformave sociale e qytetare të hapësirave të sigurta për të rinjtë.

Ligji e përkufizon “punën rinore” si “çdo veprimtari e natyrës sociale, kulturore, arsimore, mjedisore nga/me ose për të rinjtë, në grupe ose individualisht, që ka për qëllim të motivojë dhe të mbështesë të rinjtë, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi.”, por ai nuk përcakton kriteret për “punonjësin rinor apo drejtuesin rinor”.

Ligji parashtron krijimin e një baze ligjore për dy struktura konsultative rinore: Këshilli Kombëtar i Rinisë (KKR) dhe Këshilli Vendor i Rinisë (KVR) të cilat duhen fuqizuar dhe ngritur në ato bashki ku nuk ekzistojnë.

Ligji parashikon sigurimin e burimeve të financimit për politikën, programet dhe aktivitetet rinore, duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim, krahas buxhetit të shtetit. Në të njëjtën kohë, ai parashikon burime të tjera të ligjshme financimi, si të ardhurat e krijuara nga aktivitetet e organizatave rinore, donacionet, sponsorizimet, programet evropiane etj. Ligji parashikon ngritjen e këtyre strukturave organizative:

- Institucioni përgjegjës për rininë është Agjencia Kombëtare për Rininë (AKR) e krijuar me vendimin nr. 681, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave dhe zëvendëson Shërbimin Kombëtar Rinor (SHKR).

- Këshilli Kombëtar i Rinisë, një organ këshillimor që funksionon në kuadër të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe është përgjegjës për rininë. Vendimi nr. 969, datë 2.12.2020, i Këshillit të Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve

të Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe organizimin dhe funksionimin e tij.

- Këshilli Vendor i Rinisë është një organ këshillimor, i cili funksionon në varësi të kryetarit të bashkisë në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore.

- Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore (OKPR), që krijohet si OJF për të përfaqësuar të rinjtë në përputhje me vendimin nr. 274, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave.

2.3 Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR)

Në vitin 2015, qeveria miratoi PKVR 2015–2020. Vizioni i PKVR-së ishte në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015–2020, Programin e Qeverisë për Rininë, Strategjinë Kombëtare të BE-së për Rininë etj. PKVR-ja kishte gjashtë objektiva strategjike: i) Rritja dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes demokratike; ii) Rritja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës; iii) Shëndeti, sporti dhe mjedisi; iv) Edukimi i të rinjve; v) Mbrojtja sociale; dhe vi) Kultura dhe vullnetarizmi. Objektivat e përgjithshëm ndaheshin në njëzet e nëntë objektiva specifike dhe të cilët kishin 161 indikatorë të matshëm.

Në përfundim të këtij plani veprimi dhe bazuar në “Raportin final të vlerësimit të planit kombëtar të veprimit për rininë 2015–20”⁹ përgatitur nga MAS-i me mbështetjen e UNFPA-së rezulton se 40% e indikatorëve ishin realizuar plotësisht dhe 16% pjesërisht⁹. Në lidhje me secilin nga të gjashtë objektivat specifike vihet re:

- Për objektivin e parë “Rritja dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes demokratike” raporti i vlerësimit thekson se duhet të vazhdojë me tej forcimi i strukturave dhe kapaciteteve të organizatave rinore dhe e përfaqësimit të të rejave dhe të rinjve në proceset vendimmarrëse.

- Për objektivin e dytë “Rritja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës” vlerësimi thekson arritjet në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor për praktikën e

⁹ Kjo pjesë e strategjisë është bazuar në kapitullin V “Gjetje dhe rekomandime” të “Raportit Final i Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015–2020” botuar në qershor 2020 me mbështetjen e UNFPA-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.



punësimit dhe rritjen e nivelit të kualifikimeve profesionale të të rinjve në përputhje me zhvillimin e sistemeve të akreditimit. Nga ana tjetër fuqizimi i burimeve të informacionit mbi punësimin duhet zhvilluar dhe përmirësuar më tej.

- Për objektivin e tretë “Shëndeti, sporti dhe mjedisi” vlerësimi vë re se ka përmirësime si në kuadrin ligjor të politikave për mbrojtjen e shëndetit dhe të shtrirjes së edukimit shëndetësor në institucionet dhe kurrikulat e arsimit parauniversitar. Zhvillime ka pasur edhe në fushën e ndërgjegjësimit për ruajtjen e mjedisit. Edhe në këtë objektiv, përhapja e informacionit dhe planifikimi më i mirë dhe i shpërndarë gjatë gjithë vitit i aktiviteteve mbetet problematik.

- Për objektivin e katërt “Edukimi i të rinjve” vlerësimi thekson përmirësimet e kuadrit ligjor që i ka hapur rrugë reformave, por nga ana tjetër mbetet shumë për të bërë për integrimin e fëmijëve nga minoritetet. Digjitalizimi i proceseve mësimdhënëse e mësimnxënëse mbetet po ashtu problematik veçanërisht në lidhje me proceset e mësimi gjatë mbylljes pandemike.

- Për objektivin e pestë “Mbrojtja sociale” mbetet për t’u bërë shumë për krijimin e standardeve të kujdesit social për të gjitha llojet e subjekteve në lidhje me shërbimet për varësinë kundrejt drogave dhe të rinjve me HIV/AIDS. Aktivitet e ndërmarra në këtë fushë kërkojnë edhe më shumë

- Për objektivin e gjashtë “Kultura dhe vullnetarizmi” duket se ka qenë problem mungesa e një ligji që rregullon marrëdhëniet mes vullnetarëve dhe organizatave ofruese të vullnetarizmit.

- Të gjitha gjetjet e këtij vlerësimi, si edhe problemet që janë hasur në zbatimin e këtij plani janë marrë parasysh në hartimin e kësaj strategjie. Objektivat specifike të përmendur dhe analizuar më poshtë së bashku me masat dhe aktivitetet e parashikuara marrin në konsideratë problematikën e zhvilluar gjatë zbatimit të këtij plani dhe strategjia synon zgjidhje afatgjata si për problemet ashtu edhe në lidhje me zhvillimin rinor në përgjithësi.

2.4 Lidhja e SKR me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale

Ideja e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022–2029 vjen si një zhvillim jo vetëm

nga miratimi¹⁰ e ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, por edhe për faktin se në dhjetor 2020 ka përfunduar “Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015–2020”. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm etj. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029 do të jetë në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019–2027.

Në bazë të vendimit nr. 524, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Rinia” është fushë e përgjegjësisë së ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për pasojë dhe puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë ka kaluar në këtë ministri. Duke marrë parasysh kalimin e kompetencave nga MAS-i te ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka pasur disa ndryshime dhe vonesa në procesin e hartimit të strategjisë.

Në kuadër të hartimit të Strategjisë, u theksua se ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zhvilluar takime me nxënës përfaqësues të shkollave të arsimit të mesëm të lartë, të arsimit profesional, studentë nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, organizata për të rinj dhe përfaqësues nga institucione qendrore dhe vendore¹¹. Këto konsultime janë zhvilluar në të gjithë vendin gjatë periudhës tetor-dhjetor 2021, për të përfshirë të rinjtë në hartimin e kësaj strategjie. Në takimet e organizuara janë prekur tema shumë të rëndësishme dhe të ndjeshme për rininë që kishin të bënin me:

- Fuqizimin e jetës rinore në aktivitete dhe organizime të ndryshme;

- Rritjen e cilësisë në arsim dhe zhvillimin novativ të tij duke e vënë theksin te zhvillimi i

¹⁰ Neni 5 i këtij ligji përcakton në pikat a dhe g përcakton përgjegjësinë e ministrit të Shtetit për rininë për të hartuar dhe propozuar bazën ligjore dhe politika e veprimtari për rininë si edhe zhvillimin e konsultimeve me të rinjtë lidhur me politikat.

¹¹ Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, f. 407.



aftësive praktike e laboratorike, sipërmarrja, lidhja e arsimit universitar dhe atij profesional me tregun e punës, aftësive për jetën dhe të menduarin kritik;

- Fuqizimin e mekanizmave këshillues për punësim dhe karrierë dhe zhvillim profesional;

- Mirëqenie fizike dhe mendore bazuar në rritjen e mundësive për t'u marrë me sporte dhe aktivitete të tjera, si edhe mundësitë për këshillim psikologjik profesional për të përballuar streset e shkaktuara nga situata pandemike;

- Migrimi dhe roli i tij për rininë dhe zhvillimin e vendit;

- Punësim të denjë dhe domethënës në përputhje me interesat e të rinjve.

- Gjithashtu, SKR 2022–2029 është harmonizuar dhe reflekton qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në dokumentet/planet strategjike të këtyre ministrive në lidhje me zërat specifike në strategjitë e tyre që kanë të bëjnë me rininë.

- **Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–26** e miratuar me VKM nr. 659, datë 3.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026.

- **Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm** e cila ka 17 objektiva për zhvillim të qëndrueshëm të cilat ndërlidhen me politikat rimore dhe plane specifike në të paktën 20 elemente të këtyre objektivave.

- **Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–26** i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të plotë të të rinjve si brenda dhe jashtë shkollës duke krijuar mundësi për zhvillimin digjital në arsim dhe revolucionarizimin e orës së mësimi, por edhe duke ndërtuar masa specifike për aktivitetet pas mësimi. Një zhvillim i rëndësishëm ishte edhe “Pakti për Universitetin”, i njoftuar nga Kryeministri në dhjetor 2018, pas protestave masive të studentëve. Kjo përfshiu miratimin e 11 VKM dhe 4 urdhëresa ministrore për të adresuar 8 kërkesa të formuluara dhe kërkuara nga studentët gjatë protestës.

- Shqipëria ka edhe një **Strategji Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin** që nga fundi i vitit 2017 me synime specifike për angazhimin e të rinjve në proceset kërkimore shkencore dhe skemat e kërkimit shkencor në Evropë si Horizon 2020.

- **Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë** me një objektiv të veçantë për përmirësimin e drejtësisë për të mitur, e cila garanton një drejtësi miqësore ndaj të miturve, me qëllimin për të mbrojtur interesin e tyre më të lartë.

- Me **Strategjinë Antikorrupsion** synohet bashkëpunimi me organizatat rinore për monitorimin e masave antikorrupsion dhe ndërgjegjësimin kundër këtij fenomeni që në shkolla.

- **Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2021–26** ku theksohen zhvillimet në TIK dhe infrastrukturë digjitale për të mbështetur mësimin digjital dhe komunikimet elektronike dhe rritur cilësinë në arsim.

- **Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–22** ku përveç rritjes së cilësisë dhe ofertës së arsimit e formimit profesional hapen një sërë programesh që mbështesin e nxisin punësimin e të rinjve. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ndërton mbi arritjet dhe mësimet e nxjerra në periudhën 2014–2018 dhe përfshin një sërë masash të bazuara në katër prioritetet strategjike, të cilat konsiderohen të mbeten relevante për periudhën e ardhshme. Ajo synon një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që mbështetet tek “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për gjithë femrat dhe meshkujt”. Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi për gjithë femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë të gjithë ciklit të jetës. Ky qëllim do të arrihet me veprimtari politike koherente dhe të bashkërenduara, të cilat njëkohësisht i përgjigjen kërkesës dhe ofertës për punë, si dhe sjellin mënjanimin e hendeqeve të përfshirjes sociale.

- **Ligji për arsimin dhe formimin profesional** në Republikën e Shqipërisë po plotësohet me aktet nënligjore, shumica e akteve është miratuar dhe po përfundon miratimi dhe hartimi i akteve të mbetura. Qeveria së fundmi ka racionalizuar institucionet e AFP-së, duke krijuar Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe duke ristrukturuar më tej Agjencinë Kombëtare të AFP-së dhe Kualifikimeve. Në sistemin e AFP-së, tashmë është zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kualifikimeve profesionale, i cili mbështet



përshtatshmërinë e kualifikimeve në tregun e punës.

- Nga Ministria e Kulturës është hartuar **“Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025”** dhe miratuar me vendimin nr. 903, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën, 2019–2025”, dhe Plani i saj i Veprimit. Ky është dokumenti i parë i këtij lloji, me anë të cilit synohet konceptimi i një udhërrëfyese për zhvillimin e sektorit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore me qëllim të krijimit të kushteve të favorshme për zhvillim individual, social dhe shtetëror.

- **Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020–2023** synon që të luftojë pabarazitë socio-ekonomike, parashikimin e një sistemi që ka politikat dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegritit social alternuar me skemat e punësimit”.

- **Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025** ka për qëllim të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre, sipas parimeve të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjisë Evropiane për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Plani përmban qëllimin strategjik për sigurimin dhe ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

- **Plani Kombëtar i Veprimit për Integritimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025**, ka për synim heqjen e pengesave me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës, nëpërmjet integritit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor.

- **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021–2030** [15] është konceptuar si një udhërrëfyese drejt një shoqërie të mundësive të barabarta e pa dhunë, në të cilën: nevojat e grave dhe burrave merren në konsideratë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë; gratë respektohen, mbrohen, nxiten e mbështeten për të ecur përpara njëllor, si dhe

burrat; vajzat e djemtë, rriten të lumtur e të gëzuar mes parimeve të barazisë e mosdiskriminimit – pra një shoqëri, që ka në bazë një familje të shëndoshë, komunitet mbështetës dhe institucione të konsoliduara që zbatojnë legjislacionin dhe detyrimet e tyre me përgjegjshmëri.

- **Ligji për start-up**, i miratuar në 2022, krijon mundësi për të rinjtë dhe gratë e reja si në trajnime ashtu edhe në mbështetjen e ideve të tyre për biznes.

- **Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021–25** e ka në themel të saj bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse për rininë në çdo masë dhe aspekt të kësaj strategjie.

- Strategjitë që kanë një ndikim të rëndësishëm mbi rininë janë edhe dokumenti i Politikës së Përfshirjes Sociale, Planet Kombëtare të Veprimit për Romët dhe Egjiptianët, Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, si edhe plani veprimit për LGBTI që e sheh të integruar rininë në masat e parashikuara. Strategjia e shëndetit publik dhe atij mendor po ashtu kanë masa specifike të parapara për rininë.

- Me qëllim rritjen e shërbimeve të dedikuara dhe miqësore për rininë në Shqipëri në përputhje me standardet më të mira evropiane, ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka rakorduar në vijimësi punën për hartimin e kësaj Strategjie me kuadrin strategjik të të gjithë institucioneve të tjera.

2.5 Institucionet që merren me politika rinore të cilat janë ndërsektorale dhe përfshijnë shumë aktorë në procesin e zbatimit të tyre:

- Qeveria qendrore

- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët – është një institucion i krijuar me qeverinë e re të vitit 2021 dhe që ka peshën kryesore e themelore në organizmin dhe mbështetjen e rinisë. Ai është përgjegjës për politikën e përgjithshme rinore dhe kuadrin ligjor, monitorimin e zbatimit të politikave rinore dhe përfaqësimin e Qeverisë së Shqipërisë në nivel ndërkombëtar në lidhje me çështjet që lidhen me rininë.

- Ministria e Arsimit dhe Sportit deri në vitin 2021 ka pasur edhe portofolin e rinisë dhe ishte përgjegjëse e plotë për politikat rinore. Një zëvendësministër i përkushtuar për Rininë ishte pjesë jetike e kuadrit të përgjithshëm të politikave



për të rinjtë ndërsa Drejtoria për Rininë në kuadër të kësaj ministrie ishte përgjegjëse për çështjet që lidhen me politikën rinore. Kjo ministri vazhdon të ketë një rol të rëndësishëm në politika rinore sepse mban përgjegjësi për dy fusha të rëndësishme në jetën e të rinjve 15–29 vjeç, siç janë arsimi dhe sporti.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për mbështetjen e sipërmarrjes, AFP-në dhe inovacionin.

- Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për raportet e të miturve në konflikt me ligjin¹².

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MHSP) është përgjegjëse për shëndetin e të rinjve dhe përfshirjen sociale.

- Ministria e Kulturës është përgjegjëse për artin dhe politikën kulturore që synojnë edhe rininë.

- Organet e administratës shtetërore;

- Organet e vetëqeverisjes lokale;

- OJF-të;

- Parlamentet e studentëve/nxënësve dhe subjekteve të tjera juridike me qëllim të përmirësimit të statusit të të rinjve, zhvillimit të tyre personal dhe social, si dhe përfshirjes së tyre në çështjet sociale.

2.5.1 Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Bashkitë, sipas ligjit për rininë, kanë tashmë një punonjës të specializuar për çështjet rinore. Ato po ashtu, në varësi të madhësisë së tyre, zakonisht kanë një Drejtor ose Njësi për Shërbimet Sociale, ku përfshihen përgjegjësitë për çështjet që lidhen me rininë. Në nivel lokal, qendrat rinore janë një platformë thelbësore për fuqizimin e të rinjve. Qendrat rajonale rinore ekzistojnë në Korçë, Shkodër dhe Vlorë. Qendrat rinore deri më sot funksionojnë kryesisht si mjedise për organizimin e eventeve të projekteve nga OJF-të, e jo si platforma për pjesëmarrje aktive të të rinjve.

¹². **Shënim shpjegues:** Në përputhje me Kodin e Drejtësisë penale për të mitur, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për të miturit në konflikt me ligjin penal – pra, jo çdo raporti i të miturve me ligjin është përgjegjësi e MD, por vetëm kur të miturit kryejnë vepra penale. Në këtë kuadër, përgjegjësia e MD-së shtrihet me marrjen e masave për promovimin e riintegritimit të të miturit në konflikt me ligjin penal dhe që i mituri të luajë në shoqëri një rol sa më të dobishëm apo edhe garantimin e rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit që ka kryer vepër penale

2.5.2 Organizatat jofitimprurëse rinore dhe OJF-të e tjera që punojnë me të rinjtë janë aktorë thelbësorë në terren dhe ato shpesh shërbejnë për të mbushur boshllëkun në çështjet e të rinjve që nuk mbulohen nga institucionet publike. Ligji për rininë bën dallimin ndërmjet “organizatave rinore” dhe “organizatave për të rinjtë”. Ligji për rininë i përkufizon organizatat rinore si “persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për OJF-të, objekt aktiviteti i të cilave është përfaqësimi, mbrojtja dhe zhvillimi i interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse”. Ndërsa organizatat për të rinjtë janë “persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për OJF-të, të cilat në fushën e tyre të veprimtarisë synojnë gjithashtu mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve dhe që kanë përvojë në zbatimin e programeve me ndikim tek të rinjtë.”

2.6 Zhvillimi i një strategjie kombëtare për rininë në lidhje me garancinë rinore të BE-së

Në kuadër të kapitullit 19, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është në procesin e hartimit të një skeme për Garancinë Rinore (*Youth Guarantee*) në Shqipëri. Garancia rinore është një angazhim nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE, për të siguruar që të gjithë të rinjtë nën moshën 29 vjeç marrin një ofertë cilësore brenda një periudhe katër mujore të regjistrimit si punëkërkues të papunë ose të braktisjes së arsimit formal, për programet e mëposhtme:

- punësim;

- edukim të vazhdueshëm (*continued education*);

- mësim profesional (*apprenticeship*);

- trajnim profesional.

Të gjitha vendet e BE-së, janë angazhuar për zbatimin e garancisë rinore në zbatim të Rekomandimit të Këshillit (prill 2013). Nevoja për një program të tillë në BE erdhi për arsye të rritjes së papunësisë rinore dhe sidomos të atyre që u përkasin grupit të rinj as në punësim, arsim apo aftësim APAA¹³ (*NEET not in employment, education or training*). Kjo iniciativë e BE-së, po shtrihet në të gjithë vendet e Ballkanit

¹³ APAA – as në punësim, arsim apo aftësim (*NEET not in employment, education, or training*).



Perëndimor, ku bën pjesë dhe Shqipëria. Si në të gjitha vendet e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor edhe në Shqipëri arsyeja e prezantimit të këtij programi është, mbështetja e APAA, pasi shkalla e APAA për Shqipërinë më 2020 ishte 27.9, nga 26.6 në 2019 (INSTAT), më shumë se dyfishi i mesatares së BE-27 (12.6%). Në këtë grup, 36.5% janë klasifikuar si të papunë (INSTAT 2020). Vetëm rreth 18,000 të rinj APAA – nga gjithsej mbi 190,000 – janë regjistruar në zyrat e punësimit dhe mbulimi i nevojave duhet të shtrihet përtej këtij grupi, që përfaqëson më pak se 10% të të rinjve APAA.

Garancia rinore në Shqipëri do të bazohet në një grup pune ndërinstitucional dhe të një grupi teknik për hartimin e planit kombëtar të garancisë rinore, si dhe përcaktimin e koordinatorit kombëtar. Këto grupe pune do të veprojnë sipas udhëzuesit të Bashkimit Evropian për “Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor – udhëzime për garancitë rinore” dhe do të jenë përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Garancisë Rinore.

Hartimi i skemës së garancisë rinore është parashikuar në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022. Ky proces është duke u mbështetur dhe nga BE-ja, ILO dhe do të përfshijë pra, dy grupe pune në nivel politik dhe teknik, të përbërë nga institucione shqiptare siç janë Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, por dhe institucione të tjera, siç janë: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Rinisë etj. Në këto dy grupe pune do të ketë përfaqësues të partnereve sociale, përfaqësues të organizatave të të rinjve, pushtetit vendor etj.

Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe në përbërje të tij ka përfaqësues nga Kryeministria, ministrinë e linjës, nga institucionet e varësisë, shoqëria civile dhe përfaqësues të organizatave ombrellë rinore të përmendura më sipër. Grupi ndërinstitucional i punës është përgjegjës për dhënien e udhëzimeve dhe mbikëqyrjes së

procesit të hartimit të skemës së garancisë rinore në Shqipëri, shqyrton Planin Kombëtar të Garancisë Rinore dhe e monitoron atë.

3. Deklarata e vizionit

3.1 Vizioni

Duke marrë në konsideratë zhvillimet e deritanishme vizioni për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, është:

Strategjisë kombëtare 2022–2029 ju jep mundësi dhe mbështet të rejat dhe të rinjtë për t’u bërë partnerë aktivë në zhvillimin e Shqipërisë.

Misioni i kësaj strategjie është:

Rritja dhe përmirësimi i mundësive, shërbimeve dhe mbështetjes për të rinjtë dhe në bashkëpunim me të rinjtë në Shqipëri

Kjo strategji bazohet në parimet e mëposhtme:

- Mbështetje për të gjithë të rinjtë për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë, duke marrë parasysh të drejtat e tyre, zërat dhe nevojat e tyre të ndryshme, duke mos lënë askënd pas.

- Qasje e bashkërenduar për ofrimin dhe shpërndarjen e shërbimeve për të rinjtë, bazuar në dialogun ndërministror/ndërsektorial dhe shumëpalësh, me fokus të veçantë në zonat rurale, vajzat e reja dhe grupet e marginalizuara të të rinjve.

- Monitorim dhe vlerësim i orientuar drejt nxjerrjes së mësimave.

- Të rinjtë si partnerë kyç në zhvillim si në nivel kombëtar dhe atë vendor.

- Pjesëmarrja domethënëse e të rinjve në vendimmarrjen lokale dhe kombëtare, në organizatat rinore dhe jetën e komunitetit.

- Krijimi i politikave rinore të bazuara në të dhëna dokumentare e statistikore të mbështetura me buxhet specifik të dedikuar për të rinjtë dhe dispozita të tjera buxhetore sektoriale.

Vizioni synohet të jetësohet përmes 3 qëllimeve të politikës:

- **Qëllimi i politikës 1:** Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t’u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar.

- **Qëllimi i politikës 2:** Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes



edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

- **Qëllimi i politikës 3:** Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve

në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Lidhja midis vizionit, qëllimeve të politikës, objektivave specifike dhe rezultateve paraqitet në figurat më poshtë:




Figura 1: Lidhja mes vizionit dhe qëllimit të politikave të SKR-së



Figura 2: Lidhja mes qëllimeve të politikave dhe objektivave specifike të SKR-së

3.2 Treguesit kyç të performancës

Tabela 1. Treguesit kyç të performancës për SKR 2022-29

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Institucioni përgjegjës	Baseline 2021	Target 2029
Nivel i lartë/ Impakti	Indeksi botëror i zhvillimit të rinisë	E lidhur me tri qëllimet	Tregues në nivel botëror/ CommonWealth	0.764 Vendi 55 nga 181	0.8 Vendi 35
Rezultati	Indeksi i Progresit të të Rinjve	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Forumi Evropian i të Rinjve	68.49/100 Vendi 64/163	55/100 Vendi 50
Ndikimi	% e të rinjve që raportojnë se ndihen të përfaqësuar në politikat rinore të zbatuara në nivel qendror/vendor	Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore “Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar”	MSHRF	20%	80%



Rezultati	% e buxhetit të shtetit dedikuar për programet mbi rininë	Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore “Të reja dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t’u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar”	MSHRF/ MFE/ AKR	0.05%	2.4%
------------------	---	--	-----------------	-------	------

PJESA II. QËLLIMET E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SKR 2022–2029

Qëllimi i politikës 1: Të reja dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t’u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar.

Përmes fuqizimit, organizimit rinor dhe rritjes së pjesëmarrjes rinore kjo politikë, synon të arrijë tre objektivat e mëposhtëm:

Objektivi specifik 1.1: Të rinjtë janë të mirëinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike;

Objektivi specifik 1.2: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë;

Objektivi specifik 1.3: Studimet rinore dhe të dhënat për rininë nxiten të zhvillohen dhe të bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.

Institucionet drejtuese

MSHRF, AKR

Institucioni pjesëmarrës

MEF, MAS, INSTAT, AKSHI, AKPA, KQZ, AKAAPK, IAL

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e veprimit të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) dhe MSA-së.

Qëllimi i politikës nr. 1: synon ngritjen dhe bërjen funksionale të një sistemi të plotë

mbështetës dhe organizativ për rininë në të gjithë vendin duke ju krijuar mundësi të rinjve dhe të rejave të shprehen dhe të kontribuojnë efektivisht në jetën dhe zhvillimin e komuniteteve të tyre. Ky qëllim i politikës lidhet me OZHQ-të 5, 11, 13 dhe 16, të cilat promovojnë një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Duke e vënë theksin te rritja e pjesëmarrjes së të rejave në proceset zgjedhore kjo politikë nxit barazinë gjinore. Nga ana tjetër me ndërgjegjësimin e rinjve për vullnetarizëm synohet të rritet veprimi i të rejave dhe të rinjve për klimën.

Kjo politikë ka lidhje edhe me PKIE 2022–24, veçanërisht, në masat që ka parashikuar qeveria për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës që në kuadër të kësaj strategjie përkthehet në forcimin e organizatave rinore, rrjetëzimin e tyre dhe lehtësimin e kushteve për të krijuar organizata rinore.

Në lidhjet me MSA-në kjo politikë lidhet drejtpërsëdrejti me titullin VII që trajton çështjet e lirisë, drejtësisë dhe sigurisë, si edhe me nenin 78 kur zhvillon masa për fuqizimin e institucioneve rinore, nenin 99 në kuadër të masave për bashkëpunimin mes organizatave rinore për të përmirësuar komunitetet dhe rritur përfshirjen, si edhe nenin 111 në lidhje me masat e forcimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë për të zbatuar politikatat rinore, si edhe në krijimin e një fryme miqësore kundrejt të rejave dhe të rinjve në kontaktet e tyre me administratën.

Objektivat e kësaj strategjie përputhen edhe me SKZHI-në në arritjet e objektivit strategjik të paraqitur në këtë dokument në lidhje me rininë që synon nxitjen dhe thellimin e pjesëmarrjes së të rinjve në shoqëri e vendimmarrje.

Treguesit e rezultateve për qëllimin e politikës 1 janë përcaktuar në tabelën e mëposhtme:



Tabela 2: Treguesit e rezultateve për qëllimin e politikës 1

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	% e bashkive ku janë ngritur qendrat rinore multifunktionale	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/ AKR
Rezultati	Numri/përqindja i/e bashkive që kanë ngritur kënde digjitale të informimit rinor (info-points)	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF/ AKR/ Bashki
Rezultati	Numri i këshillave vendorë të ngritur dhe funksionale (në nivel bashkie)	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/ AKR/ Bashki
Rezultati	Ligji “Për rininë” i rishikuar dhe miratuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF
Rezultati	Ligji “Për Vullnetarizmin” i rishikuar dhe miratuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/AK PA/MFE
Rezultati	Platforma rinore “Të rinjtë për të rinjtë” e ngritur, funksionale dhe e përditësuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u	Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin	MSHRF/ AKR



		shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	
Rezultati	Politikat zhvillimore rinore të hartuara bazuar në analizë	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore. Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Studimet rinore dhe të dhënat për rininë nxiten të zhvillohen dhe të bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	MSHRF/ AKR

*Matrica e qëllimit të politikave, objektivat specifike dhe indikatorët janë dhënë në aneksin 3 të Planit të Veprimit.

Objekti specifik 1.1:

Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike

Analiza e situatës dhe sfidat

Në të gjitha takimet konsultative që janë bërë nga përfaqësuesit e qeverisë me të rinj në kuadër të zhvillimit të kësaj strategjie, mungesa e informacioneve të përditësuara dhe saktësia e tyre kanë dalë në plan të parë. Të rinjtë janë po ashtu të paorientuar se ku mund të kërkojnë informacione për t'u zhvilluar më tej apo fituar përvojë profesionale e vullnetare si për burimet digjitale online ashtu edhe për informacionet që duhet të ndahen në mjediset e tyre, si: shkolla, vendet e punës apo vendet e argëtimit.

Në zbatim të ligjit për rininë janë emëruar nëpunësit rinorë nëpër të gjitha bashkitë, por këshillat vendorë rinorë nuk janë efektive në të gjitha bashkitë. Organizimi rinor, veçanërisht jashtë kryeqytetit dhe jashtë organizimeve shkollore nuk i përgjigjet situatave dhe sfidave që kalojnë të rinjtë. Organizimi rinor në kuadër të organizatave joqeveritare është gjithashtu i vështirë për t'u realizuar për shkak të pagesave të larta që e shoqërojnë regjistrimin e një organizate joqeveritare dhe mungesës së përvojës nga ana e të rinjve në këtë proces. Edhe organizimet rinore në shkolla janë kryesisht formale dhe nuk i fuqizojnë të rinjtë.

Në këtë situatë, është parë me përparësi, rishikimi i ligjit të rinisë në tërësinë e tij dhe në veçanti për të rritur rolin e të rinjve në

përmirësimin dhe zhvillimin e jetës në komunitet dhe për t'i bërë të rejtat dhe të rinjtë aktivë në ndërmarrjen e politikave rinore vendore. Shembujt e mirë të analizës së pjesëmarrjes së të rinjve në proceset buxhetore dhe vendime të tjera vendore në bashkitë: Cërrik, Korçë, Fier, Përmet, Durrës, Roskovec, Belsh, Shijak, Dimal, Krujë dhe Pogradec, duhen shtrirë në të gjithë vendin¹⁴.

Takimet me të rinjtë kanë nxjerrë në pah edhe nevojën për një komunikim më efektiv me ta në platformat e komunikimit që përdoren më së shumti prej tyre. Konceptet e komunikimit digjital me të rinjtë si për të informuar ata për mundësitë për përfshirje, vullnetarizëm apo punësim apo edhe për të krijuar rrjete të përbashkëta komunikimi mes tyre duhen rishikuar. Kërkohej zhvillimi apo rikonceptimi i faqes “rinia.al” për të fuqizuar komunikimin mes të rinjve dhe për të lidhur të gjitha platformat dhe nismat rinore që ekzistojnë.

Jo vetëm infrastruktura digjitale, por edhe ajo fizike në shërbim të të rinjve mbetet problematike dhe sfiduese. Me përjashtim të një numri të paktë të qendrave rinore kërkohej shtimi i tyre në të gjithë vendin dhe mundësisht në nivel bashkie, duke krijuar hapësira të përshtatshme për të rinjtë. Sigurimi i infrastrukturës për aktivitete rinore do të rriste dhe promovonte veprimtarinë rinore dhe do të siguronte një bazë për zhvillime të mëtejshme për rininë si në çështjet e ndërgjegjësimit të tyre politik, vetëshprehjes dhe promovimit e zhvillimit të punës rinore.

¹⁴ Informacion bazuar në analizat e pjesëmarrjes së të rinjve në buxhetim në nivel vendor realizuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve mbështetur nga OKB në Shqipëri.

Institucionet drejtuese

MSHRF, AKR, MAS

Institucionet pjesëmarrëse

MFE, AKAFPK, AKPA, njësitë e vetëqeverisjes vendore, KQZ,

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e veprimit të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit

Objekti i specifik 1.1 synon aktivizimin e të rinjve në jetën social-ekonomike të vendit përmes informimit më të mirë të tyre për zhvillimet dhe

duke i bërë ata pjesë aktive të proceseve të informimit dhe pjesëmarrjes në jetën social-politike të vendit. Ky objektivi lidhet me nenin 100 që trajton çështjet e arsimit dhe trajnimit të të rinjve sepse synon aftësimin e të rinjve për të marrë informacionet në lidhje me punësimin, aftësimin dhe edukimin përmes burimeve digjitale të informacionit. Po ashtu ky objektivi lidhet edhe me nenin 77 të kapitullit të V në diskutimet e punësimit për të rejtat dhe të rinjtë si edhe me nenin 103 që lidhet me shoqërinë e informacionit pasi ky objektivi synon digjitalizimin e proceseve të shkëmbimit të informacioneve që i duhen të rinjve për zhvillimin e tyre profesional dhe shoqëror.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 3: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 1.1

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	% e bashkive ku janë ngritur qendrat rinore multifunktionale	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/ AKR
Rezultati	Numri i këshillave vendorë të ngritur dhe funksionale (në nivel bashkie)	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/ AKR/ Bashki
Rezultati	Ligji “Për Rininë” i rishikuar dhe miratuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF



Rezultati	Ligji “Për vullnetarizmin” i rishikuar dhe miratuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t’u shprehur me zërin e tyre. Politikë ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF/AK PA/MFE
------------------	---	--	---	-----------------

Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.1

Tabela 4: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 1.1

Nr. i masës	Masa sipas objektivit specifik 1.1
1.1.1	Rishikohet ligji për rininë për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej proceset e krijimit të organizatave rinore, përfaqësimit rinor, punën rinore ¹⁵ dhe ofrimin e shërbimeve të pranueshme e miqësore për të rinjtë.
1.1.2	Forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje.
1.1.3	Përmes platformës rinore “Të rinjtë për të rinjtë” dhe formave të tjera të komunikimit social shpërndahen informacione dhe udhëzues për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.
1.1.4	AKR-ja mbështet me anë të një programi grantesh organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes ngritjes së infrastrukturës për qendra rinore dhe hapësira për të rinjtë.
1.1.5	Nxitet zhvillimi i një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë nxënësit dhe mbështetet aktivizimi i Këshillave Studentore / Qeverive të Nxënësve dhe organizimeve të tjera të nxënësve ¹⁶ .
1.1.6	Rritet ndërgjegjësimi politik i të rinjve dhe në veçanti i vajzave dhe grave të reja, nëpërmjet promovimit të programeve të edukimit të votuesve dhe nismave të tjera ndërgjegjëse.
1.1.7	Promovohet dhe mbështetet e drejta e të rejave dhe të rinjve për barazi dhe gjithëpërfshirje për vetë-shprehje në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor.
1.1.8	Rishikohet ligji “Për vullnetarizmin” me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të rejave/rinjve.
1.1.9	Në përputhje me ligjet dhe VKM për njohjen e përvojës së punës dhe mësimit informal dhe joformal njihen kompetencat e fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore bazuar në përcaktimet e profesioneve të punës së të rinjve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe në bashkërendim me Portofolin Evropian të Punës Rinore (European Youth Work Portfolio).

Detajimi i plotë e masave është dhënë në planin e veprimit IPSIS

¹⁵ (punën në organizata rinore dhe në organizata të tjera nga të rinjtë)

¹⁶ në përputhje me nenin 36 të ligjit për arsimin parauniversitar



Objektivi specifik 1.2:

Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.

Analiza e situatës dhe sfidat

Ligji për rininë i vitit 2019, parashikonte edhe zhvillimin e një institucioni i cili do të ishte përgjegjës për zbatimin e politikave rinore. Ky institucion është Agjencia Kombëtare Rinore, aktiviteti i së cilës rregullohet si me ligjin për rininë ashtu edhe me një grup vendimesh qeveritare (VKM). Aktualisht ky institucion bën zbatimin e politikave rinore dhe menaxhon proceset e dhënies së granteve për organizatat rinore. Më 2022-n, buxheti i AKR-së është 211370 mijë lekë, dhe përfaqëson pak më shumë se 0.05% të buxhetit të shtetit të këtij viti. AKR, për t'iu përgjigjur sfidave të zhvillimit rinor dhe për të nxitur zbatimin e politikave me të reja të rinjve në qendër të tyre duhet fuqizuar si me personel ashtu edhe me fonde.

Sipas raportit me zbatimin e politikave të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015–2020 e kanë lidhur shkallën e realizimit të këtij plani që shkon deri në masën 40% edhe me mungesën e burimeve njerëzore për rininë¹⁷. Fuqizimi i burimeve njerëzore dhe fuqizimi i organizatave rinore do të rriste edhe përfaqësimin më cilësor të rinisë në rajon e më gjerë duke ndërtuar edhe mbi përvojat pozitive të zbatimit të politikave të programit “Tirana – kryeqyteti evropian i rinisë” dhe mbi mbështetjen e dhënë për këtë program nga qeveria.

Lidhur ngushtë me këtë gjë është edhe zhvillimi i kapaciteteve në administratën publike për t'u marrë me politikën rinore si nëpër ministrinë e linjës ashtu edhe në nivel vendor. Forcimi i kapaciteteve brenda administratës për t'iu përgjigjur kërkesave të të reja dhe të rinjve me zbatim politikash për ta duke siguruar edhe shërbime miqësore kundrejt tyre mbetet ende një sfidë edhe pse ekziston nisma

që një e treta e vendeve të punës në administratën publike duhet të përmbushen nga të rinjtë.

Edhe pse janë bërë hapa të mëdha përpara për angazhimin e të reja dhe të reja pranë proceseve politikëbërëse si me anë të stazheve profesionale apo kontratave të punësimit¹⁸ çështjet e marrjes dhe dhënies së informacioneve në lidhje me programet e punësimit apo nxitjes së punësimit mbeten problematike. Kjo në një kohë kur qeveria ka marrë një sërë masash dhe politikash për të nxitur punësimin dhe inovacionin mes të reja dhe të rinjve, politika që nga të rinjtë dhe të reja që morën pjesë në konsultimet e bëra me ta në kuadër të kësaj strategjie nuk njiheshin.

Institucione drejtuese

MSHRF, AKR,

Institucionet pjesëmarrëse

MFE, ministrinë e linjës

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e veprimit të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me MSA-në.

Objektivi specifik 1.2 synon fuqizimin e organizimit të administratës rinore që merret me rininë – Agjencinë Kombëtare të Rinisë më specifikisht për t'iu përgjigjur zhvillimeve të vullshme dhe sfidave të kohës. E parë nga ky këndvështrim, ky objektivi specifik lidhet drejtpërsëdrejti me titullin VII të MSA, neni 78 i cili fokusohet në forcimin e institucioneve publike dhe në këtë rast lidhet me forcimin e organizimit të rinisë brenda administratës. Po ashtu kjo lidhet me titullin VIII të MSA-së dhe nenin 111 që fokusohet te forcimi i administratës publike.

Ky objektivi, i cili, kërkon zhvillimin e shërbimeve miqësore kundrejt rinisë lidhet edhe me OZHQ 16 në kontekstin e krijimit e institucioneve të forta, i cili në këtë rast përkthehet në fuqizimin të mëtejshëm të kapaciteteve zbatuese, administrative e drejtuese të AKR-së.

¹⁷ Për më tepër shiko kapitullin V “Gjetje dhe rekomandime” të “Raportit Final i Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015–2020” botuar në qershor 2020 me mbështetjen e UNFPA-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

¹⁸ Mbi 3000 mijë të rinj kanë bërë praktika pune në administratë dhe 1000 prej tyre kanë marrë kontrata punësimi që prej vitit 2015. Për më shumë shiko: [1/3 e vendeve në administratën publike i dedikohet punësimit të të rinjve \(dap.gov.al\)](#)



Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 5: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 1.2.

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	Numri/përqindja i/e bashkive që kanë ngritur kënde digjitale të informimit rinor (<i>info-points</i>)	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF/ AKR/ Bashki
Rezultati	Platforma rinore “Të rinjtë për të rinjtë” e ngritur, funksionale dhe e përditësuar	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF/ AKR AKPA

Tabela 6: Lista e masave të parashikuara në lidhje me objektivin specifik 1.2

Nr. i masës	Masa sipas objektivit specifik
1.2.1	Fuqizohen rolet zbatuese, koordinuese, monitoruese të AKR përmes fuqizimit të saj me burime financiare dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e politikave sektoriale për rininë të pasqyruara në këtë strategji.
1.2.2	Përmes AKR sigurohen fonde për rritjen e prezencës së Shqipërisë në proceset e politikëbërjes rinore si në nivel rajonal, evropian dhe global.
1.2.3	Bazuar në konceptin “Të rinjtë për të rinjtë” zhvillohen dhe aplikohen shërbime mbështetëse dhe të informacionit për të rinjtë dhe rininë. Në këtë portal krijohet një platformë informimi dhe shërbimesh për të rinjtë dhe organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që do të mbështesë formimin, punësimin, edukimin, mirëqenien, zhvillimin dhe aktivizimin e tyre.
1.2.4	Fuqizohen kapacitetet e politikëbërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë dhe zbatimin e politikave rinore bazuar në konceptin e shërbimeve miqësore dhe të pranueshme nga të rejat dhe të rinjtë dhe forcohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e politikave rinore

**Objektivi specifik 1.3:**

Studimet rinore dhe të dhënat për rininë nxiten të zhvillohen dhe të bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.

Analiza e situatës dhe sfidat

Mbetet sfida në vete nxjerrja e të dhënave statistikore të sakta për rininë të cilat nuk japin të dhëna vetën në rang vendi, por të zbërthyer (disagreguara) për çështje të ndryshme që lidhen me rininë në nivel qarku apo bashkie. Edhe mungesave e databazave për organizatat rinore që kërkohet nga ligji për rininë shton paqartësinë e të dhënave.

Në kuadër të punës kërkimore për këtë strategji u vu re mungesa e studimeve rinore si njësi akademike në kërkimin shkencor dhe në IAL. Procesi i kërkimit për rininë dhe problemet e të rejave dhe të rinjve nuk mungojnë, por ato janë të shpërndara dhe jo të orientuara për të nxitur vendimmarrje specifike. Procesi i kërkimit shkencor për rininë bëhet nga organizata rinore që mbështeten nga donatorë të ndryshëm. Studimet rinore janë të shpërndara kryesisht në degët e studimit të shkencave sociale dhe nuk i paraprijnë proceseve politikëbërëse.

Edhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore që merren me rininë nuk është i rregulluar apo i orientuar drejt IAL-ve, ku sipas të dhënave, në institucionet e arsimit të lartë publik ekziston vetëm një program masteri ekzekutiv që ka në qendër përgatitjen e këshilluesve për karrierë¹⁹.

Institucionet drejtuese

- MSHRF, AKR

Institucionet pjesëmarrëse

- MiSHMS, INSTAT

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur rezultatet specifike janë përshkruar në planin e veprimit të dokumentit strategjik që do të ngarkohet në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit

Objektivi specifik 1.3 synon fuqizimin dhe konsolidimin e të dhënave dhe studimeve për rininë për të realizuar vendimmarrje të informuar dhe të lidhur me zhvillimin e rinisë si në nivelin qendror ashtu edhe në në atë vendor. Ky objektivi lidhet me titullin VIII të MSA-së që trajton politikat e bashkëpunimit dhe më specifikisht me nenin 109 që trajton çështjet e bashkëpunimit në kërkimin shkencor. Nxitja e zhvillimit të “studimeve rinore” sipas masave të këtij objektiv do të kërkojë bashkëpunim të institucioneve kërkimore dhe shkencore në vend, si edhe bashkëpunim në nivel evropian përmes programeve “Horizon” dhe “Erasmus” për të kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve në këtë fushë. Për më tej ky objektivi lidhet edhe me nenin 88 të titullit VIII që ka të bëjë me bashkëpunimin statistikor. Zhvillimi i statistikave rinore dhe mundësitë për t'i zbërthyer ato në bazë të çështjeve themelore të studimeve rinore parashikohen si masa brenda këtij objektiv.

¹⁹ Program i masterit ekzekutiv i Departamentit të Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës që mbështetet nga Bashkëpunimi Zviceran i Zhvillimit.



Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 7: Treguesit kyç të performancës në lidhje me objektivin specifik 1.3

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	Politikat zhvillimore rinore të hartuara bazuar në analizë	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore. Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar	Studimet rinore dhe të dhënat për rininë nxiten të zhvillohen dhe të bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	MSHRF/ AKR

Lista e masave të nevojshme për arritjen e objektivit specifik 1.3

Nr.	Lista e masave sipas objektivit specifik
1.3.1	Krijohen baza të dhënash statistikore dhe studimore për rininë në Shqipëri përmes forcimit të kërkimit shkencor rreth rinisë si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe fuqizohet studimi i rinisë si fushë akademike dhe shkencore.
1.3.2	Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare.
1.3.3	Në përputhje me ligjin për rininë dhe VKM-të zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për rininë duke përfutur edhe nga proceset e digjitalizimit të shërbimeve publike.

Tabela 8: Lista e masave për zbatimin e objektivit specifik 1.3

Qëllimi i politikës 2:

Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

Ky qëllim politik synon të arrijë novacionin, edukimin, autonominë, dhe barazinë e drejtë për të rejtat dhe të rinjtë përmes objektivave të mëposhtëm:

Objektivi specifik 2.1: Të rinjtë janë të aftësuar, të mirëinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive

Objektivi specifik 2.2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.

Objektivi specifik 2.3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësimin, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.

Institucionet përgjegjëse drejtuese janë” MSHRF, AKPA, AKR.

Ndërkohë institucionet kryesore pjesëmarrëse janë: MAS, MISHMS, MFE, AKSHI, RASH, AKCESK dhe AKAPFK.

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuar janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i politikës 2 përcaktohet në kushtet që të rejtat dhe të rinjtë duhet të kenë në një vend si Shqipëria për t'u angazhuar dhe zhvilluar me anë të novacionit dhe arsimit cilësor e për pasojë edhe duke e rritur profesionalizmin dhe cilësinë e punësimit të tyre. Kjo politikë adreson autonominë rinore dhe dhënien e mundësive përtej shanseve të barabarta për të mënjauar pabarazitë dhe mënjanimin sociale. Nga kjo pikë vështrimi, ky objektivi specifik lidhet ngushtë me OZHQ-të 4 dhe 8, të cilat kanë të bëjnë respektivisht me arsimin cilësor dhe punësimin e denjë. Të dhënat parapandemike dhe para tërmetit të vitit 2019 tregojnë se ka shumë për të bërë në lidhje me fuqizimin e cilësisë në arsim e në veçanti në lidhje me proceset e këshillimit për punësim dhe karrierë



OZHQ 4 - EDUKIM CILËSOR	BURIMI	VITI	TË DHËNAT
4.1.1 (1) Përqindja e fëmijëve në fund të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim <i>Meshkuj 37.9 Femra 58</i>	PISA / OECD / Përllogaritje të Bankës Botërore	2018	48
4.1.1 (2) Përqindja e fëmijëve në fund të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në matematikë <i>Meshkuj 55.9 Femra 59.4</i>	PISA / OECD / Përllogaritje të Bankës Botërore	2018	58
4.1.2 (1) Shkalla e përfundimit të arsimit në filllore <i>Meshkuj 94.16 Femra 95.7</i>	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / Përllogaritje të UNICEF	2018	94.92
4.1.2 (2) Shkalla e përfundimit të arsimit të mesëm të ulët <i>Meshkuj 97.93 Femra 97.41</i>	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / Përllogaritje të UNICEF	2018	97.67
4.1.3 (3) Shkalla e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë <i>Meshkuj 76.23 Femra 79.86</i>	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / Përllogaritje të UNICEF	2018	77.95
4.2.1 (1) Përqindja e fëmijëve (36-59 muajsh), me zhvillimin e duhur shëndetësor, mësimor dhe psiko-social			I pamatur
4.2.2 Shkalla e pjesëmarrjes në të mësuarin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të hyrjes në fillorë; 5-6 vjeç) <i>Meshkuj 91.5 Femra 86.7</i>	Ministria e Sportit Arsimit dhe Rinisë / INSTAT	2019	89.1
4.3.1 Raporti i pjesëmarrjes së të rinjve (15-24 vjeç) në trajnime formale dhe jo formale në 4 javët e fundit <i>Meshkuj 47 Femra 56.1</i>	Anketa e Forcave të Punës / INSTAT	2019	51.5
4.4.1 Përqindja e popullsisë (16-24 vjeç) ka të paktën një aftësi në Teknologji Informacion dhe Komunikimi (TIK) <i>Meshkuj - 20.9 Femra - 20.6</i>	Anketimi i Përdorimit të Teknologji Informacion dhe Komunikimi (TIK) / INSTAT	2019	41.5
4.5.1 (1) Treguesi barazisë gjinore për pjesëmarrjen në arsim e ulet	Ministria e Sportit Arsimit dhe Rinisë / INSTAT	2019	0.95
4.5.1 (2) Treguesit e barazisë gjinore për pjesëmarrjen në arsimin e mesëm të ulët	Ministria e Sportit Arsimit dhe Rinisë / INSTAT	2019	0.94

Figura 1: Të dhënat për edukim cilësor sipas botimit të UNICEF-it dhe INSTAT-it “Treguesit e mirëqenies së fëmijëve dhe adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri 2016–19”, f. 19

Mungesa e të dhënave të sakta në lidhje me punësimin, siç vihet re edhe në tabelën në vijim, thekson edhe një herë rëndësinë që ka mbledhja e të dhënave të sakta statistikore për çdo fushë që ka të bëjë me rininë dhe zhvillimin e saj. Planet dhe programet që lidhen me garancinë rinore dhe zhvillimi e nxitja e punësimit rinor do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e situatës me OZHQ 8 dhe do të përbënin një bazë të fortë për të ulur migrimin dhe rritur punësimin e të rinjve brenda vendit.

OZHQ 8 - PUNË DINJITOE DHE RITJE EKONOMIKE	BURIMI	VITI	TË DHËNAT
8.6.1 Raporti i të rinjve (15-24 vjeç) jo të shkolluar, të punësuar ose të trajnuar <i>Meshkuj - 25.8 Femra - 25.3</i>	Anketa e Forcave të Punës / INSTAT	2019	25.5
8.7.1 (1) Përqindja e fëmijëve (5-17 vjeç), që punojnë aktivitete ekonomike dhe punë shtëpie <i>Meshkuj - 3.6 Femra - 3.0</i>	Anketa e Punës së Fëmijëve në Shqipëri / INSTAT / ILO	2010	3.3
8.7.1 (2) Përqindja e fëmijëve (5-17 vjeç), që punojnë aktivitete ekonomike <i>Meshkuj - 3.4 Femra - 2.1</i>	Anketa e Punës së Fëmijëve në Shqipëri / INSTAT / ILO	2010	2.8

Figura 2: Të dhënat për punën dinjitoze sipas botimit të UNICEF-it dhe INSTAT-it “Treguesit e mirëqenies së fëmijëve dhe adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri 2016–19”, f. 19

Lidhja e objektivit specifik me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit

Ky qëllim i politikës lidhet me kapitullin V të MSA-së dhe titujt VII dhe VIII të saj respektivisht me nenet që kanë të bëjnë fuqizimin e institucioneve, bashkëpunimin social dhe kulturor, shoqërinë e informacionit dhe zhvillimin rajonal e lokal. Qëllimi i dytë i politikës së SKR 2022–2029 lidhet me kapitullin V dhe nenin 100 “Arsimi”, neni 109 “Kërkimi shkencor” dhe neni 103 “Shoqëria e informacionit”. Po ashtu ai lidhet me nenet 110 dhe 111 që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal dhe administratën publike.

Ky qëllim, gjithashtu, lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023²⁰ përmes kapitujve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, kapitullin 10 për shoqërinë e informacionit dhe media,

Miratur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 9.2.2022, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024”.”



kapitullin 19 në lidhje me politikat sociale, kapitullin 24 që lidhet me drejtësinë dhe sigurinë, kapitullin 26 në lidhjen që ka me çështjet e kulturës dhe sporteve, si edhe me kapitullin 28 në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit.

Tabela 9: Treguesit e rezultateve të lidhur me qëllimin e politikës 2

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	Shkalla e papunësisë së të rinjve (%) të ndarë sipas gjinisë	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHRF/ INSTAT/ AKPA/ MFE
Rezultati	Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive.	MSHRF/ AKPA/ INSTAT/ MFE
Rezultati	% e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	AKPA/MFE
Rezultati	Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimore	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuar cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyeteve të tyre.	MAS, AKKSHI, AKPA



Rezultati	% e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit.	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetjet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHRF/ MFE
------------------	--	--	---	------------

Objekti specifik 2.1:

Të rinjtë janë të aftësuar, të mirëinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomisht aktive.

Analiza e situatës dhe sfidat

SIPS PKIE 2022–24 (f. 74) shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15–29 vjeç, është në nivelet 53–54%, duke pësuar rritje të lehta nga viti në vit. Edhe shkalla e papunësisë së të rinjve rrotullohet mes shifrave 20%–21% dhe me ulje të lehta krahasuar në vitet e mëparshme. Shkak për këto ndryshime janë edhe politikat e ndërmarra për nxitjen e punësimi dhe zhvillimi i programeve që fokusohen te punësimi i të rinjve duke përfshirë elemente, si:

- punësim i subvencionuar për të rinjtë, gratë me fëmijë në ngarkim, të rinjtë e pakicave, ata me aftësi të kufizuara, si edhe ata që kthehen nga migrimi;

- trajnimi nëpërmjet punës;
- praktika profesionale;
- puna publike në komunitet;
- vetëpunësimi.

Dinamika e tregut të punës po përmirësohet vazhdimisht duke reflektuar efektivitetin e politikave të ndërmarra nga qeveria që shkon në favor të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe nxitjes së punësimi. Në kuadër të analizave dhe studimeve të bëra për këtë strategji, u vu re që nuk ka rritje të papunësisë mes të rinjve dhe shifrat e papunësisë janë stabilizuar. Nga ana tjetër mesatarja vjetore e të rinjve që janë larguar nga vendi për periudhën 2016–2021 është 36,813 sipas INSTAT-it²¹. Ekziston rreziku i largimit të të rinjve nga

Shqipëria për shkak të liberalizimit të politikave të punësimi në Evropë dhe plakjes së popullsisë evropiane, për rrjedhojë kërkohen politika shumë më aktive për nxitjen e punësimi mes të rinjve dhe zhvillimin e një kulture të bërjes së të ardhmes brenda vendit.

Zhvillimet e fundit që ka ndërmarrë qeveria në lidhje me nxitjen e inovacionit përmes *startup*-eve, digjitalizimit të shërbimeve dhe zhvillimin e lëndëve të kodimit tregojnë për seriozitetin e masave për t'u përballuar me këto fenomene dhe rëndësinë që i kushtohet punësimi të të rejave dhe të rinjve. Ky proces duhet të shkojë krah për krah me një proces reformimi të shërbimit të këshillimit për karrierë që i ofrohet ose nuk i ofrohet të rinjve në shkollë apo institucionet e formimit profesional. Mungon edhe veprimi në nivel vendor për të nxitur dhe zhvilluar punësimin rinor.

Bazuar në mendimet dhe idetë e të rinjve këto shërbime jo vetëm duhen modernizuar dhe digjitalizuar, por në të njëjtën kohë duhet të përshtaten me kërkesat e të rinjve, t'i kuptojnë më mirë ata dhe nevojat e tyre, dhe t'i paraprijnë zhvillimeve të tregut të punës. Këto përmirësime së bashku me mbështetjen që kërkojnë të rinjtë për të rritur shkallën e tyre të lëvizshmërisë brenda vendit dhe në rajon do të sillnin ndryshime në mënyrën se si të rejtat dhe të rinjtë marrin vendimet e tyre për të ardhmen dhe bërjen e vetes aktiv në tregun e punës.

SFIDA

- Forcimin e mëtejshëm të mekanizmave për kërkimin dhe aksesin në punë, investimin në shërbime profesionale dhe zhvillimi i aftësive

²¹[http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/STAR_T_MM/EM_01/?rxid=547ec986-8e3d-47d1-b25e-](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/STAR_T_MM/EM_01/?rxid=547ec986-8e3d-47d1-b25e-9d9b830dd3e5)

9d9b830dd3e5. Të dhënat e IINSTAT-it janë: emigrantë 2016-2021 janë 220,878. Mesatare vjetore 2016-2021, janë: 36,813. Emigrantë për vitin 2021 janë: 42,048



punëkërkuese brenda një mjedisi lejues dhe mundësues për zhvillimin e vetëpunësimit dhe të aftësive sipërmarrëse.

- Lehtësim të aksesit në kredi dhe mbështetje të shtuar qeveritare për krijimin e fondeve për *start-up* duke i kushtuar shumë rëndësi edhe promovimit të këtyre skemave në çdo bashki si për popullatën rinore të bashkisë por edhe për ata që kthehen nga migrimi.

- Punë të zgjeruar për përhapjen e ndërmarrjeve sociale bazuar edhe në udhëzuesit e hartuar në lidhje me këtë formë të biznesit social.

- Krijimin e kushteve mbështetëse për gratë e reja me qëllim shpërndarjen më të drejtë të punëve në aspektin gjinor vazhdon të mbetet sfida veçanërisht në tregun e punës.

- Gjurmimin e nxënësve dhe studentëve pasi përfundojnë studimet duhet të realizohet për të kuptuar lidhjet me tregun e punës, evidentuar APAA dhe për të kuptuar diferencën mes regjistrimeve dhe diplomimeve në arsim të lartë.

- Krijimin e alternativave të trajnimit dhe arsimit profesional si një mundësi alternative për arsimin dhe riaftësim.

Institucionet drejtuese:

MSHRF, MFE, AKPA, AKR

Institucionet pjesëmarrëse:

MAS, MiSHMS

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuar janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Objektivi specifik 2.1 synon nxitjen dhe rritjen e punësimit për të rinjtë, si edhe zhvillimin dhe përmirësimin e programeve që kanë të bëjnë me këshillimin për karrierë. Për pasojë ky objektivi lidhet ngushtë me OZHQ-të 8 (punësimi dinjitoze) dhe OZHQ 4 (arsimi cilësor).

Objektivi lidhet me kapitullin V të MSA, nenin 77, që lidhet me kushtet e punës mundësitë e barabarta, si edhe me titullin VIII të MSA me nenin 100 të saj.

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 10: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 2.1

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetjet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomiksht aktive.	MSHRF/ AKPA/ INSTAT/ MFE

Lista e plotë e masave në planin e veprimit.

Tabela 11: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.1

Nr.	Masat sipas objektivit specifik 2.1:
2.1.1	Bashkërendohet Politika Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë duke rritur nivelin e punësimit dhe sipërmarrjen e të rinjve përmes angazhimit dhe ndërveprimit të këshillave vendorë rinorë, ndërmarrjeve dhe <i>startup</i> -eve.
2.1.2	Nxitet dhe forcohet punësimi rinor në fushën e TIK dhe digjitalizimit përmes zhvillimit të programeve të aftësimit në kodim, TIK dhe digjitalizim bazuar në studimet e tregut dhe zhvillimit të punësimit në këtë fushë si në Shqipëri dhe me gjerë.
2.1.3	Pranë institucioneve arsimore dhe aftësuese zhvillohen shërbime inovative dhe digjitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë, miqësore për të rejtat dhe rinjtë, dhe në respektim të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor.



2.1.4	Nxitet dhe forcohet novacioni përmes sipërmarrjeve rinore dhe nga të rinjtë duke e vënë novacionin rinor në fokus të kuadrit ligjor dhe politikave publike të <i>start up</i> -eve, politikave të punësimit dhe mbështetjes së nismave si <i>hapësirat e përbashkëta për punë (co-working spaces)</i> .
2.1.5	Përmirësohen programet dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë e të rinjve, dhe bashkëpunimin mes tyre brenda vendit e më gjerë.
2.1.6	Lehtësohet transporti publik ndërqytetas për të rinjtë , duke rritur lëvizshmërinë e tyre në qarqe.

Objektivi specifik 2.2:

Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuar cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.

Analiza e situatës dhe sfidat

Konceptet për punësimin në Shqipëri lidhen ngushtë me degën e studimit që një e re apo i ri merr në institucionet e arsimit të lartë (IAL) dhe me shanset për t'u punësuar në administratë publike apo "shtet" duke kërkuar kështu një hyrje të sigurt në tregun e punës. Edhe pse këto lloj konceptesh po sfidohen nga rritja e numrit të të rinjve sipërmarrës dhe të angazhuar në nisma *start-up*, si dhe nga numri në rritje i të rinjve në arsimin profesional, në Shqipëri karriera vazhdon të jetë e lidhur ngushtë me mbarimin e studimeve të larta dhe gjetjen e një pune të sigurt.

Shumë të rinj e shohin si problem e jo si mundësi të re faktin që ata punësohen në një fushë që nuk lidhet drejtpërsëdrejti me studimet e tyre universitare. Kultura e gjetjes së vendit të punës bazuar në njohuritë e marra në mënyrë informale dhe joformale nuk ka fituar terrenin e duhur edhe pse tashmë janë miratuar vendimet qeveritare që e mundësojnë njohjen e përvojave të tilla, të cilat i shërbejnë të rinjve për t'u punësuar jashtë fushës së tyre të studimeve.

Zhvillimi i sektorit të ndërmjetësimit profesional apo shërbimit të karrierës si përmes zyrave të punës dhe në sistemin arsimor është një tjetër sfidë që kërkon zgjidhje të menjëhershme duke plotësuar edhe kërkesën më kryesore të të rinjve në takimet konsultuese në çdo nivel.

Së fundi sigurimi dhe nxitja e punësimit në vend dhe angazhimi i të rinjve në punësim të qëndrueshëm kërkon politika edhe më të forta nga ana e qeverisë për t'u përballuar efektivisht me fenomenin e largimit të rinisë nga vendi. Kjo strategji synon në këtë pjesë të ndryshojë perceptimet për punësimin në vend.

Mbetet shumë për të bërë për të kuptuar dhe studiuar më thellë zhvillimet në arsimin profesional dhe lidhjet që disa nga institucionet kanë krijuar me tregun e punës. Kuptimi më i mirë i të dhënave të zbërthyer në nivel qarku apo bashkie do të siguronte një shpërndarje më të mirë të degëve të studimit duke i orientuar ato fuqishëm nga tregu i punës e duke zhvilluar programe studimi që lidhen me digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve.

Zbërthimi i të dhënave statistikore do mundësonte edhe të kuptuarin e të rinjve në aktivitetet jashtë shkollore dhe jetën e tyre virtuale duke hapur kështu mundësitë për të bërë realitet planet për digjitalizimin e proceseve arsimore. Sfidat në këtë proces mbetet sigurimi i furnizimit me shërbime të qëndrueshme dhe të sigurta interneti në shkolla dhe mjedise të tjera rinore.

Institucionet drejtues

MSHRF, MAS, AKR

Institucionet pjesëmarrës

MEF, AKPA, AKSHI, RASH, AKCESK

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuar janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Objektivi specifik 2.2 synon të fuqizojë informacionet që marrin të rinjtë në lidhje me tregun e punës dhe zgjedhjes më të mirë të përvojës së tyre arsimore që t'i shërbejë punësimit.

Ky objektivi lidhet me kapitullin V të MSA, nenin 77, që specifikon kushtet e punës mundësitë e barabarta si edhe me titullin VIII të MSA me nenin 100 të saj për arsimin dhe trajnim cilësor.

Ky qëllim gjithashtu lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023²², me kapitullin 2 për lëvizjen e lirë të punëtorëve, kapitullin 19 për politikën sociale të punësimit dhe kapitullin 26 për arsimin dhe kulturën.

Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 9.2.2022 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024".



Ky objektiv specifik lidhet me OZHQ 8 (punësimi dinjitoz) dhe OZHQ 4 (arsimi cilësor) por edhe me OZHQ 10 (zvogëlimi i pabarazive) dhe 17 (partneritet për qëllimet).

Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 12: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 2.2

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimore	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuar cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyeteve të tyre.	MAS, AKKSHI, AKPA

Lista e plotë e masave në planin e veprimit:

Tabela 13: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.2

Nr. i masës	<i>Masat sipas objektivit specifik 2.2</i>
2.2.1	Mbështeten të rejtat dhe të rinjtë në pikat kritike të zhvillimit si kalimi në shkollën e mesme të lartë dhe kalimi nga shkolla në tregun e punës ose në studimet e nivelit universitar me këshillim dhe informacione që lidhin përzgjedhjen e fushës së arsimimit me mundësitë në tregun e punës në bashkërendim me masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–26 dhe në Strategjinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë
2.2.2	Promovohet përdorimi i sigurt i teknologjive të reja dhe mbështetet përvetësimi i aftësive dhe kompetencave digjitale të shekullit të 21-të për të rinjtë si në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe atë profesional ashtu edhe në sistemin e trajnimeve formale dhe joformale.
2.2.3	Mbështeten dhe zhvillohen programe të seksioneve sportive amatore, arteve, artizanatit dhe aktiviteteve të tjera jashtëkurrikulare që synojnë zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme, me fokus të veçantë tek të rejtat.

**Objektivi specifik 2.3:**

Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore

Analiza e situatës dhe sfidat

Mbetet fakt që shumica e të rinjve gjejnë punësim në sektorin e shërbimeve dhe fasonerisë ku nuk kërkohet ndonjë nivel i lartë i njohurive të specializuara. Sfida në fushën e punësimit është rritja e punësimit të qëndrueshëm, afatgjatë dhe me standarde apo siç i referohet OKB në OZHQ 8 si “punësim i denjë”.

Sfidë tjetër thelbësore është rritja e zbatueshmërisë, kryesisht jashtë Tiranës, i legjislacionit të miratuar për nxitjen e punësimit sipas programeve dhe vendimeve të qeverisë dhe në përputhje me Strategjinë e Punësimit dhe Aftësive e cila është në proces rinovimi. Në takimet me të rejtat dhe të rinjtë në kuadër të kësaj strategjie u vu re jo vetëm mungesa e informacionit për këto programe por edhe mosnjohja e programeve të financimit dhe praktikave të punësimit. Rritja e transparencës në vendimmarrje dhe rritja e pjesëmarrjes së të rejtave dhe të rinjve do të rrisnin efektshmërinë e këtyre programeve.

Në kuadër të programeve si garancia rinore që do të mbështetet nga BE-ja duhet gjetur rrugë e mundësi për të sfiduar burokracinë duke i zvogëluar hapat që një e re ose i ri duhet të ndërmarrë për të fituar nga këto programe, duke i bërë shërbimet për rininë më të orientuara e më miqësore kundrejt tyre.

- Zbutja e papunësisë mes të rinjve duke qenë se papunësia është një nga shkaqet kryesore për përjashtimin social.

- Rritjen e nivelit arsimor për të ulur papunësinë dhe diskriminim për shkak të mungesës së arsimit.

Institucionet drejtuese:

MSHR, MFE, MAS

Institucionet pjesëmarrëse:

MISHMS, AKR, AKPA, AKAPFK,

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuar janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me nën-kapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së dhe OZHQ-të.

Objektivi specifik 2.2 synon të fuqizojë integrimin e të rejtave dhe të rinjve në shoqëri duke rritur autonominë e tyre përmes punësimit dhe kalimit të suksesshëm nga shkolla në punësim.

Ky objektivi lidhet me kapitullin V të MSA, nenin 77, që specifikon kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta, si edhe me titullin VIII të MSA me nenin 100 të saj për arsimin dhe trajnim cilësor.

Ky qëllim gjithashtu lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023²³, me kapitullin 2 për lëvizjen e lirë të punëtorëve, kapitullin 19 për politikën sociale të punësimit dhe kapitullin 26 për arsimin dhe kulturën.

Ky objektivi specifik lidhet me OZHQ 8 (punësimi dinjitoz) dhe OZHQ 4 (arsimi cilësor), por edhe me OZHQ 10 (zvogëlimi i pabarazive) dhe 17 (partneritet për qëllimet).

Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 9.2.2022
“Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024”



Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 14: Treguesit kyç të performancës të lidhur me objektivin specifik 2.3

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me objektivin specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	Shkalla e papunësisë së të rinjve (%) të ndarë sipas gjinisë	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHRF/ INSTAT/ AKPA/ MFE
Rezultati	% e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	AKPA/MFE
Rezultati	% e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit.	Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.	Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHRF/ MFE

Lista e plotë e masave në planin e veprimit.

Tabela 15: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 2.3

Nr. i masës	Masat sipas objektivit specifik 2.3
2.3.1	Nxiten punët e denja dhe të përshtatshme për të rejtat dhe të rinjtë përmes politikave të punësimit, miqësore dhe të orientuara nga të rinjtë, që kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës për të rejtat dhe të rinjtë që sigurojnë qasje novative dhe digjitale në informacionet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e punësimit.
2.3.2	Sigurohet mbështetje e përshtatshme dhe miqësore për të rinjtë dhe të rejtat e në veçanti për ata me aftësi të kufizuara mbi punësueshmërinë e tyre, punësimin dhe sipërmarrjen rinore.
2.3.3	Nxitet dhe promovohet novacioni në tregun e punës për punësimin me kohë të pjesshme të orientuar kryesisht nga të rejtat.
2.3.4	Fuqizohen qasjet e integruara për të mbështetur të rinjtë që rrezikojnë lënien e parakohshme të shkollimit dhe pa mbështetje për shkollim në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit

**Qëllimi i politikës 3:**

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Qëllimi synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

- **Objektivi specifik 3.1:** Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale.

- **Objektivi specifik 3.2:** Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore, sociale, fizike dhe seksuale.

- **Objektivi specifik 3.3:** Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri duke pasur mundësi për strehim dhe argëtim (në kulturë, art dhe sport).

Institucionet përgjegjëse drejtuese, janë: MSHRF-ja, AKR-ja dhe MSHMS-ja.

Ndërkohë institucionet kryesore pjesëmarrëse janë” AKSHI, AKCESK, AMA, Agjencia e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Bashkitë, ISHP, AMMV, MB, MD, MIE dhe ASCAP.

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuar janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuara në IPSIS.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) dhe MSA-së

Qëllimi i politikës 3 lidhet me OZHQ 16 në kuadrin e forcimit të institucioneve të drejtësisë dhe mbështetjes së të drejtave të njeriut, OZHQ 3 në kuadrin e mbështetjes së të rinjve dhe të rejave për mirëqenie dhe shëndet të mirë, OZHQ 5 në kuadër të mbështetjes me masa për përfshirjen sociale, OZHQ 11 në kuadër të mbështetjes që i bën programeve qeveritare për strehimin e çifteve të reja në banesat e tyre dhe OZHQ 10 me synimin për zvogëlimin e pabarazive dhe mbështetjes të aktiviteteve që minimizojnë mënjanimin social.

Ky qëllim i politikës lidhet me kapitullin V të MSA-së dhe titujt VII dhe VIII të saj respektivisht me nenet që kanë të bëjnë me fuqizimin e institucioneve, bashkëpunimin social dhe kulturor, shoqërinë e informacionit dhe zhvillimin rajonal e lokal. Ky qëllim gjithashtu lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023²⁴ përmes kapitujve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, kapitullin 10 për shoqërinë e informacionit dhe media, kapitullin 19 në lidhje me politikat sociale, kapitullin 24 që lidhet me drejtësinë dhe sigurinë, kapitullin 26 në lidhjen që ka me çështjet e kulturës dhe sporteve, si edhe me kapitullin 28 në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit.

Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 9.2.2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024”



Tabela 16: Lista e treguesve kyç të performancës të lidhur me qëllimin 3

Nr	Lloji i treguesit	Emri i Treguesit	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucion i Përgjegjës
1	Rezultati	% e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF/ MSHMS/ AKR
2	Rezultati	% e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për rininë	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF/ MSHMS
3	Rezultati	% e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHMS/A SPA

Objektivi specifik 3.1:


Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale.

Analiza e situatës dhe sfidat

Veçanërisht në situatat e krijuara nga tërmetet e vitit 2019 dhe pandemia COVID-19, aspektet e përfshirjes më të madhe rinore dolën më në pah në politikat e ndërmarra nga qeveria. Duke qenë se Shqipëria është pjese e zhvillimeve globale dhe lëvizjet migratore kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi jetën e të rinjve dhe migrimin e tyre, angazhimi në veprimtari sociale që zhvillojnë komunitetin dhe përmirësojnë kushtet e të rinjve mbetet parësor në çdo qeveri e në politikat zhvillimore që ndërmerr vendi.


Qeveria i ka kushtuar shumë rëndësi çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe parandalimit të krimeve nga të miturit duke zhvilluar programe specifike në këto fusha të cilat edhe shpjegojnë uljen e numrit të të rinjve të dyshuar për vepra penale apo në institucionet e privimit të lirisë sipas tabelave në vijim.

Norma e fëmijëve (nën 18 vjeç) të dyshuar për vepra penale për 100,000 fëmijë, sipas grupmoshës



Shpjegimi: Numri i fëmijëve (nën 18 vjeç) të dyshuar për kryerjen e veprave penale, të regjistruar në polici gjatë vitit, në raport me 100,000 popullatë mesatare përkatëse
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / INSTAT

Norma e fëmijëve 14-17 vjeç në institucionet e privimit të lirisë për 100,000 popullatë përkatëse



Shpjegimi: Numri i fëmijëve 14-17 vjeç në paraburgim dhe të dënuar me burgim në raport me 100,000 popullatë mesatare përkatëse, në fund të vitit
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve / INSTAT

Mbetet gjithsesi shumë për të bërë në lidhje me format e krimit kibernetik dhe të bulizimit të të rinjve në formë kibernetike. Po ashtu, nga raporti i vlerësimit të PKVR 2015–2020, gjashtë indikatorë (60%) kanë mbetur të parealizuar në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale të të rinjve duke përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e informacioneve mbi dhunën, pabarazinë sociale, dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

- Mungesa e mjediseve të përshtatshme dhe të sigurta për lojën dhe aktivitetet fizike në komunitet.

- Numër i mjaftueshëm psikologësh dhe punonjësish socialë të specializuar në punën me të rinjtë nëpër gjimnaze të cilët bashkëpunojnë me shërbimet sociale të bashkive dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.

Institucionet drejtuese

- MSHRF, AKR, MAS, MD dhe MB

Institucionet Pjesëmarrëse

- AKSHI, AKCESK, AMA, Agjencia e Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e

Fëmijës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuar janë përshkruar në planin e veprimtimit të ngarkuar në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe OZHQ-të.

Objektivi Specifik 3.1 synon rritjen e sigurisë së të rejave dhe të rinjve duke krijuar mundësi për përfshirje dhe evituar mënjanimin social. Ky objektivi lidhet me titullin VII të MSA-së dhe nenin 78 të saj që ka të bëjë me forcimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës, si dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024 në pjesën e kriterit politik e më specifikisht respektimin e të drejtave të njeriut po edhe me çështjen e zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Në drejtim të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ky objektivi specifik lidhet me OZHQ 16 në aspektin e promovimit të drejtësisë dhe institucioneve të forta, me OZHQ 3 në lidhje me mirëqenien dhe OZHQ 5 në aspektin e barazisë gjinore.

Tabela 17: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.1

Nr. i masës	Masat sipas objektivit specifik 3.1:
3.1.1	Bashkërendohet zbatimi i strategjive dhe programeve kombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë me një fokus të veçantë të prezencës virtuale e të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta, krimi kibernetik dhe bulizmi online (digjital)
3.1.2	Fuqizohen programet që trajtojnë çështjet e rreziqet e sigurisë me të cilat përballen të rejtat dhe të rinjtë e trafikuar, rreziqet e formave të ndryshme të krimit dhe, parandalimi dhe luftimi i dhunës seksuale me bazë gjinore dhe dhunës nga partneri ndaj grave të reja dhe parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore/të rinjve.
3.1.3	Fuqizohen programet që u mundësojnë të rinjve të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën duke propozuar të ashtuquajturat “strategjitë e daljes”.
3.1.4	Promovohen programet për të rinjtë në masa reformuese duke vendosur mekanizma riintegrimi dhe mbështetje për trajnimin e aftësive për punësim, integrimin përmes punës në komunitet dhe mbështetje psikologjike dhe sipërmarrjeve sociale.
3.1.5	Përmirësohen me qasje specifike rinore, miqësore dhe të pranueshme, programet që trajtojnë migrimin e



	parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore me në fokus parandalimin e këtyre fenomeneve dhe kthimin e të rinjve në shkollë, trajnim ose punë.
3.1.6	Fuqizohen programet rinore që fokusohen në të drejtat e njeriut dhe të pakicave, barazinë gjinore, pranimit të diversitetit, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm.
3.1.7	Hartohen dhe fuqizohen programet dhe aktivitetet rinore që trajtojnë çështje në lidhje me format e ndryshme të diskriminimit kundrejt identiteteve socio-kulturore, fetare, seksuale dhe të tjera.

Objektivi specifik 3.2:

Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore, sociale, fizike dhe seksuale

Analiza e situatës dhe sfidat

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19 dhe vështirësitë që shoqëruan procesin e kapërcimit të krizës së tërmeteve të vitit 2019 kanë lënë pasojë shëndetësore edhe mes të rinjve shqiptarë. Duket se dhënia e shërbimeve për të rinjtë (adoleshentët) dhe shërbimet miqësore e të orientuara nga të rinjtë janë ndërprerë që prej vitit 2015 në Shqipëri²⁵ edhe pse strategjia e promovimit të shëndetit publik, shëndetit seksual dhe riprodhues dhe paketa bazë e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor (versioni i rishikuar) synojnë nevojat e të rinjve dhe adoleshentëve. Dokumentet janë në përputhje me planin e veprimit mbi sigurinë kontrceptive për 2017–2022.

Strategjia e promovimit shëndetësor të vendit synon adoleshentët dhe të rinjtë duke rritur ndërgjegjësimin shëndetësor dhe duke krijuar mjedise mbështetëse për mënyra më të shëndetshme jetese, duke trajtuar çështje që përfshin ushqimin, veprimtarinë fizike, dhunën, pirjen e duhanit, alkoolin, drogën, shëndetin mendor, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe planifikimin familjar. Ajo përfshin gjithashtu një objektivi që “së paku 50% e të rinjve përdorin shërbime shëndetësore miqësore për të rinjtë”. Paketa bazë e shërbimeve përfshin ofrimin e informacionit mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, planifikimin familjar dhe STI-të për të rinjtë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me mbështetjen e UNFPA-së, hartuan standardet për shërbimet shëndetësore miqësore për të rinjtë, të cilat më tej u integruan në paketën bazë të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor dhe nuk funksionuan si të veçanta.

Standardet ndërkombëtare të ofrimit të shërbimeve për të rinjtë kanë kërkesa specifike për të siguruar privatësinë përmes mjediseve të veçanta dhe hyrjes së veçantë në një strukturë klinike mjekësore për të ofruar shërbime miqësore për të rinjtë. Kjo gjë mbetet një shqetësim i veçantë në zonat rurale, ku aftësia për të ruajtur konfidencialitetin është e kufizuar.

Shëndeti mendor i të rinjve rrezikohet nga neglizhenca kundrejt problemeve të kësaj natyre por edhe nga lehtësia për të hyrë në rrjetet sociale ku të rinjtë ndeshen me elemente dëmtoese për shëndetin e tyre si varësia nga krahassimi me figura të njohura, qasja në materiale që janë të papërshtatshme për të rinjtë, mungesa e kohës për tu kujdesur për vete, ngacmimet kibernetike dhe diskriminimet.

Studime të ndryshme²⁶ tregojnë se gati një në tri fëmijë (32%) janë lënduar ndonjëherë fizikisht nga prindërit ose të rriturit e tjerë në familjet e tyre përkatëse. Prevalenca e abuzimit emocional gjatë gjithë jetës ishte 16% (13% te djemtë kundrejt 18% te vajzat). Abuzimi seksual qëndron në nivelin 8% dhe prevalenca e marrëdhënieve seksuale gjatë gjithë jetës me një të rritur (e tentuar dhe / ose e përjetuar) është rreth 3%. Korrelacione të rëndësishme të abuzimit seksual gjatë gjithë jetës ishin papunësia e nënës, përdorimi i duhanit dhe alkoolit gjatë gjithë jetës, marrëdhëniet seksuale gjatë gjithë jetës, si dhe dhuna në familje.

²⁵ Assessment of sexual, reproductive, maternal, newborn, child and adolescent health in the context of universal health coverage in Albania, p 22. <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/330457/9789289054706-eng.pdf>

²⁶ Studimi “Sjelljet shëndetësore të fëmijëve të moshës shkollore 11, 13 dhe 15 vjeç, 2017/18”.



3.8.1	Mbulimi i popullsisë me shërbime bazike shëndetësore (%)	I pamatur
3.9.1	Vdekshmëria në 100,000 popullatë, për shkak të ajrit të ndotur të ambientit ose të shtëpisë	I pamatur
3.a.1 (i)	Prevalanca e të rinjve (15-19, 20-24 vjeç) që konsumojnë produkte të ndryshme të duhanit	I pamatur

Figura 3: Sipas botimit të INSTAT-it dhe UNICEF-it “Treguesit e mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri 2016–19”, f. 18

Strategjia e Shëndetit 2021–2030 ka reflektuar nga mësimet e nxjerra në menaxhimin e pandemisë COVID-19 dhe adreson në mënyrë specifike nevojën për të rritur kapacitetet për t’iu përgjigjur emergjencave shëndetësore dhe për të rritur elasticitetin e sistemit shëndetësor në përgjithësi. Ajo synon të vazhdojë përpjekjet për përmirësimin e shëndetit, mirëqenien e popullatës duke përmblusur të drejtat e tyre për shëndet të mirë gjatë viteve 2021–2030. Strategjia është formuluar mbi pesë synime themelore, investimi në shëndetin e popullatës përgjatë gjithë jetës, mbulimit me shërbim universal, fuqizimin e sistemit shëndetësor, pikërisht me në qendër qytetarin, përforsimi i përgjigjes dhe shërbimeve të emergjencës dhe shëndetit digjital.

Sfida:

- Rifreskimi dhe zbatimi i protokolleve për shërbime shëndetësore miqësore kundrejt të rinjve.
- Përballimi vetjak me problemet dhe pa mbështetje nga shkolla dhe sistemi shëndetësor.
- Mungesa e politikave për të promovuar shëndetin dhe mirëqenien e adoleshentëve dhe të rinjve.
- Ofrimi i shërbimeve miqësore për të rinjtë falas/pa pagesë në 12 qarqet e vendit si edhe riorientimi i shërbimeve ekzistuese të kujdesit shëndetësor parësor për të qenë miqësore ndaj të rinjve, përfshirë shërbimet e shëndetit riprodhues.
- Edukimi i adoleshentëve me aftësitë për jetën, duke përfshirë edhe informacionet për

shëndetin, specifike sipas gjinisë dhe me ndjeshmëritë e duhura kulturore.

- Mungesa e shërbimeve të integruara shëndetësore për të menaxhuar adoleshentët abuzues me substancat (duhani, alkooli, drogat) dhe varësitë (përfshi edhe ato nga lojërat digjitale dhe pajisjet elektronike.

- Diskriminimi apo rreziku nga diskriminimi që përjetojnë grupe të rinjsh në shoqëri në bazë të gjinisë, moshës, orientimit seksual dhe etnisë.

- Bërjen e drejtësisë sociale bazuar në ndarjet rurale dhe urbane.

Institucionet drejtuese

MSHRF dhe MSHMS

Institucionet pjesëmarrëse

AKR, ISHP

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuar janë përshkruar në planin e veprimit të ngarkuar në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit

Objektivi specifik 3.2 synon të rrisë praktikën e shëndetit të mirë dhe ushtrimin e sporteve përmes fuqizimit të punës rinore në këshillimin shëndetësor dhe bashkëpunimit të fortë me MSHMS-në në aspektet e provomimit të aktiviteteve në lidhje me strategjitë kombëtare të shëndetit dhe përfshirjes.

Objektivi është i lidhur me nenin 78 të titullit të VII të MSA-së, si edhe me nenin 99 të titullit VIII.

Ky objektivi specifik lidhet me OZHQ 3 që synon shëndetin e mirë dhe mirëqenien.



Treguesit kryesorë të rezultateve

Tabela 18: Lista e treguesve kyç të performancës lidhur me objektivin specifik 3.2

Nr	Lloji i treguesit	Emri i Treguesit	Lidhja me Qëllimin e Politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucion i Përgjegjës
1	Rezultati	% e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF/ MSHMS/ AKR
2	Rezultati	% e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për rininë	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF/ MSHMS
3	Rezultati	% e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë	Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)	Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHMS/A SPA

Lista e plotë e masave është dhënë në planin e veprimit IPSIS

Tabela 19: Lista e masave për arritjen e objektivit specifik 3.2

Nr. i masës	Masat sipas objektivit specifik 3.2
3.2.1	Bashkërendohet Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030, Agjenda e Fëmijëve 2021–2026, planet e veprimit dhe strategjitë e tjera të lidhura me to me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, në veçanti promovimin e jetesës së shëndetshme.
3.2.2	Zhvillohen qasje dhe shërbime të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë në strukturat shëndetësore, të cilat marrin në konsideratë tranzicionin nga strukturat dhe shërbimet mjekësore për fëmijë tek ato për të rriturit
3.2.3	Zhvillohen shërbime të reja dhe forcohen ato ekzistuese nëpër shkolla me cilësi të garantuar për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik, si edhe mbështeten shërbimet online të shëndetit mendor në platformën për rininë “Të rinjtë për të rinjtë”.
3.2.4	Sigurohet pranimi i të rinjve në shërbimet e duhura të parandalimit dhe promovimit sipas Planit Kombëtar të Veprimit mbi Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese 2022 - 2030 për të siguruar që të rinjtë që jetojnë në Shqipëri marrin edukim / informacione të përgjithshme në formë të pranueshme dhe miqësore ndaj tyre.
3.2.5	Propozohen dhe zhvillohen veprimtari në lidhje me sjelljen e rrezikshme dhe konsumin e drogës duke siguruar që të rinjtë marrin informacione dhe edukim tërësor. Sigurohet që të rinjtë kanë akses në ndërhyrjet e duhura parandaluese dhe shërbimet e trajtimit të varësisë.



Objektivi specifik 3.3:

Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri duke pasur mundësi për strehim dhe argëtim (në kulturë, art dhe sport)

Analiza e situatës dhe sfidat

Ligji për rininë i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të hapësirave rinore të dedikuara për rininë dhe aktualisht qeveria po e mbështet këtë proces. Për më tej në programin qeveritar parashikohet mbështetja financiare për blerjen e apartamenteve nga çiftet e reja, e cila lidhet edhe me politikën qeveritare të kalimit nga rindërtim pas tërmetit të vitit 2019 në ndërtime të reja banesash për çiftet e reja dhe ata që kërkojnë jetën e pavarur sepse ka një numër të madh të rinjsh që zgjedhin migrimin në vend të zhvillimit të tyre në vend për shkak të mungesës së banesës e kushteve të tjera.

OZHQ 10 - ZVOGËLIMI I PABARAZIVE	BURIMI	VITI	TË DHËNAT
10.2.1 Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) që jetojnë nën 50% e medianes së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara	Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës / INSTAT	2018	22.1

Figura 4: Studimi i INSTAT-it dhe UNICEF-it “Treguesit e mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri 2016–19”, f. 20

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në PKVR 2015–20 në lidhje me shëndetin, sportin dhe mjedisin ishin realizuar plotësisht në masën 48%, ndërsa masat në lidhje me kulturën dhe vullnetarizmin në nivelin 39%. Ky nivel, edhe pse ndër më të lartit në lidhje me përmbushjen e indikatorëve lejon hapësira për zhvillime të reja dhe fokus më të madh në proceset e zhvillimit dhe të edukimit jashtë-shkollor ku programe si ai i shkollave komunitare dhe programi kombëtar për arte dhe zeje luajnë një rol kryesor për të integruar shoqërinë veçanërisht në një situatë post-pandemike.

Përfshirja dhe integrimi i të rejave dhe të rinjve dhe ulja e parabazive si ekonomike dhe gjinore paraqesin këto sfida:

Zhvillimi i hapësirave rinore me standarde të përcaktuara dhe në përputhje me kërkesat dhe nevojat e të rinjve;

- Ndërtimi i hapësirave në çdo bashki;
- Krijimi i hapësirave të dedikuara për rininë në mjediset shkollore;
- Ofrimi i shërbimeve dhe mbështetjes së dedikuar për përfshirjen në shkollë;
- Fuqizimi i shërbimeve rinore për të lehtësuar integrimin e të rinjve dhe kalimin e tyre në jetesë të pavarur.

Institucionet drejtuese

- MSHRF, MSHMS dhe MIE

Institucionet pjesëmarrëse

- AKR, AMMV, Bashkitë, MAS, MSHMS, MB, MD, ASCAP

Masat dhe buxhetet e ndërlidhura për të arritur objektivat e specifikuar janë përshkruar në planin e veprimtimit të ngarkuar në IPSIS.

Lidhja e objektivit specifik me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit

Objektivi specifik 3.3 është integruar nga natyra dhe synon si mospërfshirjen e asnjë të reja apo të riu dhe angazhimin e tyre aktiv në shoqëri si përmes aktivisteve vullnetare ashtu edhe përmes zhvillimit të masave për më shumë aktivitete argëtuese rinore. Ky objektivi lidhet po ashtu edhe me integrimin e të rinjve nga pikëpamja e strehimit dhe ndihmës për krijimin e jetës së pavarur në familje të reja. Kështu ky objektivi lidhet me nenin 99 të titullit VIII të MSA-s, si edhe me nenin 101 që ka në qendër bashkëpunimin kulturor.

Ky objektivi specifik lidhet specifikisht me OZHQ 3 në aspektin e mbështetjes së shërbimeve dhe infrastrukturës rinore; me OZHQ 5 dhe 10 në aspektin e gjithëpërfshirjes dhe mospërfshirjes social, si edhe me OZHQ 11 me fokusin që ka te sigurimi i strehimit të përballueshëm për të rinjtë dhe të rejat që mëvetësohen e duan të krijojnë familjet e tyre në banesa të vetat.



- Lista e plotë e masave është dhënë në planin e veprimit IPSIS.

Tabela 20: Masat sipas objektivit specifik 3.3

Nr. i masës	Masat sipas objektivit specifik 3.3
3.3.1	Mbështetet ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi edhe në kohën e lirë.
3.3.2	Mbështetet zbatimi i programeve të gjithëpërfshirjes dhe politikave të përfshirjes, sigurisë dhe mbrojtjes me fokus të veçantë tek të rejtat dhe të rinjtë.
3.3.3	Mbështetet dhe promovohet programi i qeverisë në lidhje me mbështetjen financiare të strehimit për familjet e reja dhe në bashkëpunim me aktorë qeveritarë qendrorë e vendorë si edhe organizatat donatore nxitet zhvillimi i programeve të tjera në mbështetje të familjeve dhe çifteve të reja.

Pjesa III: Masat prioritare të qeverisë për zbatimin e dokumentit strategjik

1. Metodologjia e përcaktimit të masave prioritare

Për përcaktimin e masave prioritare në këtë strategji janë përdorur mekanizma që kanë lidhje më imediate me kërkesat e të rinjve dhe njëkohësisht lidhen më drejtpërsëdrejti me procesin e integritetit evropian. Bazuar në këtë pikëpamje janë prioritetizuar masat e mëposhtme:

Masa 1.3.1. Krijohen baza të dhënash statistikore dhe studimore për rininë në Shqipëri përmes forcimit të kërkimit shkencor rreth rinisë dhe për rininë si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duke fuqizuar edhe studimin e rinisë si fushë akademike dhe shkencore. Kjo masë krijon një bazën e duhur për të ndërtuar dhe fuqizuar kërkimin shkencor për rininë. Ajo hap mundësinë për të hartuar politika rinore më efektive duke i ndërtuar ato në bazë të të dhënave statistikore dhe shkencore. Për më tepër kjo masë lejon bashkëpunim me institucione rinore në BE dhe më gjerë bazuar në shkëmbimin e të dhënave dhe bashkërendimin e politikave rinore.

Masa 2.1.2. Nxitet dhe forcohet punësimi rinor në fushën e TIK dhe digjitalizimit përmes zhvillimit të programeve të aftësimit në kodim, TIK dhe digjitalizim bazuar në studimet e tregut dhe zhvillimit të punësimit në këtë fushë si në Shqipëri dhe më gjerë. Kjo masë fuqizon synimin e qeverisë për të nxitur punësimin përmes zhvillimit të punëve në fusha të reja dhe rrit mundësitë për angazhim efektiv të të rinjve në tregun e punës duke i lejuar mundësi të mira profesionale. Kjo masë synon të rrisë pjesëmarrjen në tregun e punës të vajzave dhe grave të reja me anë të krijimit të kushteve për punësim me kohë të pjesshme dhe në mjedise alternative.

Masa 2.2.1. Mbështeten të rejtat dhe të rinjtë në pikat kritike të zhvillimit si kalimi në shkollën e mesme të lartë dhe kalimi nga shkolla në tregun e punës ose në studimet e nivelit universitar me këshillim dhe informacione që lidhin përzgjedhjen e fushës së arsimit me mundësitë në tregun e punës në bashkërendimin me masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–26. Punësimi të të rinjve në fusha inovative i paraprin një proces efektiv këshillimi për punësim dhe karrierë si në përfundim të arsimit të detyruar ashtu edhe përpara hyrjes në tregun e punës. Bazuar në garancinë rinore të mbështetur nga BE-ja, programi “Qëndro në shkollë” i mbështetur nga Republika e Italisë dhe projektet e donatorëve të tjerë në këtë fushë, procesi i këshillimit të karrierës vihet në baza të forta dhe bashkë-shoqëron të rejtat dhe të rinjtë në rritjen e tyre profesionale.

Masa 2.2.3. Mbështeten dhe zhvillohen programe të seksioneve sportive amatore, arteve, artizanatit dhe aktiviteteve të tjera jashtë kurrikulare që synojnë zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme, me fokus të veçantë tek të rejtat. Kjo masë merr prioritet sepse realizon mbështetje për të rinjtë në kohën e lirë. Angazhimi i të rejave dhe të rinjve në sporte dhe arte përmirëson shëndetin e tyre fizik dhe mendor dhe i bën ata më të lidhur si me njëri tjetrin dhe me mjedisin dhe komunitetin. Edhe kjo masë lejon zhvillimin e bashkëpunimit rajonal dhe evropian përmes lidhjes në programet e sportit dhe artit që mbështeten nga Bashkimi Evropian dhe organizma të tjera ndërkombëtare.

Masa 3.3.1. Mbështetet ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi edhe në kohën e lirë. Kjo masë merr prioritet pasi realizimi i saj mbulon pjesën e mbetur nga spektri i kërkesave parësore të të rinjve të paraqitura në takimet e



realizuara me ta. Kjo masë me karakterin e saj infrastrukturor i bën të qëndrueshme politikat rinore dhe i qendërzon ato pranë bashkive dhe më pranë të rinjve. Zhvillimi i qendrave të tilla hap mundësi bashkëpunimi evropian duke mundësuar marrjen e përvojave më të mira në këtë fushë dhe zbatimin e përshtatur të tyre në Shqipëri.

Pjesa IV: Zbatimi, llogaridhënia dhe koordinimi

Zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i SKR 2022–2029 do të arrihet përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit.

I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të menaxhohet përmes Komitetit Drejtues Sektorial për Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–29, siç parashikohet në urdhrin e Kryeministrit nr. 157 datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, dhe krijimin dhe funksionimin e një mekanizmi të integruar sektorial/ndërsektorial”.

Komiteti Drejtues për Strategjinë e Rinisë do të operojë përmes grupeve tematike të cilat do të jenë pjesë e Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për sektorin e rinisë dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse, si dhe nëpërmjet Sekretariatit Teknik, i cili do të formalizohet me urdher të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Raportet e monitorimit do të hartohen në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira, si dhe do të diskutohen në grupet tematike të krijuara për këtë qëllim sipas objektivave specifike të SKR 2022–2029 dhe më pas miratohen në Komitetin Drejtues Sektorial për sektorin e rinisë.

Gjithashtu, është dakordësuar që të ngrihet një grup pune midis menaxhimit të nivelit të mesëm nga MSHRF-ja dhe institucionet e qeverisjes së rinisë, si edhe MSHRF-ja për të diskutuar problematikat dhe pengesat që dalin gjatë zbatimit të SKR dhe gjatë ushtrimit normal të aktiviteteve të institucioneve përkatëse, të cilat kërkojnë një qasje të përbashkët.

Në qëllimin e politikës 1 përfshihet përgatitja e statistikave të përmirësuar të sektorit dhe i sistemeve të përmirësuar të menaxhimit të performancës, me qëllim realizimin në kohë dhe cilësi të raportimit për plotësimin e objektivave.

- Metodologjia e monitorimit

MSHRF-ja do të hartojë raporte gjashtë mujore dhe vjetore monitorimi dhe vlerësimi bazuar në standardet IPSIS për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në Planin e Veprimit të SKR për 2 vjetët e ardhshëm. Gjithashtu, do parashikohet dhe një monitorim afatmesëm për zbatimin në fund të vitit 2026. Plani i veprimit të dokumentit strategjik, duke marrë në konsideratë shkallën e mobilizimit të burimeve financiare për zbatimin e tij, do të rishikohet çdo 2–3 vjet për të siguruar në këtë mënyrë një vlerësim real për zbatimin e tij.

MSHRF-ja do të përdorë metodologjinë e monitorimit të bazuar në standardet IPSIS që do të përcaktojnë se si do të kryhet procesi i monitorimit dhe vlerësimit me qëllim krijimin e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit të të dhënave të të gjitha institucioneve të përfshira në zbatimin e sistemit IPSIS.

Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të secilit objektiv dhe masë, mbi buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Për monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, në lidhje me zbatimin e masave, procesi i monitorimit do të realizohet në nivel objektiv. Verifikimi i të dhënave të raportuara realizohet pjesërisht online për të garantuar saktësinë e tyre. Përpunimi statistikor i të dhënave kryhet me anë të shifrimit të përgjigjeve sipas raporteve të marrë. Këto raporte janë kryesisht të karakterit narrativ, por edhe statistikor duke përdorur indikatorë të të performancës.

Në përputhje me procedurat që do të ndiqen për raportim dhe monitorimin në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)” për përgatitjen e raporteve të monitorimit do të ndiqen fazat e mëposhtme.

Faza 1. Marrja e të gjithë kontributeve nga institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit (të rishikohet raporti);

Faza 2. Dërgimi i paketës së plotë për vlerësim në SASPAC në Kryeministri i në përputhje me



standardet e sistemit. Paketa e plotë do të duhet të përfshijë materialet e mëposhtme:

2.1 Raport progresin e konsoliduar në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e SASPAC;

2.2 Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën referuese në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e SASPAC-së;

2.3 Pasaportën e indikatorëve në përputhje me standardet e sistemit për periudhën referuese në përputhje me të gjithë indikatorët e pasaportës për reformën në administratën publike;

2.4 Bazën e të dhënave për vitin referues në zbatim të indikatorëve të pasaportës;

Faza 3: Konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga SASPAC-ja në Kryeministri;

Faza 4: Organizimi i mbledhjes së KDS për konsultimin e paketës së konsoliduar dhe marrjen e komenteve nga aktorët;

Faza 5: Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së Raportit të Monitorimit;

Faza 6: Publikimi i Raportit Vjetor;

Faza 7: Dërgimi i procedurave: a) shënimet e takimit; b) Konkluzionet operacionale) të mbledhjes së KDS-së dhe paketa finale/së bashku me linkun për njohje Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

- Metodologjia e vlerësimit të jashtëm dhe me pjesëmarrje

Procesi i vlerësimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë bazohet në një dokument me standardet e cilësisë për vlerësimin dhe monitorimin e politikave rinore²⁷ të përgatitur nga Forumi Rinor Evropian si edhe në një dokument të përgatitur nga SIGMA për vlerësimin e strategjisë së administratës publike²⁸ në Shqipëri. Ky dokumenti i fundit jep modelin se si duhen vlerësuar strategjitë

ndërsektoriale duke u bazuar në strategjinë e Reformës së Administratës Publike.

1. Masa e pestë e politikës që ka të bëjë me zbatimin dhe administrimin e strategjisë parashikon zhvillimin e mekanizmit për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë. Sipas këtij mekanizmi:

- Përmes një konference të përvitshme për rininë, mundësohet vlerësimi i SKR-së nga organizatat rinore dhe aktorë të tjerë në fushën e rinisë;

- Realizohet vlerësim i jashtëm i përvitshëm për zbatimin e SKR-së;

- Udhëzimet për buxhetimin gjinor dhe rinor, monitorimin, dhe vlerësimin zhvillohen për çdo nivel.

2. Dokumenti i përgatitur nga Forumi Rinor Evropian parashikon 8 standarde për vlerësimin e strategjive dhe secili standard ka treguesit e vet ku duhet bazuar vlerësimi.

Standardi 1: Qasja e bazuar në të drejtat ndaj politikës rinore

Treguesit

1. Të drejtat e të rinjve si koncept njihen në dokumentet përkatëse të politikave

2. Politika rinore është qartazi e ankoruar në vlerat universale apo pluraliste, demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe u drejtohet pozitivisht dhe në mënyrë të barabartë të gjithë të rinjve, pavarësisht nga gjinia, raca, grupi etnik etj.

3. Politika kombëtare për rininë miraton instrumentet ekzistuese ligjore për të drejtat e njeriut

4. Politika rinore i njeh të rinjtë jo si përfitues, por si bartës të të drejtave pjesëmarrëse. Kështu, ai vendos bartësit përkatës të detyrave si Shtetet Anëtare dhe aktorë të tjerë publikë, të cilët mund të mbahen përgjegjës për të drejtat e të rinjve.

Standardi 2: Politika rinore e bazuar në dëshmi

Treguesit

1. Rregullisht kryhen kërkime mbi kushtet e jetesës, aspiratat dhe perceptimet e grupeve përfaqësuese të të rinjve.

2. Të dhënat e kërkimit janë të pavarura dhe nuk manipulohen në të gjitha pjesët e ciklit të politikave.

3. Burimet e duhura (financiare, njerëzore) ndahen për kërkime në lidhje me të rinjtë.

4. Politika bazohet në informacione dhe kërkime të përditësuara.

²⁷ A Toolkit for Quality Standards on Youth Policy: <https://pip-eu.coe.int/documents/42128013/47262391/Toolkit+on+Quality+Standards+for+Youth+Policy+-+European+Youth+Forum.pdf/c5d10d1b-c704-e45a-50f6-e0ace956ae42>

²⁸ Dokument Koncepti mbi Sistemin e Monitorimit dhe të Vlerësimit për Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike të Shqipërisë, 2015: https://www.dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/Dokument_Koncepti_mbi_Sistemin_e_Monitorimit_dhe_te_Vleresimit.pdf

**Standardi 3: Politika rinore me pjesëmarrje Treguesit**

1. Të gjithë aktorët përkatës (organizatat e shoqërisë civile dhe sektorët e tjerë të shoqërisë) janë të përfshirë në të gjitha fazat e ciklit të politikave.

2. Organizatat rinore janë të përfshira në të gjitha fazat e ciklit të politikave.

3. Janë bërë përpjekje specifike nga autoritetet publike për të përfshirë të rinjtë e paorganizuar dhe të rinjtë me më pak mundësi gjatë gjithë ciklit të politikave.

Standardi 4: Politika rinore me shumë nivele**Treguesit**

1. Strategjia kombëtare për të rinjtë dhe politikat rinore pranojnë ekzistencën e kornizave të politikave në nivele të tjera.

2. Strategjia/objektivat e politikave për rininë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal janë të koordinuara dhe në këtë mënyrë plotësojnë dhe përforcohen reciprokisht

3. Masat e politikave rinore pasqyrojnë diversitetin gjeografik dhe socio-ekonomik brenda dhe ndërmjet njësisë të ndryshme administrative (si bashkitë, rajonet etj.).

Standardi 5: Politika strategjike rinore**Treguesit**

1. Ekziston një strategji gjithëpërfshirëse për të rinjtë.

2. Objektivat e strategjisë për të rinjtë janë të matshëm, me burime dhe të përcaktuara në kohë.

Standardi 6: Disponueshmëria e burimeve për politikat rinore**Treguesit**

1. Ka burime të mjaftueshme financiare të vëna në dispozicion nga qeveria për organizatat rinore, për të mbështetur zbatimin e politikave rinore.

2. Organizatat rinore dhe të rinjtë mbështeten me ngritjen e kapaciteteve nga autoritetet publike.

3. Ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore në dispozicion për autoritetet publike që punojnë në politikat rinore.

Standardi 7: Angazhimi politik dhe llogaridhënia në politikën rinore.**Treguesit**

1. Palët e ndryshme të interesit në procesin e krijimit të politikave marrin përgjegjësinë për veprimet e tyre dhe mund të mbahen përgjegjës për to.

2. Ka raportim publik nga politikëbërësit në të gjitha fazat e ciklit të politikave të politikës rinore në baza të rregullta.

3. Organizatat rinore po monitorojnë zbatimin e politikave rinore me qëllim që të sigurojnë plotësimin e nevojave dhe interesave të të rinjve.

Standardi 8: Politika ndërsektoriale rinore**Treguesit**

1. Ekziston një bashkëpunim efektiv dhe i koordinuar ndërmjet sektorëve, ministrive dhe subjekteve të tjera përkatëse.

2. Çështjet rinore përfshihen në fusha të ndryshme të politikave përkatëse, duke pranuar kështu që çështjet rinore janë horizontale.

3. Vlerësimi i politikës rinore përdoret si mekanizëm i të mësuarit nga kolegët për sektorë të ndryshëm të qeverisë.

3. Dokumenti i përgatitur nga SIGMA për vlerësimin e strategjive ndërsektoriale paraqet kornizën e vlerësimit dhe metodat se si duhet bërë ky proces duke i kushtuar rëndësi organizimit të brendshëm të punës brenda qeverisë dhe rregulloreve në bazë të të cilave bëhet monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë duke e venë theksin te:

- Struktura e menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit institucional

- Sistemi i monitorimit dhe raportimit për strategjinë

- Vlerësimi i politikave për strategjinë

- Procesin e monitorimit afat-mesëm të strategjisë

- Udhëzimin për raportimet 3 mujore

- Udhëzimin për raportimin vjetor

- Modelin e raporteve dhe kalendarin e veprimtarive të monitorimit



4. Vlerësimi dhe monitorimi si proces bazohen edhe në elementet e përcaktuara nga OECD në lidhje me këtë gjë të cilat përfshijnë elementët e tabelës së mëposhtme:

	Ex-ante	I ndërmjetëm	Ex-post
RËNDËSIA	- A do ta zgjidhë problemin ndërhyrja e synuar? - Cilave nevoja u përgjigjet ajo?	- A ka ndryshuar nevoja origjinale? - A kërkon ndryshimi një rregullim korrespondues të ndërhyrjes?	A ka arritur/prekur ndërhyrja grupin e synuar?
EFIKASITETI	- A ka të ngjarë që aktivitetet e parashikuara të çojnë në arritjen e objektivave? - Cilat janë kostot? A ka ndonjë mënyrë për ta ofruar programin me kosto më efektive?	- A garantojnë rezultatet e arritura deri tani se objektivat do të arrihen? - Cilët janë faktorët që ndikojnë në efektivitetin e pjesës x të ndërhyrjes?	- A janë zbatuar objektivat siç është planifikuar? - Cilat ishin arsyet për suksesin e madh/mosarritjen e objektivit x?
EFIÇENCA	- A është qasja e zgjedhur më efikase në kosto? - A janë të justifikuar mirë mekanizmi i zbatimit - strukturat dhe proceset?	- Si mund të rritet efikasiteti i procesit? - Çfarë procedurash institucionale duhet të thjeshtohen në mënyrë që zbatim të bëhet më efikas?	- A është realizuar aktiviteti x duke përdorur qasjen me kosto më efikase? - Sa e mirë ka qenë performanca e institucionit apo e procesit? - Çfarë mësimesh mund të nxirren?
NDIKIMI	- Cili është ndikimi i pritshëm i ndërhyrjes? - Cilat janë grupet e synuara të ndikimit?	A sjell ndërhyrja gjatë zbatimit disa efekte të padëshiruara?	- Cili është ndikimi i aktivitetit kundrejt pritshmërive? - Pse është ndikimi më i ulët /më i lartë se sa pritej?
QËNDRUESHMERIA	- A ka të ngjarë që ndikimi të jetë afatgjatë? - Cilat janë elementet që do ta garantojnë këtë?	- A ekzistojnë parakushtet për qëndrueshmërinë e objektivave? - Çfarë mund të bëhet për të grasatuar që ato ekzistojnë? - Cilët faktorë po ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e arritjeve?	- Cilat janë shanset që rezultatet do të zgjasin për një kohë të gjatë? - Cilat janë kostot e ardhshme të parashikuara për programin? - Cilat janë arsyet e qëndrueshmërisë së ulët të rezultateve?

Koordinimi i kuadrit strategjik

1. Struktura dhe nivelet

Strategjia Kombëtare e Rinisë përcakton një organizim institucional të menaxhimit dhe të monitorimit me disa niveleve duke filluar nga niveli politik, duke vazhduar me nivel teknike ndërsektorial dhe duke përfunduar me rolin e institucionit udhëheqës – Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MShRF).

Niveli i parë përbëhet nga institucioni kryesor - MShRF - që koordinon SKR-në në institucionet pjesëmarrëse me anë të Personave të Kontaktit (PK) të përcaktuar në çdo ministri dhe institucion varësie që lidhet për të

koordinuar zbatimin e SKR-së me MShRF. Kabineti i MShRF-së dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) , si institucion në varësi të MShRF-së, kanë për detyrë koordinimin e PKR-së. Funkcioni i nivelit të parë është menaxhimi operacional i SKR-së në baza ditore. Në bashkëpunim me personelin përgjegjës nëpër bashki AKR përgatit edhe raportet 2 mujore të monitorimit të aktiviteteve të strategjisë dhe i raporton ato pranë MShRF-së.

Niveli i dytë përbëhet nga Grupi Ndërqeveritar i Monitorimit të SKR-së. Ky grup është i nivelit të lartë i përbërë nga përfaqësuesit e emëruar zyrtarisht nga ministratë përkatëse. Ky

grup kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë. Çdo gjashtë muaj pranë këtij grupi dorëzohet një raport monitorimi i përgatitur nga AKR. Raporti diskutohet dhe grupi merr masa për zbatimin e përgjithshëm të strategjisë duke pasur fokusin në ndikimin e reformave edhe në kuadër të SKZHI-së.

Niveli i tretë përbëhet nga Konferenca Vjetore e Rinisë e cila bën vlerësimin vjetor të SKR-së përmes angazhimit të shoqatave dhe organizatave rinore. Procesi i përzgjedhjes përcaktohet me udhëzime të MSHRF-së dhe organizatat e përzgjedhura mund të bashkëpunojnë edhe organizata ndërkombëtare në fushën e rinisë dhe donatorë për të mbështetur realizimin e konferencës dhe procesin e vlerësimit vjetor të SKR-së.

Një përmbledhje e listës së treguesve / indikatorëve për Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 paraqitet në fund të këtij dokumenti.

PJESA V: Plani i Veprimit dhe Vlerësimet Financiare

Plani i detajuar i veprimit është bashkangjitur si aneks i këtij dokumenti strategjik dhe është hartuar në përputhje me metodologjinë e sistemit IPSIS. Plani i Veprimit është kostuar, dhe buxhetet e detajuara parashikohen në të njëjtën mënyrë në sistemin IPSIS, duke ofruar edhe ndarjen e duhur për programet buxhetore, edhe sipas institucioneve.

Ky kapitull i Strategjisë Ndërsektoriale të Rinisë përmban informacion në lidhje me

financimin e këtij dokumenti duke e specifikuar sipas financimit që nevojitet për secilin nga qëllimet, në mënyrë që të realizohen secili prej tyre.


Më specifikisht, në këtë pjesë të strategjisë fillimisht jepet shpërndarja e burimeve sipas qëllimeve të politikës, si dhe nevojat e paplotësuara me financim ose hendeku financiar për secilin nga qëllimet. Hendeku i financimit mund të mbulohet direkt nga buxheti i shtetit, donatorët nëpërmjet granteve apo edhe fonde të tjera të asistencës teknike.

Siç edhe është përmendur më lart, strategjia ka 3 qëllime politike dhe MSHRF do jetë institucioni përgjegjës për të koordinuar veprimet dhe për të bërë të mundur që masat e parashikuara në strategji të realizohen me sukses.

Për sa i përket hendekut të financimit, pjesa më e madhe e tij përbëhet nga shpenzimet për programe, platformën “Të Rinjtë për të Rinjtë” dhe baza të dhënash, ngritje kapacitetesh, punonjës të rinj në institucione si AKR dhe INSTAT dhe infrastruktura apo pajisjet e nevojshme për realizimin sa më të mirë të punës së tyre, dhe studim i situatës për çështje të ndryshme.

Kosto totale e strategjisë për të tetë vitet është **5,570,086,793** lekë dhe hendeku financiar është 18.6%. Hendeku financiar në total është - **1,040,395,542** lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet hendeku financiar për secilin nga qëllimet e politikës.

Grafiku 1: Hendeku financiar për çdo qëllim politike



Siç shihet edhe në grafik 64% e hendekut përbëhet nga fondet që duhen për të realizuar qëllimin e parë, 20.5% e hendekut përbëhet nga fondet që duhen për të realizuar qëllimin e dytë dhe 15.5% janë fondet që duhen për të realizuar qëllimin e tretë të politikës.

NEVOJAT PËR SHPENZIME KAPITALE DHE SHPENZIME KORENTE


Nevojat për shpenzimet korrentedhe kapitale janë identifikuar pasi u përcaktuan qëllimet e politikës, objektivat specifike dhe treguesit përkatës të performancës me pikësnyimet dhe vlerat përkatëse të tyre për periudhën 2022–2029. Tri qëllimet e politikës për të cilat janë identifikuar edhe shpenzimet përkatëse, janë:

1. Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore – të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar.

2. Edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) dhe novacioni – rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor, mbështetur nga shërbimet e këshillimit për punësim dhe orientimit në karrierë me prirje nga të rinjtë; rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor.

3. Mirëqenia dhe përfshirja – mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Grafiku 2: Përbërja e kostove sipas burimit të financimit




Siç vihet re, 71 % e kostove mbulohen nga buxheti i shtetit dhe lidhen me pagat, investimet kapitale dhe grantet që qeveria jep nëpërmjet AKR, KOKSH (Ministria e Arsimit dhe Sportit), Fondet për Startup, politikë që zbatohet nga Ministri i Shtetit për Mbështetjen e Sipërmarrjes apo edhe fonde që mbështesin iniciativat si zgjerimi i njohurive për kodimin, 10.3% financohet nga donatorët si organizatat e UN (UNICEF, UNFPA), fondet e BE, RYCO, AADF etj. dhe 18.7% janë kosto të pambuluara.

Hendeku financiar përbëhet kryesisht nga shpenzimet për krijimin e portalit Të Rinjtë për Të Rinjtë, bazës së të dhënave për rininë, studimet e situatës aktuale dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve që merren dhe janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave rinore. Gjithashtu, në hendek përfshihen edhe nevojat për grantdhënie për organizatat rinore në mënyrë që ato të jenë sa më aktive dhe të kontribuojnë drejtpërdrejtë në informimin, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e të rejave dhe të rinjve.

Bazuar në klasifikimin ekonomik, 77% e koston totale përbëhet nga shpenzimet korrente dhe 23% përbëhet nga shpenzimet kapitale.


Grafiku 3: Përbërja e kostos totale bazuar te klasifikimi ekonomik



Pjesa më e madhe e shpenzimeve korrentepërbëhet nga shpenzimet e tjera korente. Pjesa tjetër janë pagat dhe shpenzimet e punonjësve të AKR, MSHRF, punonjësit rinorë pranë 61 bashkive apo punonjës të institucioneve të tjera buxhetore.


Duke pasur parasysh se në strategji janë paraqitur tri qëllime politikë, më poshtë jepet kostoja për secilin nga këto qëllime

Grafiku 4: Kosto sipas qëllimeve të politikës




Kostot e realizimit të qëllimit të parë janë 36.6% e kostove totale. Peshën më të madhe e zënë kostot për realizimin e qëllimit të dytë të politikës që zënë rreth 56.7% të kostove totale. Ndërkohë kostot e realizimit të qëllimit të tretë zënë 6.7% të kostove totale

Grafiku 5: Përmbledhje e burimeve të financimit për tri qëllimet e politikës



Për të tria qëllimet e politikës janë identifikuar në total 9 objektiva specifike. Grafiku i mëposhtëm jep peshën që zë çdo objektiv në koston totale të llogaritur për strategjinë.

Grafiku 6: Peshë e objektivave specifike në koston totale të strategjisë



Siç shihet edhe nga grafiku, objektivi 1.1 dhe objektivi 2.1 kanë peshën më të madhe të shpenzimeve totale me përkatësisht 41% dhe 21.73%. Këta objektive janë të lidhur drejtpërdrejtë me mbështetjen që jepet nga buxheti i shtetit për organizatat rinore dhe institucionet e tjera që merren me rininë dhe me mbështetjen me grantdhënie për vënien në zbatim të politikave rinore. Objektivi 3.3 dhe objektivi 2.3 kanë peshat më të vogla me 0.83% dhe 0.84%.

Nëse analizohen fondet që duhen për të realizuar secilin qëllim të politikës, duke u bazuar te pesha që kanë objektivat te qëllimi, vihet re se për Qëllimin e parë, objektivi i tretë nuk ka financim nga donatorët. Ndërkohë, hendekun financiar më të lartë e ka objektivi 1.1.

Objektivi Specifik	Kosto Totale	Burimi i mbulimit deri në 2029		Hendeku financiar 2022-2029 (në Lekë)
		Buxheti i Shtetit	Fondet e Donatorëve	
I. Specific Objective Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	1,210,512,841	932,427,904	14,290,000	-263,794,937
Specific Objective 2 Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	668,536,102	302,369,622	102,000,000	-264,166,480
Specific Objective 3 Studimet rinore zhvillohen dhe bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	160,157,718	23,556,902	0	-136,600,816
Kosto totale Qëllimi i Politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3)	2,039,206,661	1,258,354,428	116,290,000	-664,562,233

Tek objektivi i parë përfshihet mbështetja që u jepet institucioneve dhe organizatave për tu bërë më aktive. Fokusi është te krijimi dhe bërja plotësisht funksionale e KVR dhe KKR. Mbështetja e donatorëve është e ndjeshme dhe e dukshme tek objektivi i dytë që lidhet me koordinimin e politikës rinore. Të tre objektivat kanë hendek financiar që pritet të mbulohet kryesisht me mbështetjen e donatorëve dhe më pak me mbështetjen e buxhetit të shtetit. Gjithashtu, një pjesë e kostove lidhet me mirëfunksionimin e AKR

Ndërkohë nëse analizohet financimi i objektivave të qëllimit të dytë, mund të thuhet se për të tre objektivat e qëllimit ka financim nga donatorët. Objektivi i parë ka vlerën më të lartë të financimit nga donatorët. Te këta objektiva vihet fokusi tek aftësitë digjitale të të rinjve dhe rritja e mëtejshme e tyre dhe informimin dhe aftësimin e studentëve për të bërë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë aktive.



Objektivi Specifik	Kosto Totale	Burimi i mbulimit deri ne 2029		Hendeku financiar 2022-2029 (në Lekë)
		Buxheti i Shtetit	Fondet e Donatorëve	
Objektivi Specifik 1 Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomiksht aktive	2,283,870,421	1,686,515,139	435,000,000	-162,355,282
2.2 Objektivi Specifik 2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuar cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.	826,935,027	792,489,027	14,000,000	-20,446,000
2.3 Objektivi Specifik 3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës	46,539,280	13,021,312	3,000,000	-30,517,968
Kosto totale Qëllimi i Politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)	3,157,344,728	2,492,025,478	452,000,000	-213,319,250

Për sa i përket hendekut financiar, objektivi i parë ka hendekun financiar më të madhe në vlerë dhe në përqindje ndaj totalit të koston së qëllimit. Pra, vihet re se ka nevojë të madhe për të financuar politikën që i mirinformojnë të rinjtë për mundësitë që kanë kur kalojnë në jetën aktive.. Gjithashtu, te ky qëllim përfshihen edhe shpenzimet në lidhje me novacionin dhe digjitalizimin. Gjithashtu, masa shumë të rëndësishme që kanë nevojë për financim janë edhe masat që lidhen me lehtësitë që mund të krijohen për të rinjtë për të lëvizur brenda dhe jashtë vendit.

Te qëllimi i tretë vetëm një nga tre objektivat ka financim nga donatorët në një vlerë relativisht të vogël. Ky qëllim përfshin masat që do ndërmerren për të përmirësuar Mirëqenien dhe Përfshirjen e të rinjve.

Objektivi Specifik	Kosto Totale	Burimi i mbulimit deri ne 2029		Hendeku financiar 2022-2029 (në Lekë)
		Buxheti i Shtetit	Fondet e Donatorëve	
3.1 Objektivi Specifik 3.1 Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale	165,967,773	115,318,936	0	-50,648,837
3.2 Objektivi Specifik 2: Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	161,297,116	85,214,170	4,800,000	-71,282,946
3.3 Objektivi Specifik 3: Të rejtat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimin në tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.	46,270,515	5,688,239	0	-40,582,276
Kosto totale Qëllimi i Politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2+3.3)	373,535,404	206,221,345	4,800,000	-162,514,059

Në këtë qëllim, përfshihen masat për të ndihmuar dhe nxitur të rinjtë që të kenë sjellje sa më të mira në shoqëri, larg ekstremizmit dhe dhunës, përfshihen masa për të rritur marrjen me sport e të rinjve dhe për të nxitur marrjen me sporte të ndryshme në të gjitha nivelet. Për këtë kërkohen financime për të krijuar hapësira miqësore me të rinjtë dhe për të krijuar sa më shumë terren.



Aneks: Plani i Veprimit i kostuar

	Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar								
Qëllimi i politikës I									
	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto totale	Burimi i mbulimit deri më 2029			
Objektivi specifik	Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Total kosto	Buxheti i Shtetit	Fondet e donatorëve	Hendeku financiar 2022-2029 (në lekë)	Financing Gap EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 121 ALL)
						Total BSH	Total FH		
I. Objektivi specifik: Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF, AKR	AKPA, njësitë e qeverisjes vendore, KQZ, MAS	2022	2029	1,210,512,841	932,427,904	14,290,000	-263,794,937	-2,180,123
Objektivi specifik: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF, AKR	MFE, Ministrinë e Linjës	2022	2029	668,536,102	302,369,622	102,000,000	-264,166,480	-2,183,194
Objektivi specifik: Studimet rinore dhe të dhënat për rininë nxiten të zhvillohen dhe të bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	MSHRF, AKR	• MiSHMS, INSTAT, AKPA	2023	2029	160,157,718	23,556,902	0	-136,600,816	-1,128,932
Kosto totale qëllimi i politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3)					2,039,206,661	1,258,354,428	116,290,000	-664,562,233	-5,492,250



Qëllimi i politikës II	Edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity) dhe novacioni Rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor, mbështetur nga shërbimet e këshillimit për punësim dhe orientimit në karrierë me prirje nga të rinjtë; rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor								
Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto totale Total kosto	Burimi i mbulimit deri në 2029		Hendeku financiar 2022-2029 (në lekë)	Financing Gap EUR (kursi kembimit: 1 EUR = 121 ALL)
	Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit		Buxheti i Shtetit	Fondet e donatorëve		
						Total BSH	Total FH		
Objektivi specifik 1: Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomiksht aktive	MSHRF, MFE, AKPA	MAS, MiSHMS, AKR, MAS, RASH, Njësitë e Qeverishes Vendore, MIE	2022	2029	2,283,870,421	1,686,515,139	435,000,000	-162,355,282	-1,341,779
2.2 Objektivi specifik 2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuar cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.	MSHRF, MAS, AKR	MFE, AKPA, AKSHI, RASH, AKCESK	2023	2029	826,935,027	792,489,027	14,000,000	-20,446,000	-168,975
2.3 Objektivi specifik 3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHR, MFE, MAS	MiSHMS, AKR, AKPA, AKAPFK	2023	2029	46,539,280	13,021,312	3,000,000	-30,517,968	-252,215
Kosto totale qëllimi i politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)			2022	2029	3,157,344,728	2,492,025,478	452,000,000	-213,319,250	-1,762,969



Qëllimi i politikës III	Mirëqenia dhe përfshirja Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve/rejave në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)								
	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto totale	Burimi i mbulimit deri në 2029		Hendeku financiar 2022-2029 (në Lekë)	Financing Gap EUR (kursi kembimit: 1 EUR = 121 ALL)
	Institucioni drejtues	Institucionet pjesmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit		Buxheti i Shtetit	Fondet e Donatorëve		
3.1 Objektivi specifik 3.1: Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale	MSHRF, AKR, MAS, MD dhe MB	AKSHI, AKCESK, AMA, Agjencia e Mbrojtjes së Të Drejtave të Fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Bashkitë	2022	2029	165,967,773	115,318,936	0	-50,648,837	-418,585
3.2 Objektivi specifik 2: Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF dhe MSHMS	AKR, ISHP	2022	2029	161,297,116	85,214,170	4,800,000	-71,282,946	-589,115
3.3 Objektivi specifik 3: Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimi në tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.	MSHRF, MSHMS dhe MIE	AKR, AMMV, Bashkitë, MAS, MSHMS, MB, MD, ASCAP	2022	2029	46,270,515	5,688,239	0	-40,582,276	-335,391
Kosto totale qëllimi i politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2+3.3)			2022	2029	373,535,404	206,221,345	4,800,000	-162,514,059	-1,343,091
Kosto totale Strategjia Ndërsektoriale e Rinisë					5,570,086,793	3,956,601,251	573,090,000	-1,040,395,542	-8,598,310



Treguesit e monitorimit të dokumentit të Strategjisë

Treguesit e monitorimit të SKR-së do të bazohen në përdorimin e një numri treguesish kryesorë të performancës në lidhje me qëllimet e politikës dhe objektivat specifike të planit të veprimit, siç pasqyrohen në këtë të fundit. Progresi i zbatimit të SKR-së do të monitorohet dhe vlerësohet duke matur periodikisht treguesit, të cilët janë vendosur në përputhje me qëllimet dhe objektivat e politikës përkatëse. Më poshtë tabela e tregueseve kryesorë të performancës sipas tri qëllimeve të politikës të SKR-së.

Tabela 21: Treguesit e Monitorimit të SKR-së 2022–29

Nr.	Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar 2029	Burimi i verifikimit
Qëllimi i politikës 1: Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar				
1.	Indeksi botëror i zhvillimit të rinisë	2020 0.764/1	0.8/1	Raporti Vjetor i Commonwealth “Raporti Vjetor i Zhvillimit të Rinisë”
2.	% e të rinjve që raportojnë se ndihen të përfaqësuar në politikat rinore të zbatuara në nivel qendror/vendor	2020 20%	80%	Raport specifik i studimit “Përfaqësimi i të rinjve në politikat rinore në nivel qendror dhe vendor” Sondazhi i MSHFR
3.	% e buxhetit të shtetit dedikuar për programet mbi rininë	2021 0.05%	2.4%	Raportet e MFE/ MSHRF
OS1.1a	% e bashkive ku janë ngritur qendrat rinore multifunksionale	2022 16%	100%	Raportet e AKR
1.1b	Numri i këshillave vendorë të ngritur dhe funksionale (në nivel bashkie)	2022 21 Bashki	100%	Raportet e AKR
1.1.c	Ligji “Për rininë” i rishikuar dhe miratuar	2021 Ligji jo i rishikuar	Ligji i rishikuar dhe miratuar	Raportet e MSHRF
1.1 d	Ligji “Për vullnetarizmin” i rishikuar dhe miratuar	2021 Ligji jo i rishikuar	Ligji i rishikuar dhe miratuar	Raportet e AKPA, MFE, MSHRF
1.2 a	Numri/përqindja i/e bashkive që kanë ngritur kënde digjitale të informimit rinor (info-points)	2022 2 bashki/ 3.27%	100%	Raportet e AKR
1.2 b	Platforma rinore “Të rinjtë për të rinjtë” e ngritur, funksionale dhe e përditësuar	2021 Platforma jo e ngritur	Platforma e ngritur, funksionale dhe e rishikuar	Raportet e AKR
1.3 a	Politikat zhvillimore rinore të hartuara bazuar në analizë	2021 -	8	Të dhënat e MSHRF, AKR
Qëllimi i politikës 2: Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.				
2.1.a	Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë	2021 52.5% e të rinjve nga të cilët 58.6% meshkuj dhe 46.3 % femra	60% e të rinjve	Të dhënat e INSTAT-it
2.2.a	Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimore	2021 4347 të rinj	Trend rritës	Të dhënat e MAS, AKKSHI, AKPA
2.3.a	Shkalla e papunësisë së të rinjve	2021	18.3% e të	Të dhënat e INSTAT-it



	(%) të ndarë sipas gjinisë	20.9% e të rinjve nga të cilët 20.5% meshkuj dhe 21.4 5 femra	rinjve	
2.3.b	% e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	2021 45%	Trend rritës	Të dhënat e AKPA
2.3.c	% e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit.	2019 26%	5% mbi vitin paraardhës	Raportet e studimeve të kryera nga MSHRF, MFE organizata
Qëllimi i politikave 3: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)				
3	Indeksi i progresit të të rinjve	2020 68.49/100	55/100	Raport vjetor i European Youth Forum (Forumi Evropian i të Rinjve)
3.2.a	% e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme	2021 -	5% rritje mbi vitin paraardhës	Sondazhi i kyer nga MSHRF
3.2.b	% e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për rininë	2021 -	5% rritje mbi vitin paraardhës	Të dhënat e MSHMS
3.2.c	% e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë	2021 -	5% rritje mbi vitin paraardhës	Të dhënat e MSHMS; ASPA



Plani i Veprimit SKR 2022-29

I. QËLLIMI I POLITIKAVE I: Fuqizimi organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore															
Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar															
Nr.	Titulli	Institucion i udhëheqës	Institucionet kontribuuese	Perioda e zbatimit		Kosto indikative			Burimi					Hendeku Financiar	
				Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korrente	Kapitale	Kosto totale	Korrente	PBA Kapital e	Total BSH	Korrent e	Kapital e		Financim i huaj Total FH
1.1	I. Objektivi Specifik Të rinjtë janë të mirëinformuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike	MSHRF, AKR	AKPA, NjVV, KQZ, MAS	2022	2029										
1.1.1	1.1.1 Masa 1 Rishikohet Ligji për Rininë për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej proceset e krijimit të organizatave rinore, përfaqësimit rinor, punës rinore dhe ofrimit të shërbimeve të pranueshme e miqësore për të rinjtë.	MSHRF	AKR	2022	2024	9,570,840	0	9,570,840			4,830,840			1,140,000	-3,600,000
1.1.2	1.1.2 Masa 2. Forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të reja dhe të rinjve në vendimmarrje	MSHRF	AKR, AMVV, NjVV	2023	2029	34,701,722	0	34,701,722			501,522			0	-34,200,200
1.1.3	1.1.3. Masa 3 Përmes platformës rinore “Të rinjtë për të Rinjtë” dhe formave të tjera të komunikimit social shpërndahen informacione dhe udhëzues për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.	MSHRF	AKR, AKPA, AKSHI	2023	2029	39,426,240	264,500	39,690,740			10,180,800			0	-29,509,940
1.1.4	1.1.4. Masa 4 AKR mbështet me anë të një programit grantesh organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes ngritjes së infrastrukturës për qendra rinore dhe hapësira për të rinjtë	MSHRF	MFE, AKR	2022	2029	621,584,000	400,000,000	1,021,584,000			914,904,000			11,350,000	-95,330,000
1.1.5	1.1.5. Masa 5. Nxitet zhvillimi i një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë nxënësit dhe mbështetet bërja sa më aktive e Këshillave Studentore / Qeverive të Nxënësve dhe organizimeve të tjera të nxënësve	AKR	MAS	2023	2029	51,500,000	0	51,500,000			0			1,800,000	-49,700,000
1.1.6	1.1.6 Masa 6. Rritet ndërgjegjësimi politik i të rinjve dhe në veçanti i vajzave dhe grave të reja, nëpërmjet promovimit të programeve të edukimit të votuesve dhe nismave të tjera ndërgjegjësuase	KQZ	MSHRF	2023	2029	38,927,503	0	38,927,503			144,706			0	-38,782,797
1.1.7	1.1.7 Masa 7 Promovohet dhe mbështetet e drejta e të reja dhe të rinjve për barazi dhe gjithëpërfshirje për vetë-shprehje në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor	AKR	MSHMS	2023	2029	11,524,541	0	11,524,541			1,444,541			0	-10,080,000
1.1.8	1.1.8 Masa 8 Rishikohet ligji “Për vullnetarizmin” me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të reja/rinjve)	MSHRF	MFE, AKPA	2022	2023	1,678,096	0	1,678,096			418,096			0	-1,260,000
1.1.9	1.1.9 Masa 9 Në përputhje me ligjet dhe VKM për njohjen e përvojës së punës dhe mësimin informal dhe joformal njihen kompetencat e fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore bazuar në përcaktimet e profesioneve të punës së të rinjve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe klasifikimit të profesionëve (European Youth Work Portfolio)	MSHRF	AKR, AKPA, MFE, AKAFPK	2022	2023	1,335,399	0	1,335,399			3,399			0	-1,332,000
	Kosto Indikativë e Objektivit 1.1					810,248,341	400,264,500	1,210,512,841	0	0	932,427,904	0	0	14,290,000	-263,794,937



1.2	Objektivi Specifik 2 Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.	MSHRF, AKR	MFE, Ministrinë e Linjës	2022	2029										
1.2.1	1.2.1 Masa 1 Fuqizohen rolet zbatuese, koordinuese, monitoruese të AKR përmes fuqizimit të saj me burime financiare dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e politikave sektoriale për rininë të pasqyruara në këtë strategji.	MSHRF	AKR	2022	2029	86,859,780	1,322,500	88,182,280			3,009,300		0	-85,172,980	
1.2.2	1.2.2 Masa 2 Përmes AKR sigurohen fonde për rritjen e prezencës së Shqipërisë në proceset e politikëbërjes rinore si në nivel rajonal, evropian dhe global.	MSHRF	AKR	2023	2029	426,681,918	264,500	426,946,418			291,533,118		3,600,000	-131,813,300	
1.2.3	1.2.3 Masa 3 Bazuar në konceptin Të Rinjtë për Të Rinjtë zhvillohen dhe aplikohen shërbime mbështetëse dhe të informacionit për të rinjtë dhe rininë. Në këtë portal krijohet një platformë informimi dhe shërbimesh për të rinjtë dhe organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë në funksion të mbështetjes dhe orientimit drejt nismave përkrahëse që mbështesin formimin, punësimin, edukimin, mirëqenien, zhvillimin dhe aktivizimin e tyre.	AKR	AKPA	2023	2029	18,222,054	17,710,000	35,932,054			7,502,054		0	-28,430,000	
1.2.4	1.2.4 Masa 4 Fuqizohen kapacitetet e politikëbërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë dhe zbatimin e politikave rinore bazuar në konceptin e shërbimeve miqësore dhe të pranueshme nga të rejt dhe të rinjtë dhe forcohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e politikave rinore	MSHRF	AKR, AKPA, ASPA	2022	2029	117,475,350	0	117,475,350			325,150		98,400,000	-18,750,200	
	Kosto Objektivi specifik 1.2					649,239,102	19,297,000	668,536,102	0	0	302,369,622	0	0	102,000,000	-264,166,480
1.3	Objektivi specifik 3 Studimet rinore dhe të dhënat për rininë nxiten të zhvillohen dhe të bëhen pjesë e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë dhe referenca për zhvillimet e mëtejshme në fushën e rinisë.	MSHRF, AKR	• MiSHMS, INSTAT	2023	2029										
1.3.1	1.3.1 Masa 1. Krijohen baza të dhënash statistikore dhe studimore për rininë në Shqipëri përmes forcimit të kërkimit shkencor rreth rinisë si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe fuqizohet studimi i rinisë si fushë akademike dhe shkencore	MSHRF	INSTAT, AKR, IAL, AKPA	2022	2029	109,271,820	529,000	109,800,820			0		0	-109,800,820	
1.3.2	1.3.2 Masa 2 Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare	MSHRF	MFE, AKPA, INSTAT	2022	2023	10,503,968	0	10,503,968			135,972		0	-10,367,996	
1.3.2	1.3.3 Masa 3 Në përputhje me ligjin për rininë dhe VKM-të zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për rininë duke përfunduar edhe nga proceset e digitalizimit të shërbimeve publike.	AKR	MSHRF, MFE, AKSHI	2022	2029	39,852,930	0	39,852,930			23,420,930		0	-16,432,000	
	Kosto Objektivi specifik 1.3					159,628,718	529,000	160,157,718	0	0	23,556,902	0	0	0	-136,600,816
Kosto totale qëllimi i politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3)						1,619,116,161	420,090,500	2,039,206,661	0	0	1,258,354,428	0	0	116,290,000	-664,562,233



I. ZHVILLIMI STRATEGJIK (DUHEN IDENTIFIKUAR PAS PLOTËSIMIT TË MASAVE): FAZA II

II. QËLLIMI I POLITIKAVE II: Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity)

Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës

III. PROGRAMET BUXHETORE DUHET TË IDENTIFIKOHEN PËR ÇDO MASË/REKOMANDIM : FAZA I

Nr.	Titulli	Institucionet përgjegjëse		Periudha e zbatimit		Kosto indikative			Burimi						Hendeku Financiar
		Institucion i udhëheqës	Institucionet kontribuuese	Data e fillimit	Data e mbarimit	Korrente	Kapitale	Kosto totale	PBA			Financim i huaj			
									Korrente	Kapitale	Total BSH	Korrente	Kapitale	Total FH	
2.1	Objektivi Specifik 1 Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomiksht aktive	MSHRF, MFE, AKPA	MAS, MSHMS, AKR, MAS, RASH, Njësitë e Qeverisjes Vendore, MIE	2022	2029										
2.1.1	2.1.1 Masa 1. Bashkërendohet Politika Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë duke rritur nivelin e punësueshmërisë rinore, punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve përmes angazhimit dhe ndërrimit të këshillave vendorë rinorë, ndërmarrjeve dhe startup-eve.	MSHRF	AKR, AKPA, MFE	2022	2029	28,205,086	839,346,000	867,551,086			405,982,286			435,000,000	-26,568,800
2.1.2	2.1.2 Masa 2 Nxitet dhe forcohet punësimi rinor në fushën e TIK dhe digitalizimit përmes zhvillimit të programeve të aftësimit në kodim, TIK dhe digitalizim bazuar në studimet e tregut dhe zhvillimit të punësimit në këtë fushë si në Shqipëri dhe me gjerë.	MSHRF	AKR, AKPA	2022	2029	17,753,136	0	17,753,136			5,710,656			0	-12,042,480
2.1.3	2.1.3 Masa 3 Përmes institucioneve arsimore dhe aftësuese zhvillohen shërbime inovative dhe digitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë mëqësore për të rinjtë dhe në respektim të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor.	AKPA	AKR, MSHMS, MFE, MAS, RASH, MSHRF	2023	2029	73,436,000	2,070,000	75,506,000			72,140,000			0	-3,366,000
2.1.4	2.1.4 Masa 4 Nxitet dhe forcohet novacioni përmes sipërmarrjeve rinore dhe nga të rinjtë duke e vënë novacionin rinor në fokus të kuartrit ligjor dhe politikave publike të Start Up-eve, politikave të punësimit dhe mbështetjes së nismave si co-working spaces	MSHMS	AKR, MSHRF, MAS, RASH, NjVV, AKPA	2023	2026	1,204,356,000	414,000	1,204,770,000			1,200,000,000			0	-4,770,000
2.1.5	2.1.5 Masa 5 Përmirësohen programet dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë e të rinjve, dhe bashkëpunimin mes tyre brenda vendit e më gjerë	MSHRF	MIE	2023	2026	21,042,304	0	21,042,304			2,130,303			0	-18,912,001
2.1.6	2.1.6 Masa 6 Lehtësohet transporti publik ndërrqytetas për të rinjtë, duke rritur lëvizshmërinë e tyre në qarqe.	MSHFR	MIE, NjVV	2024	2029	97,247,894	0	97,247,894			551,894			0	-96,696,000
	Kosto Objektivi specifik 2.1					1,442,040,421	841,830,000	2,283,870,421	0	0	1,686,515,139	0	0	435,000,000	-162,355,282
2.2	2.2 Objektivi Specifik 2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuar cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyete të tyre.	MSHRF, MAS, AKR	MEF, AKPA, AKSHI, RASH, AKCESK	2023	2029										
	2.2.1. Masa 1 Mbështeten të rejtat dhe të rinjtë në pikat kritike të zhvillimit si kalimi në shkollën e mesme të lartë dhe kalimi nga shkolla në tregun e punës ose në studimet e nivelit universitar me këshillim dhe informacione që lidhin përzgjedhjen e fushës së arsimimit me mundësitë në tregun e punës në bashkërendim me masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021 – 26 dhe Stategjinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë	MAS	AKR, MSHRF, MEFJ, SASPAC, AKPA	2023	2029	25,451,128	0	25,451,128			560,728			14,000,000	-10,890,400
2.2.2	2.2.2 Masa 2 Promovohet përdorimi i sigurt i teknologjive të reja dhe mbështeten përvetësimi i aftësive dhe kompetencave digitale të shekullit të 21-të për të rinjtë si në sistemin	AKR	AKCESK, MB, AKSHI	2022	2023	3,875,995	0	3,875,995			1,520,395			0	-2,355,600



	arsimor të përgjithshëm dhe atë profesional ashtu edhe në sistemin e trajnimeve formale dhe joformale.													
2.2.3	2.2.3 Masa 3 Mbështeten dhe zhvillohen programe të seksioneve sportive amatore, arteve, artizanatit dhe aktiviteteve të tjera jashtë-kurrikulare që synojnë zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme, me fokus të veçantë tek të rejtat.	MAS, MSHRF, KOKSH	NjVV	2023	2029	797,607,904	0	797,607,904			790,407,904		0	-7,200,000
	Kosto Objektivi specifik 2.2					826,935,027	0	826,935,027	0	0	792,489,027	0	0	14,000,000
2.3	2.3 Objektivi specifik 3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rinjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.	MSHRF, MFE, MAS	MSHMS, AKR, AKPA, AKAPFK	2023	2029									
2.3.1	2.3.1 Masa 1 Nsiten punët e denja dhe të përshtatshme për të rejtat dhe të rinjtë përmes politikave të punësimit, miqësore dhe të orientuara nga të rinjtë që kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës për të rejtat dhe të rinjtë dhe që sigurojnë qasje novative dhe digjitale në informacionet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e punësimit	MSHRF	AKR, MFE, AKPA, AKAPFK	2023	2029	11,659,192	0	11,659,192			1,817,592		0	-9,841,600
2.3.2	2.3.2 Masa 2 Sigurohet mbështetje e përshtatshme dhe miqësore për të rinjtë dhe të rejtat e në veçanti për ata me aftësi të kufizuara mbi punësueshmërinë e tyre, punësimin dhe sipërmarrjen rinore.	MSHRF	AKR, MSHMS, MFE, AKPA	2027	2029	6,261,844	0	6,261,844			601,860		0	-5,659,984
2.3.3	2.3.3 Masa 3 Nsitet dhe promovohet novacioni në tregun e punës për punësimin me kohë të pjesshme të orientuar nga të rejtat.	MSHRF	AKR, MFE, AKPA, AKAPFK	2027	2029	6,261,844	0	6,261,844			601,860		0	-5,659,984
2.3.4	2.3.4 Masa 4 Fuqizohen qasjet e integruara për të mbështetur të rinjtë që rrethojnë linien e parakolshme të shkollimit dhe pa mbështetje për shkollim në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit (Garancia Rinore dhe UNICEF)	MSHRF	AKR, AKPA, ASCAP	2023	2029	22,356,400	0	22,356,400			10,000,000		3,000,000	-9,356,400
	Kosto Objektivi specifik 2.3					46,539,280	0	46,539,280	0	0	13,021,312	0	0	3,000,000
	Kosto totale qëllimi I politikës I (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)					2,315,514,728	841,830,000	3,157,344,728	0	0	2,492,025,478	0	0	452,000,000

I. ZHVILLIMI STRATEGJIK (DUHEN IDENTIFIKUAR PAS PLOTËSIMIT TË MASAVE): FAZA II

III. QËLLIMI I POLITIKAVE II – Mirëqenia dhe Përfshirja

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejtave / të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejtave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)

III. PROGRAMET BUXHETORE DUHET TË IDENTIFIKOHEN PËR ÇDO MASË/REKOMANDIM : FAZA I

Nr.	Titulli	Institucionet përgjegjëse		Periodua e zbatimit		Kosto indikative			Burimi						Hendeku Financiar
		Institucion udhëheqës	Institucionet kontribuuese	Data e fillimit	Data e mbarimit	Korrente	Kapitale	Kosto totale	PBA			Financim i huaj			
									Korrente	Kapital e	Total BSH	Korrent e	Kapital e	Total FH	
3.1	3.1 Objektivi Specifik 3.1 Mbrojtja mbështetje dhe siguria e të rejtave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale	MSHRF, AKR, MAS, MD dhe MB	-AKSHI, AKCESK, AMA, Agjencia e Mbrojtjes së të Drejtave të Femijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, NjVV	2022	2029										
3.1.1	3.1.1 Masa 1. Bashkërendohet zbatimi i Strategjive dhe programeve Kombëtare të Mbrojtjes dhe Sigurisë me një fokus të veçantë te prezenca virtuale e të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta, krimi kibernetik dhe bullizmi online (digjital).	MSHRF	AKR, MB, MM, MD, MAS, AKSHI, AKCESK, AMA, Agjencia e Mbrojtjes së të Drejtave të Femijëve	2023	2029	21,452,835	1,150,000	22,602,835			4,326,834			0	-18,276,001



3.1.2	3.1.2 Masa 2. Fuqizohen programet që trajtojnë çështjet e rreziqet e sigurisë me të cilat përballen të rejtat dhe të rinjtë e trafikuar, rreziqet e formave të ndryshme të krimin dhe, parandalimi dhe luftimi i dhunës seksuale me bazë gjinore dhe dhunës nga partneri ndaj grave të reja dhe parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore/të rinjve.	MB	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	2023	2029	11,097,172	0	11,097,172		4,845,940		0	-6,251,232
3.1.3	3.1.3 Masa 3. Fuqizohen programet që u mundësojnë të rinjtë të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën duke propozuar të ashtuquajturat "strategji të daljes".	MSHRF	AKR, MB, NjVV	2023	2029	1,415,589	0	1,415,589		47,586		0	-1,368,003
3.1.4	3.1.4 Masa 4. Promovohen programet për të rinjtë në masa reformuese duke vendosur mekanizma rëntegrimi dhe mbështetje për trajtimin e afësive për punësim, integrimin përmes punës në komunitet dhe mbështetje psikologjike dhe sipërmarrjeve sociale	MD	MSHRF, MSHMS, NjVV	2025	2029	10,084,980	0	10,084,980		10,084,980		0	0
3.1.5	3.1.5 Masa 5. Përmirësohen me qasje specifike rinore, miqësore dhe të pranueshme, programet që trajtojnë migrimin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore me në fokus parandalimin e këtyre fenomeneve dhe kthimin e të rinjve në shkollë, trajnim ose punë	MSHRF	AKR, MB	2023	2029	16,151,197	0	16,151,197		13,596		0	-16,137,601
3.1.6	3.1.6 Masa 6. Fuqizohen programet rinore që fokusohen në të drejtat e njeriut dhe të pakicave, antikorupsionin, barazinë gjinore, pranimit të diversitetit, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm	MSHRF	AKR, MB	2023	2029	67,768,000	0	67,768,000		61,000,000		0	-6,768,000
3.1.7	3.1.7 Masa Hartohen dhe fuqizohen programet dhe aktivitetet rinore që trajtojnë çështje në lidhje me format e ndryshme të diskriminimit kundrejt identiteteve socio-kulturore, fetare, seksuale dhe të tjera.	MSHRF	AKR, MAS, MSHMS	2023	2029	36,848,000	0	36,848,000		35,000,000		0	-1,848,000
	Kosto Objektivi specifik 3.1					164,817,773	1,150,000	165,967,773	0	0	115,318,936	0	-50,648,837
3.2	3.2 Objektivi specifik 2: Të reja dhe të rinjtë ja ofrohen shërbime shëndetësore, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale	MSHRF dhe MSHMS	AKR, ISHP	2022	2029								
3.2.1	3.2.1 Masa 1. Bashkërendohet Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030, Agjenda e Fëmijëve 2021 – 2026, planet e veprimt dhe strategji të tjera lidhur me to me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, në veçanti promovimin e jetesës së shëndetshme	MSHRF	AKR, MSHMS, ASPA	2023	2029	74,200,000	0	74,200,000		70,000,000		0	-4,200,000
3.2.2	3.2.2 Masa 2. Zhvillohen qasje të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë në strukturat shëndetësore, të cilat marrin në konsideratë tranzicionin nga strukturat dhe shërbimet mjekësore për fëmijë tek ato për të rriturit.	MSHRF	AKR, MSHMS, ASPA	2023	2029	42,600,000	0	42,600,000		3,600,000		0	-39,000,000
3.2.3	3.2.3 Masa 3. Zhvillohen shërbime të reja dhe forcohen ato ekzistuese nëpër shkollë me cilësi të garantuar për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik, si edhe mbështetjen shërbimet online të shëndetit mendor në platformën për rininë (të rinjtë për të rinjtë).	MSHRF	AKR, MSHMS	2023	2029	9,456,475	0	9,456,475		699,114		4,800,000	-3,957,361
3.2.4	3.2.4 Masa 4. Sigurohet pranimit i të rinjve në shërbimet e duhura të parandalimit dhe promovimit sipas Planit Kombëtar të Veprimt mbi Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riproduktive 2022 - 2030 për të siguruar që të rinjtë që jetojnë në Shqipëri marrin edukim / informacione të përgjithshme në formë të pranueshme dhe miqësore ndaj tyre.	MSHMS	AKR, MSHRF	2023	2029	19,414,601	0	19,414,601		2,489,016		0	-16,925,585
3.2.5	3.2.5 Masa 5. Propozohen dhe zhvillohen veprimtari në lidhje me sjelljen e rrezikshme dhe konsumin e drogës duke siguruar që të rinjtë marrin informacione dhe edukim tërësor. Sigurohet që të rinjtë kanë akses në ndërhyrjet e duhura parandaluese dhe shërbimet e trajtimit të varësisë.	MSHRF	AKR, MSHMS	2023	2029	15,626,040	0	15,626,040		8,426,040		0	-7,200,000
	Kosto Objektivi specifik 3.2					161,297,116	0	161,297,116	0	0	85,214,170	0	-71,282,946



3.3	3.3 Objektivi specifik 3: Të rejtat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimin në tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.	MSHRF	AKR, AMMV, Bashkitë, MAS, MSHMS, MB, MD, ASCAP	2022	2029									
3.3.1	3.3.1 Masa 1. Mbështetjet ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurtat takimi edhe në kohën e lirë	MSHRF	AKR, MIE, AMVV, NJVV	2022	2029	1,124,199	0	1,124,199			3,399		0	-1,120,800
3.3.2	3.3.2 Masa 2 Mbështetja e programeve të gjithëpërfshirjes dhe politikave të përfshirjes, sigurisë dhe mbrojtjes me fokus të veçantë tek të rejtat dhe të rinjtë	MSHRF	AKR, MAS, MSHMS, MB, MD, AMVV, ASCAP, NJVV	2022	2029	42,638,976	1,322,500	43,961,476			5,600,000		0	-38,361,476
3.3.3	3.3.3 Mbështetjet dhe promovohet programi i qeverisë në lidhje me mbështetjen financiare të strehimit për familjet e reja dhe në bashkëpunim me aktorë qeveritarë qendrorë e vendorë si edhe organizatat donatore nxitet zhvillimi i programeve të tjera në mbështetje të familjeve dhe çiftëve të reja.	MSHRF	MIE	2027	2029	1,184,840	0	1,184,840			84,840		0	-1,100,000
	Kosto Objektivi specifik 3.3					44,948,015	1,322,500	46,270,515	0	0	5,688,239	0	0	-40,582,276
	Kosto totale Qëllimi i Politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2+3.3)					371,062,904	2,472,500	373,535,404	0	0	206,221,345	0	0	-162,514,059
	Kosto totale e Planit të Veprimit = QP I + QP II + QP III					4,305,693,793	1,264,393,000	5,570,086,793	0	0	3,956,601,251	0	0	1,040,395,542



GJYKATA EVROPIANE E TË
DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

**KËRKESA NR. 17475/13
SHKËLQIM QOSJA KUNDËR
SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 14 qershor 2022, si Komisioni, i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar*,

Darian Pavli,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e seksionit*,

pasi mori në konsideratë:

kërkesën (nr. 17475/13) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur përpara Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 11 prill 2012, nga një shtetas shqiptar. Z. Shkëlqim Qosja, lindur në vitin 1977, ne banim në Fushë-Krujë (“kërkuesi”), i cili u përfaqësua nga z. Pjetra, një avokat i cili e shtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të bërë me dijeni qeverinë shqiptare (“Qeveria”) – Qeveria u përfaqësua nga agjentja e saj, znj. A. Hicka, Avokatja e Përgjithshme e Shtetit – për ankesën në lidhje me mungesën e mbrojtjes në një seancë dëgjimore të zhvilluar përpara Gjykatës së Lartë, si edhe për të deklaruar pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

konstatimet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me mungesën e kërkuesit në një seancë të zhvilluar përpara Gjykatës së Lartë.

2. Kërkuesi ishte shpallur fajtor për vrasje dhe mbajtje të paligjshme të armëve, nga Gjykata e Rrethit Shkodër. Në vitin 1999, ajo gjykatë, fillimisht, urdhëroi arrestimin e kërkuesit dhe më pas e zëvendësoi atë me arrest shtëpie. Prokuroria e apeloj atë vendim dhe më pas e tërhoqi apelimin. Gjykata e rrethit e pushoi apelimin duke e përcaktuar si të tërhequr.

Gjyqtari M.H. mori pjesë në miratimin e atij vendimi.

3. Më 18 korrik 2000, Gjykata e Rrethit Shkodër e shpalli kërkuesin fajtor për akuzat dhe e dënoi me njëzet vjet burgim.

4. Më 2 maj 2001, Gjykata e Apelit Shkodër, me pjesëmarrjen e gjyqtarit M.H., la në fuqi vendimin e datës 18 korrik 2000. Në një moment të caktuar përpara shpalljes së vendimit, kërkuesi u largua nga Shqipëria. Ai u ekstradua nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 25 shkurt 2010 dhe u mbajt nën arrest. Vendimi i datës 2 maj 2001 u zbatua ndaj tij në po të njëjtën datë.

5. Më 10 qershor 2010, kërkuesi, i përfaqësuar nga avokati M.I., paraqiti një ankesë përpara Gjykatës së Lartë kundër vendimit të datës 2 maj 2001. I vetmi argument për atë ankesë ishte pretendimi për mungesë të paanshmërisë së gjyqtarit M.H., me shkak të pranisë së tij në vendimin e miratuar në vitin 1999 (shih paragrafin 1 më sipër) dhe pjesëmarrjen e tij të mëvonshme në trupën gjyqësore, e cila e dënoi kërkuesin në vitin 2001.

6. Më 13 prill 2011, Gjykata e Lartë programoi një seancë për çështjen e kërkuesit në datën 28 prill 2011, në orën 11:40 të paradites. Kjo seancë u njoftua publikisht në mjediset e Gjykatës së Lartë dhe në faqen e saj të internetit. Kërkuesit dhe avokatit të tij nuk iu dërguan fletëthirrje me shkrim për seancën që do të zhvillohej përpara Gjykatës së Lartë.

7. Përpara Gjykatës së Lartë u mbajt një seancë në mungesë të kërkuesit dhe avokatit të tij, dhe në prani të prokurorit. Gjykata e Lartë e pushoi ankesën e kërkuesit.

8. Në vijim, kërkuesi paraqiti një ankesë kushtetuese. Gjatë procedurave përpara Gjykatës Kushtetuese, ai u përfaqësua nga avokatët e zgjedhur prej tij N.P. dhe E.A. Në ankesën e tij kushtetuese, kërkuesi paraqiste dy ankesa. Së pari, ai ankohej për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit M.H. Këtë ankesë ai e kishte parashtruar edhe më herët në apelimin e tij paraqitur përpara Gjykatës së Lartë. Së dyti, ai ankohej për faktin se as ai dhe as avokati i tij nuk ishin thirrur me anë të fletëthirrjeve me shkrim në seancën e mbajtur përpara Gjykatës së Lartë, më 28 prill 2011.

9. Gjykata Kushtetuese zhvilloi një seancë më 19 janar 2012, në prani të avokatëve të kërkuesit,



të cilët bënë parashtrimet e tyre. në po të njëjtën datë, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën kushtetuese të kërkuarit. Ajo gjykoi se pjesëmarrja e mëparshme e gjyqtarit M.H. nuk kishte ndikuar në paanshmëri në gjykimin e kërkuarit. Gjykata konstatoi se vendimi i miratuar nga M.H. në vitin 1999 ishte i një natyre formale, duke qenë se ai kishte vendosur vetëm të pushonte apelimin e prokurorisë, me arsyen se apelimi ishte tërhequr dhe, në këtë mënyrë, nuk kishte dhënë asnjë opinion për meritat e çështjes.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Qëllimi i ankesave të kërkuarit

10. Gjykata vëren se kërkuari, i cili u përfaqësua gjatë procedurave përpara Gjykatës, nuk parashtrroi në kërkesën e tij fillestare ankesën e tij, në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarit F.H., i cili mori pjesë në vendimarrjen për ankesën kushtetuese të kërkuarit. Për pasojë, Qeverisë nuk iu parashtrua asnjë problematikë në lidhje me mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit F.H., dhe Qeveria nuk bëri ndonjë koment për të. Kërkuari pretendonte se ai kishte mësuar për pjesëmarrjen e atij gjyqtari vetëm nëpërmjet konstatimeve të Qeverisë. Megjithatë, avokatët e kërkuarit ishin të pranishëm në seancën e zhvilluar përpara Gjykatës së Lartë më 19 janar 2012. Në këtë rast, Gjykata gjykon se ankesa ku pretendohet për mungesë të paanshmërisë nga gjyqtari F.H. nuk përbën një zhvillim të mëtejshëm të ankesave të tij të mëparshme përpara Gjykatës, dhe për këtë arsye, nuk është me vend që të trajtohet kjo ankesë e re në çështjen konkrete (shih *Rafiq Alijev kundër Azerbajxhanit*, nr. 45875/06, §§69–70, 6 dhjetor 2011, me referenca të tjera).

B. Neni 6§§1 dhe 3(c) i Konventës

1. Prania personale e kërkuarit

11. Qeveria argumentoi se kërkesa ishte paraqitur në Gjykatë përtej afatit gjashtëmuor, sepse vendimi i brendshëm i formës së prerë ishte miratuar nga Gjykata Kushtetuese më 2 prill 2012, dhe i ishte paraqitur avokatëve të kërkuarit në po të njëjtën ditë, ndërsa kërkesa ishte paraqitur përpara Gjykatës më 15 prill 2013.

12. Gjykata vëren se kërkesa konkrete u paraqit përpara Gjykatës më 11 prill 2012. Ajo vijon me argumentin se kërkesa ishte në përputhje me afatin gjashtëmuor.

13. Parimet e përgjithshme në lidhje me praninë personale të të akuzuarit në një seancë përpara një gjykate të lartë janë përmbledhur në çështjen *Zabirović kundër Kroacisë*, nr. 58590/11, §§54–57, 25 prill 2013.

14. Në parim, prania e kërkuarit është e nevojshme kur gjykata e lartë duhet që të shqyrtojë një çështje sipas fakteve dhe ligjit, dhe kur bën një vlerësim të plotë të fajësisë apo të pafajësisë, ose kur ajo nuk mund ta gjykojë çështjen pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të fakteve të dhëna personalisht nga i akuzuari për të provuar se ai nuk e kreu aktin i cili pretendohet të përbëjë një vepër penale (shih *Dondarini kundër San Marinos*, nr. 50545/99, §27, 6 korrik 2004). Po kështu, prania e të akuzuarit kërket kur gjykata e apelit mbledhet për të shqyrtuar faktin nëse dënimi i kërkuarit duhet të rritet dhe kur procedurat e apelit mund të ngrenë çështje që kanë të bëjnë me personalitetin dhe karakterin e kërkuarit, duke i bërë këto procedime të një rëndësie të veçantë për kërkuarin, duke qenë se rezultati i tyre mund të jetë në dëm të tij (shih *Talabér kundër Hungarisë*, nr. 37376/05, §28, 29 shtator 2009; dhe *Zabirović*, cituar më sipër, §57).

15. Së pari, Gjykata vëren se problematika në çështjen konkrete nuk është mungesa e kërkuarit në gjykimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, sepse në apelimin e tij në Gjykatën e Lartë, ai u ankua vetëm për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit M.H.

16. Edhe pse në përgjithësi, Gjykata e Lartë e Shqipërisë ka autoritetin që ta shqyrtojë një çështje si mbi faktet edhe sipas ligjit, dhe të rrisë apo të zvogëlojë dënimin e një të pandehuri, një gjë e tillë nuk ndodhte me çështjen konkrete. Në çështjen konkrete, problematika e vetme përpara Gjykatës së Lartë ishte pretendimi për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit M.H., sepse kjo ishte arsyeja e vetme e apelit të kërkuarit. Për këtë arsye, duke qenë se Gjykata e Lartë nuk duhej të vendoste për fajësinë e kërkuarit ose të vlerësonte faktet e lidhura me dënimin e kërkuarit, apo të vlerësonte ashpërsinë e dënimit, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, të përmendur më sipër, prania e kërkuarit personalisht nuk ishte e nevojshme.

17. Për këtë arsye, problematika në këtë çështje ka të bëjë me faktin nëse ishte respektuar



e drejta e kërkuessit për t'u përfaqësuar nga një avokat në seancën në apel.

2. *E drejta e kërkuessit për t'u përfaqësuar ligjërish*

18. Gjykata vëren se nenit 6 i Konventës nuk parashikon forma specifike të dorëzimit të dokumenteve, duke përfshirë fletëthirrjet. Problemi është nëse, sipas rrethanave të çështjes, kërkuessit i është mohuar e drejta për një gjykim të drejtë (shih, në përgjithësi, *Teuschler kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 47636/99, 4 tetor 2001; dhe *Gakbaria kundër Gjeorgjisë*, nr. 30459/13, §33, 17 janar 2017). Nëse dokumentet e çështjes, duke përfshirë fletëthirrjet për seancat gjyqësore, nuk dorëzohen personalisht, atëherë kërkuessi mund të pengohet të vetëmbrohet gjatë procedurave (shih *Ozgur Karaduman kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 4769/02, 26 qershor 2007; *Weber kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 30203/03, 2 tetor 2007; *Zavodnik kundër Sllovenisë*, nr. 53723/13, § 0, 21 maj 2015; dhe *Vyacheslav Korchagin kundër Rusisë*, nr. 12307/16, §§ 64–65, 28 gusht 2018).

19. Gjykata e Lartë zhvilloi një seancë për të cilën as kërkuessi dhe as avokati i tij mbrojtës nuk u informuan me anë të fletëthirrjeve me shkrim. Gjykata e Lartë e shpalli datën e seancës me anë të një shpalljeje publike në mjediset e Gjykatës së Lartë, si edhe me anë të njoftimit në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë. Gjykata vëren se një gjë e tillë rezulton të ketë qenë një praktikë standarde e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë në periudhën përkatëse.

20. Gjykata thekson se detyra e saj nuk është shqyrtimi i ligjit dhe i praktikës përkatëse *in abstracto*, por përcaktimi nëse, sipas mënyrës se si ligji dhe praktika janë zbatuar për, ose kanë ndikuar kërkuessin, kanë shkaktuar një shkelje të Konventës apo jo (shih, midis autoriteteve të tjerë, *Schwarzenberger kundër Gjermanisë*, nr. 75737/01, §37, 10 gusht 2006; *Roman Zakharov kundër Rusisë* [DHM], nr. 47143/06, §164, GJEDNJ 2015).

21. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës duhet të shqyrtohet respektimi i kërkesave për një gjykim të drejtë, në lidhje me zhvillimin e procedurave në tërësi, dhe jo sipas një konsiderate të izoluar të një aspekti të caktuar apo të një incidenti të caktuar, edhe pse nuk mund të përfshihet fakti se një faktor specifik mund të jetë kaq i rëndësishëm, saqë ai mund të ndikojë në drejtësinë e gjykimit që duhet të

vlerësohet në një fazë të mëhershme në procedura (*Beuze kundër Belgjikës* [DHM], nr. 71409/10, §121, 9 nëntor 2018). Në vlerësimin e drejtësisë së përgjithshme të procedurave, Gjykata do të marrë në konsideratë, nëse është me vend, të drejtat minimale të listuara në nenin 6§3, të cilat konkretizojnë kërkesat për një gjykim të drejtë në lidhje me situatat tipike procedurale, të cilat rezultojnë në çështjet penale. Për këtë arsye ato mund të konsiderohen si aspekte specifike të konceptit të një gjykimi të drejtë në procedurat penale, sipas nenit 6§1. Këto të drejta minimale të garantuara, sipas nenit 6 §3, sidoqoftë, nuk janë qëllime në vetvete: qëllimi i tyre i brendshëm kontribuon gjithmonë në drejtësinë e procedimeve penale në tërësi (shih *Ibrahim dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 50541/08 dhe 3 të tjerë, §§251 dhe 262, 13 shtator 2016; dhe *Beuze*, cituar më sipër, §122).

22. Praktika e Gjykatës përcakton qartë se është ndërhyrja e një gjykate më të lartë e cila, në rrethana të caktuara, mund të gjykojë një shkelje të mëparshme të Konventës (shih *De Cubber kundër Belgjikës*, vendim i datës 26 tetor 1984, seritë A nr. 86, f. 19, §§33; dhe *Chmelir kundër Republikës së Çekisë*, nr. 64935/01, §68, GJEDNJ 2005-IV).

23. Së pari, Gjykata vëren se kërkuessi, i asistuar nga një avokat, ka paraqitur një apelim me shkrim përpara Gjykatës së Lartë, ku ai ka pasur mundësinë të paraqiste të gjitha argumentet e tij në lidhje me ankesën e tij të vetme, më konkretisht mungesën e pretenduar të paanshmërisë së gjyqtarit M.H., Gjykata e Lartë e shqyrtoi atë ankesë dhe e rrëzoi.

24. Në vijim të kësaj kërkesë, kërkuessi paraqiti një ankesë kushtetuese, ku ai përsëriti të njëjtin argument për paanshmërinë e gjyqtarit M.H. Gjykata Kushtetuese zhvilloi një seancë dëgjimore në prani të avokatëve të përzgjedhur nga kërkuessi, N.P. dhe E.A., të cilët mundën të paraqisnin të gjitha argumentet që dëshironin, në lidhje me mungesën e pretenduar të paanshmërisë së gjyqtarit M.H. Duhet të theksohet se avokatët e kërkuessit nuk paraqitën argumente të reja përpara Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me mungesën e pretenduar të paanshmërisë së gjyqtarit M.H., përveç atyre që tashmë ishin përmendur në apelimin e kërkuessit



përpara Gjykatës së Lartë (krahaso *Mader kundër Kroacisë*, nr. 56185/07, §167, 21 qershor 2011).

25. Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese trajtoi kërkesën e ngritur nga kërkuksi, më konkretisht mungesa e pretenduar për paanshmëri nga ana e gjyqtarit M.H., dhe dha arsye në lidhje me pikat e ngritura nga kërkuksi, arsye të cilat nuk janë arbitrare dhe janë në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës për këtë çështje (bëj një krahasim, për shembull, me vendimin *Jasiński kundër Polonisë*, nr. 30865/96, §56, 20 dhjetor 2005; *Dāvidsons dhe Savins kundër Letonisë*, nr. 17574/07 dhe 25235/07, §49, 7 janar 2016; dhe *Heiszné Szörös kundër Hungarisë*, (vendim) [Komisioni], nr. 18854/14, §§17 dhe 18, 30 qershor 2020).

26. Si përfundim dhe pa mbajtur një qëndrim të përgjithshëm në praktikën e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, në lidhje me mënyrën e informimit të palëve për seancat përpara asaj gjykate, Gjykata gjykon, se duke i konsideruar procedurat sipas ankesës së kërkuksit për mungesën e pretenduar të paanshmërisë së gjyqtarit M.H. në tërësi dhe në veçanti rrethanat e çështjes konkrete, duke iu referuar natyrës së ankesës së kërkuksit përpara Gjykatës së Lartë dhe faktin se në vijim është zhvilluar një seancë për të njëjtën problematikë përpara Gjykatës së Kushtetuese në prani të avokatëve të kërkuksit, mungesa e avokatit të kërkuksit përpara Gjykatës së Lartë nuk shkelte garancitë për një gjykim të drejtë.

27. Në përputhje me rrethanat, kërkesa është haptazi e pambështetur në fakte dhe duhet të kundërshtohet në mbështetje të nenit 35§3(a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E deklaron kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 7 korrik 2022.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Andreas Zünd
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

VENDIM KËRKESA NR. 38924/13

HASAN BUCI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 5 korrik 2022, si Komision, i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar*,

Darian Pavli,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e seksionit*,
Pasi mori në konsideratë:

kërkesën (nr. 38924/13) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur përpara Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 15 prill 2013, nga një shtetas shqiptar, z. Hasan Buci, lindur në vitin 1968 dhe me banim në Mat (“kërkuksi”), i cili u përfaqësua nga z. Rusi, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për t’ia bërë kërkesën me dijeni qeverisë shqiptare (“Qeveria”), e përfaqësuar nga agjenti i saj, znj. Alma Hicka, Avokatja e Përgjithshme e Shtetit;

konstatimet e palëve,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me drejtësinë e procedurave penale ndaj kërkuksit përpara Gjykatës së Rrethit Mat, për akuzat për vrasje me paramendim dhe mbajtje pa leje të armëve, të zhvilluar në mungesë. Policia e kërkoi kërkuksin në adresën e tij dhe mësoi se ai ishte jashtë vendit. Në këto procedura penale, kërkuksi u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga gjykata. Më 7 qershor 2007, Gjykata e Rrethit Mat e dënoi kërkuksin me tetëmbëdhjetë vjet burgim. Më 14 qershor 2007, si avokati i caktuar nga gjykata edhe vëllai i kërkuksit paraqitën apelime të veçantë ndaj dënimit. Vëllai i kërkuksit nënshkroi një prokurë më 11 tetor 2007, që kërkuksin ta përfaqësonte avokati P.R. Apelimet e paraqitura nga avokati i caktuar nga gjykata dhe nga vëllai i kërkuksit u rrëzuan që të dyja, për meritat nga Gjykata e Apelit Tiranë, më 24 tetor



2007. Në vijim, avokati P.R. bëri një apelim në Gjykatën e Lartë, i cili u rrëzua; më 15 janar 2010, Gjykata e Lartë la në fuqi dënimin ndaj kërkuarit.

2. Kërkuari u arrestua në Athinë, më 25 mars 2010, dhe u ekstradua në Shqipëri, më 27 mars 2010. Pas arrestimit, kërkuari paraqiti një kërkesë ku kërkonte leje për të apeluar jashtë afateve, leje e cila iu dha nga Gjykata e Rrethit Mat në vitin 2011, por u rrëzua nga Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2011, dhe në fund, nga Gjykata e Lartë, më 8 mars 2012, me argumentin se dënimi i kërkuarit ishte bërë *res judicata*, dhe për këtë arsye, ridëgjimi i apelimit nuk ishte i mundur.

3. Më pas, kërkuari paraqiti një ankesë kushtetuese, e cila u deklarua e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese, më 19 dhjetor 2012, pasi ishte paraqitur jashtë afatit, më konkretisht, më vonë se dy vjet, pasi kërkuari ishte bërë me dijeni mbi procedurat kundër tij.

4. Kërkuari u ankua në bazë të nenit 6§§1 dhe 3 të Konventës, për një shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë, më konkretisht e drejta për të marrë pjesë personalisht në procedurat penale kundër tij dhe për t'u përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur prej tij.

VLERËSIMI I GJYKATËS

5. Qeveria parashtroi se kërkuari nuk kishte përdorur në mënyrën e duhur mjetet e brendshme. Ai kishte paraqitur një kërkesë për apelim jashtë afatit, për dënimin e tij në mungesë. Megjithatë, ai mjet ishte i papranueshëm, sipas praktikës së përcaktuar të Gjykatës së Lartë, e cila parashikonte që në një situatë, ku familja e një të akuzuari apo avokati i caktuar nga familja kishin paraqitur ankesa ndaj dënimit për të akuzuarin në mungesë, dhe dënimi ishte lënë në fuqi, një apel i mëposhëm jashtë afatit kohor, i paraqitur nga vetë i akuzuari nuk do të ishte i pranueshëm. Qeveria argumentoi se në vend që të paraqiste një ankesë që ishte qartazi e papranueshme, kërkuari duhej të kishte kërkuar një rishqyrtim të dënimit të tij dhe të kishte paraqitur një ankesë kushtetuese brenda dy vjetëve, pasi ishte vënë në dijeni për dënimin ndaj tij. Megjithatë, kërkuari e kishte paraqitur ankesën e tij jashtë atij afati kohor dhe, për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese e kishte deklaruar atë kërkesë të papranueshme.

6. Kërkuari argumentoi se ai kishte përdorur në mënyrën e duhur mjetet e brendshme.

7. Parimet e përgjithshme në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme dhe parimi i subsidiaritetit janë përmbledhur në vendimin *Vučković dhe të Tjerë kundër Serbisë* (kundërshtim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69–77, 25 mars 2014). Gjithashtu, Gjykata thekson, se, nëse ligji i brendshëm parashikon një sërë mjeteve paralele, një kërkuar i cili ka kërkuar të përfitojë kompensim për një shkelje të pretenduar të Konventës, me anë të njërit prej këtyre mjeteve, nuk kërkohet që të përdorë domosdoshmërisht mjetet e tjera, të cilat në thelb kanë të njëjtin objektiv (shih *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §61, 10 maj 2011; dhe *Garzia Gonzales kundër Spanjës*, nr. 65107/16, §63, 6 tetor 2020).

8. Gjykata vëren, se, fillimisht, mund të duket se kërkuari kishte mundësi për të zgjedhur midis mjeteve të ndryshme. Megjithatë, sipas praktikës së gjatë të Gjykatës së Lartë, një i akuzuar i gjykuar në mungesë nuk do të mund të aplikonte me sukses për një apelim jashtë afatit, në rastet kur anëtarët e familjes së tij apo një avokat i caktuar nga familja, tashmë të kishin apeluar ndaj dënimit të tij në mungesë dhe dënimi të ishte lënë në fuqi (shih *Shkalla*, cituar më sipër, §60). Gjykata e Lartë mori një vendim për këtë çështje në vitin 2008 dhe e publikoi në faqen e saj zyrtare (shih *Sulejmani kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 16114/10, §§10 dhe 11, 9 qershor 2012; shih edhe *Izet Haxhia kundër Shqipërisë*, nr. 34783/06, §§54–56, 5 nëntor 2013).

9. Në çështjen konkrete, vëllai i kërkuarit i dha një prokurë avokatit P.R. më 11 tetor 2007. Edhe pse ajo prokurë deklaronte se vëllai i kërkuarit i jepte të drejtën avokatit për përfaqësim, është e qartë se një gjë e tillë ishte e gabuar, duke qenë se ai avokat e kishte përfaqësuar kërkuarin në seancën përpara Gjykatës së Rrethit Tiranë, kishte paraqitur një apelim përpara Gjykatës së Lartë kundër dënimit ndaj kërkuarit në mungesë, dhe për të gjitha qëllimet ishte zgjedhur nga familja që të vepronte si avokat në emër të kërkuarit. Edhe vëllai i kërkuarit kishte paraqitur një apelim ndaj dënimit të kërkuarit në mungesë. Të gjitha apelimet ishin rrëzuar për meritat dhe dënimi i kërkuarit kishte mbetur në fuqi. Për rrjedhojë, duke paraqitur një kërkesë për apelim përtej afatit ndaj dënimit të tij, kërkuari përdori një mjet joefikas, sepse ai nuk ofronte garanci të arsyeshme për sukses (shih *Vučković*, cituar më sipër, §74).



10. Në lidhje me pamundësinë e kërkuarit për të paraqitur një kërkesë për shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë, Gjykata nuk duhet të marrë një vendim për këtë aspekt në këtë çështje, sepse kërkesa është e papranueshme në çdo këndvështrim për arsyet e mëposhtme.

11. Tashmë, Gjykata kishte vendosur se pas datës 26 nëntor 2009, kërkuarit nuk do të mund të shkarkoheshin nga detyrimi i tyre për të paraqitur një ankesë kushtetuese ndaj gjykimit dhe dënimit të tyre në mungesë në Shqipëri, pasi të ishin ekstraduar në Shqipëri, dhe ata duhej të paraqisnin një kopje të vendimit dhënë në mungesë (shih *Izet Haxhia*, cituar më sipër, §50). Në atë periudhë, praktika e Gjykatës Kushtetuese tregonte se ajo mund të pranonte një ankesë kushtetuese ndaj gjykimit në mungesë, pas ekstradimit të apeluesit në Shqipëri, ku edhe u njoftuan vendimet e dhëna në mungesë (shih *Izet Haxhia*, cituar më sipër, §41). Në këtë rrethanë, ankesa kushtetuese ishte një mjet i disponueshëm dhe i mjaftueshëm, i sigurt si në teori edhe në praktikë.

12. Kërkuari u ekstradua më 27 mars 2010 dhe, për këtë arsye, duhej të paraqiste një ankesë kushtetuese ndaj dënimit të tij në mungesë, brenda dy vjetëve. Megjithatë, ankesa kushtetuese e kërkuarit u paraqit jashtë afatit. Në këto rrethana, kërkuari nuk përdori në mënyrën e duhur mjetin e disponueshëm të brendshëm dhe, në këtë mënyrë, nuk kishte respektuar kërkesën që mjeti i brendshëm duhet të përdoret në përputhje me kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin e brendshëm (shih *Vučković*, cituar më sipër, §72).

13. Në këto rrethana, kërkesa duhet të kundërshtohet në mbështetje të nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës për mosshkrim të mjeteve të brendshme.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E deklaron kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 28 korrik 2022.

Olga Chernishova
ZËVENDESEKRETARE

Andreas Zünd
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

VENDIM KËRKESA NR. 33104/15

AGONSET SHPK KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 10 maj 2022, si Komision, i përbërë nga:

- Andreas Zünd, *kryetar*,

- Darian Pavli,

- Mikhail Lobov, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e seksionit*,
pasi mori në konsideratë:

kërkesën (nr. 33104/15) kundër Shqipërisë paraqitur në Gjykatë, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 27 qershor 2015, nga Agonset sh.p.k., një kompani e regjistruar në Shqipëri (“kompania kërkuuese”), e cila u përfaqësua nga z. A. Saccucci, një avokat i cili e ushtron profesionin e tij në Romë;

vendimin për t’i përcjellë qeverisë shqiptare (“Qeveria”) ankesat në lidhje me të drejtën e kompanisë kërkuuese për liri të fjalës dhe të drejtën e saj për të mos u diskriminuar – Qeveria u përfaqësua nga agjenti i saj, z. Artur Metani, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit – si edhe vendimin për ta deklaruar pjesën tjetër të kërkesës së papranueshme;

vendimin për t’i dhënë prioritet kërkesës (rregulli 41 i Rregullores së Gjykatës);

konstatimet e palëve,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja konkrete ka të bëjë me pamundësinë e kompanisë kërkuuese për të marrë pjesë në procedurën për një “konkurs bukurie” për dhënien e një licence kombëtare për transmetim digjital dhe pamundësinë e saj për të aplikuar për të.

2. Kompania kërkuuese u themelua më 3 maj 2012, dhe më 5 prill 2013, u prezantua zyrtarisht kanali televiziv “Agon Channel Albania”. Ky kanal kishte marrë leje për të ofruar shërbim satelitor audioviziv të programacionit, gjë e cila e lejonte kompaninë kërkuuese të transmetonte programacionin e saj në rrjetet e licencuara. Ligji i



vitit 2013 për mediat audiovizive (“LMA”) e parashikonte Autoritetin e Mediave Audiovizive (“AMA”) si organin kombëtar rregullator dhe licencues. Në vitin 2013, në mbështetje të nenit 139 të LMA-së, AMA miratoi një rregullore për licencimin e rrjeteve dhe të programeve kombëtare digjitale, me rastin e “procedurës për një konkurs bukurie” (“rregullorja”). Sipas nenit 4 të rregullores, vetëm operatorët privatë, të cilët ishin pajisur më herët me licenca për një mbulim në nivel kombëtar (“transmetuesit kombëtarë”), u ftuan të merrnin pjesë në procedurë. Në korrik 2013, ajo lançoi procedurën për konkursin e bukurisë.

3. Pas një padie të ngritur nga tre transmetues kombëtarë, më 31 korrik 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi AMA-n të pezullonte procedurën për lëshimin e licencave kombëtare digjitale deri në shqyrtimin e padisë, në lidhje me anulimin e nenit 16 të rregullores. Më 8 tetor 2014, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, duke e gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, në mbështetje të nenit 10§2(b) të ligjit për gjykatat administrative, vendosi të anulonte nenin 16 të rregullores, për sa kishte të bënte me kërkesat financiare për të marrë pjesë në procedurën për konkursin e bukurisë, dhe e urdhëroi AMA-n të miratonte një rregullore të re.

4. Më 30 tetor 2014, kompania kërkuese u ankua pranë AMA-s për tri shkaqe të lidhura me procedurën e konkursit të bukurisë të lançuar në korrik 2013. Së pari, ajo argumentoi se ndalimi i transmetuesve jokombëtarë për të marrë pjesë në procedurën për konkursin e bukurisë, pavarësisht kapaciteteve të tyre teknike për të ofruar mbulim kombëtar, ishte arbitrar dhe i padrejtë. Së dyti, duke qenë se transmetuesit kombëtarë nuk mbulonin një pjesë të madhe të territorit kombëtar, kompania kërkuese pretendonte, se AMA, me anë të veprimeve të saj, i kishte lejuar që të përfitonin nga pozicioni i tyre i paligjshëm. Së treti, pezullimi i procedurës për konkursin e bukurisë dhe mosveprimi për një kohë të gjatë i AMA-s e kishin penguar rregullatorin që të lëshonte licencën digjitale për kompaninë kërkuese, në mënyrë që kjo e fundit të transmetonte programet e saj digjitale.

5. Më 16 prill 2015, AMA miratoi një rregullore të re për licencimin e rrjeteve dhe programeve kombëtare digjitale, me anë të procedurës për një konkurs bukurie, dhe ftoi pesë transmetues kombëtarë që të merrnin pjesë. Kompanisë kërkuese nuk i ishte ofruar asnjë ftesë.

6. Më 19 maj 2015, kompania kërkuese ridërgoi pranë AMA-s shkresën e saj të datës 30 tetor 2014, sepse shkresa kishte humbur. Nuk u kthye asnjë përgjigje.

VLERËSIMI I GJYKATËS

7. Kompania kërkuese u ankua se ishin shkelur e drejta e saj për lirinë e fjalës, sipas nenit 10 të Konventës, si edhe e drejta për të mos u diskriminuar, sipas nenit 14 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 12, sepse kompania kërkuese nuk ishte ftuar që të merrte pjesë në procedurën për “konkursin e bukurisë”, dhe për faktin se nuk mund të aplikonte për marrjen e licencës për transmetimet digjitale.

8. Më 8 qershor 2016, kompania kërkuese parashitroi ankesa të tjera në mbështetje të nenit 6§2 dhe nenit 10 të Konventës, dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me konfiskimin e pajisjeve të saj dhe objekte të tjera nën pronësinë e saj, dhe nisjen e procedurave penale ndaj disa prej aksionarëve të saj. Këto ankesa nuk u paraqitën në formën e duhur të një kërkesë dhe nuk u komunikuan.

9. Gjykata thekson se Qeveria ngriti kundërshtimin se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme. Në të vërtetë, kompania kërkuese nuk ka paraqitur ndonjë ankesë përpara gjykatave vendëse.

10. Parimet e përgjithshme në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme dhe parimi i subsidiaritetit janë përmbledhur në vendimin *Vučković dhe të Tjerët kundër Serbisë* ((kundërshtim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69–77, 25 mars 2014).

11. Në çështjen konkrete, kompania kërkuese pretendon se ka paraqitur një ankesë pranë AMA-s më 30 tetor 2014, por nuk ka marrë asnjë përgjigje për këtë ankesë. Megjithatë, kompania kërkuese paraqiti një padi pranë Gjykatës Administrative për mosreagimin e AMA-s ndaj asaj ankese. Ajo mund të kishte kundërshtuar edhe rregulloren e re të miratuar nga AMA më 16 prill 2015. Praktika e gjykatave administrative, siç parashihet nga Qeveria, tregon se ato mund të shqyrtojnë ankesat për ligjshmërinë e rregullores. Kompania kërkuese mund të kishte ngritur edhe çështjet, në lidhje me kushtetutshmërinë e legjislacionit të zbatueshëm përpara Gjykatës Administrative, gjë e cila kishte fuqinë që t'i pezullonte procedurat dhe ta referonte çështjen kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese.



12. Në lidhje me dyshimet e kompanisë kërkuuese, në lidhje me perspektivën për sukses të ndonjë prej mjeteve të përmendura më sipër, Gjykata thekson se ekzistenca e dyshimeve për perspektivat e suksesit të një mjeti të caktuar, të cilat nuk janë dukshëm të kota, nuk është një arsye e vlefshme që të mos i shterosh këto mjete (shih, *inter alia*, *Tamm kundër Estonisë* (vendim), nr. 15301/04, 2 shtator 2008, dhe *Mendrei kundër Hungarisë* (vendim), nr. 54927/15, §26, 19 qershor 2018).

13. Gjykata thekson, se në mbështetje të nenit 122 të Kushtetutës së Shqipërisë, çdo marrëveshje e ratifikuar ndërkombëtare përbën një pjesë të sistemit të brendshëm ligjor (pasi është publikuar në Gazetën Zyrtare), në parim është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ka prioritet kundrejt ligjeve të vendit, që nuk përputhen me të. Sipas nenit 17§2 të Kushtetutës, çdo kufizim i të drejtave dhe i lirive kushtetuese: “në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut”.

14. Si rrjedhim, Konventa përbën një pjesë integrale të sistemit ligjor shqiptar, ku ajo ka përparësi ndaj parashikimeve statutore, që janë në kundërshtim me të, dhe është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për këtë arsye, ishte në dorë të kompanisë kërkuuese në çështjen konkrete që të argumentonte përpara autoriteteve vendëse, se në rrethanat e çështjes konkrete ishin shkelur e drejta e saj për lirinë e fjalës, si edhe e drejta për të mos u diskriminuar, në kundërshtim me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe nenet 10 dhe 14 të Konventës (shih *Shpata kundër Institutit të Sigurimeve Shogërore*, Gjykata e Lartë e Shqipërisë, vendimi i datës 22 korrik 2021, ku Gjykata e Lartë zbatoi në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 6 të Konventës, duke u mbështetur në çështjen *Dauti kundër Shqipërisë*, nr. 19206/05, 3 shkurt 2009). Në këtë mënyrë, autoritetet kombëtare do të kishin pasur mundësinë t’u përgjigjeshin këtyre argumenteve. Në lidhje me këtë aspekt, argumenti i kompanisë kërkuuese se ajo nuk kishte asnjë shpresë për sukses, sepse një pjesë e ankesës së saj mbështetej në një parashikim statutor, dhe se pjesa tjetër në një rregull dytësor, nuk mund të pranohet (krahaso *Habulinec dhe Filipović kundër Kroacisë* (vendim), nr. 51166/10, §30, 4 qershor 2013).

15. Nëse kompania kërkuuese do ta kishte respektuar këtë kërkesë, ajo do t’u kishte dhënë

gjykatave vendëse mundësinë për të cilën është hartuar rregulli për shterimin e mjeteve të brendshme në mbështetje të Shteteve, më konkretisht për të përcaktuar çështjen e pajtueshmërisë së masave vendëse të kundërshtuara, ose mosveprimet për të marrë masa, sipas Konventës, dhe nëse kompania kërkuuese, sidoqoftë, do të kishte parashtruar kërkesat e saj përpara Gjykatës Evropiane, kjo Gjykatë do të kishte pasur edhe opinionet e gjykatave vendëse. Për këtë arsye, kompania kërkuuese nuk ka ndërmarrë hapat e duhur për të bërë të mundur që gjykatat vendëse të përmbushnin rolin e tyre themelor në sistemin mbrojtës së Konventës, ku Gjykata Evropiane është suplementare (shih, midis autoriteteve të tjerë, *Vučković*, cituar më sipër, §90). Gjithashtu, Gjykata nuk identifikon ndonjë arsye të posaçme që ta përjashtojë kompaninë kërkuuese nga kërkesa për të shfrytëzuar mjetet e brendshme në respektim të rregullave dhe procedurave të zbatueshme të ligjit të brendshëm.

16. Përkundrejt situatës së sipërpërmendur, Gjykata arrin në përfundimin se kompania kërkuuese, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, përpara se ta dorëzonte kërkesën e saj në Gjykatë, do të duhej t’i kishte paraqitur argumentet e saj përpara autoriteteve vendëse, duke u thënë atyre, në këtë mënyrë, mundësinë që të vendosnin për shkeljet e pretenduara të Konventës.

17. Për pasojë, kërkesa duhet të kundërshtohet në respektim të nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E deklaron kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 2 qershor 2022.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Andreas Zünd
KRYETAR



VENDIM
Nr. 21, datë 26.9.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Altin Binaj	anëtar,

me sekretare Enina Kotoni, në datën 20.9.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare publike, çështjen nr. 1 (L) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: LUAN DACI, përfaqësuar nga avokat Jordan Daci

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në mungesë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 32, datë 1.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 5, datë 8.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 17, 29, 33, 42, 43, 122, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6, 7, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe neni 2 i Protokollit Shtesë nr. 7; neni 14 i Paktit Ndërkombëtar të të Drejtave Civile dhe Politike; nenet 22, 27, 49, 50, 70, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altin Binaj, shqyrtoi pretendimet e paraqitura nga kërkuesi Luan Daci, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e paraqitura me shkrim nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), me vendimin nr. 82/2017, datë 17.6.2017, ka zgjedhur kërkuesin Luan Daci (*kërkuesi*) gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA). Zgjedhja e tij në përbërje të këtij institucioni kushtetues ka ardhur në përmbyllje të një procesi të administruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit (*Avokati i Popullit*) dhe Kuvendi. Konkretisht, kërkuesi në datën 3.2.2017 i ka paraqitur Avokatit të Popullit kërkesën për aplikim dhe emërim në vendet vakante, të shpallura në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 84/2016).

2. Ndërkohë, nga kallëzimi i paraqitur në Prokurorinë e Posaçme dhe materialet bashkëlidhur, ka rezultuar se kërkuesi deri në vitin 1997 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 6, datë 24.12.1997, pas propozimit të ministrit të Drejtësisë, ka vendosur: “Z. Luan Daci, largohet nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjës dhe paafësi në detyrë”, rrethanë të cilën kërkuesi nuk e kishte pasqyruar në kërkesën për aplikim.

3. Mbi këto fakte, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 56 të vitit 2020 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë, i Kodit Penal (KP).

4. Gjatë fazës së hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë*) për caktimin e masës ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të



një detyre a shërbimi publik”. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 54, datë 20.5.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës me arsyetimin se niveli i provave të administruara deri në këtë fazë krijonte dyshimin se kërkuesi ishte autor i veprës penale.

5. Ndaj vendimit ka ushtruar ankim kërkuesi dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*), me vendimin nr. 15, datë 5.6.2020, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 54, datë 20.5.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë. Në vendim Gjykata ka arsyetuar, se: *“duke qenë përpara mungesës së kundërligjshmërisë së faktit, pra përpara një fakti jo penal, nuk përmbushet kushti, në radhë të parë, i caktimit të kujtudo mase sigurimi personal, që është ai i dyshimit të arsyeshëm, sepse ky dyshim i arsyeshëm duhet të bjerë mbi faktin penal dhe jo mbi atë jo penal. Rrjedhimisht, sepse me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë është caktuar një masë ndaluese, në situatën e mungesës së kushtit të “dyshimit të arsyeshëm” kur në këtë situatë ligji e ndalon caktimin e saj, ky kolegji vlerëson se ajo duhet të shfuqizohet”* (shih faqen 4 të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit).

6. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria e Posaçme. Çështja me objekt caktimin e masës ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.6.2020. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 18.9.2020, ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes penale.

7. Ndërkohë me vendimin e prokurorëve të datës 15.7.2020, kërkuesit i është komunikuar akuza, duke u marrë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë, i KP-së. Në vijim, çështja është dërguar për gjykim.

8. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 32, datë 1.12.2020, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Luan Daci, për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i KP dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. Në bazë të nenit 63 të K. Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim me kusht që i pandehuri të mos kryejë veprën tjetër penale brenda një afati prove prej 12 muajsh.”*

9. Ndaj vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim kërkuesi, si dhe apel kundërshtues Prokuroria e Posaçme. Gjykata e Posaçme e Apelit,

me vendimin nr. 5, datë 8.3.2021, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 32 datë 1.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*.

10. Ndaj këtij vendimi në datën 20.4.2021 kërkuesi ka ushtruar rekurs. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, duke marrë parasysh edhe dy kërkesat për përsheptimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitura nga kërkuesi dhe nga KPA-ja, me vendimin nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Luan Daci kundër vendimit nr. 5, datë 8.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë shkak ligjor të kërkuar nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP). Pas përfundimit të çështjes së themelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për rekursin e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për caktimin e masës ndaluese, me vendimin nr. 00-2022-116 (55), datë 18.2.2022, ka vendosur mospranimin e tij, pasi Prokuroria e Posaçme kishte paraqitur kërkesë për heqje dorë nga rekursi.

11. Kërkuesi në datën 17.1.2022 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të sipërcituar. Kolegji i Gjykatës në datën 11.3.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 30.3.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. Kërkuesi ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar:

12.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor* në aspektet e mëposhtme:

12.1.1 *Parimi i paanshmërisë dhe pavarësisë*, pasi çështja e themelit në Gjykatën e Lartë është gjykuar nga i njëjti gjyqtar relator sikurse edhe çështja për caktimin e masës së sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”. Për këtë të fundit, i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes penale, ndërsa çështja e themelit (vendimet e së cilës janë objekt i ankimit kushtetues) është shqyrtuar në dhomë këshillimi. Ky qëndrim nuk është në përputhje me të drejtën



për një proces të rregullt ligjor, pasi janë përdorur standarde të ndryshme për shqyrtimin e rekursit.

12.1.2 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë kontradiktore e jo të ligjshme. Ato kanë bërë një interpretim të zgjeruar, duke krijuar një normë të re, krijimi i së cilës është atribut i ligjvënësit. Kërkesa ka si qëllim vënien në lëvizje të organit procedues dhe nuk cenon interesin publik që në këto organe të zgjidhen persona që plotësojnë kriteret. Gjykata gabon në arsyetim duke i atribuuar kërkesës vlerën e shkresës private dhe i ngatërron me qëllim elementet e domosdoshme të përmbajtjes së një akti sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe elementet e figurës së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Gjykata e Lartë abuzon kur shprehet se Gjykata e Posaçme e Apelit ka dhënë përgjigje për secilin pretendim, pasi në fakt ajo gjykatë ka arsyetuar njëlloj si Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë. Gjykatat, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, në vendimet e tyre injorojnë faktin që edhe sipas doktrinės së huaj, së cilës ato i referohen, falsifikimi ideologjik bëhet nga nëpunësi publik dhe jo nga një person privat.

12.1.3 *E drejta për të mos u dënuar pa ligj*, e parashikuar në nenin 29 të Kushtetutës, pasi vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor kërkuesi nuk parashikohet në ligj dhe nuk ekziston si fakt juridik. Akuza dhe vendimet e gjykatave, në thelb, kanë dhënë një dënim pa ligj, pasi KP-ja nuk parashikon veprën penale të falsifikimit ideologjik dhe “falsifikimi intelektual” është një shprehje pa asnjë kuptim gjuhësor dhe ligjor, madje nuk e njeh as jurisprudenca shqiptare. Gjykatat kanë interpretuar gabim nenin 186 të KP-së lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale për të cilën është dënuar kërkuesi. Ato kanë bërë një vlerësim të gjerë dhe praktikisht kanë kriminalizuar çdo lloj shkrese që mund të përmbajë të dhëna “false” pa marrë parasysh juridikisht natyrën, qëllimin, funksionin dhe efektin e dokumentit.

12.1.4 *E drejta për t'u dëgjuar para se të gjykohet*, pasi çështja në Gjykatën e Lartë është shqyrtuar në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve. Për shkak të problematikës dhe kompleksitetit të çështjes, duke respektuar parimin e barazisë para ligjit, ekzistonte një interes i lartë publik që çështja e kërkuesit të merrte një trajtim të gjithanshëm dhe shterues nëpërmjet shqyrtimit në seancë gjyqësore për të dëgjuar palët. Gjithashtu, ka kontradikta mes

vendimit objekt ankimi kushtetues dhe vendimit nr. 15, datë 5.6.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit (me objekt caktimin e masës së sigurimit).

12.1.5 *E drejta për ankim efektiv sipas nenit 43 të Kushtetutës*, e cila nënkupton ekzistencën e mjeteve të ankimit efektiv, por në rastin konkret ankimi në Gjykatën e Apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk kanë rezultuar të jenë mjete ankimi efektive.

12.1.6 *E drejta për zgjidhjen efektive dhe e apelit në çështjet penale*, të parashikuara në nenin 13 të KEDNJ-së dhe në nenin 2 të Protokollit Shtesë nr. 7 të saj, pasi çdo ankim pas zbatimit të dënimeve nuk do të bënte të mundur një “*restitutio integrum*” të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjekteve që do të mund të cenoheshin.

12.2 *Nenin 17 të Kushtetutës dhe parimin e proporcionalitetit*, pasi qëndrimi i gjykatave se neni 33 i ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9877/2008*) parashikon se masa e shkarkimit nga detyra nuk shuhet asnjëherë, është ndalim krejtësisht jo logjik dhe që bie ndesh me të kuptuarit e normave juridike si pjesë e një rendi juridik. Nëse kjo normë do të nënkuptohej si ndalim i përgjithshëm dhe i përhershëm i lidhur me një masë disiplinore, do të ishte një normë antikushtetuese, sepse bie ndesh me parimin e proporcionalitetit.

12.3 *Parimin e mosdiskriminimit*, pasi kërkuesi diskriminohet në raport me persona të tjerë, subjekt të masave të sigurisë, të cilët kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimit për refuzimin ose pranimin e kërkesës për shuarje. Një shkelje disiplinore nuk mund të sjellë pasoja të përhershme juridike ndaj një personi, ndërkohë që një gjë të tillë nuk e bën as dënimi penal për krimet më të rënda. Gjykatat kanë arsyetuar për shuarjen ose jo të masës disiplinore në mënyrë të paqartë dhe paragjyquese. Shuarja e masës disiplinore parashikohet edhe në rastin më ekstrem, sikurse është dekriminalizimi.

12.4 *Dinjitetin*, pasi është dëmtuar rëndë reputacioni dhe interesat financiare, si dhe disa parime, ai i ligjshmërisë, shtetit të së drejtës, hierarkisë së normave juridike, ndarjes së pushteteve dhe i së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme.

13. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke prapësuar se pretendimet e kërkuesit janë të



pabazuara. Në mënyrë të përmblëdhur argumentet janë si më poshtë:

13.1 Në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, gjykatat kanë trajtuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet, për rrjedhojë pretendimi është i pabazuar. Mospajtimi me arsyetimin e gjykatave, që kanë shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të kërkuarit për çështje që kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit penal, në veçanti të nenit 186 të KP-së, nuk përbën shkak në vetvete që këto pretendime të ngrihen në nivel të juridiksionit kushtetues.

13.2 Për pretendimin e dënimit pa ligj, kërkuar nuk është dënuar për ndonjë veprë penale të paparashikuar në ligj, por për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar në nenin 186, paragrafi i parë, të KP-së. Gjatë proceseve gjyqësore, pretendimi se fakti nuk përbën veprë penale dhe se fakti penal nuk ekziston është vlerësuar nga të tria gjykatat, të cilat kanë arsyetuar se fakti penal ekziston dhe se ai është kryer nga kërkuar.

13.3 Pretendimi i kërkuarit se masa disiplinore “largim nga detyra” është shuar, është i pabazuar, pasi pika 1 e nenit 6 të ligjit nr. 84/2016 nuk e lidh ekzistencën e saj me ndonjë afat kohor. Ligji në momentin e aplikimit është ligji nr. 96/2016, i cili në nenin 150, pika 3, parashikon, se: “masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri”.

13.4 Pretendimet e parashtruara në Gjykatën Kushtetuese nuk kanë të bëjnë me shkeljen e një dispozite kushtetuese, të ndonjë parimi ose të drejte kushtetuese ose procedurale. Pretendimet, në thelb, lidhen me mënyrën e zbatimit dhe interpretimin e ligjit material penal, me interpretimin e nocioneve “dokument” dhe “falsifikim”, si dhe me vlerësimin e provave të paraqitura e të shqyrtuara në gjykim, për rrjedhojë ato nuk janë pjesë e juridiksionit kushtetues, por përfshihen në juridiksionin e gjykatave të zakonshme.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për të thirrur si subjekt të interesuar Avokatin e Popullit

14. Kërkuar në parashtrimet e depozituara në datën 22.4.2022, si dhe në seancën plenare publike

ka kërkuar thirrjen e Avokatit të Popullit si subjekt të interesuar, në ndihmë të gjykimit kushtetues, pasi është institucioni që ka kryer të gjitha procedurat dhe ka administruar dokumentacionin që është bërë shkak për procedimin penal ndaj kërkuarit.

15. Gjykata vëren se në nenin 39, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të ligjit nr. 8577/2000 janë përcaktuar subjektet që marrin pjesë në gjykimin kushtetues. Në lidhje me subjektet e interesuara që thirren në çështje me interes publik, Gjykata është shprehur se në vlerësimin e legjitimitetit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por dhe të gjykimit kushtetues. Në këtë vështrim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato subjekte që, për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuarit apo dhe kryesisht nga Gjykata (*shih vendimet nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 9, datë 1.3.2021; nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 29, datë 21.10.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa më lart, Gjykata mori në shqyrtim kërkesën për të thirrur Avokatin e Popullit, si subjekt të interesuar, dhe vlerësoi se nuk ekziston nevoja e pjesëmarrjes të tij në interes të këtij gjykimi kushtetues.

B. Për legjitimitetin e kërkuarit

17. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Individidi, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

18. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

19. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që



kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

20. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor penal, për të cilin ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

21. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit, pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit, duke paraqitur përpara tyre, në substancë, pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues. Për rrjedhojë, kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

22. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, Gjykata vëren se shkronja “b” e pikës 1 të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është depozituar në Gjykatë në datën 17.1.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji.

23. Për legjitimitimin *ratione materiae* kërkuesi ka parashtruar se gjatë gjykimit është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se pretendimet janë në juridiksionin e saj dhe në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

24. Kërkuesi ka parashtruar se gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë është cenuar parimi i paanshmërisë, pasi çështja objekt shqyrtimi është gjykuar nga i njëjti gjyqtar sikurse edhe çështja me objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për caktimin e masës ndaluese. I njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë për çështjen me objekt caktimin e masës ndaluese ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë gjyqësore, ndërsa për çështjen e themelit ka vendosur shqyrtimin në dhomën e këshillimit. Ky qëndrim nuk është në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt

ligjor, pasi janë përdorur standarde të ndryshme për pranimin e rekursit.

25. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka parashtruar prapësime në lidhje me këtë pretendim.

26. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 6, datë 29.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar, se: “thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një



ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje” (*shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Ligji procedural penal përcakton rregulla të tilla që bëjnë dallim thelbësor mes fazës së hetimit paraprak dhe fazës së gjykimit. Në fazën e gjykimit, gjykata duhet të marrë vendime pa qenë e ndikuar nga vendimarrja e mëparshme, qoftë edhe kur ato bazohen në dyshime të arsyeshme. Gjykata ka çmuar se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në funksion të këtij parimi të rëndësishëm kushtetues, konkretisht lidhur me papajtueshmërinë për shkak të pjesëmarrjes në procedim, në pikën 2 të nenit 15 të KPP-së parashikohet se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod. Ky detyrim parashikohet edhe nga neni 17, pika 1, shkronja “e”, i KPP-së, sipas të cilit gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuara nga neni 15 i KPP-së. Në këtë drejtim, edhe Gjykata është shprehur se ligji nuk përjashton që gjyqtari, i cili ka shqyrtuar një kërkesë gjatë hetimit paraprak, të shqyrtojë një kërkesë tjetër të të njëjtit lloj ose të një lloji tjetër në të njëjtin procedim, por parimi është që gjyqtari që ka vleftësuar çdo kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, ka papajtueshmëri me gjyqtarin që merr pjesë në gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 18, datë 2.4.2012; nr. 40, datë 22.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata mban në konsideratë gjithashtu jo vetëm pozicionin dhe rolin kushtetues të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih*

vendimet nr. 20, datë 22.9.2022; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 3, datë 6.2.2018, të Gjykatës Kushtetuese), por edhe funksionin që kryejnë kolegjet e saj në seleksionimin e rekurseve që nuk përmbajnë shkaqe të parashikuara nga ligji (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 64, datë 16.10.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, respektimi i parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Lartë vlerësohet në këndvështrim të rrethanave të veçanta të çështjeve konkrete, të lidhura me procesin që zhvillohet në atë gjykatë, si dhe me natyrën dhe kompleksitetin e çështjes.

32. Në rastin konkret, pas regjistrimit të procedimit penal, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për caktimin e masës ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, e cila, me vendimin nr. 54, datë 20.5.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës. Ndaj vendimit ka ushtruar ankim kërkuesi dhe Gjykata e Posaçme e Apelit, me vendimin nr. 15, datë 5.6.2020, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 54, datë 20.5.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, pasi e ka vlerësuar faktin, për të cilin kërkohej caktimi i masës ndaluese, si jo penal. Mbi rekursin e ushtruar nga Prokuroria e Posaçme, çështja për caktimin e masës ndaluese është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.6.2020, ku është caktuar trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët S.S., E.P. dhe I.P. (relator). Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, në datën 18.9.2020 ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes penale.

33. Ndërkohë kërkuesit i është komunikuar akuza duke u marrë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 32, datë 1.12.2020, ndër të tjera, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit, me vendimin nr. 5, datë 8.3.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë. Mbi rekursin e ushtruar nga kërkuesi çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 8.6.2021. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët I.P., A.V. dhe K.K. (relator), me vendimin nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë shkak ligjor të parashikuar nga nenin 432 i KPP-së.



34. Gjykata çmon se në rastin konkret objekt i rekurseve të ushtruara, si në rastin e vlefhtësimit të masës ndaluese, ashtu edhe në shqyrtimin e çështjes për kryerjen e veprës penale, ka qenë vlerësimi i faktit, duke analizuar të njëjtat prova dhe rrethana të çështjes. Të dyja gjykimet, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve, lidhen me shqyrtimin dhe vlerësimin në tërësi të të njëjtit fakt, nëse përbën ose jo veprë penale.

35. Konkretisht, Gjykata vëren se gjyqtari I.P. ka qenë pjesë e trupit gjykues në dy kolegje penale të Gjykatës së Lartë. Në njërin kolegji, në datën 18.9.2020, ka vlerësuar shkaqet e rekursit të ushtruar nga Prokuroria e Posaçme dhe aktet e masës ndaluese duke vendosur kalimin për shqyrtim të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në kolegjin tjetër, në datën 26.10.2021, ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi dhe ka vlerësuar shkaqet e rekursit të ushtruar nga kërkuesi, duke analizuar të njëjtat rrethana dhe të njëjtin fakt, të cilësuar si penal, duke vendosur mbi fajësinë e kërkuesit.

36. Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete, për shkak të natyrës së veçantë të saj, kompleksitetit, pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në dy vendime të dhëna nga kolegjet penale të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar aktet për të njëjtat rrethana dhe duke e dokumentuar këtë vlerësim, krijon dyshime në respektimin e kriterit objektiv të parimit të paanshmërisë. Ndërkohë, objektivisht ka ekzistuar mundësia për shmangien e pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar në të dyja gjykimet, pasi, sikurse rezultoi, çështja gjyqësore penale për themelin është regjistruar rreth një vit pas regjistrimit të çështjes për caktimin e masës ndaluese dhe është shqyrtuar rreth katër muaj përpara çështjes për caktimin e masës së sigurimit.

37. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimet në Gjykatën e Lartë është i bazuar.

C.2. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me dënimin pa ligj

38. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë kontradiktore e jo të ligjshme. Ato kanë bërë një interpretim të zgjeruar duke krijuar një normë të re, krijimi i së cilës është atribut i ligjvënësist. Gjykatat në thelb kanë dhënë një dënim pa ligj, pasi KP-ja nuk parashikon veprën penale të falsifikimit ideologjik dhe “falsifikimi

intelektual” është një shprehje pa asnjë kuptim gjuhësor dhe ligjor, madje nuk e njeh as jurisprudenca shqiptare. Gjykatat kanë interpretuar gabim nenin 186 të KP-së lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale, për të cilën është dënuar kërkuesi.

39. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat kanë trajtuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet, për rrjedhojë pretendimi është i pabazuar. Mospajtimi me arsyetimin e gjykatave, që kanë shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit për çështje që kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit penal, në veçanti të nenit 186 të KP-së, nuk përbën shkak në vetvete që këto pretendime të ngrihen në nivel të juridiksionit kushtetues. Kërkuesi nuk është dënuar për ndonjë veprë penale të paparashikuar në ligj, por për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar në nenin 186, paragrafi i parë, të KP-së.

40. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ky detyrim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 79, datë 14.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata në këtë drejtim ka vlerësuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe çmojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e



kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 27, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Gjykata thekson se në paragrafin e parë të nenin 29 të Kushtetutës parashikohet: “*Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare*”. Ndërsa në nenin 2 të KP-së parashikohet: “*askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë penale që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj*”.

43. Gjykata rithekson se KP-ja përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përmbledhen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Ky Kod përmban jo vetëm parimet kryesore mbi të cilat duhet të mbështetet drejtësia penale, por edhe veprat të cilat konsiderohen si të dënueshme. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një veprë që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Qëllimi i këtij parimi është jo vetëm respektimi i ligjit për çdo rast dhe për çdo veprë penale, por edhe njohja e subjekteve me të gjitha ato veprime apo mosveprime, të cilat konsiderohen të dënueshme. Duke qenë se Kodi Penal, krahas Kushtetutës, është burimi kryesor i së drejtës penale dhe në zbatim të parimit të ligjshmërisë, parashikimi i veprave penale duhet të bëhet pikërisht në këtë Kod, si ligji bazë që parashikon krimet dhe kundërvajtjet penale ose në një ligj të barasvlershëm me të nga fuqia juridike. Një gjë e tillë i vjen në ndihmë shtetasve, të cilët mund të orientohen më mirë në kuadrin e gjerë të ligjeve që mund të parashikojnë vepra penale, me qëllim njohjen e tyre me ndalimet ligjore sipas fushave të ndryshme (*shiko vendimet nr. 50, datë 10.7.2015; nr. 3, datë 5.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në çështjen konkrete, sikurse u parashtrua më sipër, rekursi i paraqitur nga Prokuroria e

Posaçme për vendosjen e masës ndaluese është shqyrtuar në seancë gjyqësore, ndërsa rekursi i paraqitur nga kërkuesi ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për çështjen penale të themelit është shqyrtuar në dhomën e këshillimit. Gjykata konstaton se, nga përmbajtja e vendimit nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021 (çështja e themelit), Kolegji Penal është shprehur se nuk rezulton që kërkuesi të ketë argumentuar nëse nga gjykatat më të ulëta ka pasur zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural apo nëse vendimet e gjykatave më të ulëta bien në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 60 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Por, nga ana tjetër, Kolegji Penal në arsyetim ka vijuar se, pavarësisht kësaj, çmon se duhet t'u kthejë përgjigje disa prej pretendimeve të ngritura në rekurs, duke veçuar ato që meritojnë vëmendje të veçantë (*shih paragrafin 61 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

45. Gjykata vëren se pretendimi kryesor i kërkuesit ka qenë cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të dënimit pa ligj. Për këtë pretendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar: “*Jurisprudenca e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka njohur dhe analizuar metodën e falsifikimit intelektual si një nga mënyrat e kryerjes së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Për falsifikimin intelektual Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2017-581 i Vendimit (111), datë 12.7.2017, shpreh se: “...Falsifikimi intelektual kryhet me anë të krijimit tërësisht të aktit, dokumentit, me anë të të cilit një subjekt fizik apo juridik, publik ose privat, shpreh vullnet, merr përsipër të drejta dhe detyrime, të cilat realisht nuk i ka shprehur...”*...Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve si njëra nga format e kryerjes së përmendur më sipër, mund të bëhet në dy mënyra: ose duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi dokumentin, duke i bërë shtesa a tjetërsime të paligjshme, apo me çdo veprim tjetër material një dokumenti ekzistues të mëparshëm. Në këtë rast, do të ndodhemi përpara falsifikimit “material”; apo në mënyrën tjetër që konsiston në falsifikimin e përmbajtjes së dokumentit, pa prekur formën e tij, duke ndryshuar konceptin dhe brendinë e dokumentit. Në këtë rast, kemi të bëjmë me falsifikim “intelektual” që cenon pjesën përshkruese-dëftuese të dokumentit...”. Rrjedhimisht, pretendimi i të gjykuarit se ai është i dënuar pa ligj nuk qëndron pasi ai nuk gjen mbështetje në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë në praktikën e saj gjyqësore ka pranuar metodën e



falsifikimit intelektual si një nga mënyrat e realizimit të veprës penale të falsifikimit të dokumentit të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal” (shih paragrafët 81 dhe 82 të vendimit nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

46. Nisur nga arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në çështjen konkrete, Gjykata duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin në tërësi të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e në rastin konkret të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me dënimin pa ligj (paragrafi i parë i nenit 29 të Kushtetutës), vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk i plotëson standardet e vendosura për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Arsyetimi i vendimit për pretendimin kryesor të kërkuarit, atë të dënimin pa ligj, nuk rezulton të jetë i qartë dhe i plotë. Kolegji Penal për këtë pretendim është mjaftuar me arsyetimin e mësipërm dhe duke u bazuar në argumente të lidhura me precedentin gjyqësor.

47. Ashtu sikundër u theksua me lart (shih paragrafin 40 të këtij vendimi), detyrimi për arsyetim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë. Ndaj ky vlerësim i Gjykatës për pamjaftueshmërinë e arsyetimit merr më tepër rëndësi, nisur nga natyra e veçantë dhe kompleksiteti i çështjes konkrete. Detyrimi për arsyetim presupozon gjithësesi që një palë në proces mund të presë një përgjigje specifike dhe të shprehur për ato parashtrime që janë përcaktuese për përfundimin e procesit në fjalë, pra pretendimi kryesor për dënimin pa ligj duhet të kishte vëmendje të shtuar nga Kolegji Penal. Gjithashtu, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, duke mos dhënë arsytet për mosshqyrtimin e saj në seancë gjyqësore dhe nuk ka argumentuar për pretendimin thelbësor të kërkuarit, që lidhet me funksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit, ajo shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

48. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me dënimin pa ligj është i bazuar.

49. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tyre, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet t’u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ngritura në rekurs.

50. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit, sipas arsyetimit të mësipërm, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri²⁹,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.9.2022.

Shpallur më 28.10.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Altin Binaj, Sandër Beci

²⁹ Gjyqtarët Altin Binaj dhe Sandër Beci votuan vetëm për cenimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 656 lekë